

NDIKIMI I ZONAVE TË LIRA EKONOMIKE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Agim Derguti

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Fakultetin
Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, me profil Menaxhim, për
marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Engjëll Pere

Numri i fjalëve: 51079

Tiranë, Mars 2017



DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se ky studim është punë origjinale dhe nuk përmban plagjiaturë. Punimi është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

ABSTRAKTI

Zonat ekonomike paraqesin një program të rëndësishëm në realizimin e politikave të një vendi për nxitjen e zhvillimit ekonomik vendas dhe tërheqjen e investitorëve në kërkim të një mjedisi më të favorshëm për të bërë biznes. Zonat ekonomike në mbarë botën janë një instrument i rëndësishëm për nxitjen dhe zhvillimin e ndërmarrësisë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të një komuniteti.

Në këtë drejtim, veçanërisht vendet të cilat gjenden në fazën e tranzicionit, siç është edhe Kosova, angazhohen për komunikim ekonomik në përgjithësi dhe atë tregtar në veçanti, nëpërmjet organizimit të programeve - projekteve të ndryshme, madje edhe me emërtime të ndryshme, por gjithsesi më popullori është ai i zonave të lira ekonomike.

Programi i zonave të lira ekonomike duhet të fokusohet në nxitjen e sektorëve me rëndësi për zhvillimin e integruar ekonomik e ku faktori i produktivitetit njerëzor është më i lartë, me qëllim që të maksimizojë impaktin pozitiv ekonomik në një periudhë afatgjatë.

Ndër sfidat kryesore të shtetit por edhe të vet bizneseve të cilat zhvillojnë aktivitetin në këto organizime janë edhe kostot e larta për themelimin dhe zhvillimin e një zone.

Zonat e lira ekonomike pritet të rrisin konkurrueshmërinë e ekonomisë kosovare në kontekst rajonal, por mbetet një sfidë për autoritetet finalizimi i dizenjimit të tyre në një sistem ligjesh e rregullash që do të krijojnë një mjedis mundësish për të bërë biznes të suksesshëm.

Kompanitë kosovare duhet patjetër të bëhen pjesë e komunitetit të gjerë, të përfshihen në erën e re të virtualizimit të ekonomisë dhe teknologjisë bashkëkohore duke u bërë edhe konkurruese në tregun global.

Ky punim, veç të tjerash ka për qëllim analizimin e mjedisit kosovar në zhvillimin e zonave ekonomike dhe sfidat me të cilat po përballen ato, si dhe uljen e shpenzimeve në këto zona përmes ngritjes dhe zhvillimit të një aplikacioni për integrimin e shpenzimeve të përbashkëta të bizneseve në zona.

Për ti ulur shpenzimet e bizneseve të cilat zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Parkun Industrial në Drenas, kam zhvilluar një aplikacion i cili integron shpenzimet e kontabilitetit, marketingut, IT-së, mirëmbajtjes, sigurimit etj., i cili vlerësoj se mund të shërbej si model edhe për zonat e tjera ekonomike në Kosovë dhe në rajon.

ABSTRACT

Economic Zones represent an important program on the policies of a government for promoting local economic development and attracting investors looking for a more favorable environment to make business. Worldwide, economic zones are an important instrument, to promote and develop entrepreneurship and overall economic development of community.

In this regard, countries that are in transition, such as Kosovo are committed to economic communication in general and commercial in particular, by organizing programs - different projects, even with different designations, however the most popular is the one of free zone. The program of free economic zones should be focused on the promotion of important sectors for the development of integrated economy where human factor productivity is higher, with the aim of maximizing the positive economic impact in a long term period.

Among the main challenges of the government but also to businesses that are engaged in these activities, are also the high costs for the establishment and development of a free economic zone.

Free economic zones are expected to increase the competitiveness of Kosovo's economy in a regional contest, but remains a challenge for the authorities the finalization of their design in a system of laws and rules that will create an environment of opportunity to make the business successful. Kosovo's companies must become part of the broader community, should be involved in the new era of virtualization of economy and modern technology, also becoming competitive in the global market.

The paper, among others, aimed at analyzing the Kosovo environment in the development of economic zones and the challenges they are facing, as well as reducing costs in these zones through establishment and development of an application for the integration of common expenses of business on that zones.

In order to cut costs, businesses that develop their activity in the Industrial Park in Drenas, I have developed an application that integrates cost accounting, marketing, IT, maintenance, insurance etc., which I evaluate it could serve as a model for other areas of Kosovo and the region.

FALENDERIME

Shpreh mirënjohjen time për Universitetin European të Tiranës, Fakultetin Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Menaxhimit, që më krijoi mundësi për kryerjen e këtij studimi. Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësin tim në këtë punim Prof. Dr. Engjëll Pere, për këshillat dhe sugjerimet e vazhdueshme, e mbi të gjitha për mbështetjen morale dhe qetësinë e transmetuar tek unë gjatë gjithë kësaj kohe. Ishte privilegj për mua të punoj me Ju për realizimin e këtij disertacioni. Falënderoj miqtë dhe të njohurit e mi, mirëkuptimi dhe mbështetja e të cilëve më ka dhënë forcën dhe vullnetin për ta përfunduar këtë tezë studimore.

Familja ime meriton një falënderim të veçantë që ka sakrifikuar së bashku me mua, dhe më ka qëndruar pranë gjatë gjithë kësaj periudhe.

Këtë doktoraturë ua dedikoj PRINDËRVE TË MI.

PËRMBAJTJA E TEMËS :

Abstrakti	3
Abstract	5
Përmbajtja e temës	8
Lista e figurave	12
Lista e tabelave	14
Fjalorth mbi disa shkurtime fjalësh të përdorura	15
KAPITULLI I	17
1. HYRJE	17
1.1 Përmbledhje e punimit	17
1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit	24
1.3 Pyetjet e kërkimit shkencor dhe hipotezat	25
1.4 Metodologjia e kërkimit	26
1.5 Rëndësia e studimit	29
1.6 Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme	30
1.7 Struktura e disertacionit	31
KAPITULLI II	34
2. RISHIKIMI I LITERATURËS	34
2.1 Historiku i zonave të lira ekonomike si programe të rëndësishme zhvillimi	34
2.2 Mënyrat dhe baza ligjore për formimin e zonave të lira	39
2.3 Llojet e zonave dhe përpjekja e definimit të drejtë të institutit të ZLE	44

2.4 Koncepti i funksionimit të zonave të lira ekonomike.....	46
2.5 Arsyet e themelimit të zonave të lira.....	48
2.6 Efikasiteti dhe dobishmëria e zonave ekonomike.....	54
2.7 Faktori gjeografik për krijimin e zonave të lira.....	57
2.7.1 Zgjedhja e lokacionit.....	58
2.8 Ndimi i faktorëve ekonomik në zhvillimin e zonave të lira.....	60
2.8.1 Efektet në ekonominë e vendit	62
2.8.2 Ndikimi i zonave të lira në punësim.....	67
2.8.3 Zhvillimi i ZLE-ve faktorë për tërheqjen e investimeve të huaja	70
2.9 Parqet industriale	72
2.9.1 Fazat e zhvillimit të parqeve industriale	77
2.9.2 Madhësia e parqeve industriale	79
2.9.3 Format moderne të parqeve industriale	80
2.9.4 Roli i parqeve industriale në tërheqjen e teknologjive të reja dhe nxitjen e investimeve private në veprimtaritë prodhuese	82
2.9.5 Ndikimi i politikave fiskale në zhvillimin e parqeve industriale	84
2.10 Zonat e lira në Bashkimin Evropian	85
2.11 Praktikat menaxheriale të zonave ekonomike në Rajon	96
2.12 Zhvillimi i zonave të lira në Shqipëri	101
KAPITULLI III	110
3. PARQET DHE ZONAT EKONOMIKE NË KOSOVË	110
3.1 Karakteristikat e parqeve industriale dhe zonave ekonomike në Kosovë	110

3.2 Korniza ligjore për zonat ekonomike në Kosovë	115
3.3 Sfidat në menaxhimin e programeve – projekteve të realizuara në Kosovë	119
3.3.1 Faza e projektimit	121
3.3.2 Faza e implementimit	124
3.3.3 Faza e përdorimit	125
3.4 Efekti pozitiv i zonave të lira në Republikën e Kosovës në këtë fazë tranzicioni	127
3.5 Përceptimi për Kosovën në të bërit biznes – sfidë për investitor potencial në ZE.....	130
3.6 Parku i biznesit në Drenas	133
3.7 Zona industriale në Ferizaj	141
3.8 Parqet dhe zonat tjera në Kosovë	145
3.9 Inkubatorët e biznesit në Kosovë	152
3.10 Zonat ekonomike në Kosovë mundësi për investime nga diaspora	154
3.10.1 Parakushtet për ngritjen e investimeve të diasporës në zona ekonomike ...	159
KAPITULLI IV.....	161
4. METODOLOGJIA	161
4.1 Hyrje	161
4.2 Përshkrimi i fazave të kërkimit	163
4.3 Metodologjia e përdorur dhe analiza e të dhënave	164
4.4 Përzgjedhja e kampionit	166
4.5 Zgjedhja e mostrës	168
4.6 Mënyra e përpunimit dhe prezantimit të të dhënave	170
4.7 Kufizimet	171

4.8 Analiza e të dhënave dhe interpretimi i tyre	172
KAPITULLI V	183
5. INTEGRIMI I SHPENZIMEVE NË PARKUN INDUSTRIAL	
TË DRENASIT - MODEL PËR ZONAT DHE PARQET TJERA	185
5.1 Menaxhimi i shpenzimeve	185
5.2 Arsyet e digjitalizimit të shpenzimeve në parkun industrial në Drenas	188
5.3 Përshkrimi i përgjithshëm i aplikacionit	192
5.4 Modulet e aplikacionit	194
5.5 Procesi i regjistrimit të bizneseve në aplikacionin për uljen e shpenzimeve	195
5.6 Përdoruesit e aplikacionit	199
5.7 Funksionet e sekretarisë dhe financave	200
5.8 Përfitimet nga aplikacioni për integrimin e shpenzimeve të përbashkëta	203
5.9 Administrimi i aplikacionit për integrimin e shpenzimeve	207
5.10 Siguria dhe arkivimi i të dhënave – komponente të rëndësishme të aplikacionit	209
5.11 Krahasimet në shpenzimet jo të integruara dhe të integruara	209
KAPITULLI VI	217
6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	217
6.1 Përfundimet	217
6.2 Konkluzionet	219
6.3 Rekomandimet	222
LITERATURA.....	226
Shtojca	240

LISTA E FIGURAVE:

Figura 1: Harta e zonave të lira ekonomike në Europë	57
Figura 2: Pozicioni i tre parqeve industriale: Koplik, Spitalë dhe Vlorë	106
Figura 3: Parku industrial në Lezhë	108
Figura 4: Harta e zonave ekonomike në Kosovë	113
Figura 5: Përfaqësimi regional i ZE në Kosovë	114
Figura 6: Parku i biznesit në Drenas	134
Figura 7: Pozita e parkut në zonën industriale në Korroticë, Komuna Drenas	135
Figura 8: Numri i bizneseve në parkun e Drenasit nga viti 2010 – 2015.....	136
Figura 9: Investimet e realizuara në parkun e Drenasit 2005-2015	140
Figura 10: Zona ekonomike në Ferizaj	142
Figura 11: Numri i të punësuarve 2006 - 2013 në ZE Ferizaj	144
Figura 12: Parku i biznesit në Mitrovicë	145
Figura 13: Parku industria “Zinkunie” në Prizren.....	146
Figura 14: Zona në raport me vendbanimin	148
Figura 15: Zona industriale në Shirokë – Suharekë	150
Figura 16: Parku teknologjik në Shtime	151
Figura 17: Parku teknologjik në Skenderaj	151
Figura 18: Parku i biznesit në Vushtrri	152
Figura 19: Remitancat sipas viteve në Kosovë (në milion €)	157
Figura 20: Profesionet (kategoria) e të anketuarve	167
Figura 21: Ndikueshmëria e zonave ekonomike në punësim	174
Figura 22: Ndikueshmëria e ZE në zhvillimin ekonomik lokal	175

Figura 23: Performanca e zonave ekonomike	176
Figura 24: Përgjigjet e të anketuarve për rritjen e numrit të ZE	176
Figura 25: Disa komponentë të rëndësishëm për ZE në Kosovë	177
Figura 26: Llojet e ZE për të cilat ka nevojë Kosova	178
Figura 27: Angazhimi i institucioneve përkatëse në mbështetjen e ZE	178
Figura 28: Opinionet në lidhje me politikat fiskale	179
Figura 29: Kuadri ligjor lidhur me zonat ekonomike	181
Figura 30: Opinionet në lidhje me politikat kreditore	182
Figura 31: Kënaqshmëria me lokacionin e zgjedhur	182
Figura 32: Përbushja e objektivave në parkun e Drenasit	183
Figura 33: Pranueshmëria për integrimin e shpenzimeve	189
Figura 34: Shpenzimet të cilat më së lehti do të integroreshin	192
Figura 35: Çasja në aplikacionin për integrimin e shpenzimeve	193
Figura 36: Modulet e aplikacionit	194
Figura 37: Regjistrimi i bizneseve	196
Figura 38: Lista e bizneseve të regjistruara.....	198
Figura 39: Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve	202
Figura 40: Përfitimet kryesore nga aplikacioni për integrimin e shpenzimeve	204
Figura 41: Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve për biznese	208
Figura 42: Grafiku i ndryshimit midis shpenzimeve të integruara dhe të pa integruara....	213
Figura 43: Përqindja e uljes së shpenzimeve	214
Figura 44: Ndikimi i aplikacionit në uljen e shpenzimeve	215
Figura 45: Shpenzimet e integruara dhe jo të integruara për pesë biznese	216

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1: Tipet e zonave të lira	46
Tabela 2: Formalitetet doganore në zonat e lira në BE	91
Tabela 3: Projektet e parqeve industriale në Shqipëri	103
Tabela 4: Numri i kompanive aktive në periudhën 2005-2012	108
Tabela 5: Sipërfaqja e parqeve/zonave në Kosovë	115
Tabela 6: Dallimet në fazat e realizimit të projekteve në Kosovë dhe vendet e zhvilluara	126
Tabela 7: Ndërmarrjet në parkun e Drenasit dhe veprimtaria e tyre.....	137
Tabela 8: Ndërmarrjet, fillimi i aktivitetit, veprimtaria e tyre dhe numri i punëtorëve në ZE në Ferizaj	143
Tabela 9: Grupmosha e të anketuarëve	168
Tabela 10: Shpenzimet jo të integruara për të gjitha bizneset në zonë	210
Tabela 11: Shpenzimet e integruara për të gjitha bizneset në zonë	211
Tabela 12: Totali i shpenzimeve mujore të integruara dhe jo të integruara	213

Fjalorth mbi disa shkurtesa të përdorura

AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
AMNVM	Agjensioni për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi European
CPM	Critical Path Method
CEU	Unioni Doganor European
EPZs	Zonat e Eksportit dhe Përpunimit
ETDZs	Zonat e zhvillimit ekonomik dhe teknologjik
FC	Free Citizen
FPs	Free Parks
FTU	Free Trade Union
FTZ	Free Trade Zone
IB	Inkubatori i Biznesit
ICC	International Chamber of Commerce
IHD	Investimet e huaja direkte
KE	Këshilli i Europës
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MISHZE	Menaxhimi i integruar i shpenzimeve ne Zona Ekonomike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

NMVM	Ndërmarrjet Mikro të Vogla dhe të Mesme
OBD	Organizata Botërore e Doganës
PERT	Program Evaluation and Review Technique
PM	Project Management
PMI	Project Management Institute
SEZ	Special Economic Zone
TEDA	Technical and Economic Development Areas
UE	Unioni European
UNIDO	United Nations Industrial Development Organization
WEPZA	World Export Processing Zone Association
ZES	Zonat Ekonomike Speciale
ZE	Zona Ekonomike
ZLE	Zona e lirë ekonomike

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Përmbledhje e punimit

Duke parë avantazhet e grupimit të bizneseve në një territor të caktuar, shtetet e ndryshme në mbarë botën, varësisht prej specifikave të vendit, në formë ligjore kanë krijuar zonat e lira ekonomike, parqet industriale, parqet teknologjike, parqet e biznesit etj., si instrumente të zhvillimit ekonomik lokal, kombëtar, rajonal e ndërkombëtar. Një numër i madh i vendeve kanë krijuar zonat e lira ekonomike (ZLE), me qëllim të tërheqjes së investimeve të huaja, krijimin e mundësive të punësimit dhe nxitjen e eksporteve. Arsyetimet kryesore teorike për krijimin e zonave të lira ekonomike në përgjithësi pohojnë se ekzistojnë ekonomitë e shkallës në zhvillimin e vendit dhe në ofrimin e shërbimeve të përbashkëta, si dhe grupimi i industrive të ngjashme. Programet qeveritare që kanë për qëllim zhvillimin ekonomik duhet dizajnuar në atë mënyrë që të mbështesin aktivitetin e sektorit privat. Në studimin tonë do të trajtojmë programet me organizime dhe emërtime të ndryshme si: zona ekonomike, parqe ekonomike, inkubator i biznesit etj. të cilat, sidomos në shtetet në tranzicion, nuk janë definuar saktësisht prandaj ka aq shumë diversitete në emërtimet e tyre. Përvojat e vendeve në tranzicion kanë treguar se disa lloje të zonave ekonomike nuk kanë qenë instrument efikas i politikave zhvillimore. Disa nga problemet e shpërfaqura të cilat kanë dominuar janë:

- Situata e paqëndrueshme politike dhe rregullat ligjore lidhur me zonën, duke çuar në një nivel të ulët të investimeve, korrupsion dhe shpërdorim të privilegjit për qëllime

të pastrimit të parave. Në disa vende të rajonit, disa dispozita që rregullojnë zonën, përcaktohen në mënyrë të paqartë. Prandaj, disa kompani kanë pasur probleme me autoritetet tatimore, të cilët kanë miratuar një qasje shumë agresive në monitorimin e përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave;

- Problemet me lokacionin (infrastruktura nuk ka qenë në nivelin e duhur, burimet natyrore dhe njerëzore janë të vogla, tregu është shumë i vogël), dhe këto zona janë bërë jotërheqëse për investitorët;
- Madhësia e zonës nuk është e përcaktuar mirë. Zonat e mëdha kërkojnë një investim të madh fillestar për zhvillimin e infrastrukturës. Përveç kësaj, menaxhimi efektiv i këtyre zonave mund të jetë një sfidë e madhe, sidomos për vendet që nuk kanë pasur përvojë të mjaftueshme në menaxhimin e tyre, siç është edhe rasti i Kosovës dhe i disa vendeve të regjionit;
- Zonat janë bërë një pengesë serioze për disa vende në negociatat e tyre me BE-në. Për të harmonizuar ligjet kombëtare me ligjet e vendeve të BE-së, disa vende në tranzicion kanë ndryshuar legjislacionin që ka të bëjë me zonat. Për më tepër, për shkak të ligjeve anti-diskriminuese të BE-së, këto vende nuk mund të ofrojnë stimuj për investime.

Të gjitha shtetet, e këtu nuk bën përjashtim edhe Kosova, konceptualisht themelojnë zona ekonomike për të realizuar disa objektiva:

- Me përdorimin dhe operimin e zonave të lira do të mund të realizohet ristrukturimi dhe zhvillimi i shpejtë i ekonomisë kombëtare, si dhe projekteve të veçanta ekonomike, pa investime të konsiderueshme të shtetit.

- Zonat e lira e rrisin nivelin e efikasitetit të bizneseve nacionale ekonomike, ndërmarrjeve për menaxhimin e zonave dhe ndërmarrjeve shfrytëzuese të zonës.
- Zonat e lira mund të jenë një lloj i laboratorëve ekonomik dhe vend për testimin e masave ekonomike të shtetit të parapara për tërheqjen e kapitalit të huaj.

Ndonëse studimi i zonave ekonomike ka filluar shumë kohë më parë, ende nuk ka një definim përfundimtar se çfarë në të vërtetë paraqesin këto organizime. Janë dhënë përkufizime të ndryshme në lidhje me zonat ekonomike, por definimi më i pranueshëm është ai që e konsideron zonën ekonomike si një hapësirë e madhe toke, e ndarë në parcela dhe e destinuar për përdorim të njëkohshëm nga disa ndërmarrje, që karakterizohen nga përdorimi i përbashkët i infrastrukturës dhe afërsia e vendndodhjes së firmave me njëra-tjetrën dhe nga lehtësia sa i përket afrimit dhe qarkullimit. Përfitimet themelore të zonave ekonomike nxjerrin rolin e tyre si instrumente të tregtisë dhe politikës së investimeve (Farole, 2011, Akici, 2013).

Një varietet përfitimesh identifikohen si rezultat i funksionalizimit të zonave ekonomike. Përfitimet e përgjithshme të cilat aplikohen si për standardin teknologjik ashtu dhe atë profesional, përfshijnë edhe inkurajimin e inovacionit, teknologjisë, garantimin e tregjeve, konkurrencën më të pastër, etj.

ZLE janë përdorur për të stimuluar investimet private dhe zhvillimin ekonomik përmes politikave qeveritare preferenciale, për të krijuar një ambient më të favorshëm që promovon investimet dhe eksportet. Funksionalizmi i zonave të lira ekonomike dhe menaxhimi në formën e duhur ndikon në procesin e sensibilizimit për të rritur investimet edhe nga diaspora në nivelin e investimeve të huaja direkte. Prandaj në të ardhmen duhen kërkuar

lehtësime për investorët në të gjithë spektrin, gjithashtu duhet një angazhim në kërkim të masave për të rritur ndjeshmërinë dhe reagimin ndaj investorëve potencial.

Shoqëria kosovare ngadalë po kalon fazën e tranzicionit dhe të ndryshimeve të gjithëanshme strukturore. Kosova renditet në mesin e vendeve që gjatë historisë së saj ka kaluar nëpër një transformim dinamik politik, ekonomik, legjislativ, etj. (Krasniqi, 2016). Me këtë rast duhet të nisemi nga fakti se jemi në kohën e ndryshimeve globale, të cilat i kanë përfshirë të gjitha vendet ballkanike. Këto ndryshime si procese, kanë sjellë dinamikë të re dhe rrjedhimisht kërkojnë politikë shtetërore të zhvillimit ekonomik, strategji dhe forma të reja të menaxhimit që do të jenë më konkurrense dhe më të avancuara.

Në rrethana bashkëkohore komunikimi ndërkombëtarë ekonomik në përgjithësi dhe ai tregtar në veçanti është shumë domethënës. Pikërisht për këtë arsye, të gjitha vendet sot angazhohen për kërkimin dhe gjetjen e formave më të levërdishme të afarizmit ekonomik në kuadër të menaxhimit të programeve apo projekteve. Në këtë drejtim, veçanërisht vendet të cilat gjenden në fazën e tranzicionit, siç është edhe Kosova, angazhohen për komunikim ekonomik në përgjithësi dhe atë tregtar në veçanti, përmes organizimit të programeve - projekteve të ndryshme, madje edhe me emërtime të ndryshme, por gjithsesi më popullori është ai i parqeve apo zonave të lira ekonomike.

Arsyeshmëria e zhvillimit ekonomik dhe promovimi i Republikës së Kosovës si treg dhe zonë e ekonomisë së lirë, qëndron në faktin se është prioritet rritja ekonomike, duke tërhequr investimet e jashtme direkte, si dhe angazhimin e kapitalit të jashtëm, përmes programeve prodhuese brenda zonave të lira. Kjo për faktin se angazhimi i kapitalit të jashtëm si investim direkt apo si investim në programet prodhuese, shërbyese apo përpunuese, duke shfrytëzuar infrastrukturën e zonave të lira ekonomike dhe favoret ligjore

nga politikat fiskale, do të jetë shumë domethënëse për zhvillimin ekonomik të vendit. Në të njëjtën kohë, infrastruktura e përgatitur ligjore për zonat e lira ekonomike dhe baza ligjore me të cilën caktohen favoret nga politika fiskale, paraqesin inkurajim, që partnerët e jashtëm ekonomik të vijnë me aktivitetet e tyre prodhuese dhe përpunuese në tregun e Kosovës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se për partnerët ekonomik të jashtëm, është shumë domethënëse pozita gjeostrategjike e Kosovës. Kjo për faktin se vendi ynë gjendet në mesin e Ballkanit dhe ka të konsoliduar infrastrukturën rrugore që lidhet me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Përveq kësaj, në Kosovë aktualisht është shkallë e lartë e papunësisë dhe rrjedhimisht si rezultat i kësaj, fuqia punëtore është shumë e lirë. Kësisoj mund të konkludohet se ekzistojnë parakushtet për angazhimin e kapitalit të jashtëm duke shfrytëzuar fuqinë punëtore të vendit, në forma të ndryshme të aktivitetit ekonomik brenda zonave të lira ekonomike, të cilat në të ardhmen do të jenë instrument i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik.

Kosova i ka hapur rrugën zhvillimit të zonave ekonomike me miratimin e ligjit nr. 04/l-159 për zonat ekonomike, të cilat vlerësohen si instrumente të zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal. Duke ditur historinë e suksesit të parqeve industriale në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, në përputhje me tendencat e fundit, Kosova është një vend që ka hedhur hapat e parë në krijimin e infrastrukturës ligjore, por njëkohësisht është përballur me vështirësi për të përmbushur nevojat që ndjejnë parqet industriale për të përmbushur objektivat e tyre. Përqendrimi i llojeve të caktuara të kompanive, gjithmonë ka tërhequr investitorët dhe ka lehtësuar zhvillimin e grupimeve me qëllim të shfrytëzimit të hapësirave të përbashkëta, shfrytëzimit të infrastrukturës moderne, bashkëpunimin e bizneseve etj.

Roli i zonave ekonomike është vlerësuar edhe si nxitës i zhvillimit të sektorit privat që rezulton në krijimin e ndërmarrjeve konkurruese, në të cilat punëtorët gjithashtu marrin edhe aftësitë që i ndihmojnë ata të përgatiten për kërkesat vazhdimisht në ndryshim të ekonomisë globale.

Zonat ekonomike në Kosovë, rajon dhe në botë kanë emërtime të ndryshme varësisht prej veprimtarisë që kryhet brenda zonës dhe ato janë të emërtuara si: zonë e lirë ekonomike, park i biznesit, park teknologjik, zonë industriale, zonë ekonomike speciale etj. Në disa qytete të Kosovës janë zhvilluar disa zona të emërtuara si: zona ekonomike, parqe të biznesit, parqe teknologjike apo parqe industriale.

Kosova ka propozuar një model për formimin e zonave, i bazuar në karakteristikat më të mira të parqeve industriale dhe zonave të lira. Ky model, konform ligjeve në fuqi mundëson shfrytëzimin e hapësirës së caktuar e pajisur me infrastrukturë të nevojshme për tërheqjen e të gjitha llojeve të investimeve të destinuara për instalimin e prodhimtarisë, si për tregun vendas ashtu edhe për eksport. Kështu, është përzgjedhur një model fleksibël i cili i plotëson nevojat e ndryshme të investitorëve potencial, të cilët mund të shfrytëzojnë përfitimet e ndryshme që sjellin zonat ekonomike. Me një sërë masash të qeverisë për të tërhequr investime, modeli i propozuar i "Zonave të Lira" kombinon të mirat e dhëna të legjislacionit shtetëror (Ligji për zonat e lira) bashkë me kompetencat e caktuara të komunave dhe përfituesëve të të cilëve me një proces garues u ndahen sipërfaqet e caktuara. Në këtë punim dëshmohet se Kosova duhet të drejtojë zhvillimin e zonave të lira në drejtim të principeve të cilat vlejnë për zonat e lira në BE. Standardet themelore të aktiviteteve në zona si importi dhe eksporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve nga/në zonë, janë të njëjta në të gjitha zonat në botë, qofshin ato të organizuara si tregtare apo prodhuese, qofshin të

vendosura në Bashkimin Evropian apo në ndonjë shtet tjetër jashtë BE-së. Në këtë epokë të globalizimit, promovimi i eksportit është parë si një politikë e rëndësishme për rritjen ekonomike në vendet në zhvillim (Aggarwal, 2005).

Zonat ekonomike janë konsideruar instrument i rëndësishëm për promovimin e bizneseve dhe kanë një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik. Rezultatet e deritanishme sugjerojnë se ndërtimi i një zone ekonomike në mungesë të infrastrukturës ndihmëse apo avantazhit që ka përzgjedhja e lokacionit nuk ofron gjasa të larta për arritjen e suksesit të synuar. Shpjegimet e suksesit apo dështimit të zonave ekonomike shpesh kanë të bëjnë me cilësinë e infrastrukturës, vendndodhjes dhe madhësinë e zonës (Farole dhe Akinci, 2011).

Vendndodhja, zhvillimi dhe funksionimi i zonave ekonomike është bërë subjekt i trajtimit nga legjislacioni shtetëror dhe i vendimeve administrative vendore.

Sfidë më vete, sidomos në Kosovë, duke pasur parasysh mungesën e mjeteve të xhiros, pastaj politikat kreditore dhe fiskale jo të favorshme, mungesën e përvojës së mjaftueshme në aktivitete të tilla dhe shumë faktorë të tjerë, është edhe ulja e shpenzimeve dhe profesionalizimi i shërbimeve në zona ekonomike. Në këtë drejtim, jam përpjekur që të zhvilloj një aplikacion i cili për zonat ekonomike në Kosovë do të kishte rëndësi të veçantë.

Qëllimi i këtij aplikacioni veç të tjerash është që:

1. Të ulë shpenzimet
2. Të profesionalizoj shërbimet

Zonat ekonomike në Kosove sot të ndara (fragmentuara) paguajnë:

- Shpenzimet e kontabilitetit;
- Shpenzimet e IT-së;
- Shpenzimet e mirëmbajtjes;

- Shpenzimet e sigurisë;
- Shpenzimet e marketingut etj.

Integrimi i shpenzimeve i cili është testuar në parkun industrial në Drenas vlerësoj se do të sjell përfitime për 41 bizneset të cilat aktualisht veprojnë në këtë park dhe gjithashtu mund të shërbej si model referimi për zonat e tjera të themeluara dhe për ato të cilat mund të zhvillohen në vitet në vijim në Republikën e Kosovës.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi kryesor i studimit është që të masë ndikimin e zonave të lira ekonomike në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës dhe të tregohen mënyrat për të rritur efektivitetin e zonave ekonomike. Punimi kërkon të analizoj efektin që kanë zonat ekonomike në Kosovë për të krijuar ambient të përshtatshëm për biznes, tërheqje të investimeve, futjen e teknologjive dhe risive të reja, rritje të aftësive ndërmarrëse dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Objektivat e studimit konsistojnë në konfirmimin e mundësive të cilat janë të bazuara në ndikimin pozitiv socio-ekonomik që kanë zonat ekonomike, krijimin e mundësive për zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe për tërheqjen e investimeve të huaja.

Objektivat e këtij disertacioni janë që të paraqes domosdoshmërin dhe dobishmërin e efekteve dhe rezultateve pozitive që sjellin ZE si:

- Promovimi i investimeve vendase dhe të huaja;
- Krijimi i ndërmarrjeve konkurruese në bazë të teknologjive moderne dhe inovative;

- Kryerja e veprimtarive ekonomike sipas mundësive të zhvillimit specifik për zonën përkatëse, duke përfshirë përdorimin më efikas të pronës publike;
- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Krijimi i vendeve të reja të punës brenda zonave;
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, për të rritur cilësinë e shërbimeve.

Menaxhimi i efikasitetit të kostove do të jetë një segment me rëndësi në studimin tim. Në këtë drejtim, kam zhvilluar një aplikacioni i cili do të integroj shpenzimet e përbashkëta të bizneseve në zona/parqe si: shpenzimet e kontabilitet, IT-së, sigurimit, mirëmbajtjes, marketingut etj., i cili mund të jetë model edhe për zona apo parqe të tjera, jo vetëm në Kosovë.

Vlerësoj se studimi im do të jetë një kontribut modest në përmirësimin e performancës së zonave ekonomike, sidomos në uljen e shpenzimeve dhe përofesionalizimin e shërbimeve.

1.3 Pyetjet e kërkimit shkencor dhe hipotezat

Qëllimi kryesor në studimin tim do të jetë shqyrtimi dhe analiza e faktorëve të cilët ndikojnë në rritjen e efikasitetit të zonave ekonomike. Menaxhimi i shpenzimeve në zona ekonomike gjithashtu do të jetë një segment bosht në studimin tim.

Dy nga çështjet që i kam ngritur si pyetje kërkimore e të cilave do t'iu jap përgjigje janë:

- Cili është efektiviteti i zonave ekonomike në Kosovë?
- A mund të përdoret teknologjia e informacionit në rritjen e efikasitetit dhe uljen e shpenzimeve të përbashkëta të bizneseve në zonat ekonomike (shpenzimet e kontabilitetit, IT-së, mirëmbajtjes, sigurimit, marketingut etj.)?

Në funksion të pyetjeve të ngritura më sipër, kemi ngritur dy hipoteza kryesore:

Hipoteza 1: Zonat ekonomike në Kosovë kanë krijuar mundësinë direkte për të rritur investimet e huaja, futjen e teknologjive të reja dhe hapjen e vendeve të reja të punës, por që kjo mundësi nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm.

Hipoteza 2: Aplikacioni i zhvilluar për integrimin e shpenzimeve do të ndikojë në uljen e kostos së shpenzimeve të bizneseve në zona ekonomike.

Hipotezat e mia do të bazohen edhe në parqet industriale apo zonat aktuale industriale në Kosovë, si ajo në Drenas, Ferizaj, Shtime, Suharekë , Prizren etj., të cilat edhe përkundër pompozitetit të madh nuk kanë treguar performancë të nivelit të dëshiruar.

Për ta trajtuar sa më mirë këtë temë do të analizoj edhe çështje të tjera të cilat vlerësoj se kanë interferime në punimin tim shkencor si:

- Çfarë zonash ekonomike duhen sot dhe në cilat nivele është zhvillimi i tyre?
- A mund të përdoren zonat si një avantazh konkurrues për zhvillim ekonomik dhe tërheqje të investimeve?
- A dallon mjedisi kosovar nga mjedisi i vendeve të regjionit sa i përket sfidave të zhvillimit të zonave ekonomike?
- A janë koherente ZE në Kosovë me ato të regjionit dhe BE-së?

1.4 Metodologjia e kërkimit

Për përgatitjen e këtij punimi është dashur kohë e gjatë pasi që kam analizuar literaturë apo materiale studimore të shumta në lidhje me zonat e lira ekonomike. Nga një numër i madh i

punimeve teorike dhe empirike që kanë trajtuar zonat ekonomike ende nuk ka pikëpamje përgjithësisht të pranuar në favor, ose kundër ZE.

Metodologjia e punimit është hartuar nëpërmjet metodave të ndryshme me qëllim vërtetimin e hipotezave kërkimore të ngritura. Metodologjia e punës kërkimore është bazuar në përdorimin e metodave cilësore dhe sasiore në funksion të temës dhe strukturës së parashtruar të punimit, gjithnjë me qëllim të evidentimit të situatës aktuale dhe dhënies së rekomandimeve sa më përmbajtësore. Studimi im, për shkak të specifikave të tij, është zhvilluar në formën e një kërkimi metodash të kombinuara. Metodën që spikasim janë metodat analitike dhe krahasimore. Këto metoda i janë përshtatur arritjes së qëllimeve të këtij punimi doktoral. Metodën e hulumtimit shkencor të përdorur janë shfrytëzuar në varësi të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura në këtë punim.

Me metodën analitike kam analizuar në mënyrë të detajuar literaturën lidhur me zonat ekonomike, pastaj legjislacionin në nivel kombëtar, regjional dhe në kuadër të BE-së i cili trajton këtë fushë. Po ashtu janë analizuar zonat në disa shtete të regjionit, lehtësirat dhe përfitimet që sjellin ato për ekonominë vendore, si dhe zonat ekonomike në disa shtete të BE-së. Të gjitha këto më kanë ndihmuar në nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Metoda krahasimore trajton faktorë të rëndësishëm të zonave ekonomike, si futjen e teknologjive të reja, rritjen e efikasitetit, uljen e papunësisë, etj. në nivel krahasimor brenda zonave të një vendi apo regjioni dhe krahasimin tjetër, në ndikimin e uljes së shpenzimeve përmes teknologjisë së informacionit.

Kampioni ishte përfaqësues në këndvështrimin e pozicioneve që kishin të anketuarit brenda institucioneve (shefa të sektorëve, drejtorë, zyrtarë të lartë etj.). Në përzgjedhje jam përpjekur të bëjë një ndarje paraprake në pesë kategori: zonë ekonomike, park industrial,

institucion qendror, institucion lokal dhe aleancë e bizneseve, me qëllim që përfshirja të jetë sa më reprezentative. Gjatë hulumtimit tim në caktimin e mostrës kam përdorur disa kritere: kriteri i gjinisë, vendbanimit dhe profesionit, ndërsa grupmoshat ishin të ndara në pesë nëngrupe duke filluar nga mosha “më e vogël se njëzet” e deri te ajo “më e madhe se pesëdhjetë vjet”. Në fillim të punimit, kam prezantuar njohuri mbi zonat ekonomike dhe avantazhet që sjellin ato në zhvillimin ekonomik, në futjen e teknologjive të reja, në punësim etj. Duke parë nga afër gjithë aktivitetin e tyre kam ndërtuar një bazë të të dhënave që më vonë e kam zhvilluar në një softuer për integrimin e shpenzimeve të bizneseve në zonë. Për të studiuar zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë dhe ndikimin e aplikacionit të zhvilluar i cili do të përmirësonte eficiencën dhe do të ulte shpenzimet në zona ekonomike, kam realizuar një pyetësor dhe kam zhvilluar intervista të strukturuar me protagonistë për të cilët kam menduar se mund të japin kontributin e tyre në trajtimin e kësaj teme. Ministria për Tregti dhe Industri, departamentet-sektorët të cilët trajtojnë këtë fushë tematike, gjithashtu kanë qenë adresa ime e referimit.

Për mbledhjen e të dhënave kam kombinuar disa teknika të formateve të ndryshme. Në punim janë prezantuar 24 pyetje të parashtruara të cilat u janë shpërndarë 56 të anketuarve. Vëmendje i kam kushtuar edhe diversitetit të të anketuarve, duke pasur parasysh moshën, profesionin, përgatitjen profesionale etj. Përgjigjet e pranuar nga pyetësi kanë identifikuar disa nga sfidat me të cilat përballen bizneset gjatë aktiviteteve të tyre në këto zona ekonomike dhe mund të shërbejnë për kërkime në formën e procedurave të matjes periodike (vjetore) të disa indikatorëve. Vetëm mënyra apo trajtimi real i tyre siguron bazën për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.

Në fund, për të studiuar më thellë raportin zonë ekonomike-zhvillim-punësim-teknologji të reja, kam prezantuar rezultate ose tregues në lidhje me ndikimin e teknologjisë së informacionit në uljen e shpenzimeve në zona ekonomike.

Hulumtimi i paraqitur dhe rezultatet e tjera krahasuese tregojnë se Kosova ende nuk ka arritur nivel zhvillimi të zonave/parqeve, krahasuar me shtetet e BE-së. Këto rezultate duhet të jenë një sinjal për hartuesit e politikave në përcaktimin më tej të prioritetëve dhe aktiviteteve në mënyrë që Kosova mund t'ju përgjigjet sfidave të zhvillimit.

1.5 Rëndësia e studimit

Kontributi i studimit do të paraqitet nëpërmjet:

- Paraqitjes së literaturës, studimeve dhe kërkimeve të realizuara, pasi që në Kosovë ka fare pak studime në lidhje me këtë instrument të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik;
- Mundëson vendosjen e bazave krahasuese për studime të mëtejshme;
- Ndhmon institucionet dhe përfituesit në identifikimin e avantazheve që kanë zonat/parqet ekonomike.

Rëndësia e këtij studimi mendoj se është e madhe sepse në radhë të parë u vjen në ndihmë institucioneve, por edhe menaxherëve të cilët aktualisht zhvillojnë veprimtari ekonomike në zona dhe atyre që pretendojnë të zhvillojnë aktivitete në të ardhmen. Gjithashtu në këtë punim bëhet një studim i thelluar i zonave dhe parqeve ekonomike gjë që nuk është bërë më parë nga autorë të tjerë.

1.6 Arsyeja e zgjedhjes së kësaj teme

Për përzgjedhjen e kësaj teme, veç të tjerash, jam motivuar nga përvoja ime menaxheriale në Republikën e Kosovës që nga viti 2000 në sektorin publik dhe privat. Përkundër përmirësimeve të ngadalshme në vitet e fundit, raportet monitoruese të institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si: Ministria e Planifikimit Hapësinor, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Fakulteti Teknik, Banka Botërore, USAID, Agjencioni Evropian, institute të ndryshme shkencore dhe profesionale etj., japin vërejtje të shumta në menaxhimin e projekteve – programeve investive siç janë zonat ekonomike.

Arsyet e ndërmarrjes së këtij studimi janë:

- Hulumtimi i problemeve që lidhen me zhvillimin e zonave ekonomike si programe të rëndësishme zhvillimi;
- Identifikimi i praktikave aktuale të funksionimit të organizimeve të tilla;
- Identifikimi i mundësive për uljen e kostos së shpenzimeve brenda këtyre programeve-zonave ekonomike;
- Krahasimi i praktikave të aplikuara në zonat ekonomike në Kosovë me praktikat më të mira të menaxhimit nga vendet në rajon, por edhe më gjerë.

Ky punim vlerësoj se do të jetë si pikënisje e studimit për të analizuar faktorë të shumtë të cilët mund të jenë indikator suksesi për studimet e mëtejshme lidhur me zonat ekonomike për të cilat në Kosovë ka fare pak studime.

1.7 Struktura e disertacionit

Kapitulli 1: Kapitulli i parë trajton në mënyrë të shkurtër ndikimin e zonave ekonomike në zhvillimin ekonomik dhe futjen e teknologjive të reja, inkurajimin e investitorëve dhe përmirësimin e rrethinës biznesore në përgjithësi. Pastaj vazhdohet me qëllimin dhe objektivat e këtij studimi, duke treguar dhe objektivin kryesor, i cili fokusohet në rëndësinë që kanë zonat/parqet ekonomike. Për të arritur këtë qëllim janë ngritur dy pyetje bazike kërkimore dhe dy hipoteza, të cilat na kanë orientuar gjatë gjithë këtij studimi. Temat që vijnë kanë të bëjnë me shpjegimin e termave kyçe të punimit si; qëllimi i studimit, metodologjia, arsyeshmëria e zgjedhjes së kësaj teme etj.

Kapitulli 2: Ky kapitull prezanton studimin e literaturës në lidhje me zonat dhe parqet ekonomike duke filluar nga programet – projektet zhvillimore; historikun e zhvillimit të zonave, ndarjen e tyre, arsyet e themelimit për të vazhduar me ndikimin ekonomik që kanë ato. Më tutje janë trajtuar edhe përfitimet ekonomike që sjellin zonat në zhvillimin ekonomik siç janë punësimi, futja e teknologjive të reja, inkurajimi i investimeve, etj. Pjesa e dytë e këtij kapitulli prezanton ecurinë e zhvillimit të zonave ekonomike në Evropë dhe rajon, ku jam përpjekur që të zgjedh disa modele më pozitive të këtyre zonave të cilat mund të shërbenin edhe si modele për Kosovën. Në fund të këtij kapitulli kam prezantuar edhe ecurinë e zhvillimit të zonave në shtete të rajonit, si në Shqipëri, Maqedoni, Kroaci etj., dhe sfidat me të cilat përballen ato.

Kapitulli 3: Kapitulli i tretë trajton zonat dhe parqet ekonomike në Kosovë të cilat kryesisht janë zhvilluar në dekadën e fundit. Vëmendje më e madhe i është kushtuar parkut industrial

në Drenas, por janë trajtuar edhe zonat e tjera si edhe sfidat me të cilat ballafaqohen ato në këtë fazë tranzicioni.

Kapitulli 4: Ky kapitull përshkruan metodologjinë e përdorur në realizimin e këtij studimi duke filluar nga përzgjedhja e kampionit, zgjedhja e mostrës, mënyra e përpunimit dhe prezantimit të të dhënave, kufizimet që kam pasur në metodologjinë e punimit e deri te analiza e të dhënave – interpretimi i tyre. Ky kapitull gjithashtu përmbanë edhe disa nga rezultatet e hulumtimit tim lidhur me zonat ekonomike.

Kapitulli 5: Ulja e shpenzimeve në zona ekonomike është tema bosht e këtij kapitulli. Kam zhvilluar një aplikacion për integrimin e shpenzimeve të përbashkëta në zona siç janë: shpenzimet e kontabilitetit, marketingut, mirëmbajtjes, IT-së, sigurimit etj. Ky kapitull trajton në mënyrë të detajuar zhvillimin e aplikacionit që nga ideja, pastaj krijimi i bazës së të dhënave, vlerësimi i gjendjes aktuale duke bashkëbiseduar me ekspertë dhe menaxher të bizneseve në zona për të analizuar se cilat nga shpenzimet integrohen më lehtë dhe më shpejtë. Aplikacioni i zhvilluar për integrimin – uljen e shpenzimeve është testuar dhe në këtë kapitull kam paraqitur përfitimet që sjell aplikimi i tij. Pjesë e këtij kapitulli janë edhe siguria e aplikacionit dhe mundësia e avancimit të tij në të ardhmen edhe me module të tjera. Në brendësi të këtij kapitulli janë paraqitur rezultatet e hulumtimit tim lidhur me ndikimin e aplikacionit të zhvilluar për uljen e shpenzimeve.

Kapitulli 6: Në këtë kapitull kam dhënë një sërë konkluzionesh dhe rekomandimesh të cilat mendoj se janë të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre organizimeve ekonomike. Në mbështetje të analizës së punimit kam konkluduar se zonat/parqet ekonomike të mbështetura nga një menaxhim modern mund të jenë komponent i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës në rrugën e saj evropiane.

Aneks: Në këtë pjesë janë vendosur pyetjet e bëra gjatë intervistës për grumbullimin e informacioneve të nevojshme, si dhe studime apo statistika të cilat i kemi përdorur si instrumente krahasimi apo referimi gjatë hartimit të këtij punimi.

Bibliografia: Pjesa e bibliografisë përmban listën e librave, artikujve, të konferencave shkencore si dhe adresat e faqeve të internetit.

KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1 Historiku i zonave të lira ekonomike si programe të rëndësishme zhvillimi

Zonat e lira ekonomike zanafillën e tyre e kanë qysh në Romën antike dhe paraqiten paralelisht me paraqitjen e tregtisë. Ndryshimet dhe evoluimi i funksionit dhe strukturës së zonave të lira ekonomike botërore duhet të analizohen në një qasje sistematike. Robert J. McCalla (1990)¹ ka fokusuar studimin e tij mbi evoluimin strukturor dhe hapësinor, si dhe disa shembuj të zonave të lira ekonomike deri në vitin 1986, të tilla si FPs (Parqet e Lira), FTZs (Zonat e Tregtisë së Lirë), EPZs (Zonat e Eksportit dhe Përpunimit) etj.

Pavarësisht koncepteve të ndryshme dhe përkufizimeve të përdorura për zonat e lira ekonomike, ato tradicionalisht janë një pjesë e territorit sovran kombëtar të caktuar në një mënyrë të tillë që, mallrat me origjinë të huaj mund të ruhen, shiten ose blihen lirë në bazë të taksave të zakonshme doganore. Me fjalë të tjera, ky është një vend pa doganë ose një depo, e cila edhe pse ndodhet brenda kufijve fiskal kombëtarë, konsiderohet si jashtë kufirit². Përkufizimi thelbësor i një zone të lirë, si dhe udhëzimet dhe standardet për ta propozuar, janë të përfshira në Konventën e reviduar të Kjotos të Organizatës Botërore të Doganave (OBD)³. Kësisoj porti Romak Delos është themeluar që në Greqinë e vjetër. Porte të lira kanë qenë të organizuara edhe në qytete-shtete të tjera si Venediku. Edhe në

¹McCalla, Reobert J. (1990), "The Geographical Spread of Free Zones Associated with Ports", In: "Geoforum". Vol. 21. No. 1. Pergamon Press Plc.

²Andrew Kuznetsov. "Promotion of Foreign Investment in Russia." Russian and East European Finance and Trade, 1993/94: 56.

³Annex D of the International Convention on the Harmonization and Simplification of Customs (revised in 1999) defines a free zone as "part of the territory of a Contracting Party where any goods introduced aregenerally regarded, insofar as import duties and taxes are concerned, as being outside the Customs territory ... and not subject to the usual Customs control."

periudhën e feudalizmit kanë qenë mjaft aktive. Në shekullin e XIII disa qytete përgjatë detit Baltik dhe detit Verior kanë krijuar FTU "Free Trade Union". Në qytetet gjermane Hamburg dhe Bremen na paraqiten zonat e lira tregtare, si FC "Free Citizen". Këto qytete kanë pasur rol dominant dhe mbikëqyrës në aktivitetin tregtarë të ushtruar nga subjektet e ndryshme brenda portit të lirë Leyghorn (1547) të qytetit Italian Genoa.

Portet e para të lira në Europë janë krijuar në vitin 1888, ndërkaq në ShBA u krijuan në vitin 1934. Karakteristikë e përbashkët e tyre është se zonat e lira janë organizuar zakonisht në portet detare dhe në hapësirat e tyre është zhvilluar kryesisht aktivitet tregtar.

Zonat e lira ekonomike bashkëkohore paraqiten në pjesën e dytë të shekullit të kaluar, fillimisht në Porto Riko dhe në Irlandë. Zona e lirë Shannon në Irlandë është konsideruar si model i parë i zonës së lirë ekonomike. Kjo ZLE është ngritur në vitin 1959 dhe është përsëritur në një formë apo në tjetër në disa vende të tjera.

Në kontinentin e Azisë, respektivisht në Indi ZLE e parë është themeluar në qytetin Kandla në vitin 1965. Në Kinë ZLE e parë është formuar në qytetin Taipei në Kaohsiung në po të njejtin vit. Në vendet aziatike ZLE organizohen edhe në Republikën e Koresë, në qytetin Masan në vitin 1970, në Malajzi në qytetin Sungei Way në vitin 1971, në Filipine në qytetin Bataan në vitin 1972, ndërkaq në Indonezi në qytetin Tanjung Priok në vitin 1973. Formimi i ZLE vazhdon edhe në Bangladesh, Sri Lankë dhe Tajlandë gjatë viteve 1977-1980. Disa nga këto vende, si India, Malajzia dhe Filipinet, themeluan disa zona, por me një numër relativisht të kufizuar të punëtorëve. Përkundër kësaj, ZLE në Taipei pas vetëm disa vitesh u zhvillua shumë shpejtë duke punësuar rreth 90.000 punëtorë. Rritja e shpejtë e numrit të zonave të lira në botë është shënuar në njëzet vitet e fundit. Kësisoj, zonat e lira janë krijuar në Hong Kong, Singapor, Kopenhagen, Stokholm, Gdansk, Los Angeles, Nju Jork etj. Sipas

Organizatës Botërore të zonave të lira, sot në botë ekzistojnë 847 zona të tregtisë së lirë në 102 vende të botës, në të cilat janë të punësuar mbi 27 milionë punëtorë.

Zonat e lira ekonomike, në vendet në zhvillim mund të japin rritje të flukseve të kapitalit që kanë implikime potencialisht të rëndësishëm të mirëqenies. Krijimi i zonave të lira të cilat largojnë barrierat dhe shkaktojnë rrjedhën e kapitalit që ngre produktivitetin e punës, gjeneron efekte për krijimin e lidhjeve dhe krijon të ardhura tatimore dhe të ardhura nga fitimi i firmave të huaja. Këto të ardhura përkthehen në përfitime, në mirëqenie dhe me afat të gjatë, për zhvillimin e vendit pritës⁴. Besohet se objektivat, mekanizmi i zonave, si dhe roli i tyre në ekonominë globale janë thelbësore për suksesin e çdo zone⁵. Koncepti i zonave me privilegje të veçanta ka qenë rreth e rrotull të paktën që prej shekullit të XVI-të, por zona ekonomike speciale e parë moderne u themelua në Irlandë më 1959 (Guangwen, 2003). Në ditët e sotme, zonat e lira janë përdorur për qëllime të ndryshme, duke përfshirë zhvillimin e rajoneve të pafavorizuara, gjenerimin e të ardhurave dhe të punësimit, tërheqjen e investimeve (sidomos të investimeve të huaja direkte), dhe duke promovuar transferimin e teknologjisë⁶. Presionet konkurruese kanë qenë të shtyrë në drejtim të standardizimit të stimujve të ofruar nga zonat e lira në të gjithë botën⁷.

Zonat e lira janë si një “zemër” që ndihmon shumë vende për të mësuar se si të veprojnë ekonomikisht, teknikisht dhe politikisht në botë (Dodescu, 2012). Zonat e lira lajmërohen si institute të rëndësishme juridike dhe ekonomike. Qysh në vitet e tetëdhjeta mendohej se

⁴Herbert Grubel. “Towards a Theory of Free Economic Zones.” *Weltwirtschaftliches Archiv*, No.118, 1982:52

⁵Andric Kuznetsov, op.cit., 1993/94: 48-49.

⁶Raúl A. Torres, ‘Free Zones and the WTO Agreement on Subsidies and Countervailing Measures’, *Global Trade and Customs Journal* 2, no. 5 (2007).

⁷G. Akinci & J. Crittle, *Special Economic Zones: Performance, Lessons Learned, and Implications for Zone Development* (Washington, DC: The World Bank, 2008).

perspektiva e tregtisë botërore është në zhvillimin e zonave të lira, sepse atëherë vlerësohej se 20% e tregtisë në botë në të ardhmen do të zhvillohej përmes zonave të lira.

Literatura në lidhje me zonat e lira ekonomike është shumë voluminoze. Një numër i madh i punimeve teorike dhe empirike është shkruar për këtë temë, por ende nuk ka pikëpamje përgjithësisht të pranuar në favor, ose kundër ZE. Teorikisht duket se përkrahësit e zonave ekonomike kanë shënuar dhe po vazhdojnë të shënojnë fitore kundrejt kundërshtarëve të tyre. Sipas Griswold në Institutin Cato⁸, në varësi të faktit nëse ata, pra teoricienët, mbështesin apo jo idenë e një zone të lirë ekonomike, ka një dallim në mes të:

- Përkrahësve të ZE, grup i cili përfshinë ekspertë të cilët janë për ZE;
- Internacionalistë, ku përfshihen ekspertë të cilët janë në parim për liberalizimin e ekonomisë në përgjithësi, dhe mendojnë se masat e vendeve ku zhvillohen zonat duhet të miratojnë subvencione për të ndihmuar eksportuesit vendas;
- Ndërhyrës - ky grup përfshinë kundërshtarët e ZE, dhe
- Izolacionistë - Ata që janë kundër ZE, por edhe kundër çdo lloj ndihme ndaj eksportuesëve vendas.

Aktivitetet ekonomike në ZLE janë shkaktuar kryesisht nga forcat e tregut dhe kanë karakteristikat e mëposhtme (FIAS, 2008 e NPC 2000 - Rregulloret mbi ZLE): Produktet janë kryesisht të orientuar nga eksporti, mbështesin tërheqjen dhe shfrytëzimin e kapitalit të huaj, ose të ndërmarrjeve të përbashkëta me kapital të huaj. ZE janë krijuar me qëllim të arritjes së një ose më shumë nga katër objektivat e mëposhtme (FIAS 2008):

- Tërheqjen e investime të huaja direkte;
- Të shërbejnë si një "valvul presioni" për zbutjen e papunësisë në shkallë të gjerë;

⁸ Daniel Griswold (2005): "Free Trade, Free Markets", Cato Institute, www.cato.org

- Të mbështesin strategjinë për zhvillim dhe reformave ekonomike; dhe
- Të ndikoj si një laborator eksperimental për zbatimin e politikave dhe qasjeve të reja.

ZE janë perceptuar si agjentë të mundshëm të ndryshimeve strukturore të brendshme pasi që ato ofrojnë një qasje në tregjet e reja, tërheqjen e IHD-ve, duke krijuar një klimë të favorshme të mjedisit biznesor, duke rritur punësimin, promovuar eksportet dhe për të rritur të ardhurat valutore duke eksperimentuar liberalizim gradual (Cheesman, 2012, FIAS 2008, Johansson dhe Nilsson, 1997). Ekonomistët gjithashtu kanë diskutuar shkallën në të cilën ZE janë në gjendje për të stimuluar ekonominë e vendit, si dhe mundësitë për transferimin e teknologjisë së re që rezultojnë në përmirësimin e rrethinës biznesore dhe përhapje industriale (Johansson dhe Nilsson, 1997; Litwack dhe Qian, 1997; O 'Flaherty 2008, Din, 1994). Në të kundërtën, literatura ka theksuar gjerësisht se ZE kanë ndryshuar tregues të rëndësishëm të ekonomive vendore, duke argumentuar se zbatimi i tyre është nxitur kryesisht nga politika dhe nuk ka marrë mjaftueshëm në konsideratë faktorët teknik që lidhen me realitetin ekonomik të vendit nikoqir apo mysafir, apo të disa vendeve (Bräutigam dhe Xiaoyang, 2011, Farole, 2010; FIAS, 2008, Aggarwal, 2004).

Aggarwal (2004) ka treguar kufizimet e efekteve zingjire të ZE në ekonominë e brendshme, që kanë të bëjnë me zhvillimin e pamjaftueshëm ndërlidhës në mes të ndërmarrjeve vendore dhe atyre jo vendore. Izolimi ekonomik dhe fizik i ZE nga pjesa tjetër e ekonomisë kombëtare, si dhe përqendrimi i IHD-ve në sektorët e parapërcaktuar nga politika, pengojnë zona të veçanta ekonomike "në nxitjen e ekonomisë së vendit".

Rolfe et al. (2004) argumentojnë se investimet e huaja direkte kanë gjithashtu gjasa për të gjetur vende të mira dhe të braktisin ZE në periudhat që pushimet apo privilegjet tatimore

kanë përfunduar afatin e aplikueshërisë. Analiza e kostos së përfitimit (Warr 1983) të ZE në disa vende në zhvillim tregonë se efektet negative, duke përfshirë edhe të ardhurat e pashmangshme të taksave, kostot sociale dhe mjedisore, kanë rezultate të shumta nga përfitimet ekonomike që rrjedhin nga IHD-të dhe gjenerimin e eksportit, edhe pse autori nuk ka kapur efektet zingjimore në ekonominë e vendit nikoqir (Cheesman, 2012). ZE në disa raste kanë treguar performancë të dobët duke përshkruar në thelb se ato kishin një mjedis jo të zhvilluar të biznesit, mangësi në infrastrukturë dhe lidhje të dobëta me ekonominë lokale (Cheesman, 2012). Në këtë frymë për shkak të rritjes së konkurrencës së jashtme, prodhuesit vendas janë të detyruar të përtërijnë produktet e tyre në mënyrë që të sigurojnë një pozicion më të favorshëm në treg së pari, dhe së dyti mund të ndikoj në humbjen e vendeve të punës për shkak të presionit të konkurrencës së huaj⁹.

2.2 Mënyrat dhe baza ligjore për formimin e zonave të lira ekonomike

Zonat e lira mund të krijohen në disa mënyra, por gjithsesi për formimin e tyre duhet paraprakisht një bazë ligjore. Janë të njohura disa mënyra për formimin e zonave të lira dhe ato janë:

- Me akt të njëanshëm juridik;
- Me marrëveshje ndërkombëtare;
- Me konferenca dhe kongrese.

⁹ Dani Rodrik (2000): “Trade Policy Reform as Institutional Reform”, Harvard University

Zona e parë në bazë të ligjeve amerikane për zonat e lira tregtare është themeluar në Nju Jork në vitin 1937, ndërsa e dyta në Alabama në vitin 1938¹⁰.

Krijimi i zonave të lira me anë të aktit të njëanshëm juridik – Mënyra më e rëndësishme dhe më masive e formimit të zonave të lira, është me anë të aktit të njëanshëm juridik i cili nënkupton pavarësi dhe sovranitet të plotë (në kuptimin ekonomik, doganor dhe të tregtisë së jashtme) se një shtet i caktuar është i pavarur nga shtetet tjera për të miratuar një akt juridik përkatës (ose akte juridike) për formimin e zonave të lira. Shteti e bënë këtë, jo vetëm me anë të ligjit, i cili paraqet aktin më të lartë legjislativ të një vendi pas Kushtetutës, por edhe me akte përkatëse nënligjore të organit kompetent.

Të gjitha zonat të cilat sot aktualisht funksionojnë në Kosovë janë themeluar me anë të aktit të njëanshëm juridik. Për shkak të problemeve që ka pasur Kosova me anëtarësimet – pranimet në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar, mbase ka qenë më e vështirë që të krijoj zona ekonomike me anë të kontratave apo konferencave – kongreseve ndërkombëtare.

Krijimi i zonave të lira me anë të kontratave ndërkombëtare – Zonat e lira mund të krijohen me anë të kontratave ndërkombëtare, qoftë bilaterale apo multilaterale. Disa autorë vlerësojnë se ZLE mund të krijohen me anë të kontratave ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale, që nënkupton se ZLE mund të formohen me marrëveshje në mes të dy shteteve, por edhe me marrëveshje me dy ose më shumë shtete.

Krijimi i zonave të lira me konferenca dhe kongrese ndërkombëtare – Zonat e lira mund të krijohen edhe me anë të kongreseve dhe konferencave paqësore ndërkombëtare. Në këtë mënyrë ish Çekosllovakia me kontratë paqësore të Versajës ka fituar zonat e lira në

¹⁰ Thoman dr R-free ports and foreign trade zones, Cambrige 1956, Maryland, str. 133-157

Shçeqin dhe Hamburg. Mënyra më e shpeshtë e formimit të zonave të lira mbetet ajo me anë të aktit të njëanshëm juridik, pastaj me marrëveshje dypalëshe ndërmjet dy ose më shumë shteteve zhvilluese potenciale të zonave të lira.

Duke pasur parasysh historikun e krijimit të zonave të lira, evoluimin e tyre dhe ekspansionin e madh në dekadat e fundit të shekullit XX, shohim se ideja fillestare e shërbimit ekonomik në dobi të vendeve tjera, si dhe baza juridike e cila është krijuar me kontrata bilaterale apo multilaterale, i ka hapur rrugën ligjeve nacionale mbi zonat e lira. Çdo shtet me ligjet e veta e përcakton dhe rregullon shkallën e lirive dhe përfitimeve të cilat u ofron investitorëve të huaj dhe atyre vendas.

Një pyetje me rëndësi, e cila shpesh parashtrohet dhe interpretohet në tryeza profesionale dhe institucione shtetërore, kur bëhet fjalë për bazën ligjore të zonave të lira si dhe benefiteve dhe lehtësirave për afarizëm në zona dhe lidhja e tyre me pjesën tjetër të vendit, është termi dhe shkalla e eksterritorialitetit të zonave të lira. Vetëm çështja e eksterritorialitetit në kuptimin ligjor është e ndryshme nga shteti në shtet. Kështu në Gjermani mendohej se zonat e lira kanë statusin doganor të eksterritorialitetit, si një njësi doganore.

Ligji i tanishëm doganor i Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code) i konsideron zonat e lira si pjesë speciale të territorit doganor të Bashkësisë Evropiane, ku mallrat dhe shërbimet janë të liruara nga pagesa e detyrimeve doganore, tatimi në vlerën e shtuar dhe detyrimet tjera të importit, domethënë për detyrimet e importit ato nuk janë pjesë e territorit doganor të bashkësisë. Konventa e Kyotos e vitit 1993 si dhe Aneksi i Veçantë i Korrigjuar

i Konventës së Kyotos¹¹ e vitit 1999, gjithashtu interpretojnë për zonat e lira jashtë territorit doganor të bashkësisë kur bëhet fjalë për detyrimet e importit dhe tatimet në mallra dhe shërbime të kryera në zonë. Peter Riedl në studimin e vet „Portet e lira dhe zonat doganore të lira në Europë“ në vitit 1964, shkruan se zonat e lira në aspektin e funksionimit të dispozitave juridike e doganore konsiderohen si territore jashtë - territoriale të cilat janë të ndara nga pjesa tjetër e territorit shtetëror me masa përkatëse sigurie, me të cilat mallrat e ndryshme ruhen, përpunohen dhe manipulohen dhe nuk i nënshtrohen procedurës doganore”. Richard Thoman në pjesën e “Free Port and Foreign Trade Zones” konsideron se “zonat vetëm në aspektin e rregullave doganore konsiderohen si eksterritoriale (pranuar si hapësirë jashtë kufijve shtetërorë), ndonëse ato në mënyrë direkte apo indirekte janë nën kontrollin e organeve doganore.

Sot, në shumicën e rasteve zonat mbeten pjesë përbërëse e territorit shtetëror në të cilat me akte ligjore të shtetit përcaktohen rregullat për biznes. Kryesisht i lirojnë shfrytëzuesit e zonave nga masat e politikës ekonomike që ekzistojnë jashtë zonës, dhe në të njëjtën kohë, në epokën e globalizimit, duke u bërë institute të shërbimit internacional si mjet efikas i bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe zhvillimit të tregtisë dhe shkëmbimit të jashtëm. Kuptimi i eksterritorialitetit në këtë kontekst, paraqet të kaluarën me vet faktin se ekziston e drejta e mbikëqyrjes doganore në territorin e zonave të lira në botë dhe që zona e lirë e mbikëqyrjes doganore është pjesë e territorit shtetërorë në të cilën në mënyrë të veçantë janë përcaktuar masat e mbikëqyrjes doganore.

¹¹Annex D of the International Convention on the Harmonization and Simplification of Customs (revised in 1999) defines a free zone as “part of the territory of a Contracting Party where any goods introduced are generally regarded, insofar as import duties and taxes are concerned, as being outside the Customs territory ...and not subject to the usual Customs control.”

Rregullativa Juridike Evropiane merret me zonat e lira dhe rregullon çështjen e tyre si: hyrjen e mallrave, kontrollin, punën, daljen e mallrave, rieksporin dhe aktivitetet e tjera. Të gjitha këto janë të trajtuara me Konventën e Kyotos (The Kyoto Convention) dhe Protokollin e Briselit të datës 26 qershor 1999. Direktivat e caktuara ligjore në detaje definojnë çështjet lidhur me funksionimin e zonave të lira.

Akti i parë ligjor ndërkombëtar që prekë çështjen e zonave të lira është Traktati i paqes i Versajës. Kjo marrëveshje u nënshkrua pas Luftës së Parë Botërore dhe pranon parimin e zonave të lira në qytete, që i janë nënshtruar kontrollit. Rezoluta e Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC – International Chamber of Commerce), e miratuar në vitin 1991 në Londër, rekomandoi krijimin e zonave të lira.

Në parimet thelbësore të Konventës së Kyotos (The core principles) janë kyçur konceptet moderne të procedurave doganore dhe tregtisë moderne, duke përfshirë teknologjitë e reja, filozofinë e re të kontrollit doganor dhe gatishmërinë e sektorit privat për të bashkëpunuar me doganat për përfitimin e tyre reciprok. Konventa e Redaktuar e Kyotos gjithashtu përmban rregulla të reja dhe të detyrueshme të cilat të gjithë anëtarët e Organizatës Botërore të Doganave duhet t'i pranojnë. Kjo Konventë gjithashtu përmban dispozita të detajuara për funksionimin e zonave të lira, që kanë të bëjnë me formimin e kontrollit doganor, hyrjen e mallrave, procedurat për mallrat, çështje të sigurisë, etj. Konventa e Redaktuar e Kyotos hyri në fuqi kur 40 shtete anëtare të Konventës së Kyotos të vitit 1974 ratifikuan dhe ranë dakord me protokollin e amandamentuar.

Me qëllim të inkurajimit të zhvillimit të tregtisë së jashtme dhe shkëmbimit ndërkombëtar të mallrave në përgjithësi, administratat e caktuara doganore garantojnë lehtësira në lidhje me obligimet doganore dhe taksave për mallin nga lokacionet me të cilat janë të lidhura, si dhe

në lidhje me doganat dhe taksat jashtë territorit të doganës. Këto lokacione citohen si „zona të lira“. Disa administrata përdorin edhe emra të tjerë si: „porti i lirë“, „deponi e lirë“ ose „zonë e lirë tregtare“.

2.3 Llojet e zonave të lira dhe përpjekja e definimit të drejtë të institutit të ZLE

Zonat e lira kanë detyra dhe role të ndryshme, privilegje dhe kompetenca, krijohen për arsye të ndryshme, dhe me qëllim që të arrihet ajo për çka edhe janë themeluar. E gjithë kjo ndikon që ato edhe të dallohen ndërmjet tyre, prandaj edhe bëhen klasifikime të ndryshme që janë:

a) Për nga mënyra e formimit ato mund të jenë:

- Zona të cilat formohen me akte autonome të një shteti dhe
- Zona të cilat formohen me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale.

b) Për nga mënyra e shfrytëzimit, zonat mund të jenë:

- Zona të dedikuara për shfrytëzim të përgjithshëm,
- Zona për të gjitha vendet dhe
- Zona për vende të caktuara.

c) Për nga funksioni zonat e lira mund të jenë:

- Zona të lira me funksione të kufizuara;
- Zona të lira me funksione plotësisht të lira.

d) Duke pasur parasysh formimin historik, zonat e lira mund të ndahen në:

- Zona të cilat janë themeluar dhe zhvilluar nga portet e lira dhe

- Zona të cilat nuk janë themeluar në atë mënyrë.

e) Sipas shkallës së preferencës së kontrollit dhe regjimit doganorë, zonat e lira mund të ndahen në:

- Zona të cilat gëzojnë privilegje dhe benefite të shumta për investitorë të huaj dhe shfrytëzues të zonave dhe
- Zona të cilat kanë shkallë më të vogël të privilegjeve dhe benefiteve dhe këto zona merren më pak me prodhimtari industriale.

f) Duke pasur parasysh faktin se a janë zonat pjesë përbërëse e territorit doganor të vendit apo janë jashtë atij territori, zonat e lira mund të jenë:

- Zona të cilat janë pjesë përbërëse e territorit doganorë të vendit, por me privilegje dhe stimulime të caktuara dhe
- Zona të lira të cilat nga pikëpamja doganore janë përjashtime nga zona doganore e vendit dhe në aspektin doganor nënkuptohen si eksteritor doganor dhe në to aplikohet e drejta doganore dhe tregtare e shtetit amë.

g) Ndarja e zonave të lira sipas llojit të destinimit mund të jenë:

- Zonat e lira tregtare dhe
- Zonat e lira industriale (prodhuese).

h) Duke pasur parasysh kriterin gjeografik, zonat e lira mund të jenë:

- Sipas vendit – lokacionit dhe
- Sipas regjioneve dhe shteteve.

i) Duke pasur parasysh veprimtarinë, zonat e lira mund të jenë:

- Zona për vendosjen dhe ruajtjen e mallit,
- Prodhuese dhe të orientuara nga eksporti,

- Zona të lira turistike.

Tabela 1. Tipet e Zonave të Lira

Zonat e vogla	Zonat e mëdha	Zonat specifike industriale	Zona me tipare specifike
Komerciale	Zonat ekonomike speciale	Bankare	Programi Maquiladoras
Industriale	Zonat e populluara	Të sigurimit	Parqet teknologjike
Të përziera	Multi industriale	Zonat e lojërave të fatit	Inkubatorët e zhvillimit
Prodhuese eksportuese	Zonat hoteliere	Turistike	Fabrikat eksportuese
Shërbyese		Tekstilit	Të orientuara kryesisht drejtë punësimit
Korporatave / Urbane		Informatike	Të orientuara kryesisht drejtë investimeve
Republika Domenikane, SHBA, Egjipti, Kenia, Europa etj	Kina, Evropa Jugore, Azia Qendrore, Rusia, Sudani, Koreja Veriore	SHBA (New York), Bangladeshi, India, Xhamajka, etj.	Meksika, Shri lanka, Tunizia, India etj.

Burimi: WEPZA (World export processing zone association) – www.wepza.org

2.4 Koncepti i funksionimit të zonave të lira ekonomike

Bazuar në rolin dhe funksionin e zonave të lira ekonomike, patjetër nevojitet një analizë e thellë për të përshkruar produktin që rrjedhë nga zonat e lira ekonomike dhe gërshetimi i ligjeve e përvojave të mira që duhet bashkërenduar deri në formimin e një zone të lirë ekonomike. ZE janë krijuar në mënyrë tipike me qëllim të arritjes së një ose më shumë nga katër objektivat e mëposhtme të politikës (Madani 1999; Cling dhe Letilly 2001, FIAS 2008, Zeng 2010; Farole dhe Akinci 2011; Fuller dhe Romer 2012):

- Të tërheqin investimet e huaja direkte (IHD);
- Të shërbejnë si "valvula presioni" për zbutjen e papunësisë në shkallë të gjerë;
- Të mbështesin një strategji më të gjerë të reformave ekonomike; dhe

- (iv) Të veprojnë si laboratorë eksperimental për zbatimin e politikave dhe reformave të reja.

Funksionimi i një zone ekonomike varet nga shumë faktorë ndër të cilët janë: kuadri ligjor, politikat e preferuara, kapacitetet dhe praktikat menaxheriale etj. Këto do të ishin inputet bazike të nevojshme për kompletimin e infrastrukturës ligjore bashkë me burimet e nevojshme njerëzore e teknike. Objektivat e zhvillimit të një vendi janë elementi bazë që interferon në kuadrin ligjor që mund të jetë i favorshëm apo stimulues dhe politikat e preferuar që do të mund ti japin përparësi ZLE-ve.

Kuadri ligjor, politikat e preferuara dhe praktikat menaxheriale janë të ndëlidhurar në mes vete dhe po ashtu janë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e ZLE. Nga stadi i zhvillimit të ZLE do të varet qëndrimi/interesimi i investitorëve të huaj, niveli/volumi i investimeve si dhe shkalla e punësimit. Vështruar konceptualisht, zonat e lira paraqesin një pjesë të territorit të shtetit, i rrethuar dhe shënuar, në të cilin zhvillohen aktivitete ekonomike dhe të tjera me përfitime dhe lehtësira të garantuara.

Në mes të këtyre lehtësirave dhe përfitimeve janë:

- Lirimi nga detyrimet, taksat (tatimi në vlerën e shtuar, taksat e akcizës, tatimi në të ardhurat, tatimi në të ardhurat e korporatave, taksat pronësore etj.);
- Lirimi nga rregullat në lidhje me pagat minimale, shpenzimet sociale, kushtet e punës, politikat kufizuese ekonomike, etj;
- Dhënia e tokës me qera, shërbime me kosto të ulëta (sigurimi, uji, energjia elektrike dhe shërbime të tjera);
- Përdorimi i infrastrukturës;

Zonat e lira kudo në botë konceptualisht zhvillohen me anë të ndihmës dhe mbështetjes së fortë të shtetit, i cili ofron një shumëllojshmëri të benefiteve dhe avantazheve.

Zonat e lira të cilat funksionojnë në hapësirën ekonomike të një vendi, duhet të jenë pjesë integrale e strategjisë gjithëpërfshirëse e cila çon në reforma të mëtejshme ekonomike. Kjo çasje parasheh se zonat e lira duhet të kenë një afat të kufizuar jetësor dhe e humbin rëndësinë e tyre kur shtetet kyçen në tregtinë botërore dhe kur ato i arrijnë parametrat makroekonomike të parashikuara.

2.5 Arsyet e themelimit të zonave të lira

Ndihma e shtetit për zhvillimin e projekteve të zonave të lira është e rëndësishë së veçantë (Goldstein, 2009), ndërsa në këtë punim janë analizuar arsyet kryesore ekonomike dhe administrative të ekzistencës dhe funksionimit të zonave të lira, në veçanti nga aspekti i shtetit dhe ndërmarrjeve shfrytëzuese të zonës, sikurse janë:

- Mundësojnë kursim shfrytëzuesve në fusha të ndryshme të aktiviteteve biznesore, (dogana - mospagesa ose shtyrja e pagesës, taksa, tatime, masa stimuluese të politikës ekonomike);
- Përqendrojnë shpenzimet e shërbimeve në një vend - qendra logjistike e përcjelljes, dogana, shërbimet e transportit dhe deponimit, transfere, deponim etj.;
- Krijimi i hapësirave të përshtatshme për organizimin e prodhimit (rasti i zonës ekonomike në Ferizaj në të cilën e zhvillojnë aktivitetin e tyre 14 biznese ekskluzivisht prodhuese);

- Sigurimi i doganave, taksave dhe TVSH-së, eksteritorialitetin e mallrave dhe shërbimeve në eksporte dhe importe;
- Janë një mjet efikas për tërheqjen e investimeve dhe teknologjive të reja për zhvillim kombëtar dhe rajonal;
- E orientojnë tregtinë ndërkombëtare nëpërmjet kanaleve që mund të monitorohen dhe zbatojnë efektivisht kontrollin doganor, mbikëqyrjen dhe sigurinë e mallrave;
- Janë një lloj i laboratorëve ekonomik shtetërorë për testimin e të gjitha llojeve të reformave ekonomike pa ndikim negativ në pjesën tjetër të ekonomisë kombëtare.

Janë përcaktuar kushtet ekonomike dhe institucionale të cilat duhet të plotësohen për të realizuar misionin dhe qëllimet e zonave të lira dhe për të siguruar kushtet më të përshtatshme për aktivitetet e shfrytëzuesve. Këto mundësojnë realizimin e profiteve të pjesëmarrësve në aktivitetet në zonë, me qëllim të realizimit të interesave të shfrytëzuesve në zonë, ekonomi dhe shtet nëpërmjet:

- Zhvillimit të programeve të reja prodhuese dhe profitabile;
- Angazhimit të kapitalit të huaj në projekte me anë të investimeve të huaja direkte;
- Rritjes së eksportit;
- Punësimit më të madh të fuqisë punëtore;
- Krijimit të kushteve hapësinore për punë (ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës);
- Krijimit të një ambienti të favorshëm për punë në zonë.

Zonat e lira sot në botë mund të ndahen në dy lloje themelore: lloji i instituteve plotësisht të lira dhe lloji i instituteve me funksione të kufizuara. Tek lloji i parë i zonave të lira, lejohet jo vetëm deponimi i mallit, por edhe përpunimi i mallit, kryesisht përpunimi dhe prodhimi me shumë favore doganore dhe jodoganore, ndërsa tek llojet e tjera të zonave të lira nuk

lejohet prodhimtaria industriale, por më tepër ato janë „deponi “ për vendosjen dhe ruajtjen e mallit nën mbikëqyrjen doganore.

Sot në botë ka zona të lira, të cilat janë të orientuara më shumë nga prodhimtaria dhe eksporti dhe janë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Ky lloj i zonave, para së gjithash mundëson më shumë investime të huaja me benefite të rëndësishme, që ndërlidhen me zhvillimin e prodhimtarisë në zona, punësim të fuqisë punëtore vendase, zhvillimin e infrastrukturës moderne, futjen e teknologjive dhe inovacioneve të reja etj. Zona e lirë formohet atëherë kur pas studimeve paraprake konstatohet se ka arsyeshmëri ekonomike. Në këto zona importohen mallra dhe shërbime jashtë vendit që të sigurohen kushte hapësinore, energjetike dhe teknike, kushte në aspektin e mbrojtjes së mjedisit dhe kushte të tjera për punë të papenguar në zonën e lirë.

Në formimin dhe punën e zonave të lira dallohen tri grupe interesi:

- Shteti ekonomik (nikoqir);
- Shfrytëzuesi i zonës, (pronari i kapitalit, investitori) dhe
- Vet zona e lirë.

Në mënyrë që zona e lirë të tregoj efikasitet dhe dobi është e nevojshme që shteti:

- Të ofroj kushte më të mira për punë në zonat e lira, në raport me afarizmin në shtete fqinje, me anë të një sërë privilegjesh dhe lehtësirash, administrim të lehtë dhe të shpejtë, siguri ligjore dhe stabilitet politik;
- Në afatin sa më të shkurtër të tërheq kapitalin e huaj, të rrisë eksportin dhe qarkullimin devizorë, të punësojë fuqi punëtore dhe të ndihmoj kyçjen e ndërmarrjeve vendore në rrjedhat ndërkombëtare ekonomike;

- Shfrytëzuesve të zonave të lira (investitorëve), t'ju mundësoj qarkullim të shpejtë të kapitalit me sa më pak shpenzime në operim.

Shumë shtete me zona të lira e vlerësojnë efikasitetin e tyre me anë të shqyrtimit të pyetjeve në vijim:

- A mundësojnë zonat rritjen e investimeve të huaja direkte?
- A sjellin ato investime punësimin në nivelin e dëshiruar?
- A nxisin investimet rritjen e eksportit?
- A ndikojnë në zgjerimin e investimeve?
- Çfarë ndikimi kanë në zhvillimin e NVM-ve?
- Çfarë ndikimi kanë në rrethinën e afërt në funksion të zhvillimit regional etj.

Analizat tregojnë se shumica prej tyre i plotësojnë këto qëllime, por ekzistojnë edhe nga ato që nuk i kanë plotësuar në tërësi, ose i kanë plotësuar pjesërisht. Për ekonomitë me tepricë të fuqisë punëtore, interesi kyç reflektohet në numrin e të punësuarve. Shkalla e privilegjeve investive ndikon direkt në rritjen e numrit të kontratave në zona dhe nxitë investime të rangut të vogël dhe të mesëm, çka tregon se zonat e lira janë një mjet i mirë për rritjen e punësimit.

Në shumë shtete me zona të lira, qëllimi kryesor është rritja e investimeve dhe rritja e numrit të të punësuarve. Ato presin që me anë të investimeve të huaja të inkurajojnë dhe promovojnë eksportin, ngjirjen e standardit të prodhimit dhe të shërbimeve me anë të shkëmbimit të përvojave me firmat vendore, transferin e teknologjisë dhe njohurive, si dhe zhvillimin e aktiviteteve prodhuese në zona.

Një numër i madh i ekonomistëve në botë merren me studimin e efekteve të bizneseve në zonat e lira dhe ndikimin e tyre në makroekonomin e shtetit ekonomik dhe në ekonominë e

përgjithshme botërore. Përvojat e zonave të pazhvilluara kryesisht në Azinë Lindore dhe Juglindore, Amerikën Latine dhe territoret Afrikane janë vlerësuar në bazë të pyetjeve të shumta sikurse janë niveli i krijimit të vendeve të reja të punës, zhvillimi i teknologjisë, veprimtaritë industriale, fitimi, kushtet e punës dhe marrëdhëniet ekonomike në mikro nivel. Këto vlerësime kanë ndodhur në kontekst të zhvillimit makroekonomik gjatë procesit të liberalizimit afarist në zona (Young, 1987; Miyagiwa, 1986), analiza e shpenzimeve dhe fitimeve (Warr, 1983, 1987, 1989), raporteve industriale dhe funksionimi i tregut të punës (ILO/UNCTC, 1988). Problemi është se shumë nga këto studime, shpejtë vjetërsohen për arsye të valës së madhe të përhapjes së zonave në botë. Zonat e lira nuk janë fenomen statik, kështu që kushtet ekonomike ndryshojnë kohë pas kohe, e kjo ndikon në vetitë e tyre dhe vlerësimet për efikasitet.

Richard L.Bolin, drejtor ekzekutiv i WEPZA (World Export Processing Zones Association) kontributin e vet të analizës së operimit të zonave e jep në punimin “Pse janë të nevojshme zonat e lira“, duke i krahasuar shtetet me dhe pa zona të lira, në aspektin e eksportit të realizuar (Flagstaff, Arizona, USA). Krahasimi është bërë për 102 shtete me zona të lira dhe 126 shtete pa zona të lira, duke shfrytëzuar të dhënat nga departamenti për zonat e lira (WEPZA, 1997).

Sipas të dhënave të Drejtorisë Ndërkombëtare të Zonave të Lira dhe Zonave për Përpunimin e Eksporteve (IDFZ and EPZs), në kombinim me të dhënat e Bankës Botërore mbi numrin e popullsisë dhe të ardhurat kombëtare për vitin 1995, dhe të dhënat e importit në SHBA dhe BE për vitin 1993-1996, kemi këto rezultate:

Eksporti në SHBA, 1996	US\$ 791,312,085,000
------------------------	----------------------

Eksporti në BE, 1996	US\$ 707,812,999,000
----------------------	----------------------

Gjithsej në SHBA/EU US\$ 1,499,125,084,000

Eksporti botëror SHBA/BE është (39-42) % gjatë viteve 1993-1996 nga të gjitha shtetet, me dhe pa zona të lira, mirëpo dallimi më i madh vërehet tek norma e rritjes bruto të të ardhurave kombëtare për banor (GNP/Capita category). Shtetet me të ardhura të ulëta, me zhvillimin e zonave të lira e përmirësojnë rrethinën e tyre biznesore e cila është faktor i rëndësishëm për inkurajimin e eksportit përkatësisht përmirësimin e bilancit të tyre tregtar. Për vetëm 3 vite, 58 shtete pa zona, me të ardhura mesatare, kanë humbur 28% të tregut. Tek shtetet pa zona të lira, 28 shtete me të ardhura të larta, shënojnë rritje të eksportit prej 33%, ndërsa tek 30 shtete me të ardhura të ulëta, rritja është vetëm 1%.

Ky përceptim është një dëshmi e drejtpërdrejtë e suksesit të zbatimit të konceptit të zonave të lira në vendet në zhvillim.

Zonat e lira janë bërë një fenomen i ri dhe po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme si një mjet për tërheqjen e programeve të investimeve dhe të prodhimeve. Shumë vende kanë filluar të zbatojnë këtë instrument për procesin e industrializimit, sidomos si një mënyrë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte (IHD), kryesisht në sektorin e prodhimit, krijimin e vendeve të punës, gjenerimin e eksporteve dhe këmbimit të valutave, etj.¹².

Me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike, shtetet synojnë të rrisin punësimin, të tërheqin kapitalin e huaj dhe t'i transferojnë teknologjitë e reja. Për shtetet në fazat e hershme të industrializimit, kjo është një mënyrë për të absorbuar tepricën e fuqisë punëtore.

¹² Zeng, Zhihua. 2015. *Global experiences with special economic zones : focus on China and Africa*. Policy Research working paper; no. WPS 7240. Washington, D.C. : World Bank Group.
<http://documents.worldbank.org/curated/en/810281468186872492/Global-experiences-with-special-economic-zones-focus-on-China-and-Africa>

2.6 Efikasiteti dhe dobishmëria e zonave ekonomike

Efikase dhe të dobishme janë ato zona të lira të cilat ofrojnë:

- Hyrje dhe dalje të lirë të mallit dhe shërbimeve;
- Procedura të thjeshta për fillimin e biznesit;
- Procedura të thjeshta doganore;
- Lehtësira fiskale (lirimi nga TVSH, tatimi në të ardhura, tatimi në fitim, tatimi në pasuri, tatimet lokale etj.);
- Nxitje financiare (riatdheshimi i lirë i kapitalit, profitit dhe dividendës si dhe interesave kreditore të përshtatshme),
- Infrastrukturë publike (qiratë e ulëta, shërbimet e lira, transport i shpejtë dhe i lehtë.

Efikase dhe të dobishme janë ato zona të lira të cilat ndodhen në lokacione të përshtatshme, ku infrastruktura është plotësisht e rregulluar, me rrethine politikisht të qëndrueshme, me fuqi punëtore të përgatitur, me marketing të mirë, me shërbime efikase dhe logjistikë, me teknologji informative dhe telekomunikim, me drejtime të specializuara dhe bashkëpunim me rrethinë.

Dobitë kyçe nga zonat e lira mund të përfshihen në disa fusha:

- Shpejt dhe në mënyrë efikase krijojnë vende të reja pune (direkte dhe indirekte);
- Tërheqin investime ndërkombëtare direkte;
- Mundësojnë transferim teknologjik dhe shpërndarjen e njohurive;
- Janë instrument i suksesshëm për ristrukturimin e ekonomive në tranzicion;

- E rrisin BPV (Bruto Produktin Vendor) 0.52% sipas të dhënave të hulumtimit IFC International Finance Corporation, anëtare e World Bank Group, (J.P Gauthiera, 2006);
- E rrisin eksportin e shtetit (24% të eksportit botërorë zhvillohet përmes zonave të lira);
- Përfaqësojnë qendrat logjistike efikase në zinxhirin e transportit ndërkombëtar duke zhvilluar infrastrukturën lokale (rrugët, energjetika, uji, gasi etj.);
- E drejtojnë tregtinë ndërkombëtare në rrjedhat e rregullta (kontrollë doganore të intensifikuara);
- Kanë ndikim pozitiv në ekonominë vendore.

Është e vështirë që të kryhet një analizë e mirëfilltë e shpenzimeve dhe fitimeve në zona. Sidomos është vështirë të vlerësohet kontributi afatgjatë dhe strukturor në ekonominë lokale. Sa i përket resurseve njerëzore, zonat e lira mund të kontribuojnë në ekonominë e vendit nëse investitorët janë të interesuar edhe për trajnimin komunitetit të atij vendi, siç ka ndodhur në Singapor dhe Filipine. Zhvillimi i burimeve njerëzore është me rëndësi për vendet në zhvillim pasi që atyre u mungojnë njohuritë në fushën e marketingut që janë të rëndësishme për depërtimin e tregut të jashtëm. Për shkak të rregullave të reja të tregtisë dhe dinamikës së shpejtë të ndryshimeve, shtetet duhet ti përshtaten lehtë këtyre transformimeve përmes zonave të lira, parqeve industriale, parqeve shkencore etj, pasi që ato konsiderohen katalizatorë të rritjes së përshpejtuar ekonomike. Vlerësimi i ndikimit të zonave të lira në ekonominë e shtetit është vështirë të përcaktohet me saktësi. Një nga punimet e rralla që merret me këtë problematikë është punimi i Takayoski Kusago-a dhe Zairis Tzannatos-a për zonat prodhuese eksportuese, i publikuar nga Banka Botërore në vitin 1998. Me disa

përafrime dhe modifikim klasik të analizës coast-benefits, është e mundur të arrihen disa rezultate. Me analizën coast-benefits krahasohen të gjitha përparësitë (benefits) dhe shpenzimet (coast) e ndonjë projekti investiv. Analizohen efektet e investimeve kapitale në planin e gjerë shoqërorë dhe dobia e tyre për shoqëri, duke vështuar efektet eksterne të investimit, ku ndërmarrjet të cilat operojnë sipas principeve të tregut, nuk kanë interes. Me analizën coast-benefits hulumtohen disproporcionet në mes të interesave të ndryshme të bashkësisë shoqërore dhe ndërmarrjes-investitorit. Ndonjë investim me efekte të konsiderueshme për shoqërinë, mund të jetë jo atraktiv për investitorët. Zhvillimi i zonave të lira përmban karakteristika të krahasueshme ekonomike me vendet me zona, në raport me performancën hipotetike (të imagjinuar) të një vendi pa zona. Profitet e vlerësuara (the net estimated benefits) përfshijnë neto shtesën e vendit - nikoqir, duke pasur parasysh zhvillimin e punësimit, të ardhurat nga tregtia e jashtme, përdorimi i lëndës së parë vendore, pajisja shtesë dhe favoret e lehtësirat tatimore dhe kthimi. Analiza është më shumë makro se sa mikro, sepse ka të bëjë me problemin e shpërndarjes së mjeteve. Profiti i pastër përfshinë, fitimin e pastër për vendin ekonomik në harmoni me prodhimtarinë, fitimet e jashtme, përdorimin më të madh të materialeve vendore, pajisje shtesë dhe të ardhura shtesë nga tatimet e mbledhura. Shpenzimet përfshijnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e mirëmbajtjes të zonës së lirë, si dhe pagesat për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e infrastrukturës. T. Kusaga dhe Z. Tzannatos kanë përdorur formulën matematikore (Warr, 1989), e cila në analizë përfshinë një numër të madh elementesh, sikurse janë punësimi, çmimi i punës, ndikimi i lëndës së parë vendore, shërbimet komunale, interesi dhe përqindja për kthimin e borxheve vendore, tatimet, çmimi i kushtueshëm i zonës administrative, çmimet e mirëmbajtjes së infrastrukturës në zona ekonomike etj.

2.7 Faktori gjeografik për krijimin e zonave të lira

Faktori gjeografik për zhvillimin e institutit të zonave të lira është i një rëndësie të veçantë sepse nga faktori i përshtatshëm gjeografik i zonave të lira mund të pritët edhe prosperiteti i tyre ekonomik. Marshall (1920) vëren dy arsye të lidhura se pse firmat do të vazhdojnë të qëndrojnë në të njëjtën zonë gjeografike. Së pari, firmat në një mjedis të afërsisë janë në gjendje të bëhen më të efektshme nga puna e specializuar. Së dyti, firmat janë në gjendje të përgjigjen më shpejtë kushteve të tregut, për shkak të rrjedhjes së dijes në grupe (Gordon & Mc Cann, 2000).




Figura 1. Harta e zonave të lira ekonomike në Europë

Investitorët e huaj në veçanti i kushtojnë rëndësi këtij faktori gjatë planifikimeve të tyre për investime në zona të lira. Ata parapëlqejnë të bëjnë investimet e tyre në atë zonë të lirë e cila ka përparësi në drejtim të vendndodhjes së saj të përshtatshme gjeografike, dhe që është një fushë lidhëse ndërmjet regjioneve apo lokaliteteve të caktuara gjeografike. Për shembull lidh veriun dhe jugun e vendit, lindjen dhe perëndimin e një regjioni të caktuar, dhe kështu

me radhë. Faktori gjeografik është i rëndësishëm, sepse u mundëson investitorëve që më shpejtë të shkëmbejnë mallrat në zona apo tregje të ndryshme gjeografike e gjithashtu edhe malli nga zonat e ndryshme gjeografike të arrij sa më shpejt në zonë të lirë. Kjo në kushtet bashkëkohore të shitjes dhe kalimit të mallit ka rëndësi të veçantë, sepse kalimi më i shpejtë i mallrave do të thotë qarkullim më i shpejtë i kapitalit, lëndëve të para dhe materialit reprodutiv dhe kështu bëhet pjesë e një cikli të ri të prodhimit me kosto më të ulët.

Edhe pse nuk ka studime lidhur me pozitën gjeografike të zonave/parqeve të themeluara në Kosovë, vlerësoj se vendndodhjes, përkatësisht pozitës gjeografike nuk i është kushtuar vëmendje e merituar.

2.7.1 Zgjedhja e lokacionit

Teoritë gjithëpërfshirëse për vendndodhjen e aktiviteteve prodhuese janë zhvilluar gjatë historisë. Në marrjen e vendimeve për ndarjen, disa përcaktues apo faktorë të tillë si kostot e transportit, shpenzimet e punës, avantazhet e marketingut dhe afërsia me industrinë ndihmëse janë konsideruar (Sunkara, 2016). Shumë faktorë duhet të merren parasysh para se të merret një vendim në lidhje me lokacionin, si:

- Çfarë është me optimale për të prodhuar apo shërbyer?
- Cila është kërkesa e synuar e tregut?
- Çfarë është tendenca për shërbime apo prodhime të tilla në qytet, regjion apo edhe më gjerë?
- Rezultati i analizës së fizibilitetit për përmbushjen e objektivave;
- Madhësia optimale;

- Kapitali i nevojshëm për fillimin e veprimtarisë etj.

Nëse analiza për lokacion vazhdohet më tutje, atëherë duhet patur parasysh edhe klasifikimi i industrisë në bazë të akomodimit, e cila mund të jetë: industria e pastër dhe e papastër, industria e lehtë, industria bazike, industria e shërbimeve, industritë primare, sekondare dhe terciare etj. Edhe detajet e tjera mund të jenë shumë të rëndësishme si: nevoja për lëndë të parë, energjia, forca e punës, transporti, si dhe kontaktet me konsumatorët dhe tregun në tërësi. Çelësi i suksesit të zonave të lira të projektuara është lokacioni i përshtatshëm, me infrastrukturë të brendshme të zhvilluar, komunikacion të hapur ndaj botës, fuqi punëtore të lirë dhe të përgatitur, rrethinë politike stabile, mbështetje e shtetit, spektër i zhvilluar i shërbimeve operative, administratë efikase dhe benefite të tjera. Përvojat botërore, tregojnë për suksesin dhe arsyeshmërinë e zonave të lira të cilat janë themeluar në lokacione atraktive dhe të përshtatshme, me instrumente të shumëllojshme të stimulimeve dhe mënyrë të përshtatshme pune.

Njëri ndër faktorët kryesor i cili duhet të ndikoj në vendosjen e zonës, gjithsesi është zhvillimi i hapësirës, qoftë ai qytet apo regjion. Një hapësirë e zhvilluar mirë me një infrastrukturë gjithashtu të zhvilluar mirë, me treg të punës të konsoliduar dhe përparësi të tjera për investitorët potencial është në avantazh shumë më të madh se sa hapësirat të cilat kanë mangësi në faktorët e cituar më lartë. Në anën tjetër për vendet në zhvillim, siç është Kosova, vendosja e një zone të tillë me disa ndërmarrës do të nënkuptonte mundësinë e një zhvillimi më të shpejtë, tërheqjen e investimeve të tjera dhe hapjen e një perspektive të re zhvillimore. Teoria dhe praktika tregon se, zonat e lira të themeluara në lokacione të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike, mundësojnë tërheqje të shpejtë të investimeve direkte dhe rritjen e punësimit, që e ilustron nga praktika e një numri të madh të shteteve

me zona të lira. Krijimi i zonave ekonomike është një nga mjetet më të fuqishme në duart e qyteteve dhe rajoneve për të tërhequr industrinë e saj në një hapësirë të urbanizuar e cila në perspektivën e saj ofron më shumë mundësi për aktivitet ekonomik me qëndrueshmëri më të lartë. Kjo do të thotë se procedurat administrative urbane të miratuara garantojnë zbatimin e zonimit, planifikimin e zhvillimit dhe mbrojtjen e mjedisit, komponente këto të rëndësishme në planifikimet afatgjata.

2.8 Ndimi i faktorëve ekonomik në zhvillimin e zonave të lira

Faktorët gjeografik nuk mund të konsiderohen të vetmit faktorë me rëndësi për formimin dhe funksionimin e duhur të zonave të lira. Kushtet ekonomike dhe politike përbëjnë faktorët të rëndësishëm në formimin dhe zhvillimin e tyre. Si faktorëve me rëndësi në këtë kontest në literaturë numërohen:

- Rrethina potenciale;
- Pozita kufitare;
- Konkurrenca në mes porteve dhe zonave të lira;
- Fuqia punëtore dhe
- Niveli i privilegjeve ligjore.

Në këtë pjesë të studimit tonë do të trajtojmë dy nga faktorët e mësipërm: tregun e fuqisë punëtore dhe nivelin e privilegjeve ligjore.

Tregu i fuqisë punëtore, paraqitet si faktor me rëndësi për krijimin e institutit të zonave të lira. Ky faktor, vjen në shprehje jo vetëm tek zonat e lira të cilat merren me deponimin e mallrave por në veçanti edhe tek zonat të cilat merren me përpunimin e mallrave, gjegjësisht

me prodhimtari industriale. Për bizneset në zonat e lira nevojitet fuqi punëtore profesionale dhe e specializuar, kur bëhet fjalë për përpunimin e mallrave në prodhimtari industriale. Këtij faktori i kushtojnë rëndësi themeluesit e zonave të lira dhe investitorët për prodhimtari industrial në zonë, sidomos kur bëhet fjalë për çmimin e fuqisë punëtore dhe a është ai çmim i lirë në vendin ku po krijohet zona. Faktori i fuqisë punëtore është i rëndësishëm dhe në analizë nuk duhet anashkaluar sepse ndikon në çmimin kushtues të prodhimit final, dhe sa do të jetë më i lirë krahasuar me të njëjtin prodhim apo të ngjashëm të prodhuar jashtë zonës. Zakonisht zonat e lira synojnë që numri më i madh i fuqisë punëtore të jetë nga lokacioni ku është ndërtuar zona.

Në nivelin e privilegjit ligjor, për formimin dhe zhvillimin e zonave të lira, vëmendje e veçantë i është kushtuar themelimit dhe lokacionit të zonës së lirë. Me këtë shprehje të nivelit të privilegjeve ligjore nënkuptojmë lehtësirat doganore, tatimore, të tregtisë së jashtme, kreditore dhe lehtësira të tjera ligjore, të cilat shteti i ofron gjatë themelimit të zonës së lirë në territorin e tij.

Në veçanti i kushtohet rëndësi nivelit të privilegjeve ligjore të shtetit, sepse kjo është një çështje me rëndësi të veçantë dhe mjaft e ndjeshme, qoftë për subjektet ekonomike të cilat do të zhvillojnë aktivitet në zonë të lirë ashtu edhe për ato subjekte ekonomike që do të zhvillojnë aktivitete jashtë „dyerve“ të zonës së lirë në territorin e shtetit ku po themelohet (zhvillohet) zona. Kjo për arsye se duhet të arrihet masa e caktuar dhe përshtatja në ofrimin e privilegjeve ligjore, sidomos në lëmin e doganave, të tatimit dhe transporti për subjektet ekonomike në zonë dhe për ata që zhvillojnë aktivitete jashtë zonës.

Zona e lirë në Nju Orleans ka miratuar transport shumë të përshtatshëm hekurudhor për shfrytëzimin e zonës së lirë, për të tërhequr subjektet ekonomike që të shfrytëzojnë sa më

shumë atë zonë të lirë. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë mospërputhje të madhe në atë aspekt, për shembull në trajtimin tatimor të subjekteve të cilët operojnë në zonë, në raport me ato të cilat operojnë jashtë zonës, por në afërsi të saj. Edhe pse ekziston një përparësi e subjekteve ekonomike të cilët operojnë në zonë të lirë në raport me ata të cilët operojnë jashtë zonës, ajo përparësi nuk mund të jetë me ndikim të madh.

Niveli i privilegjeve ligjore dallon nga shteti në shtet dhe për këtë arsye investitorët e huaj dhe themeluesit e zonave të lira i kushtojnë shumë rëndësi kësaj komponente. Ky faktorë edhe më vonë kur zona e lirë të filloj aktivitetin, do të jetë një nga faktorët me rëndësi dhe prezent për „tërheqjen“ e kapitalit të jashtëm dhe investimet në zonë.

2.8.1 Efektet në ekonominë e vendit

Vlerësimi i ndikimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte të ZLE-ve në vendin pritës është një detyrë e vështirë sepse ato mund të shihen më mirë si një proces sesa një produkt përfundimtar. Megjithatë, me disa ndryshime në analizën e përfitimeve konvencionale, dalin disa rezultate empirike interesante (Warr 1989). Analiza fillon në krahasimin e performancës ekonomike të një ekonomie me ZLE kundrejt ecurisë hipotetike të ekonomisë pa ZLE, dhe kjo analizë është më shumë makro se mikro, në kuptimin që nuk adreson çështjet e shpërndarjes së të ardhurave. Përfitimet neto të vlerësuara përfshijnë fitimin neto në vendin pritës në lidhje me gjenerimin e punësimit, të ardhurat në valutë, shfrytëzimin më të madh të materialeve vendore, pajisjet shtesë të kapitalit dhe të ardhurat shtesë tatimore. Shpenzimet përfshijnë kostot administrative dhe të mirëmbajtjes së ZLE-ve, si dhe infrastrukturën e nevojshme fizike dhe administrative shtesë. Përveç kësaj, ZLE-të sjellin

një numër të efekteve indirekte apo përhapje të cilat nuk mund të atribuohen në terma monetare:

- në mesin e një numri të shërbimeve sociale të ofruara në ZLE, mund të përmendim e spitalet, qendrat mjekësore, institucionet arsimore, përfitimet në mënyrë të tërthortë të punëtorëve;
- ndërmarrjet ZLE kanë kontribuar dukshëm në aspektin e diversifikimit të eksportit.

Shteti duhet të bëjë vlerësimin e efekteve pozitive dhe negative të themelimit të zonave të lira. Sot në botë është zhvilluar ideja e zonave të lira, kështu që tani shfrytëzuesve dhe investitorëve u ofrohen përfitime të cilat nuk mund të imagjinoreshin para dy dekadave. Zonat ekonomike janë rritur me shpejtësi në 20 vitet e fundit.¹³ Sipas Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), ka pasur 176 zona në 47 vende dhe deri në vitin 2015 është vlerësuar se ka rreth 4,300 zona në mbi 130 vende (The Economist, 2015).

Nuk është e mjaftueshme vetëm të predikohet se në disa zona operohet pa taksa doganore dhe pa tatime e obligime tjera, por tani duhet të sigurohen një sërë përfitimesh për biznese, të ketë infrastrukture të zhvilluar, shërbime të lira dhe efikase, etj. Gjatë formimit të zonave të lira moderne dhe konkurrenente është e nevojshme të sigurohen:

• Kushtet e përgjithshme:

- stabilitet politik dhe ligjor i cili garanton sigurinë e investimeve;
- një ligj i veçant për zonat e lira, mundësisht statusi “*elex specialis*”, i cili siguron mbrojtje nga nacionalizimet ose shpronësimet;
- riatdhesimin e lirë të profitit;

¹³ Farole, Thomas. 2011. Special Economic Zones in Africa : Comparing Performance and Learning from Global Experience. Directions in Development ; trade. World Bank. © World Bank. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/2268> License: CC BY 3.0 IGO

- regjim liberal i këmbimit devizor të operimeve dhe posedim i lirë i devizave;
 - themelimi dhe funksionimi i lehtë i ndërmarrjeve në zonë.
- Një sërë përfitimesh doganore si:
 - importi/eksporti i lirë i mallrave dhe shërbimeve në/nga zona;
 - lirimi nga pagesa e doganës në kufijtë e zonës;
 - procedurë e thjeshtë dhe e lehtë doganore.
- Një sërë përfitimesh tatimore.
- Rregulla liberale për punë dhe marrëdhënie të punës në zonë.
- Një sërë përfitimesh në fushën e shfrytëzimit të tokës, ndërtimit të objekteve dhe shfrytëzimin e tyre.
- Infrastrukturë e zhvilluar
 - aeroporti, porti ose rrugët ndërkombëtare dhe hekurudhat;
 - qendrat logjistike, organizim efikas të ngarkimit/shkarkimit të të gjitha llojeve të transportit dhe pajisjeve;
 - depo me qera;
 - telekomunikacioni: telefoni, interneti, mobifoni, lidhjet satelitore;
 - lidhjet infrastrukturore: energjia elektrike, uji, ngrohja, avulli, gasi, kanalizimi;
 - shërbime efikase komunale;
 - shërbime shpërndarjeje, organizimi i transportit, shërbime bankare dhe postiere;
 - shërbime hoteliere dhe shërbime biznesi;
 - shkollat, spitalet dhe banimi;
 - parkingu;
 - sigurimi dhe mbrojtja kundër zjarrit;

- mbrojtja policore;
- qendrat tregtare;
- qendrat për argëtim;
- administratë efikase në zonën e lirë.

Robert D. Sinkler në punimin e tij “Zonat e lira industriale – komponentë të liberalizimit të suksesshëm” (*Robert D. Sinclair, The Maxwell School of Syracuse University, Department of Economics*), me analizë detale matematikore të parametrave të shumtë, vjen te konkludimi se formimi dhe zhvillimi i zonës në mënyrë efikase rrit për 0.52 % normën e rritjes së BPV për banorë. Nga kjo rritje e BPV për banorë, më shumë se 60% është në radhë të parë për shkak të ndikimit direkt të zonës në lëvizjet e fuqisë punëtore në sektorë të ndryshëm. Komponenti i dytë i cili kontribuon në efektin e zhvillimit të zonave të lira, rrjedh nga tranzicioni i drejtë i ekonomisë së lirë.

Për të qenë zonat efikase dhe të dobishme, shteti duhet të siguroj një klimë të përgjithshme miqësore investive në mënyrë që të mos ketë pengesa juridike dhe të sigurisë që mund të shfaqen në disa zona të lira:

- që investitorët të kufizojnë prodhimtarinë e tyre në operacione të thjeshta prodhuese pa transferta juridike të teknologjisë dhe të njohurive;
- pak investime në shkollim dhe aftësim të fuqisë punëtore;
- që ndikimi të transferohet në rrethinë, përderisa çdo gjë zhvillohet në kufi të zonës së lirë;
- mbajtja afatshkurtër e kapitalit pa ndikuar në shtet;
- pjesëmarrja e vogël e lëndës së parë në prodhimtarinë vendore.

Parimet dhe rekomandimet për përcaktimin e iniciativave të duhura i jep Qendra për Koorporatat Transnacionale të Kombeve të Bashkuara (UN The Challenge of Free Economic Zones in Central and Eastern Europe 1991, Centre of Transnational Corporations):

- Kostot e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së zonave të lira duhet t'i mbulojnë shfrytëzuesit e ndërmarrjeve në zona, duke paguar qeran e tokës, hapësirën për zyre dhe mirëmbajtjen, dhe atëherë stimujt e proklamuar nuk do të sjellin humbje.
- Stimulimi nuk duhet të tejkalojë të ardhurat e supozuara në valutë të huaj dhe përfitimet e tjera. Masa e stimulimit duhet përcaktuar sipas qëllimit, për të tërhequr industri specifike dhe për këtë detyrë të vështirë duhen përdorur përvojat nga vende të tjera të botës.
- Stimulimi duhet bërë ashtu që të mundësoj zhvillimin e të gjitha llojeve të aktiviteteve. Përveç shërbimeve prodhuese duhen nxitur edhe shërbimet e marketingut dhe biznesit.
- Stimujt duhet të jenë të qartë, të kuptueshëm, të sigurt dhe të pandryshueshëm.

Shpenzimet për krijimin e zonave të lira janë një çështje e rëndësishme dhe ka përvoja botërore të ndryshme në varësi të karakteristikave dhe studimeve ekonomike të çdo zone, si dhe norma e parashikuar e kthimit të fondeve. Shpenzimet më të mëdha përbëjnë investimet në infrastrukturë dhe objekte, pastaj mjetet fillestare për funksionimin e administratës së zonës dhe mirëmbajtjen, nga momenti kur zona mund të mbështetet dhe të mirëmbahet vet. Rekomandimi për zonat e lira në Kosovë është që të bëhet përpjekje për shfrytëzimin e kapaciteteve të cilët kanë ndaluar së vepruari, ndërsa janë të pajisur me infrastrukturë të nevojshme. Këtu bëhet fjalë për objekte të cilat dikur ishin prona shtetërore, pastaj hapësira

të caktuara me infrastrukturë të konsoliduar, për toka të cilat janë prona publike etj. Çdo projekt investiv, në këtë kontest edhe zona e keq-konceptuar mund të jetë një dështim financiar. Për këtë arsye, gjatë themelimit të zonave insistohet në një studim paraprak fizibiliteti për qëndrueshmërinë e tyre ekonomike.

Me rëndësi të veçantë për arritjen e qëllimit të formimit të zonave është vendosja e konceptit të drejtë të monitorimit dhe mbështetjes së projekteve në zona në nivel shtetëror. Bashkëpunimi i organizuar sistematik dhe kujdesi i vazhdueshëm i shtetit, mund të sjellin rezultatete të mira. Një shembull për Kosovën mund të jetë formimi i një departamenti në kuadër të Ministrisë për Tregti dhe Industri e cila do të merret me zonat, ose krijimi i një agjencioni të veçantë, por të cilat nuk do të ndikonin aspak në autonominë e tyre të bërit biznes.

2.8.2 Ndikimi i zonave të lira në punësim

ZLE përbëhen nga aktivitete me intensitet të lartë të punës dhe ndërmarrjet në ZLE përbëjnë një burim domethënës të punësimit të ri. Për shkak të disponueshmërisë së punës në paga të ulëta, vendet në zhvillim në përgjithësi tërheqin investime në industri të përpunimit të thjeshtë të punës me intensitet të lartë. ZLE-të gjenerojnë punësim për punë të pakualifikuar duke krijuar kërkesa për infrastrukturë fizike brenda zonës. Zonat e lira kanë kontribuar në rritje të konsiderueshme në punësim të popullsisë me arsimim të ulët, duke zgjidhur problemet e mëdha të papunësisë në shumë vende në zhvillim. ZLE nxisin industrinë lokale të ndërtimit, gjithashtu rritet kërkesa për shërbimet si uji, energjia elektrike, komunikimi dhe administrata. Përveç këtyre rritet kërkesa për shërbime të ndryshme mbështetëse si

hotelet, restorantet dhe transporti, që të gjitha këto mund të kenë ndikim thelbësor në gjenerimin e punësimit. Me krijimin e vendeve të reja të punës, shtetet rrisin shkëmbimin në tregtinë e jashtme, në formën e të ardhurave nga jashtë në zonat e lira. Në aspektin ekonomik, punëtorët në zonat e lira paguhën në mënyrë indirekte në monedhë të huaj dhe, nga perspektiva ekonomike, kjo është e ngjashme me eksportin e drejtpërdrejtë të punës. Ata kanë rolin e punonjësve të jashtëm, të cilët fitimet e tyre i derdhin në ekonominë e vendit. Kështu, nëse krijimi ose zgjerimi i një zone të lirë ekonomike do të çonte në përfitime substanciale të punësimit do të varet nga faza e zhvillimit ekonomik të vendit pritës.

ZLE gjenerojnë vende pune përmes tre kanaleve:

- Sigurojnë fitime në valutë të huaj duke gjeneruar kështu fonde zhvillimi, të cilat lehtësojnë gjenerimin e aktiviteteve ekonomike dhe punësimin.
- Gjenerojnë aktivitet ekonomik jashtë zonës për shkak të transformimit të fondeve të investimeve në asetet fikse dhe blerjen e inputeve dhe shërbimeve nga pjesa tjetër e ekonomisë.
- Gjenerojnë të ardhura shtesë, që reflektojnë në një rritje të kërkesës për mallra dhe shërbime të ndryshme si strehimi, arsimi, shëndetësia dhe transporti, etj. të cilat kanë efekte shumëfishuese mbi të ardhurat dhe punësimin.

Programet në zona në shumë raste përbëhen nga veprimtaritë të cilat kërkojnë punë intenzive nga fuqia punëtore. Nëse elektronika dhe industria e tekstitit merren si prodhimtari serike me operacione të punës intensive, shkalla e investimeve në industri me përdorim intensiv të punës në investimet e përgjithshme është 66-68% (në Kore, Tajvan dhe Tajlandë) dhe 56% në Kinë.

Efektet e zonave të lira më shumë i ndjejnë shtetet në fazën fillestare të industrializimit, kur zonat paraqesin program efikas për zvogëlimin e papunësisë, ku në fazën e hershme të industrializimit aftësia e zonave për të absorbuar tepricën e fuqisë punëtore e ndihmon shumë ekonomin shtetërore. Ky krijim dhe ekspansion i zonave varet nga shkalla e zhvillimit ekonomik të vet shtetit ku ndodhet zona e lirë. Zonat, padyshim kanë kontribuar në punësimin e konsiderueshëm të fuqisë punëtore.

Ashtu si të gjitha ekonomitë e tranzicionit në rajon, Kosova liberalizoi ekonominë e saj dhe inkurajoi rritjen e sektorit privat. Krijimi i zonave ekonomike në Kosovë ka ndikuar në inkurajimin e investimeve të sektorit privat dhe për investitorët e huaj. Që nga krijimi i zonave të para në Kosovë janë rritur investimet brenda këtyre hapësirave, janë vendosur në vazhdimësi biznese të reja dhe si rezultat i saj është rritur numri i të punësuarve çdo vit duke përmirësuar gjendjen ekonomike dhe sociale.

Njëkohësisht, zonat kanë reflektuar në ndihmën dhe mbështetjen e qeverisë shtetërore në drejtim të zhvillimit dhe inkurajimit të investimeve në vendin tonë, duke u krijuar lehtësira të vërteta dhe të prekshme për të gjithë investitorët në mënyrë të veçantë atyre që investojnë në zonat ekonomike.

Zonat e lira si gjeneratorë të zhvillimit ekonomik dhe instrument për të tërhequr investimet e huaja direkte dhe teknologjitë e reja mund të jenë të rëndësishme edhe për të kontribuar në zhvillimin më të shpejtë ekonomik dhe zgjidhjen e një prej problemeve më të mëdha në rajon siç është papunësia, e cila kërcënon të bëhet një problem serioz social dhe politik me pasoja afatgjate. Megjithatë, mund të konkludohet se ZLE-të kanë kontribuar dukshëm në punësimin e punëtorëve më pak të kualifikuar edhe pse potenciali i tyre për të zgjidhur problemet masive të punësimit në shumë vende në zhvillim ka qenë mjaft i kufizuar.

2.8.3 Zhvillimi i ZLE-ve faktorë për tërheqjen e investimeve të huaja

Investimet e huaja direkte dhe flukset e tjera të investimeve janë çështje thelbësore në zhvillim që kanë nevojë për një mjedis të përshtatshëm për bashkëpunim politik, ekonomik, teknologjik dhe kulturor midis vendeve. Zhvillimi i politikave qeveritare dhe një mjedisi biznesi janë faktorë që synojnë nxitjen e investimeve të huaja direkte dhe arritjen e një modeli dhe cilësie të caktuar të hyrjes së IHD-ve duke prodhuar rezultatet e dëshiruara. Në një ekonomi në zhvillim dhe në tranzicion si Kosova, burimet qeveritare nuk duhet të jenë të kufizuara, ndërsa vendosja e politikave që lidhen me IHD-të, përfshirë investimet publike ose koncesionet tatimore, janë çështje shumë të rëndësishme. Literatura sugjeron se IHD-të janë një mjet për lejimin e vendeve në zhvillim për të fituar teknologjitë më të avancuara të prodhimit, si dhe për infuzion të aftësive organizative dhe menaxheriale (Aggarwal, 2007). ZLE-të tërheqin IHD të orientuara nga eksporti dhe promovojnë forma të tjera të bashkëpunimit ndërmjet kompanive vendore dhe kompanive shumëkombëshe, duke lehtësuar futjen e NVM-ve (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) vendase në zinxhirët e vlerave globale, duke u ofruar atyre një klimë të përshtatshme investimi (Gereffi 2005). Standardet globale, konkurrenca me kosto të ulët dhe përparimet në teknologji ngrenë sfida për njësitë e ZEL-ve që konkurrojnë në zinxhirët e vlerave globale. Kjo nxit të mësuarit dhe inovacionin, të cilat janë aspekte thelbësore të zhvillimit njerëzor. Kompanitë shumëkombëshe gjithnjë e më shumë janë duke lëvizur aktivitetet e sektorit që janë intensive në përdorimin e fuqisë punëtore të kualifikuar në vendet në zhvillim. Zonat ekonomike në Kosovë janë të hapura për investimet e huaja dhe nuk ekzistojnë kurrfarë kufizimesh dhe pengesash të cilat do t'i pengonin apo do t'i ngushtonin aktivitetet e tyre.

Një mjedis i përshtatshëm biznesi është jetësor jo vetëm për të mobilizuar burimet e brendshme por edhe për të tërhequr dhe përdorur në mënyrë efektive investimet e huaja. Dokumentet e Bankës Botërore (2013) tregojnë prova të një korrelacioni të rëndësishëm midis treguesve të Bërjes Biznesi (DB) dhe flukseve të IHD-ve. Kjo do të thotë që renditja më e lartë e DB-së do të shoqërohet me më shumë investime të huaja, për të cilat besohet se krijojnë vende pune, sjellin teknologji dhe procese të reja dhe kanë efekte të tjera kolaterale të dobishme në ekonominë reale. Në rrugëtimin e themelimit të zonave mund të lajmërohen kufizimet e caktuara të cilat kanë të bëjnë me llojin e veprimtarisë në zonën e lirë si dhe në lidhje me investimet e huaja. Nga ana tjetër, mund të thuhet se ka tendenca shumë të theksuara për të nxitur investimet e huaja në zonat e lira përmes privilegjeve të shumta dhe përfitimeve që jepen për investitorë të huaj dhe investimet e tyre apo edhe për ndërmarrjet e përbashkëta.

Zonat e lira bashkëkohore përpiqen që me anë të privilegjeve dhe përfitimeve të shumta, të tërheqin sa më shumë investime të huaja, teknologji moderne dhe fuqi të lirë punëtore vendore, sidomos në shtetet në zhvillim, në mënyrë që me prodhimet dhe shërbimet e tyre të jenë konkurrencte.

Kur i kemi parasysh një sërë privilegjesh dhe përfitimesh të cilat investitorët e huaj i shfrytëzojnë në zonë të lirë dhe shumë shpesh edhe fuqinë e lirë punëtore vendore, atëherë interesi i investitorëve të huaj është i konsiderueshëm dhe ka të bëjë edhe me prodhimtarinë e tyre bashkëkohore në këto zona. Gjithashtu, investitorëve të huaj u përgjigjet ky zgjerim i prodhimtarisë së tyre dhe dislokimi i tyre në shumë zona, thuajse në të gjitha kontinentet, sepse në këtë mënyrë ata janë prezent në tregjet botërore me prodhimet e tyre finale.

2.9 Parqet industriale

Ndonëse studimi i parqeve industriale mbulon disa dekada, ende nuk ka një definim përfundimtar. Që nga vitet 1950 deri me sot janë dhënë definime të ndryshme (Kovacik, 1965) por definimi më i pranueshëm është ai që e konsideron parkun industrial si një hapësirë e madhe toke, e ndarë në parcela dhe e destinuar për përdorim të njëkohshëm nga disa firma, që karakterizohet nga përdorimi i përbashkët i infrastrukturës dhe afërsia e vendndodhjes së firmave me njëra-tjetrën (Peddle 1990, 1993; Cote & Cohen-Rosenthal 1998; Geng & Hengxin 2009; Geng, Zhang, Ulgiati, Sarkis 2010).

Teoria e parqeve industriale është komplekse. Sipas kësaj teorie parqet industriale duhet të jenë konkurruese (Saleman & Jordan, 2015). Parqet në përgjithësi dhe ato industriale në veçanti konsiderohen një institucion dhe instrument i zhvillimit ekonomik që mund të përdoren edhe nga shteti edhe nga privati (Peddle, 1993). Parqet industriale janë njëri nga faktorët e rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit pozitiv ekonomik. Parku industrial është i bazuar në filozofin e integritit të funksioneve të prodhimit, të shërbimeve, edukimit, etj. në një zonë industriale me shumicë të prodhimit industrial dhe shërbimeve me qarkullim të lartë të ekonomisë dhe punësimit të lartë. Parku industrial është një pjesë e një qyteti e zonuar për përdorim industrial (në krahasim me përdorimin banesorë dhe komercial), mund të përmbajë rafineritë e naftës, portet, magazina, qendra e shpërndarjes, fabrika kimike, prodhuesit e plastikës, aeroportet, përpunuesit dhe prodhuesit e çelikut etj.

Parqet industriale në literaturë i hasim me terme të ndryshme të tilla si pasuri industriale, pasuri tregtare, pasuri të fabrikës, park i zyrave apo fusha të punësimit (Keppl, 2001).

Përkufizimi i gjerë i UNIDO-s për parqet industriale është "një trakt i tokës i zhvilluar dhe i

ndarë në ngastra sipas një plani gjithëpërfshirës me ose pa ndërtime të fabrikave, ndonjëherë me objekte të përbashkëta për shfrytëzimin e një grupi të industrive".¹⁴ Një park industrial është përcaktuar si një zonë e rezervuar për zhvillimin industrial e cila është e vendosur zakonisht në afërsi të ambientit të transportit. Kur është fjala për parqet industriale, ne mund të përmendim *Teorinë e zonave të koncentruara*, e shpikur nga Ernest Burgess¹⁵ (1925) i cili e ka elaboruar këtë teori në bazë të historisë së qytetit të Çikagos në dekadën e fundit të shekullit të XIX (Hoyt, 1939).

Koncepti i parqeve industriale është një fenomen ekonomik që është vendosur në një kontekst konkurrues në të cilën shumë biznese njëherësh konkurrojnë dhe bashkëpunojnë për të fituar avantazhe të ndryshme ekonomike. Parqet më të sofistikuara industriale ofrojnë një gamë të gjerë të objekteve të përbashkëta dhe shërbime mbështetëse, të tilla si konsultime, shërbime financiare, trajnime, udhëzime teknike, shërbimet e informacionit, objektet e përbashkëta kërkimore dhe shërbimet mbështetëse të biznesit për të kënaqur nevojat e korporatave dhe teknologjive për qeramarrësit.¹⁶

Parqet industriale janë pjesë të tokës ndërtimore të destinuar për zhvillim industrial. Një park industrial mund të jetë në pronësi dhe operohet nga një agjensi publike, gjysmë-publike ose një organizatë krejtësisht private (Falcke, 1999). Zakonisht janë të vendosur pranë rrugëve kryesore, lumenjëve të lundrueshëm dhe aeroporteve. Koncepti i parqeve industriale bazohet në idenë e ndërtimit dhe koncentrimit të infrastrukturës lokale në sipërfaqet e lira, jashtë qytetit. Modeli i parqeve industriale si formë e aktiviteteve të

¹⁴ UNIDO. (1997). *Industrial Estates: Principles and Practices*. Vienna: UNIDO

¹⁵Ernest Watson Burgess 16. May 1886 – 27. December 1966 was an urban sociologist at the University of Chicago. Such kind of sociology takes care about life in cities, structure, processes and problems about urbanism and provides outputs for planning and forming of policies.

¹⁶UNIDO. (2002). *Industrial Development Report 2002-2003*. Vienna: UNIDO

ndryshme ekonomike dhe nxitjes së ndërmarrësisë është i shpërndarë në shumë vende të zhvilluara dhe ato në zhvillim. Kjo formë është krijuar si një instrument për tërheqjen e investimeve të huaja dhe në ditët e sotme gjithnjë e më shumë aplikohet në vendet me zhvillim të hovshëm ekonomik. Ky model është i kombinuar me forma të tjera të ushtrimit të veprimtarisë dhe tërheqjen e kapitalit të huaj, siç janë: zonat e lira, parqet teknologjike, inkubatorët e biznesit, zonat industriale, etj. BE në rekomandimet e veta thekson këtë model si jashtëzakonisht të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të ekonomive të vogla kombëtare. Në vendin tonë në vitet e fundit gjithashtu janë të pranishme aktivitetet për ngritjen e parqeve industriale dhe teknologjike. Kosova duhet të hartoj politikat për nxitjen e zhvillimit industrial ashtu siç kanë vepruar edhe shumë shtete të botës. Si pjesë e sistemit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara, UNIDO është përgjegjës për nxitjen e zhvillimit industrial në të gjithë botën në zhvillim, në bashkëpunim me 171 shtetet anëtare të saj. Mbështetja e UNIDO-s është në zhvillimin e sektorit privat prodhues dhe përqendrohet në tri nivele: krijimin e politikave qeveritare, kapaciteteve institucionale dhe aftësi sipërmarrëse dhe teknologjike. Kjo përforcon trajnime në menaxhim dhe vendimmarrje dhe kjo ndihmon në hartimin e politikave kombëtare dhe rajonale për të kontribuar në nxitjen e një klime të favorshme biznesi (Falcke, 1999).

Projektligji mbi parqet industriale në përgjithësi e definon parkun industrial si një kompleks të caktuar të tokës, i cili në mënyrë urbane është paraparë për prodhimtari dhe veprimtari përcjellëse dhe ka infrastrukturë bashkëkohore primare dhe sekondare për kryerjen e veprimtarive industriale dhe i plotëson kushtet e tjera të përcaktuara me ligj. Si park industrial dhe park teknologjik mund të quhet vetëm ai kompleks tokash për të cilën udhëheqësi i parkut teknologjik dhe parkut industrial ka marrë çertifikatën (vërtetimin) e

shtetit të njohjes së statusit të parkut teknologjik, gjegjësisht të parkut industrial, në kuptimin e këtij projektligji. Shfrytëzuesi i parkut industrial është një subjekt ekonomik i cili zhvillon një aktivitet ekonomik në kuadër të parkut industrial. Shfrytëzuesi i parkut teknologjik është subjekt ekonomik, institut shkencor apo universitet i cili realizon veprimtari hulumtuese dhe zhvillimore në kuadër të parkut teknologjik. Mund të ekzistojnë disa lloje të parqeve industriale varësisht nga lloji i pronësisë, lokacionit dhe qëllimit (industrial, teknologjik, inkubator, shkencor - hulumtues etj.).

Është shumë me rëndësi që propozuesi i ligjit e ka pranuar sugjerimin i cili i hap mundësitë për realizimin e idesë (e cila është kyçe në këtë punim) – krijimi i hapësirave fleksibile të zhvillimit industrial, në të cilat ofrohen të gjitha favoret për biznes të destinuar në tregun vendor dhe ndërkombëtar duke kombinuar të gjitha dobitë e zonave të lira dhe infrastrukturën e ndërtuar e cila është karakteristikë e parqeve industriale. Një park modern industrial duhet t'i plotësoj nevojat standarde që kanë të bëjnë me sipërfaqet minimale (rekomandimi për Kosovën është jo më pak se 10 ha), me pronësi të tokës të përcaktuar qartë, të pajisur me infrastrukturë teknike dhe transportuese dhe me kyçje sa më të shpejtë në korridoret kryesore. Është thelbësore edhe lidhja me mjedisin dhe mundësia e shfrytëzimit të llojeve të ndryshme të shërbimeve, të kapaciteteve të akomodimit dhe rekreacionit. Është e nevojshme edhe mbështetja e qeverisë lokale dhe organeve shtetërore. Ndihma shtetërore reflektohet me dispozita ligjore, me ndihmën financiare dhe infrastrukturë, ndërsa qeveria lokale duhet të siguroj shërbime komunale kualitative dhe favore të tjera nga kompetencat e saj, sikurse janë subvencionet e ndryshme dhe lirimet gjatë ndërtimit dhe eksplotimit të objekteve.

Në Francë për shembull, Ministria e Ekonomisë paraprakisht financon deri në 50% të vlerës së shpenzimeve të ndërtimit të infrastrukturës sekondare të parkut, 70% të vlerës së ndërtimit të infrastrukturës sekondare të parkut industrial strategjik dhe deri në 80% të vlerës të ndërtimit të infrastrukturës sekondare të parkut industrial i cili ndodhet në territor të regjionit të pazhvilluar. Ekzistojnë shumë shembuj të parqeve industriale të suksesshme.

Disa elemente të etikës Palme për parqet industriale¹⁷ janë:

- Përgatitja e një plani vendor zhvillimi me rregulloret përkatëse dhe udhëzimet;
- Përgatitja e një raporti paraprak "Gjendja e Mjedisit" për vendin;
- Krijimi i një plani të peisazhit dhe kërkesave arkitektonike për ndërtesat;
- Sigurimi i përputhshmërisë me rregulloret, aktet nënligjore, dhe mbështetjen në udhëzimet operative;
- Të krijojë dhe zbatojë një plan për florën dhe faunën natyrore për të mbajtur ose rivendosur ekuilibrin ekologjik të vendit;
- Zbatimi i një programi për ndërgjegjësimin publik dhe programin e informacionit në lidhje me mjediset natyrore dhe konservimin;
- Krijimi i një shërbimi këshillues për teknologjitë e pastra;
- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi "një vend ndërtimor i pastër";
- Krijimi i një plani për menaxhimin e mbeturinave të ngurta;
- Krijimi i një plani për mbeturinat industriale dhe rrjedhat;
- Krijimi i një plani për menaxhimin e shiut, vërshimet në sipërfaqe dhe ndërtimin e ndonjë instalimi të nevojshëm;

¹⁷United Nations Environmental Programme. The environmental management of industrial estates. Industry and Environment technical report no. 39, Paris, 1997.

- Këshillimi i ndërmarrjeve mbi masat e zvogëlimit të zhurmës;
- Cilësia e monitoruesve të ajrit dhe zhurmave;
- Krijimi i një plani të menaxhimit të energjisë;
- Hulumtimi dhe analiza për burimet alternative të energjisë;
- Themelimi i një mekanizmi ndërlidhës me autoritetet përkatëse vendore;
- Themelimi i një njësie të monitorimit dhe koordinimit.

2.9.1 Fazat e zhvillimit të parqeve industriale

Parë nga dinamikat e zhvillimit, Parku Industrial reflekton disa stade zhvillimi, të cilat mund të përmbliken në pesë periudha kryesore:

- Në periudhën 1900-1930, parku industrial shfaqet si një tipar i zhvillimit në SHBA, ka formën e “distriktit industrial”, zë një sipërfaqe larg qytetit, ndërtohet, zhvillohet, dhe financohet privatisht dhe gjendet i vendosur kryesisht pranë linjave hekurudhore;
- Në periudhën 1940-1950, parku industrial shfaqet i zhvilluar, i menaxhuar, dhe i financuar nga pushteti qendror dhe lokal dhe synon ringjalljen e zhvillimit urban, shënon suksese por nuk i kushtohet ndonjë vëmendje e madhe;
- Në periudhën 1960-1975 parku industrial shfaqet si një realitet që gëzon vëmendje gjithnjë e më të madhe dhe që përhapet në të katër anët e SHBA. Përhapja influencohet nga një numër faktorësh si: zhvillimi i rrjetit të rrugëve, rritja e përdorimit të kamionëve të tonazhit të madh, rritja e pronësisë së makinave, rritja e

kostos dhe konkurrencës së aktivitetit në qendër të qytetit, interesi komercial i bizneseve për parqet industriale, ndryshimet në teknologjinë e prodhimit, zhvillimi i pajisjeve të kontrollit me informacion elektronik etj.;

- Në periudhën 1980-1995 parku industrial shfaq një karakter të ndryshëm. Karakteri i tij nuk është më tipik industrial por fillon të përfshijë edhe aktivitete që kanë të bëjnë me përdorime mikse ose zhvillimin intensiv të tokave;
- Në periudhën 2000-2013 parku industrial shfaq një karakter që reflekton në orientimin dhe lidhjen e ngushtë të destinacionit, funksionimit, dhe zhvillimit të tij me teknologjinë e avancuar, metodat menaxheriale, me kuadrin dhe institucionet ligjore.

Subjekt i trajtimit nga legjislacioni shtetëror dhe vendimet administrative në Kosovë janë bërë edhe parqet industriale që trajtohen në kuadër të ligjit për zonat ekonomike. Me ndërtimin, zhvillimin dhe financimin e parqeve do të arrihet:

- nxitja dhe inkurajimi i investimeve në Kosovë duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim të veprimtarive;
- ndihma në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës, veçanërisht të sektorit privat;
- hapja e vendeve të reja të punës dhe krijimi i të ardhurave;
- tërheqja e teknologjive të përparuara;
- përqendrimi i bizneseve në një vend të caktuar;
- zgjerimi i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve;

- krijimi i kushteve për biznese për afrim më të lehtë në lidhje, transport, furnizim me energji, ujë, shërbime në mbështetje të biznesit dhe rritjen e konkurrencës në biznesin vendor, etj.

Parku industrial përfaqëson formën me tradicionale të zhvillimit të planifikuar industrial që vazhdon ende të ekzistojë me orientim dhe fokus vetëm tek të prodhuarit dhe të qenit i destinuar për të akomoduar firmat dhe industritë prodhuese, depot dhe magazinat. Dinamika e zhvillimit pritet të formojë burimet e përparësisë konkurruese kombëtare dhe të paraqesë sfida të reja dhe mundësi për firmat dhe vendet (O’Sullivan, Andreoni, López-Gómez, & Gregory, 2013).

Parqet, përveç se ndikohen nga kushte dhe faktorë të caktuar (politikat fiskale, kuadri ligjor, politikat kreditore, etj.) këto influencojnë ndikimin e tyre në forma të ndryshme (hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen dhe inkurajimin e investimeve, tërheqjen e teknologjive të reja, nxitjen e investimeve private në veprimtaritë prodhuese etj.).

2.9.2 Madhësia e parqeve industriale

Edhe pse në të gjitha vendet është provuar që parqet industriale të konfigurohen sipas madhësisë, lirisht mund të thuhet se nuk mund të krijohet një standard për madhësinë, por edhe për klasifikimin e tyre. Në disa vende, zonat e vogla kanë më pak se 100 hektarë, të mesmet 100-500, ndërsa të mëdhatë më shumë se 500 hektarë. Një kriter tjetër më i avancuar, më i afërt me realitetin dhe i përkrahur është se zonat e vogla kanë deri në 50 hektarë, të mesmet deri në 100, ndërsa të mëdhatë më shumë se 100 hektarë.

Ka diskutime të shumta për madhësinë optimale, por edhe për lokacionin optimal. Ekspertë të ndryshëm përcaktojnë madhësinë bazuar në numrin e të punësuarve. Në Francë dhe Belgjikë, dendësia e vendeve të punës në zonat industriale shkon mesatarisht në mes të (60-70) punëtorëve për hektarë, me 20% në fushën e ndërtimit. Në SHBA rrallë do të gjendet një ndërmarrje industriale e cila ka një sipërfaqe më të madhe se 10 hektarë e vendosur në zonën industriale.

2.9.3 Format moderne të parqeve industriale

Parqet industriale eksportuese në kohët moderne kanë vëmendjen më të madhe, veçanërisht në vendet në zhvillim. Zona e parë e këtij lloji është themeluar në Irlandë (Shannon) në vitin 1959 (Akinci & Crittle, 2008) dhe tjetra në Indi (Kandla). Nga vitet 1970 numri i tyre është rritur me shpejtësi. Qëllimi kryesor i këtyre zonave është tërheqja e investimeve të huaja direkte dhe teknologjisë moderne për të ndërtuar kapacitete të reja industriale dhe për të promovuar industrializimin dhe eksportet e vendeve në zhvillim, pastaj për të rritur fitimet në valutë të huaj dhe për të inkurajuar punësimin. Qëllim tjetër i këtyre zonave është edhe përmirësimi i cilësisë së produkteve me çmime më të ulëta, e cila do të rriste konkurrencën jo vetëm në tregun lokal por edhe në atë ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i zonave industriale në vendet e zhvilluara është për të stimuluar zhvillimin e industrisë klasike, futjen e teknologjive të avancuara dhe për të rritur eksportet e larta, me qëllim forcimin e pozitës në trendet e globalizimit. Në shumicën e parqeve industriale në vendet industriale në zhvillim, në fazat e para të zhvillimit ka mbizotëruar prodhimi i

veshjeve dhe produkteve elektronike, pastaj montimi i pajisjeve për automobila dhe prodhime të tjera komplekse. Disa nga forma të organizimit të këtyre zonave janë:

- Zonat e lira bankare u krijuan në fillim të viteve 1960, kur transferuan një pjesë të aktiviteteve të tyre në vende të tjera në të cilat masat restriktive kanë qenë më pak të rrepta apo ku aktivitetet e tyre zhvilloheshin me më pak kufizime. Shtetet që kanë nisur themelimin e zonave bankare janë Panamaja, vendet e Karaibeve, Bahrain, Hong Kong, Singapor, Luksemburg etj.;
- Zonat e lira turistike sot ekzistojnë në disa vende të zhvilluara si një kategori e veçantë për zhvillimin e turizmit elitari. Ato ofrojnë banim me cilësi të lartë duke ju ofruar klientëve të tyre shërbime me kërkesat më të larta dhe më të shumëllojshme;
- Zonat e informacionit (Telezone) janë hapësira të veçanta të qendrave të fuqishme të informacionit ku rrjedha, përpunimi dhe shitja e informacioneve të ndryshme, kryesisht zhvillohet në mënyre të integruar. Ato ofrojnë shërbime të telemarketingut dhe zhvillojnë sistemet e IT-së për kompanitë, bankat, hotelet, etj. Ky lloj i zonave të lira u aktualizua në fund të viteve '80 në Xhamajka dhe në Republikën Domenikane, me mbështetjen e autoriteteve publike dhe SHBA-ve, për tu shndërruar më vonë në korporata të mëdha të telekomunikacionit;
- Parqet shkencore dhe teknologjike janë zona të veçanta për krijimin dhe komercializimin e produkteve dhe shërbimeve të reja për tregun botëror në bazë të kërkesës së lartë teknologjike në bashkëpunim të ngushtë midis industrisë, institucioneve kërkimore shkencore dhe universiteteve;
- Zonat komplekse të lira janë zona në të cilat në të njëjtën kohë zhvillohen disa lloje të aktiviteteve të vendosura në disa pjesë të zonave. Ato kryesisht përfshijnë

tregtinë, industrinë, bankat dhe turizmin, aktivitete që shpesh plotësojnë njëra-tjetrën. Shembuj të zonave të tilla janë Hong Kongu, Singapori, etj.

Llojet e mësipërme të parqeve dhe modeleve të tjera të papërmendura në analizën tonë janë rezultat i zhvillimit të përshpejtuar ekonomik dhe përpjekjes për pjesëmarrje sa më të suksesshme në tregun global. Marrëdhënia e tyre dimensionale dhe funksionale mund të manifestohet me prodhimin, marketingun apo marrëdhënie të tjera biznesi.

2.9.4 Roli i parqeve industriale në tërheqjen e teknologjive të reja dhe nxitjen e investimeve

Parqet industriale janë një mjet i rëndësishëm zhvillimi i adoptuar nga shumë vende të industrializuara (Hakansson dhe Johanson, 1993). Rritja e mbështetur nga teknologjia e përdorur në parkun industrial hap mundësi për krijimin e vendeve të reja, përmirësimin e produktivitetit lokal edhe ruajtjen e një mjedisi konkurrues në vendin përkatës (Markusen et al, 1986). Parqet industriale të periudhës 2000-2013 shfaqen si një realitet që gëzojnë vëmendje gjithnjë e më të madhe dhe që përhapen jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Rritja është influencuar nga zhvillimi i rrjetit të rrugëve, ndryshimet teknologjike, zhvillimi i pajisjeve të kontrollit me informacion elektronik e mbi të gjitha interesi i bizneseve për parqet industriale. Sipas disa autorëve, ndër efektet kryesore sa i përket nxitjes së investimeve dhe tërheqjes së teknologjive të reja përfshihen:

- 1) Rritja e aktiviteteve të qendrave të kërkimeve studimore dhe zhvillimit (Luger & Goldstein, 1991);
- 2) Formimi dhe zhvillimi i kompanive dhe firmave private (Peddle, 1993); dhe
- 3) Rritja dhe zhvillimi ekonomik i rajonit (Luger & Golstein, 1993).

Duke ditur se në parqet industriale kryesisht kryhen aktivitete të karakterit industrial, të gjitha bizneset janë të karakterit prodhues me orientim dhe fokus vetëm tek të prodhuarit. Të qenit i destinuar për të akomoduar bizneset dhe industrinë prodhuese, depot dhe magazinat, në parkun/zonën industrial në Ferizajt të gjitha bizneset janë të karakterit prodhues. Të gjitha bizneset për herë të parë kanë filluar punën dhe me këtë rast kanë instaluar makineritë prodhuese që i përkasin teknologjive të avancuara. Përve makinerive dhe përvojave të fituara nga vendet e zhvilluara, në parkun industrial kanë sjellur edhe kulturë të punës. Ekziston një bashkëpunim i mirë ndërmjet tyre pasi që produktet e prodhuara mund të jenë pjesë përbërëse e ndonjë produkti final brenda zonës.

Inkurajimi i investimeve të huaja, si një instrument i rëndësishëm në rritjen ekonomike, duhet të mbështet nga institucionet me program të ndërtuar mbi objektiva të qarta e të matshme. Nisur nga kjo, mund të thuhet se duhet ndërtuar infrastruktura ligjore që i hap rrugë krijimit të parqeve industriale të cilat duke kombinuar mbrojtjen e të drejtave të pronës private, pushimin tatimor dhe tarifën preferenciale afatgjatë të përdorimit të tokës, tërheqin investimet e huaja direkte (Wang, 2013)

Krijimi i zonave ekonomike, parqeve të biznesit, parqeve industriale etj., është bërë adresë referimi e investitorëve të ndryshëm. Aktualisht kanë filluar të funksionojnë disa zona ekonomike të cilat janë emërtuar në varësi të mënyrës së funksionimit dhe llojeve të bizneseve të cilat veprojnë në këto zona. Ndër to është edhe parku/zona industrial në Ferizaj i cili është themeluar me vendim të asamblesë Komunale në vitin 2003. Në këtë zonë janë vendosur të gjitha kompanitë që kishin aplikuar në fazën e parë, të cilat kanë qenë shtysa kryesore për të nxitur dhe inkurajuar edhe bizneset e rajonit, të konkurrojnë në vendosjen e bizneseve në zonat ekonomike që shtrihen në territorin e Kosovës. Numri i investitorëve që

janë të interesuar të investojnë shtohet çdo ditë, sikurse është duke u rritur edhe numri i parqeve industriale.

2.9.5 Ndikimi i politikave fiskale në zhvillimin e parqeve industriale

Politika fiskale njihet si proces i formulimit të tatimeve dhe të shpenzimeve publike në funksion të gjenerimit të cikluseve rritëse ekonomike dhe të disperzionit ekonomik të cilësuar me shkallë të lartë punësimi dhe të mbrojtur nga ciklet inflatore. Pra me termin politikë fiskale nënkuptojmë mënyrën se si qeveria zgjedh të shpenzojë buxhetin e saj me qëllim të furnizimit të qytetarëve me shërbime dhe mallra publike – shpesh duke u referuar si “shpenzime”. Këto mallra dhe shërbime përfshijnë infrastrukturën publike, edukimin, shëndetësinë, sigurinë publike, gjyqësinë etj. Qeveria përpiqet t’i gjejë metodat më të mira për financimin e këtyre shpenzimeve nëpërmjet llojeve të ndryshme të tatimeve si: TVSH, taksat doganore, tatimet në të hyra personale, tatimet në të hyra të korporatave, kontributet për sigurimin social, etj. Gjatë zbatimit të politikave tatimore, akteret mundohen të sigurojnë nivel të ulët të ngarkesave tatimore dhe trajtim të barabartë si për biznese, ashtu dhe për qytetarë. Objektivat e politikave fiskale ndryshojnë dhe mund të përfshijnë:

- Alokimin e të hyrave publike (tatimet);
- Stabilitetin makroekonomik;
- Rritjen ekonomike, dhe
- Rishpërndarjen e të hyrave.

Lehtësirat tatimore në zonat e lira duhet të jenë një nga stimujt kryesorë duke ofruar tatime të zvogëluara ose përjashtime në të ardhurat e korporatave, pasurinë, fitimet, tatimi në të

ardhura në veprimtaritë e pavarura, tatimi në të ardhura autoriale, tatimi në të ardhura nga kapitali, tatimi në të ardhura nga patundshmëritë dhe tatimi në përfitimet nga kapitali, së paku për vitet e para të punës. Pjesë të rëndësishme të sistemit të stimulimit paraqesin dhe lehtësirat doganore.

Sistemi i përfitimeve dhe benefiteve të cilat i jep shteti duhet kombinuar me përfitimet dhe lehtësirat lokale të departamenteve të cilat janë pjesë e ndikimit në parqet industriale.

2.10. Zonat e lira në Bashkimin Europian

Historia e Zonave të Lira Ekonomike (ZLE) në Europë mund të ndiqet në shekullin e 15-të. Pas Luftës së Dytë Botërore, ZLE u zhvilluan shumë shpejtë dhe u përhapën në të gjithë botën. Ato janë në faza të ndryshme të zhvillimit dhe kanë prejardhje të ndryshme politike dhe ekonomike, në mënyrë që ZLE të posedojnë nomenklatura të shumta dhe tipologji të ndryshme. Aktualisht janë të paktën 66 terma të ndryshëm për të përshkruar atë që është e njohur përgjithësisht si ZLE. Në vitet 1970 dhe 1980, ZLE në Europë kanë arritur konkurrencën ndërkombëtare dhe standarde të larta të punësimit, edhe pse ato janë bazuar në firmat lokale të vogla dhe të mesme dhe të përqendruara në sektorët tradicional (Schmitz & Musyck, 1994). Këto kanë krijuar një multi-zinxhir të grupeve të ndërlidhura të firmave, duke përfituar nga kosto të ulëta, përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorin dhe avantazhet reciproke konkurruese (Jizi, 2012).

Zonat e Lira Ekonomike kanë ekzistuar për shekuj me radhë, fillimisht për të inkurajuar tregtinë dhe normalisht mori formën e zonave në shkallë qyteti të vendosura në rrugët e tregtisë ndërkombëtare, të tilla si Gibraltar (1704), Singapor (1819), Hong Kong (1848),

Hamburg (1888), dhe Kopenhagen (1891)¹⁸. Ashtu si disa studiues dhe organizata, të tilla si Grubel,¹⁹ Qendra e Bashkuar Kombëtare në Korporatat Transnacionale,²⁰ Fan Sujie,²¹ dhe Xiangming Chen,²² preferojnë të përdorin "zonë të lirë ekonomike", si një përcaktim të përgjithshëm për të mbuluar të gjitha llojet e tjera të ZLE, sepse ato mund të përgjithësojnë karakteristikat e tyre dominuese. Në Bashkimin Europian, ndonëse ekzistojnë opsionet alternative (eksporti i përkohshëm i mallit dhe deponimi, depot doganore, kthimi, prodhimtaria nën kontrollë doganore etj.) është ruajtur sistemi i zonave të lira. Pritet që ky koncept të zhvillohet edhe më tej, për të mundësuar operacione më të lira. Zonat në BE mundësojnë koncentrim dhe modernizim teknologjik dhe investime direkte në fusha të ndryshme. Në vendet e industrializuara, anëtare të BE, më të rëndësishme se koncepti doganor i zonave tregtare të Europës, janë mjetet inkurajuese të zhvillimit regjional, sikurse janë lehtësirat doganore dhe direktivat shtetërore për ndihmë. Parqet industriale dhe teknologjike dhe koncepti modern i zonave – inkubator për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe qendrat logjistike me investime të unifikuara në transportin e mallit, janë drejtime ku zonat e lira të BE do ta gjejnë vendin e tyre. Në zona po aplikohet përdorimi i doganimit bashkëkohorë të mallit (sasitë e mëdha të mallit të bashkësisë dhe lirimi nga dogana) dhe praktika moderne e punës (përdorim më i shpeshtë i teknikave të

¹⁸FIAS The Multi-donor Investment Climate Advisory Service of the World Bank Group], "Special Economic Zones: Performance, Lessons Learned, and Implications for Zone Development, " 2008, p.9.

¹⁹Grubel, Herbert G. (1982), "Towards a Theory of Free Economic Zones", In: "Review of World Economics", Vol. 118/1

²⁰United Nations Center on Transnational Corporations (1991), "The Challenge of Free Economic Zones in Central and Eastern Europe: International Perspectives", United Nations, New York

²¹Fan Sujie, Wang Guangzhong (1993), "World Free Economic Zone", (Shijie Ziyou Jingjiqiu), People's Publishing House, Beijing

²²Xiangming Chen (1995), "The Evolution of the Free Economic Zones and the Recent Development of Cross-National Growth Zones", In: "International Journal of Urban and Regional Research", Vol. 19, p. 593, explanation

kontrollit të llogarive më shumë se verifikimi fizik i mallit). Zona e lirë ekonomike moderne filloi të funksionoj në fund të viteve '50, me ngritjen e zonës së lirë ekonomike në Shannon të Irlandës në vitin 1959, duke u njohur gjerësisht si modeli i parë modern të ZLE²³.

Themelimi i ZLE në Europë është i veçantë karshi ZLE në kontinentet e tjera. Kjo për arsye se në Europë, në bazë të marrëveshjes multilaterale, është formuar Bashkimi European i cili konsiderohet si integrimi më i fuqishëm ekonomik në Europë. Anëtare të këtij Bashkimi doganor sot janë 28 shtete të fuqishme ekonomike. Qarkullimi i mallrave në mes të shteteve të cilat janë anëtare të këtij Bashkimi doganor bëhet pa obligime për pagesë të tagrave importuese. Për këtë arsye mbi këto ZLE nuk bëhet kontrolli fizik i mallrave që dalin ose hyjnë në ZLE. Kësisoj vendet anëtare të Bashkimit European nuk kanë interes për themelimin e ZLE në vendet e tyre për mallrat të cilat kanë origjinë nga shtetet anëtare të këtij integrimi ekonomik. Edhe përkundër kësaj, ZLE ekzistojnë edhe në këto vende, por ato funksionojnë vetëm kur në to vendosen mallra me origjinë nga vende të cilat nuk janë anëtare të këtij Bashkimi doganor. Sot në vendet anëtare të Bashkimit European ekzistojnë 74 ZLE. Që të gjitha, pavarësisht se në cilin shtet janë të themeluara, veprojnë në vështirësi të Kodit Doganor të Bashkimit European. Edhe më lartë është thënë se ZLE e parë në Europë është themeluar në Irlandë, fillimisht për të mbështetur aeroportin ndërkombëtar të Shannonit. Zgjerimi i bashkësisë tani më e ka ndryshuar pamjen për numrin dhe karakterin e zonave të lira në Bashkimin European. Shumë shtete si Hungaria, Çekia, Sllovakia dhe Polonia kanë zona të lira prodhuese mjaft të zhvilluara, kështu që përveç aspektit tregtarë, shumë më tepër po e rrisin karakterin prodhues.

²³Michael Engman et al., "Wxport Processing Zones: Past and Future Rle in Trade and Development, " OECD Trade Policy Working Paper No.53, TD/TC/WP (2006)39/FINAL (23 May 2007), p.11.

Bashkimi Evropian bashkë me shtetet anëtare të pranura së fundmi (Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia, Sllovenia, Bullgaria, Rumania) dhe kandidatët për anëtarë të BE më 2012, bashkëpunojnë në harmonizimin e ligjeve të tyre nacionale për zonat e lira me dispozitat e ligjit doganor të BE të cilat kanë të bëjnë me zonat e lira dhe depot doganore. Kjo është shumë me rëndësi edhe për zonat e lira në Kosovë për integrimin e tyre në BE sepse me kohë duhet të fitohen përvojat e nevojshme të zonave të lira të Europës.

Sipas kësaj kornize ligjore, zonat e lira ekonomike janë bashkësi territoriale doganore të cilat mundësojnë:

- Që mallrat, të cilat nuk i përkasin bashkësisë, të konsiderohen sikur nuk janë në territor të bashkësisë doganore, për arsye të masave doganore dhe politikave tregtare;
- Që mallrat e bashkësisë të klasifikohen si produkte të cilat do të trajtohen në eksportin e mallrave (p.sh. kompensimi i shpenzimeve të eksportit) në bazë të rezervave që ndodhen në zonë të lirë.

Ligji fiskal i bashkësisë e ka pezulluar tatimin në vlerën e shtuar (TVSH) për mallra të cilat ndodhen në zonën e lirë. Shërbimet të cilat kanë të bëjnë me zonat e lira gjithashtu mund të lirohet nga tatimi në vlerën e shtuar. Gjatë gjithë kohës sa mallrat ndodhen në zonën e lirë, akciza nuk paguhet. Mallrat, prejardhja e të cilave nuk është nga BE, kur hyjnë në zonën e lirë nuk konsiderohen se kanë prekur territorin doganor. Deklaratat import – eksport bëhen kur malli largohet nga zona e lirë. Ekzistojnë edhe përjashtime (lehtësira) të tjera për mallrat në zonat e lira të Bashkësisë Evropiane, të cilat kanë të bëjnë me tatimin, akcizën, tatimin në qarkullim dhe taksat lokale, të cilat ndryshojnë nga zona në zonë. Në zonat e lira

të BE, shërbimet e dedikuara për biznese kanë lehtësime apo përjashtime nga formalitetet doganore. Përparësitë në zonat e lira të BE janë se, malli është i liruar nga formalitetet doganore, gjatë hyrjes në zone të lirë, gjatë deponimit, transportit dhe trajtimit në territorin e vendeve të BE-së. Para zgjerimit të madh të Bashkimit Europian, deri në vitin 2004, kanë ekzistuar 31 zona të lira në 15 shtete anëtare të saj në atë kohë²⁴. Në këtë çështje në një takim të përfaqësuesve të shteteve që kanë zonave të lira (Londër, 4 Dhjetor 2003), znj. Marjut Hannonen thekson se në BE, zonat e lira tregtare kanë të njëjtin rol si depot doganore. Deponimi doganor është një procedurë sipas së cilës mallrat e importuara ruhen nën kontroll doganor në një vend të caktuar, pa pagesën e detyrimeve dhe taksave. Në BE, për dallim nga disa vende të tjera, zonat e tregtisë së lirë janë pjesë e territorit të doganave dhe taksave. Prandaj, rregullat e bashkësisë për harmonizimin dhe koordinimin e taksave, si dhe ndihmën shtetërore, aplikohen në këto territore.

Pas ndryshimit të fundit në Kodin Doganor Komunitar, në dhjetor të vitit 2000, kemi një ndarje në dy lloje të zonave të lira. Në llojin tradicional "llojin e kontrollit të I-rë të zonave të lira", i cili ka rregulla të veçanta. Në këtë kontekst, mallrat të cilat janë sjellë direkt në zonën e lirë nuk i nënshtrohen doganimit. Hyrja fizike në zonë të lirë e fut nën statusin e zonës së lirë. Gjatë ri-eksportimit të mallrave, duhet të deklarohen në doganë. Megjithatë, kjo kërkesë është subjekt i përjashtimeve të caktuara, dhe ndryshon për ato mallra të cilat nuk janë shkarkuar apo janë shpërndarë. Në "llojin e kontrollit të II-të të zonave të lira" aplikohet deponimi formal doganor. I vetmi ndryshim në krahasim me depot e doganës është në lidhje me importimin e mallrave direkt në zonën e lirë dhe të cilat nuk shkarkohen, por vetëm shpërndahen. Në raste të tilla, kërkesa për deklarimin e arritjes apo nisjes së

²⁴European Commission, TAXATION AND CUSTOMS UNION, List of free zones.

mallrave në doganë mund të lehtësohet. Në BE, zonat e lira janë kryesisht të orientuara nga eksporti, si parqe teknologjike apo qendra të logjistikës me teknologji më bashkëkohore ose si zona industriale. Koncepti është ruajtur, për të mundësuar operimin më të lirë dhe zhvillimin regjional. Privilegjet tatimore të cilat zonat e BE i ofrojnë janë:

- Lirimi nga TVSH;
- Heqja e akcizës;
- Tatimi në të ardhura;
- Tatimi në të ardhurat e korporatave dhe
- Tatimi në patundshmëri.

Sa i përket lehtësirave doganore, nuk ekzistojnë kurrfarë kufizimesh për çështjen e sasisë, prejardhjes dhe destinimit të mallit. Zonat e lira mundësojnë koncentrimin e teknologjisë moderne dhe investime direkte. Edhe në rastet e normave të ulëta doganore, kjo që është më me rëndësi në zonat e BE-së, është lirimi nga tatimet dhe ndihma direkte e shtetit. Qeveria Irlandeze i ofron mbështetje të plotë zonës me lehtësira të mëdha tatimore dhe me mbështetje financiare. Ajo që Shannon konkretisht ju ofron shfrytëzuesve të vet, janë përfitimet-lehtësirat doganore dhe subvencionet e shtetit. Irlanda është shembull i transformimit të ekonomisë bujqësore në zona të lira ekonomike. Në vitin 1958 i është përkushtuar rritjes së zhvillimit të industrisë me anë të investimit në reklama, për të inkurajuar transferin e teknologjisë dhe futjen e shumëllojshmërisë në prodhimtari, rritjen e punësimit, dhe në këtë mënyrë e ka ndaluar migrimin. Për t'ia arritur qëllimit të vet, Irlanda kishte planifikuar të financoj pasurinë industriale, të heqë dorë nga taksat e importit për lëndën e parë dhe të mbështet shkollimin. Irlanda ka zgjedhur modelin e zhvillimit të zonave të orientuara nga eksporti, sepse ajo nuk e kishte të zhvilluar industrinë, kështu që

ajo mund të aplikonte privilegjin e importeve pa doganim. Kompanitë e huaja janë të inkurajuara për të investuar edhe me shtyrjen e pagesës së tatimit në të ardhurat e korporatave. Shërbimi Doganor në Irlandë ishte i arsimuar dhe në gjendje të organizonte trajnime të veçanta për monitorimin e investitorëve të huaj dhe importeve të tyre.

Tabela 2. Formalitetet doganore në zonat e lira në BE

Lloji i Kontrollit të I-rë	Lloji i Kontrollit të II-të
Formalitetet kur mallrat hyjnë në zonë nga jashtë BE-së	
Nuk është e nevojshme deklarata doganore (neni 38 dhe 47 KDK (Kodi Doganor Komunitar) Nuk është e nevojshme për të raportuar mallrat për çdo procedurë doganore në qoftë se ajo do të shitet në zonë (Neni 166 KDK)	Merret një deklaratë doganore me përjashtim nëse mallrat kanë një procedurë të veçantë (neni 38 dhe 47 KDK) Nëse ju nuk jeni duke planifikuar të hyni në territorin e lirë doganor të BE-së mund të përfshihen në zonën e lirë 20 ose 40 ditë në qoftë se malli ka ardhur me anije (neni 48.49 KDK)
Formalitetet mbi hyrjen dhe daljen e mallit me origjinë nga BE	
Hyrja e mallrave nga BE-ja është e lirë me kusht që vërteton origjinën e mallit (Neni 169-170 KDK) Me hyrjen në territorin doganor të BE-së mallrat kalojnë nën rregullat për mallrat e blera në territorin doganor (Nenet 37,47,177,179 dhe 180 KDK)	Nuk ka formalitete për hyrjen dhe daljen e mallrave, sepse supozohet se ato kanë statusin e mallrave vendore. Vlen procedura e rimbursimit të eksportit (Neni.98 KDK)
Lejet e veçanta	
Nuk ka leje të veçanta për aktivitetet dhe trajtimin e mallrave (Neni 172-174 KDK) Është i nevojshëm për të plotësuar formularin e magazinimit (Neni 176 KDK)	Autorizohen procedurat me mallrat si manipulimi, magazinimit, etj. (Nenet 85,100,105,106 dhe 109 KDK)
Formalitetet me rastin e magazinimit të mallit	
Duhet ndarë dokumentacioni për mallrat me origjinë nga BE-ja, përveç për ngarkimin dhe mbajtjen e shkurtër (Neni 176 KDK)	Mbajtja e dokumentacionit në kontroll lidhur me origjinën e mallrave (Nenet 168a, 105 dhe 106 KDK)
Borxhi doganor me rastin e mungesës (zhdukjes) së mallrave	
Zhdukja e pashpjegueshme e mallrave obligon pagesën e detyrimeve doganore (Neni 205 KDK)	Humbja e mallrave obligon pagesën e detyrimeve doganore (Neni 203 dhe 204 KDK), përveç në rast të rrethanave të paparashikuara, në varësi të natyrës së mallit
Formalitetet kur mallrat hyjnë nga vendet e BE me licencë doganore nga vendi i origjinës	
Lajmërimi (regjistrimi) i ri-eksportit, përveç për transit si dhe transport dhe ruajtje e shkurtër (Neni 182 KDK).	Deklarimi i riekportit, ose vetëm transportim mallrashtransitsi dhe transportimi dhe ruajtja e shkurtër (neni 182 KDK)

Burimi: Dr.Francesca Trampus World Free Zone Convention 2003; The EU regulation on Free Zones and Kyoto Convention on the simplification and harmonization of Customsprocedures of 18 May 1973, amended by the Protocol of Brussels of 26 June 1999.

Një nga zonat e lira të suksesshme në BE është **Zona e Lirë e Barcelonës** që është vlerësuar një nxitës i zhvillimit ekonomik të qytetit por edhe më gjërë. Në kuadër të zonës ekziston një zonë e lirë industriale dhe Parku Logjistik i zonës. Zona përfshinë 160.000 m². Të gjitha ndërtesat janë në pronësi të Konsorciumit, i cili menaxhon me zonën, dhe i jepen me qera palëve të treta, të cilat janë të interesuara për biznes detyrime doganore. Në zonë, ka mbi 100 kompani, 25 prej të cilave përdorin një zonë magazinimi edhe konsiderohen si operatorë duty-free. Në vitin 2012 numri i të punësuarëve në këtë zonë ishte mbi 700 punëtorë, ndërsa fitimi arriti në 24.5 milion euro. Investimet e realizuara brenda një viti kapin shumë mbi 60 milion euro. Kualiteti i ofertës dhe lokacioni i veçantë, mundësojnë 100% shfrytëzim të kapaciteteve dhe listën e gjatë të pritjes të shfrytëzuesve potencial.

Pas viteve 90-të, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor²⁵ kanë kaluar në një periudhë relativisht të gjatë tranzicioni, nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi të tregut të lirë. Kësisoj, duke kaluar nëpër fazën e tranzicionit, u orientuan kah zhvillimi ekonomik i vendit me metoda dhe forma të konceptit të ekonomisë me treg të lirë. Kushti i parë në këtë drejtim ishte harmonizimi i legjislacionit të tyre në fuqi. Në këtë drejtim këto vende nxorën ligjet përkatëse mbi angazhimin e kapitalit të jashtëm, siç ishte ligji mbi themelimin e ZLE. Sipas (Farole & Kweka, 2011) ligji për zonat ekonomike duhet t'i jap një mandat ligjor autoritetit rregullator për të fuqizuar atë dhe për të kryer dy role, atë të monitorimit dhe zbatimit të standardeve dhe si një "one-stop-shop" si lehtësues për investitorëve. Përmes

²⁵ E. Pere "Economic trade relation in focus of regional integration of West Balkans Countries"; (First International Conference on Balkan Studies ICBS'08, Tirana 7-8 November 2008; proceedings: ISBN: 978-99956-681-3-6; fq. 197 - 209).

"one-stop-shop" bizneset do të kenë qasje në të gjitha kërkesat institucionale dhe plotësimin e dokumentacionit në një vend (Burani, 2016).

Edhe **Republika Çeke** ka ndjekur trendin e vendeve tjera në lidhje me krijimit të zonave të lira ekonomike dhe momentalisht ka tetë zona të lira. Pas rënies së Perdes së Hekurt në vitin 1989, filloi riorientimi i vendit drejtë Perëndimit, gjithashtu forcimi i mëvonshëm ndodhi si rezultati i ndarjes së Çekosllovakisë në fillim të vitit 1993²⁶. Në republikën e Çekisë është e njohur zona industriale strategjike Ostrava-Mosnov është plotësisht e hapur për aktivitete moderne tregtare, veçanërisht duke u fokusuar në eksportet dhe inovacionet teknologjike. Kjo zonë është e akredituar nga agjencia për investime ndërkombëtare, Czech Invest dhe e mbështetur fuqimisht nga shteti. Kjo zonë ka sipërfaqen aktuale 200 ha, ndërsa sipërfaqja për shitje për investitor është 164 ha. Zona ndodhet 25 km në jug të qendrës së qytetit dhe është shumë e përshtatshme për transport rrugor, hekurudhor ose ajror. Zona industriale Ostrava-Hrabova është një lokalitet strategjik për zhvillimin e qytetit Ostrava. Projektet në këtë zonë kanë marrë rëndësinë themelore për atraktivitetin e lartë ekonomik të krijimit të qytetit dhe vendeve të punës. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës e pajisur me infrastrukturën brenda zonës industriale është 110 hektarë.

Hungaria sikurse shtetet e rajonit ka hartuar strategji për të tejkaluar më lehtë dhe më shpejtë problemet e tranzicionit dhe privatizimit, për të zhvilluar një ekonomi tregu dhe për të tërhequr investime të huaja në vend. Duke filluar nga mesi i viteve tetëdhjetë, Hungaria

²⁶The separation of Slovakia - the eastern part of the former Czechoslovak federation – increased both the geographic and the political distance between the Czech Republic and East Europe, shifted the centre of gravity of the country westward (see Illner and Andrlé in this issue) and increased the importance of its western neighbour.

ka hapur ekonominë e saj për investitorët e huaj dhe procesi i tranzicionit i ka ofruar mundësi nëpërmjet privatizimit të firmave shtetërore (Szanyi, 2003).

Hungaria po zhvillon dy koncepte të ndara: Parqet industriale dhe Zonat e Lira. Parqet industriale në Hungari ofrojnë benefite për investitorët vendor dhe të huaj si toka të pajisura me infrastrukturë të rregulluar, për ndërtime të kapaciteteve prodhuese dhe deponuese (uji, rryma, telefoni, interneti etj.), lidhje me rrugët kryesore dhe shërbime të ndryshme në operime. Qeveria lokale ofron të gjitha llojet e privilegjeve dhe lehtësirave me rastin e themelimit të ndërmarrjeve në parqe, sikurse është toka e lirë dhe shërbimet komunale, administrimi i thjeshtë dhe favore të ndryshme për investitorë, kështu që shumë parqe industriale janë tani aktive në Hungari.

Zonat e lira në Hungari janë enklava speciale, të regjistruara nga ana e shërbimit doganor (Nacional Headquarters of the Customs and Finance Guard), të cilat konsiderohen si eksterritoriale në raport me pjesën tjetër të shtetit në aspektin e doganave dhe tregtisë së jashtme. Kështu, karakteristika e "eksterritorialitetit" të zonave të lira janë të dukshme nga tre faktorë. Së pari, mallrat transportoheshin nga një zonë e lirë në pjesën tjetër të territorit të vendit apo anasjelltas, ato konsideroheshin sikur të ishin importuar, respektivisht eksportuar nga territori doganor. Së dyti, mallrat në zonat e lira zakonisht i nënshtrohen kontrollit doganor fleksibël, si masa të zbatuara nga autoritetet doganore për të siguruar përputhjen me ligjin doganor. Së treti, mallra që hyjnë në zonat e lira zakonisht gëzojnë përfitimet ekskluzive tatimore dhe doganore²⁷.

Hungaria në zonat e lira të saj ofron favore në lirim nga tatimi – në 5 vitet e para 60%, kurse pas 5 viteve 40% sipas të gjitha bazave tatimore. Nëse bëhet fjalë për mallra

²⁷Sherzod Shadikhodjaev, "International University Press), Vol.10, No.2 (2011), pp.192-193.

strategjike të rëndësishme për shtetin, lirimi nga tatimi është 100% në 5 vitet e para, më vonë 60%. Nëse investimi i huaj është më i lartë se 30% ndërmarrja – shfrytëzuesi i ZLE është liruar nga pagesa e tatimit në të ardhura. Dërgesa e mallrave në zonë konsiderohet dhe subvencionohet si eksport. Zonat e lira industriale zhvillohen duke i tejkaluar të gjitha pritjet në disa vite të kaluara. Pjesëmarrja e tyre në eksportin e Hungarisë është rritur nga 24,8% në vitin 2006 në 52% në vitin 2012. Hungaria ka të zhvilluara 179 parqe industriale të destinimeve të ndryshme në të cilat veprojnë ose kanë një pjesë të prodhimtarisë 30 kompani transnacionale me qarkullim prej 4,1 miliardë dollarë. Në fund të vitit 2002, 2152 ndërmarrje që operuan në parqe ofruan 128,000 vende pune (15.7% e të punësuarve në industri), kontribuan për 26.3% të shitjeve të përgjithshme industriale dhe për 39% të eksporteve industriale²⁸.

Bullgaria ka themeluar zonën e saj të parë të lirë në vendin Ruse në vitin 1987. Më vonë, ajo themeloi pesë zona të tjera. Zona e lirë Plovdiv, konsiderohet si zonë e suksesshme dhe më fitimprurësja. Zona e lirë në Burgas ka hapësirat më të mëdha të magazinimit dhe objektet e shpërndarjes të makinave në Bullgari, dhe shfrytëzohet nga më shumë se 100 ndërmarrje të huaja dhe sipërmarrje të përbashkëta, duke përfshirë Samsung dhe Daewoo. Prodhimi i kufizuar kryhet në ZL Plovdiv dhe ZL Ruse. Në përgjithësi, Bullgaria ka tërhequr një numër të investitorëve të huaj në prodhimtari dhe aktivitete tregtare në ZL, duke përfshirë Hyundai, Kia Motors, CITCO, Schawartskopf, Henkel, Monumente chemicals Ltd, Grupi Scneider, Bindlach Enegric ZLstems GmbH.

²⁸Ministry of Economy and Transport, 2003

2.11 Praktikë menaxheriale të zonave ekonomike në Rajon

Pas rrënimit të murit të Berlinit, të gjitha shtetet e Ballkanit të cilat i përkisnin Bllokut të vendeve socialiste, dikush më herët e dikush më vonë u shkëputen nga koncepti komunist i cili predikonte zhvillimin e vendit me ekonomi të dirigjuar. Duke kaluar nëpër fazën e tranzicionit, ato u orientuan kah zhvillimit ekonomik i vendit me metoda dhe forma të konceptit të ekonomisë me treg të lirë. Kushti i parë në këtë drejtim ishte harmonizimi i legjislacionit të tyre në fuqi. Në këtë drejtim këto vende nxorën ligjet përkatëse mbi angazhimin e kapitalit të jashtëm ndër të cilët ishte edhe ligji mbi themelimin e ZLE. Sot ZLE e hasim në të gjitha vendet ballkanike, pa asnjë përjashtim.

Institucionet shtetërore duhet të ofrojnë shërbime efektive dhe me kohë për krijimin dhe funksionimin e zonave të lira. Kjo përfshinë hartimin dhe zbatimin e programeve të investimeve, funksionimin efikas të doganave dhe institucioneve të tjera mbikëqyrëse.

Në çdo rast, fenomeni i zonave të lira në njëzet vitet e fundit ka qenë studim i ekonomistëve në mbarë botën. Ka mendime pro dhe kundër, por kjo është vetëm e rëndësishme për të dizajnuar në mënyrë korrekte zonat, të cilat mund të miratohen nga institucionet ndërkombëtare (përmes negociatave të barabarta), duke sjellë rezultatet e projektuara të shtetit dhe rajonet në të cilat janë themeluar.

Në **Sllloveni** ekzistojnë dy zona ekonomike, në Kopër dhe Maribor, dhe 6 zona doganore. Sipas legjislacionit në fuqi ZLE mund t'i themelojnë një ose disa persona juridik. Në kuadër të zonës janë të lejuara të gjitha aktivitetet ekonomike legale. Mallrat janë të liruara nga TVSH në importin e lëndës së parë dhe pajisjeve. Shfrytëzuesit paguajnë tatim në të ardhura të korporatave me normë prej 10% (norma zyrtare është 25%). Investitorët të cilët

investojnë në infrastrukturën e zonës janë të liruar për 50% nga tatimi në mjetet e investuara. Ofrohen edhe privilegje tatimore për 50% të bazës tatimore për pagat e praktikantëve për një periudhë prej 6 muajsh. Qendra e mbështetjes biznesore (BSC) në Kranj, gjatë vitit 1998 ka orientuar shumicën e aktiviteteve të saj në ndërtimin e qendrës së re. Këshilli komunal i komunës Kranj ka ndarë 2000 m² të tokës ndërtimore, për t'u ndërtuar inkubatori i cili ka qenë pjesë e projektit PHARE. Parku teknologjik ka statusin e zonës publiko-private ku kompanitë teknologjike përfshihen në një mjedis të favorshëm me mundësi të zhvillim të teknologjive të reja, prodhimeve dhe shërbimeve të avancuara, si dhe qasje në një treg më konkurrent.

Në këtë zonë gjithashtu janë të përfshira edhe aktivitetet në vijim:

- Krijimi i klimës së përshtatshme për zhvillimin e bizneseve të bazuara në shkathhtësitë dhe njohuritë lokale;
- Promovimi i vetëpunësimit si trend modern në shoqëritë bashkëkohore;
- Krijimi i imazhit pozitiv të sipërmarrësve;
- Krijimi i një platforme e cila do të ofronte informacione të detajuara për bizneset;
- Krijimi i vendeve të reja të punës.

Zonat e lira në **Kroaci** paraqesin pjesë të caktuar të territorit doganor të Republikës së Kroacisë, dhe mund të themelohen me marrjen e lejes për hapjen e ZL në portin e caktuar, ose me vendim të veçantë të Republikës së Kroacisë. Investitorët në ZL me aksione më shumë se 150 000 €, lirohen nga tatimi në fitim. Shfrytëzuesit e tjerë paguajnë tatimin në të ardhura të korporatave 50% të normës zyrtare. Ndihma gjatë themelimit të zonave të lira dhe mbikëqyrja e afarizmit i është besuar Departamentit të Zonave të Lira në Ministrinë e Ekonomisë. Aktivitetet të cilat mund të kryhen në zonat e lira të Kroacisë janë:

prodhimtaria, montimi, shitja me shumicë, aktivitetet e shërbimit, veprimtaria bankare dhe aktivitete tjera financiare, aktivitetet e sigurimit etj. Mallrat e prodhuara në ZL i nënshtrohen detyrimeve doganore vetëm gjatë importit në Kroaci. Në Kroaci operojnë 13 zona të lira të aprovuara nga Ministria e Ekonomisë, por me karakteristikën e zonave të lira ekonomike: Krapinsko-Zagorska, Kukuljanovo (Rijeka), Limani Rijeka, Osijek, Podi (Shibenik), Limani Ploqe, Limani Split, Splitsko-Dalmatinska, Obrovac, Zagreb, Pulë, Buje. Kroacia e ka miratuar Ligjin për Zonat e Lira në vitin 1996. Sipas këtij Ligji, ndërmarrjet në zonë mund të merren me prodhimtari, tregti me shumicë, por jo edhe me tregti me pakicë, me tregti të jashtme, veprimtari bankare ose veprimtari të tjera financiare. Shfrytëzuesit e ZL kanë të drejtë lirimi nga dogana në prodhimet e importuara. Shfrytëzuesit të cilët ndërtojnë ose marrin pjesë në projekte të ndërtimit të infrastrukturës në zone, të cilët janë me vlerë prej 1 milion kuna (HRK), kanë të drejtë:

- Përfshirjen nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave ose uljen e kësaj takse për pesë vitet e para të funksionimit të zonës;
- Përfshirjen nga kufizimet të tjera që lidhen me tregtinë e jashtme apo aktivitetet devizore;
- Përfshirjen nga detyrimet doganore dhe taksat mbi mallrat të cilat nuk do të vihen në qarkullim apo nuk do të përdoren në tregun e brendshëm.

Këto zona të lira ekonomike kanë ndikuar në tërheqjen e investimeve, veçanërisht të IHD-ve, si qendra tregtie ndërkombëtare për ata operatorë që i përdorin këto zona vetëm për pak kohë. Shumë kompani vendase janë vendosur brenda këtyre zonave si dhe është shtuar prezenca e investitorëve të ndryshëm. Zona e lirë është pjesë e caktuar e territorit të Republikës së Kroacisë ndërsa firmat dhe prodhimet i nënshtrohen rregullave doganore

sipas ligjit mbi zonat e lira. Zona e lirë në Kroaci mund të themelohet me marrjen e koncesionit për hapjen e zonave, gjegjësisht me marrjen e lejes për hapjen e zonës në portin përgjegjës, ose me vendim të veçantë të Republikës së Kroacisë. Zonën e lirë mund ta themeloj cilido person fizik dhe juridik vendor ose i huaj.

Shfrytëzuesit të cilët marrin pjesë në projekte e infrastrukturës, dhe nëse investimet e tyre i tejkalojnë 1.000.000 kuna (rreth 150.000 USD), janë të liruar nga pagesa e tatimit në 5 vitet e para. Ndërmarrjet e tjera të cilat operojnë në zonë, paguajnë tatimin në të ardhura i cili është sa gjysma e vlerës së ndërmarrjeve jashtë zonës. Shfrytëzuesit e zonës nuk i nënshtrohen kufizimeve doganore, tatimore dhe administrative. Prodhimet nga zonat e lira mund të lëvizin lirshëm në mes zonave të lira, ndërsa dogana paguhet vetëm gjatë importit në Kroaci. Përveç një kuadri të favorshëm për kushtet e operimit, zonat e lira në Kroaci nuk i kanë plotësuar pritjet, ndonëse arritjet nuk janë të vogla. Në zonat e lira të Kroacisë momentalisht janë të punësuar mbi 2.000 punëtorë në rreth 300 ndërmarrje, ndërsa investimet e përgjithshme në zona në vitin 2013 kapin shumën prej rreth 100 milion kuna.

Turqia është një shembull shumë i mirë i nxitjes së investimeve të huaja direkte dhe zhvillimit ekonomik të vendit, nëpërmjet krijimit të zonave ekonomike. Autoritet lokale shpronësuan tokat private me çmimin e tregut dhe pastaj filluan me ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme brenda zonës. Në Turqi aktualisht ekzistojnë katër lloje zonash ekonomike:

- Zonat e tregtisë së lirë;
- Zonat e organizuara industriale;
- Zonat e zhvillimit teknologjik;
- Parqet industriale.

Parku industrial Gebze është njohur si “praktika më e mirë” jo vetëm nga Turqia, por edhe nga shumë vende të tjera në rajon dhe jashtë tij. Gjithashtu, është dhe një model i mirëfilltë zhvillimi i partneritetit publiko-privat, dhe është njohur nga Banka Botërore si një operacion i suksesshëm për të ulur barrierat administrative të investimeve në Turqi.

Në **Federatën e BH** shfrytëzuesit e ZL janë liruar nga të gjitha tatimet dhe kontributet, përveç kontributeve për të ardhurat e punëtorëve. Sa i përket privilegjeve doganore, mallrat në zonë janë të liruara nga pagesa e doganës gjatë importit dhe eksportit.

Zona e lirë industriale në Mostar ka një sipërfaqe prej 37.000 m² dhe ndodhet në rrjetin e hekurudhës, Mostar-Sarajevë-Osijek-Budapest. Zonën e adminitron ndërmarrja për menaxhimin e zonave, ndërsa përfitimet janë:

- Shërbimet komplete bankare, të shpërndarjes dhe të sigurimit;
- Pagesat me valutë të huaj në mënyrë të lirë, në kuadër të aktiviteteve biznesore të cilat zhvillohen në zonë;

Qeveria Maqedonase e ka miratuar ligjin për zonat e lira ekonomike në qershor të vitit 1999. Zonat janë nën kompetencat e departamentit për zonat e lira ekonomike. Përfitimet të cilat ofrohen janë:

- Në zonë nuk paguhen detyrimet doganore për lëndën e parë, pajisje, mallrat e përdorimit të përgjithshëm, prodhimet bujqësore dhe ushqimore;
- Lirimi nga tatimi në të ardhura dhe tatimi në pronë për 10 vite;
- Lirimi i përgjithshëm nga TVSH;
- Gjatë ndërtimit shfrytëzuesi lirohet nga taksa për kontribute dhe detyrime të tjera në lidhje me shfrytëzimin e tokës ndërtimore, kyçja në rrjetin e ujësjellësit, të ngrohjes, gazit dhe energjisë elektrike.

Maqedonia, aktualisht ka katër zona industriale: zona Bunarxhik 1 dhe Bunarxhik 2 në Shkup dhe nga një në Shtip dhe Tetovë. Sipas Drejtorisë së Maqedonisë për Zonat e Zhvillimit Teknologjik e Industrial, plani është të hapen shtatë zona të tjera të lira ekonomike në Prilep, Gjevgjeli, Strumicë, Kërçovë, Rankovc, Strugë dhe Radovish. Investitorët në zonat e lira nuk paguajnë TVSH dhe janë të përjashtuar nga taksa mbi të ardhurat dhe taksa mbi të ardhurat personale për dhjetë vjet që nga fillimi i tyre. Investitorët e huaj në zona janë gjithashtu të përjashtuar nga pagimi i (5-20) % të detyrimeve doganore për importin e mallrave, materialet e papërpunuara dhe pajisjet. Vlera totale e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara në vitin 2012 në zonat e lira në Maqedoni u rrit për 29.13 %, duke arritur në 1.3 milion euro.

Në **Mal të Zi** është themeluar ZLE në qytetin e Tivarit e quajtur "Zona e Lirë", Porti Bar. Praktika e deritanishme e kësaj zone të lirë ekonomike dëshmon për avantazhet e të bërit biznes në zonën e portit. Meqë shfrytëzuesve të kësaj ZLE, qeveria e këtij shteti me ligj ka përcaktuar favore të shumta, shërbimet e kësaj ZLE i shfrytëzojnë 29 operatorë ekonomik, nga të cilët 19 janë operatorë vendor ndërkaq 10 prej tyre janë të huaj.

2.12 Zhvillimi i zonave të lira në Shqipëri

Në Shqipëri historiku i zonave ekonomike fillon me përpjekjet për hartimin e kuadrit përkatës ligjor. Ligji i Koncesioneve si dhe Ligji për zonat ekonomike inkorporon praktikën më të mirë procedurale në zhvillimin e kësaj iniciative, duke qenë plotësisht konform

legjislacionit europian të ndihmës shtetërore përsa i përket trajtimit të zonave të lira ekonomike.²⁹

Qeveria shqiptare në vitin 2007 ka miratuar një kornizë bazë ligjore "Mbi krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", "Mbi miratimin e rregulloreve në lidhje me krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike", më qëllim sigurimin e bazës ligjore dhe institucionale për krijimin e zonave të lira ekonomike dhe parqeve industriale. Qysh nga viti 2010, qeveria ka miratuar nëntë zona ekonomike, tetë prej tyre kanë statusin e parqeve industriale, ndërsa njëra statusin e zonës së lirë. Parashikohen afërsisht 60 milion euro investime dhe krijimi i 30 mijë vendeve të punës.

Qeveria e Shqipërisë po ndërmerr një gamë të gjerë të reformave strukturore për të forcuar sundimin e ligjit, rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe për të krijuar një mjedis ndërkombëtar konkurrues të biznesit. Shqipëria ka një kuadër ligjor mbështetës për Investimet e Huaja Direkte (IHD), Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë me tregjet kryesore rajonale dhe më gjerë, forca konkurruese dhe të reja të punës, regjime të favorshme tatimore dhe doganore të shpejtë, përmirësimin e klimës së biznesit duke rritur normat e IHD-ve dhe në përgjithësi rritje të ekonomisë. Zonat ekonomike do ti hapin rrugën investimeve të huaja, dhe për Shqipërinë do të nisë një kapitull i ri i zhvillimit industrial. Konsiderohet si një objektiv i rëndësishëm që ndikon në rritjen e investimeve të huaja, si dhe rritjen e aftësisë së kapaciteteve gjeneruese në vend. Parqet industriale synohet të bëhen operative për të siguruar shërbime të standardeve të larta për investitorët që vijnë.

Iniciativa për zhvillimin e zonave ekonomike gjen shprehjen e saj procedurale në Ligjin "Për Zonat Ekonomike" dhe konceptin e saj juridik në ligjin e Koncesioneve. Shqipëria ka

²⁹Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik Bashkia e Tiranës

miratuar ligjin Nr. 9789 për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike. Deri tani janë programuar 7 parqe industriale kombëtare. Për tre parqe janë lidhur kontratat dhe në total investimi parashikohet në 55 milionë euro, ndërsa janë planifikuar të punësohen deri në 30 mijë punëtorë. Në disa qytete të Shqipërisë janë formuar disa zona ekonomike të emërtuara parqe industriale.

Tabela 3. Projektet e Parqeve Industriale në Shqipëri

Zonat dhe lokacioni	Propozimi	Destinacioni	Vlera e Investimeve
Parku Industrial Shëngjin, sipërfaqe 3.2 ha	"ATX International" zhvillim /operim për 35 vjet	Qendra Tregtare dhe Industriale. Industria e përpunimit të lehtë.	17,054,152 € 1400 - 3000 vende pune
Parku Industrial Koplik, sipërfaqe 61 ha	AIIOA	Qendra Tregtare dhe industriale	16,374 vende pune
Parku Industrial, Spitallë, Durrës sipërfaqe 850 ha	METE	Qendra Tregtare dhe Industriale. Aktiviteteve komerciale dhe prodhuese.	109 milion lekë për projektin e fizibilitetit
Parku Industrial Shkodër, sipërfaqe 130 ha	Bashkia Shkodër	Rivitalizimi i Brownfield	5.3 milionë USD
Parku Industrial Vlorë, sipërfaqe 125 ha	"Idea Vlora"	Qendra industriale. Prodhimit të lehta, përpunim i ushqimit.	20,819,797 € 18,586 vende pune
Parku Industrial Elbasan, sipërfaqe 254.7 ha	METE	Revitalizimi i ish-zonës bimore metalurgjike industriale.	41 milionë lekë për projektin e fizibilitetit
Propozimi për "Zonë e Lirë" në Portin e Durrësit	KURUM Steel Co Sh.p.k.Tiranë	Aktivitetet e riparimit të anijeve. Ndërtimi i anijeve të reja.	7.3 milion € 600 vende pune
Propozimi për "Zonë e Lirë" dhe kontejnerë port në Triport, Vlorë	"ZumaX LTD"	Kontenierë	1.7miliardë€

Burimi: METE

Qeveria shqiptare po promovon sërish zonat industriale, si projekte të levërdishme ku mund të fokusohet interesi i investitorëve të huaj. Krijimi i parqeve dhe zonave industriale do të

ndikojë në rritjen e aftësisë konkurruese të industrisë shqiptare për eksport dhe si projekte të levërdishme ku do të mund të fokusohet interesi i investitorëve të huaj. Veprimtaria ekonomike që zhvillohet në këto zona është e orientuar më shumë drejtë rritjes së eksporteve se sa drejtë mbrojtjes së tregut lokal. Por nga ana tjetër, ndikon në rritjen e punësimit lokal, në një performancë më të lartë të fuqisë punëtore si rezultat i trajnimeve të marra gjatë punës, në rritjen e prodhimit vendas si dhe në futjen e teknologjisë bashkëkohore.

Shqipëria, në dritën e të qenit një treg i vogël, mund të përfaqësoj një vend shumë interesant për IHD-të për shkak të pozicionit të saj të veçantë gjeografik dhe afërsia me tregun evropian³⁰. Shqipëria përshkohet nga Korridorit VIII që është bosht i izhvillimit të Bashkimit Evropian. Një faktor tjetër që tërheq vëmendjen e investitorëve është forca dinamike e moshës së re punëtore, kostoja e ulët e punës dhe norma relativisht të larta të rritjes ekonomike në krahasim me vendet fqinje.

Parku industrial në Vlorë gjendet në veri-perëndim të qytetit të Vlorës, në zonën e quajtur Jalli të Nartës, në një sipërfaqe prej 125 ha. Investimet që parashikohen në këtë park kapin vlerën prej 21 milion euro, do të zërë një sipërfaqe prej 125 ha dhe do të ofrojë vende pune për rreth 18000 persona.

Projekti urbanistik i konceptuar, përmban rrjetin rrugor me profile të ndryshme me qëllim që çdo njësi prodhuese apo e shërbimit të ketë qasje të lehtë në komunikacion. Është planifikuar parcelizimi paraprak i blloqeve që krijon shumëllojshmëri të tipologjive të

³⁰Totoni, A., Qefalia, A. (2000). Industrial parks in the balkans and their performance in competitiveness growth and FDIs attraction. IBAC 2012 (1), 331-343.

sipërfaqeve të cilat mund të bashkohen apo të ndahen për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të të interesuarve si për kategoritë e prodhimit ashtu dhe atyre të shërbimeve.

Lokacioni i parkut industrial të Vlorës mund të konsiderohet si vend strategjik sepse është :

- 5.7 km larg nga Porti i Vlorës;
- 151 km larg nga kryeqyteti Tirana;
- Është pjesë e Korridorit të 8-të;
- Është ngjitur me autostradën Adriatik-Jon;
- 147 km larg nga Aeroporti Kombëtar i Tiranës "Nënë Tereza".

Zona ekonomike me statusin e **“Parkut Industrial” në Koplik**, Shkodër, është miratuar më 4 janar 2008, me kërkesën e shoqërisë “Zona Industriale dhe Tregtare Koplik”. Zona shtrihet në 61 hektarë. Leja është dhënë për aktivitete prodhuese industriale, agropërpunimi, tregtare etj.

Është programuar për t'u shtrirë në mbi 60 hektarë dhe me një vlerë investimi mbi 18 milionë euro dhe 16 mijë vende pune. Shoqata e Sipërmarrësve Italianë që operojnë në Shqipëri (AIIOA) ka realizuar një projekt me të cilin synon të zotërojë, e vetme ose në bashkëpronësi me qeverinë shqiptare një zonë prej 70 ha në veri të Shkodrës, në brendësi të së cilës të realizojë një zonë të vërtetë industriale tërësisht të dedikuar sipërmarrësve që operojnë në Shqipëri. Brenda zonës industriale do të ketë hapësira të destinuara për: aktivitete prodhuese, zyra dhe shërbime (studio profesionale, banka, sigurime, agjensi, dogana etj), shërbime mjekësore (roje mjekësore, ndërhyrje e shpejtë, mjekësi e punës), zona të dedikuara për trajnim, shoqërizim etj. Përveç këtyre, ky projekt kompleks parashikon edhe ndërtimin e ambienteve dhe faciliteteve ndihmëse dhe rekreative të tilla si hotel, restorant,

ishull i gjelbër, teatr i hapur, shatërvan, etj. Kopliku³¹ ka shërbyer e shërben si një nyje lidhëse midis Malit të Zi dhe qytetit të Shkodrës, prandaj plani parashikon tri pika hyrjeje përgjatë autostradës E762, drejtuese primare për në Malin e Zi që përbën një aks strategjik si për pikë të mundshme drejtimi ashtu dhe treg furnizimi. Rajoni i Shkodrës njihet si rajon me evoluim të fortë, me një ekonomi aktive si dhe me lidhje të ngushta me Italinë dhe Europën Perëndimore. Mund të konsiderohet si urë për gjithë zonën ballkanike duke marr për bazë avantazhet e pozicionit gjeografik.

Parku Industrial në Spitallë të Durrësit është me sipërfaqe 850 ha me pronësi shtetërore dhe private. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, agropërpunuese, tregtare dhe shërbyese.



Figura 2. Pozicioni i tre parqeve industriale: Koplik, Spitallë dhe Vlorë

³¹ Plani Lokal i Veprimt në Mjedis, 2008.

Parku industrial në Spitallë, tani i emërtuar “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” është në fazën e shpalljes së konkursit për zhvilluesin e zonës.

Vendndodhja e planifikuar është në pozitën e favorshme strategjike, ndërsa shumë faktorë luajnë një rol të rëndësishëm në këtë: flukset e ardhshme të mallrave dhe akset e trafikut trans-europiane, porti i Durrësit, e ardhmja e rrjetit rrugor dhe e ardhmja e rrjetit hekurudhor. Përparësitë e lokacionit janë:

- Parku është i vendosur në rrethinën e Durrësit, vendi i dytë më i zhvilluar në Shqipëri;
- 36 km larg nga kryeqyteti Tirana;
- Shkëmbimi i drejtpërdrejtë me autostradën Tiranë–Durrës, përqendrimi më i lartë i bizneseve në Shqipëri;
- 6.4 km larg nga porti i Durrësit, porti kryesor shqiptar dhe një nga më të mëdhenjt në detet Adriatik dhe Jon;
- 33 km larg nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës "Nënë Tereza";
- Kryqëzimi i Korridorit të 8-të dhe autostradës Adriatik-Jon (korridori i kaltër).

Parku Industrial në Shëngjin të Lezhës është shpallur zonë ekonomike në vitin 2008. Lezha është një nga bashkitë që gjendet në rajonin perëndimor të Shqipërisë, i cili ka qenë dhe mbetet rajoni më i zhvilluar në Shqipëri.³² Lokacioni ku është paraparë ndërtimi i parkut industrial shtrihet në një sipërfaqe prej 3.2 ha, pronësi shtetërore. Aktivitetet që do të ushtrohen janë prodhuese, industriale, agropërpunuese, tregtare, eksport-importi dhe shërbyese.

³²Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2030, Bashkia Lezhë

Në këtë park është planifikuar një investim prej 17 milion euro. Këtu do të krijohen, sipas planifikimeve 3 mijë vende pune. Degët kryesore të industrisë në rajonin e Lezhës dikur ishin industria e drurit dhe letrës, e materialeve të ndërtimit (tulla, tjegulla etj.) si dhe industria ushqimore (përpunimi i peshkut). Industria, zhvillimi i së cilës vazhdon edhe sot, është industria ushqimore e përfaqësuar nga industria e përpunimit të peshkut.



Figura 3. Parku industrial në Lezhë

Numri i bizneseve të regjistruara që nga viti 2005 deri në vitin 2012 ka shënuar një ngritje, prandaj investimet në parkun industrial do të jenë të mirëpritura për sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për biznese si dhe do të ndikojnë në rritjen e numrit të të punësuarve.

Tabela 4. Numri i kompanive aktive në periudhën 2005-2012

Bizneset sipas aktivitetit	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Ndërtim	5	10	8	10	11	15	12	12
Industri	211	268	212	356	418	325	240	285
Tregti	56	71	125	226	335	448	435	462
Shërbimi	185	208	211	218	227	186	172	156
Transport	1	1	1	1	2	2	2	2
Total numri i bizneseve	457	557	656	810	991	974	859	915

Burimi: Bashkia Lezhë

Në kuadër të planit strategjik për zhvillim të qëndrueshëm, do të përfshihet edhe trajtimi i zonës ekonomike gjegjësisht parkut industrial. Strategjia e zhvillimit³³ duhet të përmbajë elemente të ndryshme me tematikë aktuale dhe me kohë të qëndrueshme, duke respektuar dëshirën dhe nevojën e realizimit të interesave individuale të kolektivit dhe shoqërisë së gjerë për zhvillimin e ndërmarrjeve ekzistuese dhe për krijimin e kushteve të formimit dhe zhvillimit të bizneseve të reja. Pjesë përbërëse e strategjisë duhet të jetë edhe infrastruktura sepse paraqet njërin nga sistemet themelore fizike të një vendi apo popullsisë së komunitetit, duke përfshirë rrugët, shërbimet komunale, uji, kanalizimi etj.³⁴. Sigurimi i një infrastrukture funksionale është baza për funksionimin dhe zhvillimin e parkut industrial dhe është njëri prej standardeve që duhet plotësuar në funksion të zhvillimit ekonomik dhe nxitjes së investimeve të huaja.

Në **Parkun Industrial në Shëngjin** parashikohen investime rreth 17 milionë euro në një periudhë funksioni koncesionare për 35 vjet. Investimet parashikohen të bëhen nga magazinimet deri tek tërheqja e investitorëve për prodhime të teknologjive të larta duke nxitur punësimin dhe tërheqjen e investitorëve. Zona shtrihet në një sipërfaqe prej 3.2 ha me pronësi shtetërore. Në këtë zonë ekonomike do të zhvillohen veprimtari: prodhuese, industriale dhe agropërpunimi, tregtare, eksport-import dhe ndihmëse.

Ky projekt është i rëndësishëm jo vetëm për zhvillimin e pjesës veriore të Shqipërisë, por është i një rëndësie të veçantë edhe për bashkëpunimin në fushën e zhvillimit të vendeve të rajonit, Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë.

³³M.Mustafa, E.Kulltovci, P.Gashi, P.Krasniqi.lit.”Biznesi i vogël dhe i mesëm”. Fq . Nr. 172. Prishtinë, 2006.

³⁴Frank Barry,“ FDI, Infrastructure and the Welfare Effects of Labor Migration”, University College Dublin, January 2002

KAPITULLI III: PARQET DHE ZONAT EKONOMIKE NË KOSOVË

3.1 Karakteristikat e zonave ekonomike dhe parqeve industriale në Kosovë

Duke ditur rëndësinë e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin ekonomik, në Kosovë në periudhën e pasluftës kanë lindur iniciativat nga qeveritë lokale dhe komuniteti i biznesit për shpalljen e zonave të ndryshme që emërtoheshin si: zona industriale, parqe të biznesit, parqe industriale, inkubator të biznesit etj. Këto organizime paraqesin avantazhet e grupimit të bizneseve në një territor të caktuar si instrument të zhvillimit ekonomik lokal (Shao, Zilibotti & Alder, 2013) e kombëtarë. Grupimet janë dimensione të rëndësishme të mjediseve të forta të biznesit (Ketels & Memedovic, 2008). Përcaktimi i grupeve bazohet në tri shtylla kryesore. Shtylla e parë është gjeografia. Grupimet janë të shtyrë nga afërsia dhe shpesh janë të përqendruar në një rajon, në një komb të madh dhe nganjëherë në një qytet. Shtylla e dytë është krijimi i vlerës. Grupet përfshijnë kompanitë në industri të ndryshme që janë të lidhura me njëra-tjetrën në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve me vlerë nga konsumatorët. Shtylla e tretë është mjedisi i biznesit. Grupimet janë të prekura nga kushtet e mjedisit të biznesit specifik që rezultojnë nga veprimet individuale, bashkëpunimin e kompanive, agjensive qeveritare, universiteteve dhe institucioneve të tjera të sistemit kombëtar dhe rajonal si dhe të inovacionit (Lundvall, 1988, Lundvall, 1993, Freeman, 1995; Edquist, 1997; Cooke dhe Morgan 1998; Cooke et al, 2000; . Cooke, 2001).

Bazuar në historinë e suksesit të parqeve industriale në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, në përputhje me tendencat e fundit për krijimin e parqeve industriale, Kosova

është një vend që ka hedhur hapat e parë në krijimin e infrastrukturës ligjore për themelimin e zonave ekonomike.

Duke pasur parasysh nevojën për vendosjen e rregullave për ngritjen dhe zhvillimin e zonave ekonomike në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe punësimit në Republikën e Kosovës, qeveria në vitin 2009 miraton ligjin për zonat ekonomike. Subjekt i trajtimit nga legjislacioni shtetëror dhe vendimet administrative vendore, janë bërë edhe parqet industriale që trajtohen në kuadër të ligjit për zonat ekonomike. Me ndërtimin, zhvillimin dhe financimin e zonave ekonomike është synuar që të arrihet:

- nxitja dhe inkurajimi i investimeve në Kosovë duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim të veprimtarive;
- ndihma në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës, veçanërisht të sektorit privat;
- hapja e vendeve të reja të punës dhe krijimi i të ardhurave;
- tërheqja e teknologjive të përparuara;
- përqendrimi i bizneseve në një vend të caktuar;
- zgjerimi e bashkëpunimi mes bizneseve;
- krijimi i kushteve për biznese për afrim më të lehtë në lidhje, transport, furnizim me energji, ujë dhe shërbime në mbështetje të biznesit dhe rritjen e konkurrencës në biznesin vendor etj.

Sipas ligjit për zonat ekonomike të drejtën për krijimin e zonave ekonomike e ka:

- Komuna;
- Komuniteti i biznesit;
- Partneriteti publiko-privat;

- Ministria relevante nëse zonat ekonomike financohen nga buxheti i Kosovës dhe janë me interes publik.

Shpallja e çdo zone ekonomike përfshinë:

- statusin e zonës, kufijtë e zonës;
- llojet e veprimtarive që do të zhvillohen në të;
- periudhën e funksionimit të zonës dhe mënyrën e dhënies së zonës (qera apo koncesion).

Zonat e lira ekonomike, janë cilësuar si zona të veçanta që synojnë tërheqjen e investimeve dhe nxitjen e eksporteve nëpërmjet stimujve të taksave të ndryshme dhe shërbimeve mbështetëse. Zonat e lira brenda kontekstit ndërkombëtar, janë një instrument i zbatimit universal dhe janë afirmuar si qendra të veçanta të zhvillimit, të cilat sot konsiderohen ndër faktorët më të rëndësishëm përmes së cilave po ndryshon konfigurimi dhe infrastruktura e zhvillimit duke ju përshtatur nevojave në ndryshim. Në terminologjinë ekonomike, “zonat e lira ekonomike” njihen si sipërfaqe të mbrojtura trojesh, ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme të veprimtarive prodhuese, të tregtimit dhe të shërbimeve, që konsiderohen pjesë e territorit doganor të Republikës së Kosovës, por që është i ndarë nga ky territor në aspektin e politikave tatimore e tregtare, dhe detyrimeve të import-eksportit. Zonat e lira gëzojnë eksterritorialitetin doganor të vendit ku janë të vendosura. Në zonat e lira mund të prodhohet, të përpunohet, të riparohet, të deponohet, të tregtohet, të ofrohen shërbime të ndryshme etj. Zonat e lira ekonomike janë kryesisht zonat, ku përveç lokacionit të favorshëm dhe të infrastrukturës, sipërmarrësit gëzojnë privilegje dhe preferenca. Zonat e lira ekonomike (ZLE) janë një rajon gjeografik që është përcaktuar dhe themeluar sipas ligjeve ekonomike, të cilat janë më liberale dhe janë themeluar me qëllim të krijimit të

kushteve më të favorshme dhe të ofrojnë masa stimuluese për investorët për të nxitur investimet e huaja. Pas miratimit të ligjeve të nevojshme, zonat e lira ekonomike janë themeluar edhe në Kosovë. Zhvillimi i zonave ekonomike ka për qëllim:

- rritjen e konkurrencës në biznesin vendor dhe ndërkombëtar;
- tërheqjen e teknologjive të përparuara dhe rritjen e konkurueshmërisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore;
- përshejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut Kosovar me atë ndërkombëtar;
- shpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe të kapitalit.



Figura 4. Harta e zonave ekonomike në Kosovë

Pas kompletimit të infrastrukturës ligjore, në Kosovë janë shpallur disa zona ekonomike ndër të cilat mund të veçohen: parku i biznesit në Drenas, parku i biznesit në Mitrovicë, parku teknologjik në Skenderaj, parku teknologjik në Shtime etj. Në vitin 2013 është hartuar koncept plani kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014-2018. Bazuar në këtë plan janë formuar edhe disa zona të lira ekonomike (ZLE) si: ZLE në Gjakovë, ZLE në Mitrovicë dhe ZLE në Prizren.




Figura 5. Përfaqësimi regjional i ZE në Kosovë

Procesi i dizenjimit dhe krijimit të zonave të lira ekonomike duhet të kalojë nëpër faza të mirëprojektuara e ku në secilën prej tyre menaxhimi me efikasitet të lartë duhet të jetë i një rëndësie prioritare me qëllim që të mos shkaktoj barrë të shtuar buxhetore, të shërbejë në zhvillimin ekonomik të zonave dhe ekonomisë si një e tërë, e gjithashtu të minimizojë eksternalitetet negative që e bashkëshoqërojnë këtë proces.

Tabela 5. Sipërfaqja e parqeve/zonave në Kosovë

Nr.	Parku / Zona	Sipërfaqja (ha)
1	Parku i Biznesit në Drenas	24
2	Park i Biznesit në Mitrovicë	3.5
3	Zona Ekonomike – Parku Industrial në vendin e quajtur "Frashër i vogël – Zhigovina" në Mitrovicë	48.25
4	Zona Ekonomike – Parku Teknologjik në Shtime	10.7
5	Zona Agro-industriale gjendet në fshatin Samadraxhë – Suharekë	28
6	Zona Industriale në Shirokë – Suharekë	162.5
7	Zona Ekonomike në Ferizaj	13
8	Zona industriale në Ferizaj	5.85
9	Park Industrial Holandez ZINKUNIE Prizren	12
10	Parkut Teknologjik – Skënderaj	19.63
11	Parku i Biznesit – Vushtri	14.86
12	Zona Ekonomike – Lipjan	139
13	Zona e lirë Ekonomike në Mitrovicë	/
14	Zona e lirë Ekonomike në Gjakovë	/
15	Zona e lirë Ekonomike në Prizren	/

Burimi: MTI e plotësuar nga autori

3.2 Korniza ligjore për Zonat Ekonomike në Kosovë

Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve është themeluar në vitin 2005 me Ligjin për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla e të mesme³⁵.

Me këtë ligj rregullohen masat dhe politikat qeveritare për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mbi bazën e këtij ligji Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve ka krijuar strukturat përkatëse funksionuese dhe njëkohësisht ka shërbyer dhe si një ombrellë qeveritare. Në vitin 2008 është miratuar ligji për ndryshimin

³⁵Shih Neni 8 Nr.02/L-5 Ligji për mbështetje ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe Ligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

dhe plotësimin e ligjit 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme³⁶. Në ligjin e ndryshuar fjala Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme “NVM” zëvendësohet me fjalën Ndërmarrja Mikro, e Vogël apo e Mesme “NMVM”. Misioni i Agjencisë për Mbështetjen e Ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme është që të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie ndërmarrëse në të cilën ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) të zhvillohen me sukses dhe të arrijnë potencialin e tyre, me një shtim të numrit të njerëzve të cilët synojnë të hyjnë në biznes. Synim tjetër i agjencisë është edhe përmirësimi i produktivitetit të përgjithshëm dhe konkurrencës së NMVM-ve.

Përveç ligjit për mbështetje të ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme, Kuvendi i Kosovës ka miratuar edhe ligjin për zonat ekonomike³⁷. Me këtë ligj rregullohen aspektet e krijimit, funksionimit, mbikëqyrjes dhe zhvillimit të zonave ekonomike, të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, operatorëve menaxhues, shfrytëzuesve që veprojnë në to, llojin e veprimtarive që kryhet brenda tyre, si dhe mënyra e përcaktimit të lokacionit për zonat ekonomike. Në kuadër të kompetencave të veta, Agjencia për Mbështetjen e NMVM-ve ka nxjerrë një numër të caktuar të akteve nënligjore të cilat mundësojnë implementimin e dy ligjeve të lartpërmendura: Ligji për mbështetje të ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme si dhe ligjit për zonat ekonomike. Sa i përket ligjit për zonat ekonomike, Agjencia për Mbështetjen e NMVM-ve ka nxjerrë një numër të caktuar të akteve nënligjore, siç janë:

- Udhëzim administrativ Nr.2009/14 për themelimin e divizionit të zonave ekonomike;

³⁶Shih Ligjin Nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 02/L-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

³⁷Shih Ligjin Nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike

- Udhëzimi administrativ Nr.2009/23 mbi procedurat për aplikim dhe kriteret e pajisjes me vendim të zhvilluesit;
- Udhëzimi administrativ Nr.2009/24 për marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës, zhvilluesit të zonës dhe institucioneve të tjera;
- Udhëzimi administrativ Nr.2009/25 mbi procedurat e kontrollit të ZE;
- Udhëzimi administrativ Nr.2009/26 për formën, përmbajtjen, vlefshmërinë dhe taksën për dhënien e vendimit;
- Udhëzimi administrativ Nr.2009/27 për rregullimin e logos, vulës së agjencisë për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe përdorimi i tyre;
- Udhëzimi administrativ (MTI) Nr. 01/2014 për përcaktimin e procedurës së paraqitjes së kërkesës për marrjen e pëlqimit, procedimit të saj dhe dhënien e pëlqimit, mënyrën dhe procedurat për konsultim publik, si dhe përmbajtja e regjistrit të zonave ekonomike;
- Udhëzimi administrativ (MTI) Nr. 02/2014 për përmbajtjen e studimit të fizibilitetit;
- Udhëzimi administrativ (MTI) Nr. 03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Në vitin 2013 është ndryshuar ligji për zonat ekonomike³⁸ me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit të legjislacionit për zonat ekonomike. I gjithë ky legjislacion që përfshinë ligjet dhe aktet nënligjore paraqet një bazë të mirë për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike në Republikën e Kosovës. Legjislacioni në fuqi i cili rregullon këtë fushë është i

³⁸Shih Ligjin Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike

hartuar mbi bazën e përvojave dhe praktikave të vendeve të ndryshme, kryesisht të atyre vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Nëse tërheqim një paralele në mes të mënyrës se si një gjë e tillë është e rregulluar në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Sllovenisë, për shembull, atëherë do shohim se në rastin e Republikës së Sllovenisë, ligji mbi zonat ekonomike, në nenin 5 dhe 7, definon shumë qartë rrethanat se si mund të krijohet një zonë ekonomike. Dallimi kryesor konsiston në atë se ajo çka në rastin e Republikës së Sllovenisë është rregulluar me ligj, në rastin e Republikës së Kosovës është e rregulluar me akte nënligjore, respektivisht udhëzimet administrative të lartpërmendura³⁹.

Agjensioni për Mbështetjen e NVM-ve në Kosovë (AMNVM) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë është formuar në bazë të ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ligji për mbështetjen e NVM-ve është plotësuar në vitin 2007 duke u harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për NVM-të. AMNVM ka fokus primar zhvillimin e sektorit privat në Kosovë duke krijuar kushte më të mira për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Gjithashtu ka përgjegjësinë për mbështetjen e NVM-ve përmes mekanizmave të ndryshëm si:

- zhvillimin ligjor dhe të politikave;
- qasjen në programe dhe skema të tjera të mbështetjes së drejtpërdrejtë;
- investimet në sektorin privat;
- eliminimin dhe reduktimin e barrierave në të bërit biznes dhe në zhvillimit të NVM-ve dhe hapjen e mundësive të tregut për NVM-të;
- trajnimin dhe konsultimet me sipërmarrës;

³⁹Programi për menaxhimin e zonave ekonomike, Prishtinë 2011

- trajnimin me menaxherët e inkubatorëve të biznesit, parqeve industriale dhe të biznesit;
- vendosjen e rregullave fleksibile që rregullojnë marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës;
- lehtësimin e komunikimit ndërmjet NVM-ve etj.,

Korniza e promovimit të NVM-ve përfshinë aktivitetet që kanë të bëjnë me nxitjen e përdorimit të plotë të inkubatorëve të biznesit, parqeve të biznesit, parqeve industriale, zhvillimin e një sistemi eficient për menaxhimin e të dhënave, krijimin e parqeve të biznesit dhe industriale, analizimin e funksionimit të tyre dhe dhënien e rekomandimeve. Pjesë e infrastrukturës ligjore për përkrahjen e bizneseve në Kosovë është edhe ligji për investimet e huaja i hartuar me qëllim të mbrojtjes, promovimit dhe inkurajimit të investimeve të huaja në Kosovë.

Ligji ju ofron investitorëve të huaj një tërësi të drejtash themelore dhe të ekzekutueshme si dhe garancish ligjore, për të siguruar që ata dhe investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen me drejtësi, në pajtim të plotë me shtetin e së drejtës dhe me standardet e praktikat ndërkombëtare të pranura gjerësisht.

3.3 Sfidat në menaxhimin e programeve – projekteve të realizuara në Kosovë

Shumica e vendeve dhe shteteve të ndryshme botërore nuk kanë mundësi të radhiten në vendet e zhvilluara dhe të civilizuara pa një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të projekteve të sektorit publik dhe menaxhim efikas të buxhetit për projektet e këtij sektori.

Në vendet më pak të zhvilluara, siç është Kosova, përdorimi i mjeteve dhe teknikave të menaxhimit të projektit është në fazën e konsolidimit. Autorë të ndryshëm kanë identifikuar barrierat që pengojnë suksesin e projekteve në vendet më pak të zhvilluara. Përgjithësisht këto janë:

- Procedura të tejzgjatura të miratimit;
- Sistemi administrativ;
- Ndryshim i porosive;
- Mungesë e pronësisë;
- Mungesë e autoritetit;
- Vlerësime të dobëta të kostos së aktiviteteve, të kohëzgjatjes, etj.

Për të analizuar disa faktorë në të cilët ka ngecje më të mëdha, të njëjtat duhet rishikuar dhe përmirësuar për t'u përafuar drejtë një menaxhimi modern të projekteve investive që sot në vendet e BE-së është standard i cili duhet përmbushur. Para se të analizohet efikasiteti i parqeve të biznesit dhe ndikimi i tyre në ekonominë e Kosovës, duhet të shikohet se sa në të vërtetë janë funksionale ato. Sot shumica e parqeve të biznesit janë gjysmë funksionale, ka ngecje në ndërtimin e infrastrukturës së parkut, ka një përzierje të veprimtarive biznesore brenda një parku qofshin ato edhe të rrezikshme për njëra-tjetrën, si dhe ka parqe që kanë dështuar tërësisht si projekte, të iniciuara në bazë të modelit publiko-privat.⁴⁰

Në këtë punim do të analizohen projektet e këtij lloji apo ato analoge të realizuara në Kosovë. Përshkrimi i gjendjes do të përfshijë tre faza, fazën e projektimit - nga ideja në letër, fazën e realizimit - implementimit të projekteve si fazë më komplekse dhe fazën e përdorimit që përshkruan gjendjen e projekteve pas një periudhe të shkurtër të përmbylljes

⁴⁰GAP, Analize politikash, 2012, Prishtinë faqe 13

së projektit. Të gjitha këto kanë një rol të veçantë dhe padyshim meritojnë një trajtim adekuat me qëllimin e vetëm që duke analizuar projektet e hershme dhe duke analizuar të metat në projektet e përfunduara, të arrihet një standard i duhur i projektimit, të bëhet punë e mirë dhe profesionale gjatë ekzekutimit të punëve në terren dhe në fund si rezultat të rritet jetëgjatësia e projektit dhe funksionaliteti i tij.

3.3.1 Faza e projektimit

Definimi i saktë i problemit, të kuptuarit e kontekstit dhe palëve të interesit, përputhja me kërkesat ligjore, dhe vlerësimet lidhur me koston dhe riskun, janë pjesë e fazës parapërgatitore dhe konceptuale në planifikimin e projekteve.

Varësisht nga projekti, dokumentacioni tekniko-teknologjik mund të përbëhet prej shumë pjesëve dhe të paraqes një tërësi të projekteve të posaçme, si për shembull:

- Projektet teknologjike në të cilat përshkruhet procesi i punës, procesi transformues i burimeve (inputeve) në rezultate (autpute);
- Projektet e punëve ndërtimore, ku përfshihen punët ndërtimore në objektet e infrastrukturës;
- Projekti i instalimeve elektrike, klimatike, etj.;
- Projekti i montimit të pajisjeve;
- Projekti i mbrojtjes në punë;
- Projekti i mbrojtjes së mjedisit, etj.

Cilësia e dokumentacionit tekniko-teknologjik ka rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e projektit investiv. Kjo mund të ndikoj në shpenzimet e ndërtimit e po ashtu edhe në

shpenzimet e mirëmbajtjes dhe eksplotimit. Faza e planifikimit luan rol të rëndësishëm sepse përmban planin e termineve që përfshinë fillimin dhe përfundimin e aktiviteteve gjatë kryerjes së projekteve.

Planifikimi i realizimit të projektit investiv duhet të përfshijë:

- Përkufizimin preciz të aktiviteteve, listën e aktiviteteve dhe marrëdhënien e tyre reciproke;
- Vlerësimin e aktiviteteve në aspektin e resurseve që duhet të angazhohen për kryerjen e tyre, kohën e nevojshme, etj.;
- Modelimin në formë diagrami (Ganto-grami dhe diagrami rrjetor) të aktiviteteve në nivel të projektit, grupeve të punëve dhe personelit, etj.

Vlerësimi i kohëzgjatjes së aktiviteteve duhet të bëhet nga ekipi i projektit që njohin mirë teknologjinë dhe resurset tjera të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve.

Në bazë të lidhshmërisë së aktiviteteve, respektivisht të rrjedhjes së tyre, ndërtohet diagrami rrjetor, i cili bëhet sipas dy metodave: CPM dhe PERT. Te projektet ku është siguria më e madhe dhe ku mund të llogaritet koha e normuar zbatohet Metoda e Rrugës Kritike (CPM-critical path method). Ndërsa te projektet ku siguria është më e vogël dhe ku nuk mund të llogaritet koha e normuar aplikohet Metoda e Rishqyrtimit dhe Vlerësimit të Projektit (PERT- Program Evaluation and Review Technique). Qëllimi themelor i përcaktimit të rrugës kritike, e cila ka qenë në përdorim në projekte për rreth 30 vjet, është që të mundësoj skeduluesin që të gjej kohën më të shkurtër të mundshme, për të përfunduar projektin. George Lewis e përcakton rrugën kritike si "seria më e gjatë e aktiviteteve (që nuk mund të bëhet në mënyrë paralele) dhe për këtë arsye përcakton se sa shpejt projekti mund të përfundoj". CPM (metoda e rrugës kritike) bën të mundur ekonomizimin e kohës si faktor

shumë i rëndësishëm për realizimin e projekteve investive. Ajo mundëson edhe identifikimin e aktiviteteve kritike (që nuk kanë tolerancë për shtyrjen e kohës) në çdo fazë të realizimit të projektit.

Dikur përgatitja e projekteve është bërë në një formë tjetër nga ajo që bëhet sot. Kërkohej një punë voluminoze dhe e mundimshme për të kompletuar një projekt i cili përmban të gjitha komponentët e nevojshme për të vënë në jetë një vepër konstruktive, qoftë rrugë, urë, objekt shkollor, objekt administrativ etj. Arritjet e teknologjisë kanë thjeshtuar procedurat e projektimit por njëkohësisht edhe kanë zhvendosur volumin e punëve në një drejtim tjetër. Softuerët që përdoren për projektim kanë hapur horizonte për gara në risinë e projektimit. Teknologjia ka thjeshtësuar shumë punët në aspektin e hartimit të projekteve dhe si rezultat i saj, gara e projektimit është zhvendosur në sjelljen e risive duke ndryshuar format e strukturave. Sot urat projektohen me gjatësi që dikur as që mendohej, tunelet projektohen për hapësirat nënujore, objektet e banimit projektohen në forma të ndryshme, rrugët projektohen me shumë nivele për qarkullim të automjeteve dhe transportit hekurudhor. Krahas teknologjisë dhe inovacioneve janë krijuar edhe standarde të reja, duke u bazuar në mundësitë e shumta që japin softuerët për trajtimin e objekteve edhe në formën më komplekse.

Standardet e reja të projektimit për Kosovën ndoshta edhe janë sfiduese, pasi këto standarde janë ende në fazën e konsolidimit. Këto standarde Kosova i ka filluar t'i aplikoj në fund të viteve 90-të të mileniumit të shkuar por akoma nuk është ambientuar plotësisht me normat europiane të projektimit.

Gjeneratat e reja janë ato që ballafaqohen që në fillim me risitë që vijnë nga vendet e zhvilluara dhe janë ato që ndjekin në hap trendet e zhvillimit. Te këto gjenerata të reja ka

raste kur mungon përvoja praktike e ballafaqimit me vepra të ndryshme gjigante çfarë ndërtohen në vendet e zhvilluara. Kjo derivon sfidat e projektuesve për t'u marr me projekte të karakterit ndërkombëtar (konkurse ndërkombëtare të projektimit).

3.3.2 Faza e implementimit

Kohët e fundit janë realizuar shumë projekte dhe mund të themi se Kosova tani është në vëmendje të bashkësisë ndërkombëtare dhe është në rrugë drejt standardeve evropiane sa i përket fazës së implementimit të projekteve. Në dekadën e fundit ka pasur një evoluim në drejtim të realizimit të shumë programeve dhe projekteve dhe mund të themi se ka filluar të përmbushet boshllëku që ka pasur Kosova në kuadër të implementimit të projekteve. Të gjitha projektet të cilat janë në këtë fazë padyshim se kanë kaluar më parë fazat paraprake të nevojshme, por a janë marr për bazë të gjithë faktorët që ndikojnë në implementimin e projektit, mbetet të kuptohet pas ballafaqimit me realitetin në terren.

Po të marrim rastin e themelimit të një parku industrial, nga përvojat e deritanishme e formës së menaxhimit të projekteve në Kosovë do të shohim pengesa të natyrave të ndryshme të cilat janë neglizhuar në fazën e projektimit.

Një nga pengesat do të ishte analiza e pamjaftueshme në detaje e projektit në aspektin gjeomekanik, analiza detale e lokacionit, apo një analizë e mirëfilltë konkurruese e cila do t'i identifikonte qartë përparësitë, mundësitë, kërcënimet dhe rreziqet. Pa dyshim që të gjitha pengesat që lindin në këtë fazë ndikojnë në realizimin e planit dinamik, ndikojnë në rritjen e vëllimit të punëve, në koston e projektit etj., që në vete këto komponente paraqesin rrezik të madh për projektin në tërësi.

3.3.3 Faza e përdorimit

Kjo është faza e produktit final ku mund të bëhet vlerësimi i të gjitha aktiviteteve. Në këtë fazë evidentohen të gjitha lëshimet që janë bërë në fazat e hershme dhe tani dalin në sipërfaqe gabimet dhe të metat e projekteve. Kjo është periudha kur personat që nuk kanë qenë të kyçur në projekt, qofshin ekspert apo jo, mund t'i vërejnë dallimet në standarde që aplikohen në Kosovë me ato të vendeve të zhvilluara.

Sot në kohën e globalizmit ku kompanitë e ndryshme bëjnë gara për mbajtjen e tregjeve që kanë të bëjnë me “okupimin“ e territoreve të reja, bëjnë gara në fushën e menaxhimit dhe tentojnë që vazhdimisht të merren me teori të avancuara të menaxhimit për t'i aplikuar në praktikë.

Kosova ende është në fazën e konsolidimit të rregullave elementare të standardeve të menaxhimit. Proceset në të cilat kalon një projekt, varen nga mënyra e menaxhimit qoftë të operacioneve, burimeve njerëzore apo teknike etj., dhe suksesi apo dështimi i atribuohet menaxhimit. Kosova që është duke kaluar ngadalë fazën e tranzicionit, ka pasur përvoja nga më të ndryshmet sa i përket menaxhimit të projekteve, ka pasur donacione të ndryshme nga vendet e zhvilluara të cilat bashkë me stafin vendës janë menaxhuar, gjë që kanë ndikuar në fitimin e përvojave pozitive.

Projektet kanë faza tipikisht të dallueshme dhe secila fazë mbartë në vetvete një kompleks sfidash unike për t'u përballuar nga çdo menaxher projekti, prandaj procesi i konsolidimit të plotë dhe barazimi me shtetet e zhvilluara është sa i lehtë aq edhe sfidues.

Nëse marrim për studim rastin e zonës ekonomike në Ferizaj dhe analizojmë tërë proceset që ka kaluar ky projekt që nga fillimi deri në një fazë dhjetë vjeçare të përdorimit. Hapi i

parë duhej të ishte studimi i fizibilitetit, pastaj përgatitja e projektit kryesor detal, i cili do të bazohej në kërkesën e komunitetit të biznesit, nëse nuk ishte përfshirë në planin e investimeve të qeverisë qoftë lokale apo qendrore, apo projekti do të përgatitej në bazë të planit detal urban që mund të mos ishte i miratuar dhe do të binte ndesh me rregulloret apo ligjet në fuqi.

Diferencat në menaxhim të projekteve në përgjithësi në këtë fazë në mes Kosovës dhe vendeve të zhvilluara, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 6. Dallimet në fazat e realizimit të projekteve në Kosovë dhe vendet e zhvilluara

Në vendet e zhvilluara	Në Kosovë
Projekti është pjesë e një plani detal të një zone të caktuar	Projekti nuk është pjesë e një plani detal të një zone të caktuar
Projekti hartohet për zonën në të cilën paraprakisht janë definuar - nuk ka probleme pronëso-ro-juridike	Projekti hartohet por problemet pronëso-ro-juridike në disa raste nuk janë të zgjidhura - ka shumë kontestime
Projekti hartohet pasi janë bërë analizat gjeologjike të truallit dhe një studim fizibiliteti	Projekti hartohet në të shumtën e rasteve pa bërë analizat gjeologjike të truallit dhe në raste të pakta me studim fizibiliteti
Në hartimin e projektit marrin pjesë njerëz profesionistë dhe vendosin profesionistët për detajet e rëndësishme të projektit	Në hartimin e projektit marrin pjesë njerëz profesionistë por vendosin (jo) profesionistët (politikanët) për detajet e rëndësishme të projektit
Projekti përfshinë gjithë infrastrukturën nëntokësore	Projekti në të shumtën e rasteve nuk përfshinë infrastrukturën nëntokësore

Të gjitha këto dallime të theksuara më lartë janë vetëm disa nga faktorët e shumtë që ndikojnë në vëllimin e punëve, kohën e përfundimit të projektit por edhe në koston e projektit.

Prej dobësive më të mëdha gjatë fazës së realizimit që janë parë në dekadën e fundit janë:

- Tejkalimi i vëllimit të paraparë të investimeve në 35% të rasteve;

- Vonesë në përfundimin me kohë të projektit në 60% të rasteve;
- Ndryshimi në madhësinë e projektit në 70% të rasteve, etj.

Te gjitha këto dobësi janë si rezultat i mungesës së përvojave dhe kuadrove profesionale, në fazën e përgatitjes së projekteve dhe menaxhimit të dobët gjatë realizimit të këtyre investimeve. Për këtë arsye rëndësi të veçantë ka edhe aftësimi i personelit për menaxhmentin e projekteve dhe sigurimi i një asistence sa më të mirë teknike në vendet në zhvillim siç është Kosova.

3.4 Efekti pozitiv i zonave të lira në Republikën e Kosovës në këtë fazë tranzicioni

Vitet e fundit është vënë re një rritje e nivelit të investimeve të huaja në vendet e Ballkanit duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Një nga masat më të rëndësishme që mund të ndërmerret nga qeveria për nxitjen e investimeve të huaja, është heqja e barrierave që lidhen me IHD-të në mënyrë që të përmirësohet klima e investimeve në Kosovë dhe perceptimi nga investitorët e huaj. Hartuesit e politikave duhet të shfrytëzojnë flukset hyrëse të investimeve për të gjeneruar përfitime maksimale të zhvillimit përmes punësimit, transferimit të teknologjisë, konkurrencës dhe rritjes së ndërmarrjeve vendase. Gjatë tridhjetë viteve të fundit, janë zhvilluar shumë hulumtime për të përcaktuar në mënyrë empirike se si dhe në çfarë rrethanash gjenerojnë IHD-të përhapjen e njohurive për përmirësimin e industrisë. Industria, më saktë sektori i prodhimit në Kosovë, ende mbetet dukshëm prapa rolit që duhet ta ketë në procesin e ringjalljes ekonomike dhe tejkalimit të shpërpjesëtimeve makroekonomike, e që në rend të parë kanë të bëjnë me bilancin tregtar, bilancin në tregun e punës, rritjen ekonomike dhe tejkalimin e shpërpjesëtimeve sektoriale.

Rregulli më i rëndësishëm i biznesit në një ekonomi të orientuar nga tregu është kënaqësia e konsumatorëve. Kjo vlenë për çdo veprimtari ekonomike, duke përfshirë edhe menaxhimin e parqeve industriale.

Zhvilluesi i parkut industrial në Kosovë është MTI-ja e cila përmes mekanizmave të saj mbledh informacionet për gjendjen në terren të zonave ekonomike në kuadër të të cilit janë edhe parqet industriale. MTI ka hartuar një koncept plan integrues për zhvillimin ekonomik dhe industrializimin e vendit përmes zonave ekonomike.

Ky koncept plan mbështetet në:

- Ligjin për zonat ekonomike;
- Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Mbështetje të NVM-ve;
- Kodin Doganor dhe të Akcizave;
- Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve;
- Planin dhe Vizionin për Zhvillimin Ekonomik;
- Deklaratën e Politikave Prioritare Afatmesme;
- Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017.

Në vitin 2013 është formuar Këshilli Kombëtar për zona ekonomike i cili si trup koordinues ka për detyrë të hartoj planet kombëtare për zhvillimin e zonave ekonomike. MTI në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, përmes NVM-ve, janë institucione përgjegjëse për implementimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë i cili është hartuar në vitin 2013 dhe do të përkrahet nga ministrinë relevante, komunat, shoqëritë e bizneseve dhe investitorët. Bazuar në gjendjen e tanishme të zonave ekonomike në Kosovë duke përfshirë edhe zonat me statusin e parkut industrial, janë në

rrugë të mbarë drejtë suksesit pasi janë vënë themelet ligjore për zonat e reja që do të formohen në të ardhmen, por edhe janë siguruar mekanizmat për kontrollin e atyre ekzistuese. Në parqet industriale ekzistuese janë vendosur biznese vendore dhe të huaja, janë rritur investimet, është rritur numri i të punësuarve, kështu që zhvillimet në treguesit kryesor makroekonomik sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në vend u karakterizua me normë pozitive të rritjes. Ekonomia e Kosovës gjatë viteve të kaluara u karakterizua me një rritje të theksuar pozitive ekonomike, e cila krahasuar me vendet e rajonit, ishte më e larta. Të dhënat për vitet 2007-2013 tregojnë për rritje të performancës ekonomike, që ka rezultuar me normë mesatare të rritjes së Bruto Produktit Vendor (BPV) prej më tepër se 4.5%.

Së këndejmi, si çështje e rëndësishme e cila duhet theksuar është se a mundet Republika e Kosovës, si shtet i ri që është në fazën e konsolidimit të institucioneve shtetërore, të zbatimit të reformave ekonomike, të ngritjes dhe të demokratizimit të shoqërisë civile, përmes zonave të lira ekonomike t'i shpejtojë këto procese, në drejtim të arritjes së standardeve ndërkombëtare? Nëse nisemi nga arsyeja pse ato janë themeluar gjithandej vendeve të botës, atëherë mund të thuhet se hyrja e kapitalit të jashtëm në vëllim domethënës, përshpejton zhvillimin ekonomik e me këtë i përshpejton drejtpërsëdrejti edhe proceset e reformave ekonomike dhe të demokratizimit të jetës në të gjitha dimensionet. Për këtë arsye objektivi kryesor i zonave të lira ekonomike është tërheqja e kapitalit të jashtëm në vëllim sa më të madh, dhe minimizimi i rreziqeve për hyrjen e kapitalit në tregun e Republikës së Kosovës. Zonat e lira ekonomike në territorin e Republikës së Kosovës nuk do të mundin vet të krijojnë strukturën dominuese të marrëdhënieve ekonomike. Sidoqoftë, edhe përkundër kësaj nuk është kontestuese se zonat e lira ekonomike kanë ndikim domethënës në qarkullimin e kapitalit, mallrave dhe njerëzve. Qëllimi i themelimit të zonave të lira

ekonomike në komunat Gjakovë, Mitrovicë dhe Prizren qëndron në ushtrimin e veprimtarisë industriale me orientim të eksportit në radhë të parë. Kësisoj Republika e Kosovës angazhohet për sjelljen e operatorëve të jashtëm, duke ju ofruar favore doganore të përcaktuara me dispozita ligjore. Të njëjtit operatorë ekonomikë, duke shfrytëzuar pozitën shumë të volitshme gjeografike të Kosovës, lidhjet e mira të komunikimit me botën, infrastrukturën e zonës së lirë ekonomike dhe fuqinë e lirë punëtore të vendit, me kosto më të ultë të prodhimit dhe rrjedhimisht edhe me çmime më të ulëta, do të depërtonin më lehtë në tregun e jashtëm. Ambienti i krijuar nuk është i kënaqshëm për prurjet e kapitalit të jashtëm në ekonominë e Republikës së Kosovës. Me qëllim të joshjes së partnerëve të jashtëm për të investuar në Republikën e Kosovës, duhet të krijohen parakushte të caktuara të cilat krijojnë siguri në radhë të parë për kapitalin e jashtëm. Konkretisht në këtë drejtim mendohet për:

- Treg stabil, konkurrencë të shëndoshë dhe veprim të shtetit ligjor;
- Mundësinë e futjes së kapitalit të huaj në programet prodhuese dhe përpunuese, brenda zonave të lira ekonomike, dhe
- Investimet direkte të huaja në të gjitha degët ekonomike të vendit.

3.5 Përceptimi për Kosovën në të bërit biznes - sfidë për investitor potencial në ZE

Investimet e huaja direkte janë një fenomen shumë i përhapur dhe i dëshiruar nga të gjitha vendet, në çfarëdo stadi të zhvillimit qofshin ato. Në morinë e shumë qëllimeve për themelimin e zonave ekonomike është edhe tërheqja e investimeve nga jashtë. Por, që të inkurajohen investitorë nga jashtë duhet që të ekzistoj një rrethinë biznesore atraktive dhe

joshëse e cila do të përmbushte kërkesat e investorëve konform standardeve për një ekonomi të lirë me një konkurrencë të mirëfilltë. Se sa Kosova i plotëson këto parakushte është një çështje e cila duhet analizuar me shumë kujdes dhe për të cilën duhet vëmendje e shtuar në hartimin e politikave në të bërit biznes. Përceptimi i Kosovës nga ana e investorëve potencial varet nga opinionin publik ndërkombëtar për Kosovën. Vendi ynë cilësohet si vend në tranzicion. Kjo reflekton edhe në bindjet se korrupsioni është një ndër problemet më të mëdha me të cilat duhet ballafaquar për të drejtuar një biznes. Në një raport të vitit 2008 të publikuar nga Dhoma Ekonomike Amerikane, 47% të bizneseve, citohet se besojnë se zhvillimi efektiv i biznesit në Kosovë varet nga dhënia e ryshfetit institucioneve të Kosovës. Në anën tjetër, 12% e bizneseve e cilësojnë këtë si të vërtetë vetëm për institucione të caktuara. Për më tepër, mungesa e transparencës në institucione të Kosovës ndikon në përceptimin e Kosovës si vend me politika zhvillimore jo të kënaqshme dhe me mjedis ekonomik të paqëndrueshëm. Institucionet në Kosovë kanë nevojë për vëmendje të gjerë që i adreson të gjitha çështjet problematike me të cilat ballafaqohet vendi ynë, sidomos në përmirësimin e infrastrukturës, në përmirësimin e rrethinës biznesore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të cilat më së shumti në vendet tranzicionale gjenerojnë punësimin dhe zhvillimin ekonomik.

Banka Botërore, si hartuesi i këtij raportit për rrethinën biznesore, evidenton një mori kufizimesh siç janë: përqendrimi vetëm në qytetin më të madh, vetëm në ekonominë formale dhe vetëm në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për më tepër, Banka Botërore thekson se përqendrimi i drejtpërdrejtë vetëm në përmirësimin e renditjes në të bërit biznes nuk do të garantojë përmirësim të mjedisit biznesor. Si rezultat, siç sugjerojnë edhe përvojat

e vendeve të tjera, ndryshimet në praktikë kërkojnë politika përtej raportit të të bërit biznes dhe investorët nuk e konsiderojnë raportin si instrument për vendimmarrje.

Duke pasur parasysh të dhënat e mësipërme, mund të shtrohet pyetja nëse faktorët e cekur kanë ndikuar që në parqet aktuale në Kosovë të mos këtë numër të admiruar të investorëve të jashtëm.

Institucionet e Kosovës e kanë përdorur raportin e të bërit biznes si mjet bazë për përpilimin e politikave lidhur me të bërit biznes e mbase edhe të gjithë zhvillimit të sektorit privat. Themelet e këtyre politikave janë draftuar zyrtarisht në Planin e Veprimit të Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014, ku specifikisht thuhet se përmirësimi në të bërit biznes është objektivë kryesore. Qeveria e Kosovës ka miratuar disa ligje për përmirësimin e mjedisit afarist për ndërmarrjet e vogla dhe te mesme. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, e cila administron zonat dhe parqet ekonomike duke u bazuar në një raport që asesi nuk garanton përmirësime reale të gjendjes, ka inicuar pesë reforma për të rritur rezultatin në tre tregues të raportit të të bërit biznes.

Sidoqoftë, problemi madhor i Kosovës nuk është mungesa e ligjeve të përditësuara me legjislacionin ndërkombëtar, por zbatimi i tyre në praktikë. Si rezultat, përmirësimi i Kosovës në renditjen e raportit të të bërit biznes është drejtpërdrejt i ndërlidhur me përmbajtjen e ligjeve dhe atë se çka ato tentojnë të rregullojnë, e jo me zbatimin e tyre.

Kufizimi i këtyre në indikatorë të përzgjedhur të suksesit mund të tingëllojë mirë në letër, por nuk e përmirësojnë mjedisin e biznesit në përgjithësi dhe në veçanti në zona dhe parqe në Kosovë.

3.6 Parku i biznesit në Drenas

Në vitin 2013 është miratuar projektligji Nr. 04/L-159 për ZE i cili ka për qëllim themelimin e zonave ekonomike, zonave ekonomike të lira, krijimin e bazës për hartimin e planit kombëtar për zonat ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit të ZE, promovimin e ZE, hartimin e planit kombëtar për ZE dhe formimin e këshillit kombëtar për ZE. Projektligji për ZE i përgatitur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), rregullon themelimin, funksionimin, menaxhimin si dhe mbikëqyrjen e zonave ekonomike në Kosovë. Me këtë dokument parashihet edhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për ZE, si organ këshillues lidhur me politikat e ZE dhe do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e tyre në Kosovë.

Parku i Biznesit në Drenas, gjendet në fshatin Korreticë e Epërme të Drenasit dhe shtrihet në kilometrin e 22-të përgjatë magjistrales Prishtinë – Pejë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 24 ha. të ndarë në 56 njësi të madhësive të ndryshme: 43 parcela me sipërfaqe deri në 3000 m², 7 parcela me sipërfaqe prej 3000 deri në 6000 m² dhe 6 parcela me sipërfaqe mbi 6000m². Është një sipërfaqe e tokës e ndarë nga Komuna e Drenasit dhe e financuar nga Buxheti i Kosovës, respektivisht nga MTI.

Ky park shtrihet në rrugën Prishtinë – Pejë pranë zonës industriale në Drenas e cila në të ardhmen do të jetë njësi e integruar brenda kësaj zone me sipërfaqe prej 100 hektarë. Zona industriale e planifikuar nga komuna e Drenasit do të ofrojë sipërfaqe tokë me infrastrukturë, plan rregullativ dhe urbanistik. Menaxhimi kësaj Zone do të jetë konform Ligjit mbi ZE. Në PBD, gjithnjë sipas rekomandimeve të MTI do të vendosen biznese prodhuese dhe shërbyese të cilat përveç të tjerash vëmendje të veçantë i kushtojnë mbrojtjes

së ambientit. Për themelimin e parkut Industrial në Drenas është hartuar edhe një studim fizibiliteti. Studimi ka përfshirë një analizë të detajuar duke filluar nga inxhinieria, teknologjia, analiza ekonomike, analiza financiare e detajuar me nivelin e investimeve, hyrjet financiare, koston, dobinë bruto dhe neto, burimet e mundshme dhe diversitetin e financimit, marketingun e zonës industriale, analizën e riskut dhe sigurimin financiar, politikën e tatimeve, politikën doganore, shembuj të suksesit etj. Ky studim përmban edhe kuadrin ligjor dhe administrimin dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe masat e propozuara për minimizimin e tyre.



Figura 6. Parku i Biznesit në Drenas

Parku i Biznesit në Drenas është një nga projektet më kapitale të Qeverisë së Kosovës në fushën e mbështetjes së bizneseve vendore dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Ky Park i Biznesit pretendon të jetë një promotor i zhvillimit të Kosovës që do të gjeneroj punësim dhe të ardhura dhe do të jetë edhe një vend i testimit të një projekti dhe filozofie të re mbi zhvillimin e ardhshëm të ndërmarrjeve në Kosovë.

Parku Biznesit paraqet fazën e parë të një zone të madhe që MTI synonte ta zhvilloj brenda një periudhe pesë vjeçare në pjesën qendrore të Kosovës. Ky ishte një projekt i përbashkët i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Kuvendit Komunal të Drenasit, ku MTI ka investuar në ndërtimin e këtij parku ndërsa Kuvendi Komunal i Drenasit ka ofruar tokën për këtë destinim.



Figura 7. Pozita e Parkut në zonën industriale në Korroticë, Komuna Drenas

Parku i Biznesit i Drenasit do të hapë perspektivë të punësimit për një mijë punëtorë të rinj nga të cilët rreth 40% do të jenë nga rajoni ku është i vendosur. Ky park shtrihet në zonën qendrore të Kosovës nga e cila pikë në një diametër prej 80 km. prekë çdo cep të hapsirës gjeografike të Kosovës.

Distancat referuese me portet dhe rrugët kryesore korrespondojnë si më poshtë⁴¹:

- 5 km larg Aeroportit të Prishtinës;

⁴¹http://mti-ks.org/repository/docs/Kerkesat_dhe_kriteret

- 7 km larg Terminalit kryesor hekurudhor të vendit;
- 210 km nga porti i Durrësit;
- Në largësi më të vogël se 130 km nga Shkupi, Podgorica, Nishi dhe Sofia;
- 100 km në afërsi të qasjes në korridorin e 8-të rrugor pan-evropian;
- Në largësi më të vogël se 400 km ka qasje në korridoret rrugore pan-evropiane 4, 5 dhe 7.

Komuna e Drenasit ka një pozitë strategjike ekonomike, me afrim të mirë në autostradën Prishtinë-Tiranë, në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup, gjendet pranë linjës kryesore hekurudhore dhe aeroportit të Prishtinës. Me iniciativën e komunës së Drenasit, qeveria e Kosovës në vitin 2005 mori vendim për caktimin e lokacionit dhe lejimin e themelimit të Parkut të Biznesit, projekt ky me interes të përgjithshëm të vendit ku qëllimi kryesor ishte krijimi i kushteve të volitshme për të bërë biznes si për investitorë vendorë po ashtu edhe të huaj.




Figura 8. Numri i bizneseve në Parkun e Drenasit nga viti 2010 – 2015

Siç vërehet edhe nga grafikoni numri i bizneseve të vendosura në vitin e parë (2010) ka qenë 5, duke u rritur çdo vit, duke arritur në 41 biznese në vitin 2015.

Bizneset e vendosura deri më tani në PBD (41 biznese) sipas planeve të prezantuara të biznesit do të investojnë mbi 55 milion euro si dhe do të punësojnë afro 1000 punëtorë.

Në PBD janë vendosur biznese prodhuese dhe shërbyese të cilat nuk dëmtojnë ambientin dhe janë konform legjislacionit në fuqi. Parku përfshinë një sipërfaqe prej 24 hektarësh dhe është i ndarë në 56 ngastra të madhësive të ndryshme të cilat janë të destinuar për vendosjen e bizneseve:

- 43 ngastra me sipërfaqe deri në 3000 m²;
- 7 ngastra me sipërfaqe 3000-6000 m²;
- 6 ngastra me sipërfaqe mbi 6000 m².

Tabela 7. Ndërmarrjet në parkun e Drenasit dhe veprimtaria e tyre

Nr.	Emri i kompanisë	Veprimtaria
1	"Liftkos" sh.p.k	Prodhim dhe montim të ashensorëve
2	OPT "G.P Metal" sh.p.k	Prodhim, shërbim shitje me shumicë dhe pakicë si dhe eksport
3	"MP Azzurro" sh.p.k	Prodhimi dhe distribuim i produkteve nga mielli
4	NPM "Metaj"	Prodhimi ekskluziv i xhamit antiplumb dhe antivandal
5	"Exin" sh.p.k	Shitja e pajisjeve për fëmijë si dhe kozmetikë për të rritur
6	NPSH "Allmakes" Global Services	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, tregtimin e mjeteve dhe shitja e makinave
7	Unikat sh.p.k	Prodhimin e uniformave dhe rrobave të punës
8	NTP "Aero – Com"	Prodhimi letër plloteri, letër për arka fiskale, letër krep-silotejp
9	NNP "Wiena"	Prodhim të kubëzave dhe anësoreve. Ndërtimi të lartë dhe të ulët.
10	N.P.T. "Abi metal"	Përpunimi i konstruksioneve metalike dhe përpunimi metalik; Prodhimi i objekteve Industriale, shkallëve emergjente, llamarinës dhe montimi i gurëthyesve dhe të gjitha llojet e kontejnerëve të mbeturinave, dhe shtyllave të ndriçimit.
11	N.T.P. "Shehu"	Prodhimi i shkalleve dhe dyerve të hyrjes, montimi i prodhimeve; Repromateriale për prodhimin e dyerve dhe dritareve nga druri, PVC-ja dhe Alumini.

12	D.P.Z. "Argent"	Prodhimin, përpunimin dhe shërbime që kanë të bëjnë me mjetet e punës për zdrukthëtarë; Prodhimin e brisqeve dhe thikave për dru, plastikë, alumin etj.
13	"Plastika" sh.p.k.	Prodhim, përpunim, shërbim dhe tregti me plastikë dhe najlon
14	"Toni tex"	Prodhim i tekstilit
15	"Mirusha Transport"	Reparti për prodhimin e gozhdave, distancave, telit gjembor dhe telit rrjet për rrethoja; Reparti për prodhimin e produkteve nga plastika
16	N.T. "Besimi"	Prodhimi i dyerve dhe dritareve të aluminit dhe plastikes; Përpunimi i llamarinës.
17	"Gentipharm"	Prodhues i prodhimeve farmaceutike
18	NTP "Medruplast"	Prodhimi i etiketave reklamuese për produkte tëndryshme ushqimore dhe jo ushqimore
19	"Scampa"	Ndërmarrje prodhuese e cila merret me prodhimin e folieve të najlonit dhe riciklimin e tyre si dhe paketimin elektrës.
20	DPZ "Dani plast"	Prodhim i dyerve dhe dritareve nga AL PVC, montimi i tyre dhe punimi i profileve të metalta.
21	"Eng grup" shpk	Prodhimin e kanaleve nga llamarina për sistemet e ajrosjes, klimatizimit.
22	NTP "Termo"	Prodhime nga polietileni (pe-lde) dhe shitje me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit
23	"R.I SPA-ARKOS"	Konstrukt i çeliktë, hekurit inox dhe module të parafabrikuara të hekurit
24	"Antika Technologies" shpk	Ngritjen e kapaciteteve prodhuese në lëmin e teknologjisë informative dhe telekomunikacionit në partneritet me kompaninë gjermane Muehlbauer.
25	"E maliku"	Prodhimin e stufave dhe kaminave
26	"Maxi 69" shpk	Prodhim i mbathjeve për fëmijë dhe të rritur.
27	"Brymako" shpk	Prodhim dhe përpunim i fasadave
28	NPSH "Elting-Elektronics"	Pajisje për furnizim me energji në telekomunikacion dhe IT.
29	"M SORA" Prishtinë	Përpunimin e drurit, prodhimin e dyerve (normale dhe automatike), dritareve, panele, elemente për enëlarëse, etj.
30	"Semenarna" sh.p.k	Linjë për prodhimin dhe përpunimin e farërave.
31	"Metropol Group" sh.p.k	Përpunimin e patateve, si ato të skuqura etj, si dhe linja e përpunimit të perimeve
32	"Hajdari WDVS-TrockenBau"	Kompania merret me prodhimin, përpunimin, paketimin si dhe eksportimin e produkteve të llacit dhe ngjitësve të thata.
33	"Konica" sh.p.k	Prodhimin e ambalazheve dhe paketimeve të elektrës dhe plastikes, si: etiketa ushqimore, për produkte higjienë, ambalazhe ushqimore, paketime plastike dhe letra, etj

34	“Star” sh.p.k	Kompania merret me prodhimin e produkteve të miellit (brumërave), makaronave, etj.
35	“Behari” sh.p.k	Prodhimin e dymave të garazhës me teledirigjues nga sendvich paneli; Prodhimin e pjesëve për dym të dhomave dhe përpunimi i tyre; Prodhimin e disa llojeve të bulonave dhe gozhdëve.
36	NTP “Dijamant”	Merret me prodhimin e dymave, dritareve , mobileve të ndryshme për hoteleri dhe amvisëri si dhe shumë prodhime dhe përpunime nga druri.
37	“Adi Group” sh.p.k	Fabrika e pare planifikon prodhimin e çipsave, mëlmesa të ndryshme me bazë të misrit dhe nishestës së patates. Derisa fabrika dyte planifikohet te beje prodhimin e shamponeve, detergjenteve dhe kozmetikës.
38	“Kras Group” sh.p.k	Prodhim dhe përpunim i produkteve të detergjenteve dhe produkte të reja
39	NTP “Sigma”	Kompania merret me prodhimin e produkteve të drurit nga mediapani montimin e laminatit dhe përpunimin e produkteve nga panelet e drurit.
40	“Helvetica Profarm”	Prodhim i produkteve farmaceutike, ndërsa në PBD prodhime nga Latexi.
41	“Europe systems LLC”	Prodhimi i transformatorëve dhe gjeneratorëve elektrik

Me qëllim të krijimit të lehtësirave për periudhën fillestare të vendosjes së kompanive në PBD, MTI në vitin 2009 ka nxjerr një vendim për zbritjen e qerasë bazë 0.15 €/m² duke përshkallëzuar për dhjetë vitet e para:

- 0.03 €/m² - 1 deri 3 vitet e para;
- 0.075 €/m² - 4 deri 6 vitet e para;
- 0.1125 €/m² - 7 deri 10 vitet e para.

Shërbimet që ofron Parku i Biznesit në Drenas janë:

- Parcela të gatshme për ndërtim të objekteve të biznesit;
- Lidhje në rrjetin energjetik;
- Furnizim me ujë industrial dhe ujë të pijshëm;
- Qasje në rrjetin e kanalizimit fekal dhe atmosferik;

- Qasje në rrjetin e gazit për nevoja industriale;
- Qasje në rrjetin e ngrohjes;
- Hapësira për vendparkingje;
- Rrjet të telefonisë;
- Rrjet të internetit;
- Shërbime hotelierie dhe restoranti;
- Hapësirë për shërbime biznesi (shërbime bankiere, shpeditimi, marketingu, etj.);
- Hapësirë për shërbime të përbashkëta (salla për seminare, konferenca simpoziume etj.).

Investimet nga MTI në fazën fillestare në PBD kryesisht kanë qenë investime në infrastrukturën e rrugore, kanalizime, ndriçimi brenda zonës, sigurimin e energjisë së mjaftueshme për bizneset prodhuese brenda zonës etj.




Figura 9. Investimet e realizuara në Parkun e Drenasit 2005-2015

Investimet e qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë park kanë filluar në vitin 2005 në vlerë gjysmë milioni euro, ndërsa shuma totale e investimeve deri në vitin 2015 është

afërsisht nëntë milion euro. Nga viti 2005 deri në vitin 2010, investimet e qeverisë ishin orientuar kryesisht në përgatitjen e hapësirës së parkut dhe kompletimit të infrastrukturës.

Pas plotësimit të kushteve për vendosjen e bizneseve, në vitin 2010 filluan të vendosen bizneset e para. Bizneset investimet e tyre i kanë filluar nga viti 2010. Tendencia e investimeve të bizneseve në park nga viti 2005 e deri më 2015 ka qenë me ritme të njëjta. Vlerësohet se shuma e investimeve deri në fund të vitit 2015 të jetë afër 11 milion €.

3.7 Zona industriale në Ferizaj

Kosova është një ndër vendet e cila ka nevojë për investime të cilët do të ndihmonin në krijimin e vendeve të reja të punës. Në këtë kontest, njëra ndër nismat e para për krijimin e një zone ekonomike në Kosovë ishte krijimi i Zonës Ekonomike në Ferizaj në vitin 2005 duke ndjekur modelin e shteteve të zhvilluara, në të cilat funksionimi i zonave ekonomike ka qenë një element i rëndësishëm në zhvillimin e gjithëmbarshtëm të vendit.

Komuna e Ferizajt në vitin 2003, ka shpallur zona industriale ngastrat kadastrale nr.1144, 1149, 1152, 1505 dhe 629/1. Sipërfaqja e tërësishme e tyre në zonën industriale në Babush, komuna e Ferizajt, është 5.85 ha. Administrimin e këtij projekti investiv e ka realizuar drejtoria për Planifikim, Rindërtim dhe Zhvillim.

Ishin disa arsye të cilat kanë justifikuar shpalljen e zonave industriale, ndër të cilat do të veçojmë:

- Krijimi i kushteve më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- Inkurajimi i zhvillimit të sektorit privat;
- Hapja e vendeve të reja të punës;

- Rritja e kapaciteteve prodhuese;
- Rritja e të hyrave buxhetore;
- Zhvillimi ekonomik i komunës.



Figura 10. Zona ekonomike në Ferizaj

Nga ndërmarrjet konkurruese, kandidate potenciale për të përfituar në këtë proces garues është kërkuar që konform kornizës ligjore t'i përmbushin kriteret krahasuese me regjionin.

Pjesë e dokumentacionit për këtë sfidë konkurruese ishin:

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit;
- Plani i zhvillimit të biznesit;
- Projekti i objektit;
- Projekti për mbrojtje të mjedisit – ambientit;
- Leja nga Drejtoria Komunale e Urbanizmit pas përfitimit të parcelës.

Përfitues të parcelave për zhvillimin e veprimtarive ekonomike në këtë park industrial ishin

14 ndërmarrje:

Tabela 7. Ndërmarrjet, fillimi i aktivitetit, veprimtaria e tyre dhe numri i punëtorëve në
ZE Ferizaj

Nr.	Ndërmarrja	Fillimi i punëve	Sipërfaqja m ²	Veprimtaria sipas planeve të biznesit	Nr. i punëtorëve 2013
1.	Burimi company	2005	4300	Prodhimi i asfaltit	27
2.	Ata projekt	2004	3500	Prodhimi i betonit dhe elementeve të betonit	16
3.	Autogoma	2005	4000	Regjenerimi i gomave dhe thërrmimi i tyre	11
4.	Kema	2005	3000	Prodhimi i kapakëve për puseta dhe pllaka të shporeteve	21
5.	Shumolli	2005	3000	Prodhimi i dyerve dhe dritareve nga plastika, alumini me elemente përcjellëse, gjami roletat si dhe montimi dhe mirëmbajtja e tyre	10
6.	Dafina	2005	2000	Prodhimi i materialit hidroizolues	5
7.	Cadi	2005	2000	Prodhimi i fshesave elektrike për amvisëri dhe prodhimi i fshesave vertikale për autolarje	17
8.	Ekologjia	2006	1000	Prodhimi dhe paketimi i substancave kimike për dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim	8
9.	Zotaj	2005	1000	Prodhimi i jorganëve dhe mobileve prej druri	5
10.	Ngjyrosës Feridi	2005	1500	Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe fasadave të ndryshme	9
11.	Condor	2005	1500	Prodhimi i kondorit dhe letrës së zeze izoluese	7
12.	Terziu	2007	2000	Prodhimi i produkteve të ndryshme nga stiropori	11
13.	Liridoni	2006	3370	Prodhimi i elementeve të betonit (skajore dhe ballore, prodhimin e kubëzave për trotuare dhe prodhimin e gypave të betonit)	40
14.	Gashi	2009	1000	Prodhimi i detergjenteve të lëngëta	5
Totali:			33.170		192

Burimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik - Ferizaj

Nga intervistat e strukturuar në zonën industriale me përfaqësuesit e ndërmarrjeve prodhuese, është konstatuar se nuk janë përmbushur në tërësi obligimet kontraktuese të disa ndërmarrje.




Figura 11. Numri i të punësuarve 2006 - 2013 në ZE Ferizaj

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar numrit të të punësuarve, të cilët janë të evidentuar nga ndërmarrjet në Administratën Tatimore. Nga informacionet e marra përmes intervistave të strukturuar janë nxjerrur disa përfundime:

- Ka devijime në planin dinamik të punëve në ndërtimin e objekteve si dhe fillimin e procesit të prodhimit;
- Vonesat në fillimin e prodhimit kanë ndikuar në mospërmbushjen e planeve të biznesit të hartuar nga vetë ndërmarrësit;
- Infrastruktura në zonë nuk është e kompletuar.

E ndodhur në distancë shumë të afërt mes dy kryeqyteteve, 29 kilometra nga Prishtina dhe 54 nga Shkupi, kjo zonë në fillimet e veprimtarisë së saj për shkak të mungesës së kornizës ligjore në radhë të parë, por edhe për arsye të tjera si: politikat fiskale jo të favorshme,

mungesa e përvojave, tregu i pastudiuar mirë etj., është ballafaquar me vështirësi të shumta. Siç shihet edhe nga kurba e grafikut më lartë, numri i të punësuarve në tri vitet e para ka pasur fare pak variacion pozitiv.

3.8 Parqet dhe zonat e tjera në Kosovë

Parku i biznesit në Mitrovicë shtrihet në pjesën veri-lindore të qytetit të Mitrovicës, në afërsi të rrugës magjistrale që lidhë Kosovën me Serbinë dhe përfshinë një sipërfaqe prej 3.5 ha, nga i cili kanë përfituar gjithsej 22 biznese. Nga 22 biznese të selektuara vetëm 2 biznese nuk kanë filluar së ndërtuari objektet e tyre afariste. Parku është i kompletuar me infrastrukturën e nevojshme e cila ofron kushte relativisht të mira për aktivitete të bizneseve.



Figura 12. Parku i Biznesit në Mitrovicë

Pas aprovimit të legjislacionit për Zonat Ekonomike, Komuna e Mitrovicës ka filluar me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për legalizimin e Parkut të Biznesit në

Mitrovicë konform legjislacionit në fuqi. Ky park është shpallur Zonë Ekonomike konform legjislacionit në fuqi për ZE, me vendim të Kryeministrit në vitin 2012.

Parku industrial Holandez “Zinkunie” në Prizren është një Park Industrial me një investim holandezo-kosovar në të cilin veprojnë biznese të industrisë së lehtë. Parku gjendet në rrugën e Transitit në Prizren dhe ka një sipërfaqe prej rreth 12 ha. Brenda kësaj zone ekzistojnë 30 parcela, me infrastrukturë përcjellëse. Veprimtaria kryesore e tyre është tregtimi dhe përpunimi i metaleve si: zinku, bakri, plumbi e të ngjashëm, duke prodhuar ulluqe, gypa, zbukurime, kulme e fasada kryesisht nga zinku. Ndërtimi i një Parku Industrial, brenda së cilës do të futeshin reparte të prodhimit, objekte të nevojshme për depo, duke ulur koston e prodhimit, të transportit dhe njëkohësisht duke ruajtur kualitetin, sigurisht do të rriste edhe aftësinë konkurruese dhe rritjen e shitjes së prodhimeve në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.



Figura 13. Parku industrial “Zinkunie” në Prizren

Zona agroindustriale në Suharekë - Komuna e Suharekës karakterizohet si një regjion bujqësor. Rreth 53% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës së Suharekës është tokë bujqësore dhe 60% e popullsisë jeton në zonat rurale, shumica e tyre varen nga punimi i tokës për të siguruar jetesën e tyre. Sektori i bujqësisë kontribuon me rreth 19% të GDP-së bruto, dhe ofron 42% të punësimit total.

Zona agroindustriale në Suharekë ndodhet në kilometrin e 9-të të rrugës regjionale Suharekë-Rahovec. Kjo zonë për shkak të pozitës strategjike është planifikuar të jetë një ofertë për shprehjen e interesave të bizneseve të cilat veprojnë në këtë regjion. Zona shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Suharekës, me sipërfaqe prej 28 ha, në kufi me Komunën e Rahovecit dhe konsiderohet një lidhëse regjionale për shkak të afërsisë me autostradën (6.0 km). Rëndësia e krijimit të zonave agroindustriale vjen nga nevoja e zhvillimit industrial të ekonomisë që të optimizoj koston e prodhimit, sigurimin e produkteve cilësore dhe do të ketë efekt pozitiv në përsheptimin e investimeve.

Kështu, zona agroindustriale do të jetë një instrument efikas i rritjes ekonomike në nivel komunal dhe regjional për shkak të ndikimit të saj në zhvillimin e prodhimit bujqësor të destinuar për industrinë përpunuese të ushqimit e cila do të ndikoj në rritjen e të ardhurave prej prodhimeve bujqësore. Studimi i fizibilitetit i zhvilluar për zonën në Suharekë siguron mundësitë për krijimin e zonës agroindustriale dhe skenarin optimal të zhvillimit duke u bazuar në rekomandimet strategjike për zhvillim komunal dhe regjional. Studimi i fizibilitetit është ndërmarrë për të përcaktuar realizueshmërinë e krijimit të zonës agroindustriale me orientim në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore në territorin e komunës së Suharekës. Analiza e potencialit të regjionit për krijimin e një zone agroindustriale është e fokusuar në resurset që janë të disponueshme për zhvillimin e

aktivitetit bujqësor dhe agropërpunues nga pikëpamja e zhvillimit sektorial të ekonomisë në regjion.

Mbi bazën e një numri treguesish që rezultojnë në vërtetimin e skenarit optimal të veprimtarisë, si prioritet i agrozonës është identifikuar orientimi i veprimtarisë së zonës agroindustriale në sektorët e prodhimit primar dhe përpunues dhe ofrimi i shërbimeve shtesë duke përfshirë marketingun e produkteve finale përmes krijimit të tregut me shumicë brenda zonës agroindustriale. Investimet në zhvillimin e infrastrukturës teknike dhe të prodhimit për krijimin e zonës agroindustriale janë vlerësuar në vlerën prej 1,5 milion Euro, e cila do të zbatohet në pesë faza brenda 5 viteve të ardhshme. Krijimi i zonës agroindustriale, sipas modelit të identifikuar do të ketë një ndikim pozitiv socio-ekonomik në regjion duke përdorur në mënyrë efikase potencialet e zhvillimit ekonomik.




Figura 14. Zona në raport me vendbanimin

Ndërtimi i infrastrukturës moderne të shërbimeve në kuadër të projektit të zonës agroindustriale gjithashtu do të zvogëlojë ndotjen e mjedisit ekzistues në kushtet aktuale.

Si përfundim krijimi i kësaj zone në regjionin ekonomik jugor të Kosovës do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e mjedisit e të bërit biznes, rritjen e të ardhurave nga produktet

bujqësore si dhe krijimin e së paku 100 vendeve të reja të punës. Me Planin Zhvillimor Komunal të komunës së Suharekës janë caktuar njëmbëdhjetë prioritete strategjike ku disa prej tyre janë në interes të zhvillimit, si:

- Mbrojtja e tokës bujqësore;
- Rritja dhe rivitalizimi i tokave ekzistuese të bujqësisë;
- Krijimi i një qendre aftësimi-shkollë e mesme për bujqësi, me hapësira për hulumtim;
- Mbrojtja e peisazhit natyror;
- Ndërtimi i agjensisë lokale për hulumtim dhe menaxhim të lokacionit për biznes.

Duke u bazuar në nevojat e biznesit vendor si dhe në prioritetet strategjike që definojnë me PZhK të cilat pjesën më të madhe ia kushtojnë zhvillimeve bujqësore, mund të themi se ky projekt i iniciuar nga komuna është mjaft i qëlluar i cili do të ndihmojë në zhvillimin dhe modernizimin e agrobiznesit.

Nga analiza e realizuar, kemi arritur në konkluzione se në zonën agroindustriale në Samadraxhë aktualisht mund të vendosen 42 biznese. Me realizimin e këtij projekti do të gjenerohen afër 100 vende të reja të punës. Agrozona do të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e të ardhurave vetanake për fermerët në regjion.

Gjatë themelimit të zonës agroindustriale në Samadraxhë janë paraparë tri mënyra të financimit:

- Financimi nga buxheti i Komunës;
- Financimi nga grandit qeveritar; dhe
- Financimi nga investitorë të tjerë.

Investimet prej 1.5 milion euro të planifikuara do të shërbejnë për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për biznese në sektorin e prodhimitarisë, bujqësore, dhe me theks të veçantë është e fokusuar tek zhvillimi i bizneseve të vogla dhe të mesme. Komuna e Suharekës ka planifikuar që Agrozona Industriale në Samadraxhë të themelohet dhe të jepet në shfrytëzim konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës, konkretisht për 99 vite. Llojet e veprimtarive janë të natyrës së prodhimit, shërbimit, përpunimit, grumbullimit të cilat janë të parapara edhe në kuadër të planit rregullues të hollësishëm, të Agrozons Industriale në Samadraxhë.

Zona industriale në Shirokë të Suharekës ka një sipërfaqe totale prej 162,25 ha. dhe në këtë sipërfaqe janë 77 parcela, me mundësi të zgjerimit në të ardhmen. Veprimtaritë që parashikohen të vendosen në zonën industriale janë: përpunimi i produkteve ushqimore, përpunimi i prodhimeve nga tekstili dhe lëkura, përpunimi i elementeve nga materiali i aluminit, plastikës dhe drurit, përpunimi nga qelqi, guri, mermeri dhe hekuri, elemente nga betoni etj.



Figura 15. Zona industriale në Shirokë-Suharekë

Parku teknologjik në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime-Ferizaj dhe përfshinë një sipërfaqe prej 10.70 ha. Në të parashihet vendosja e 15 bizneseve

të vogla dhe të mesme të karakterit kryesisht prodhues dhe në të cilën pritshmëritë janë që të punësohen rreth 600 punëtorë.



Figura 16. Parku teknologjik në Shtime

Për investitorët e interesuar, Komuna e Shtimes ofron tokën në shfrytëzim dhe njëkohësisht garanton lehtësime nga taksat e ndryshme komunale si p.sh. dhënia e Lejes Ndërtimore pa pagesë, lehtësime në taksën komunale për biznes dhe në tatime tjera.

Parkut Teknologjik në Skenderaj gjendet në Zonën kadastrale në Klinë e Poshtme. Ka një sipërfaqe prej afro 19.63 ha, dhe sipas projektit është e ndarë në 33 parcela te cilat janë të destinuara për ushtrimin e veprimtarive industriale.




Figura 17. Parku teknologjik në Skënderaj

Arsyetimi për ndërtimin e Parkut Teknologjik është interesi i përgjithshëm i Komunës për zhvillim ekonomik dhe social.

Parku i Biznesit në Vushtrri shtrihet në zonën kadastrale të Komunës së Vushtrrisë. Ka një sipërfaqe rreth 14.86 ha. dhe është e ndarë në 22 parcela. Toka e dedikuar për këtë park është pronë e Komunës.



Figura 18. Parku i Biznesit në Vushtrri

3.9 Inkubatorët e biznesit në Kosovë

Inkubatorët e biznesit janë themeluar me qëllim të përkrahjes së bizneseve të cilat janë në fazën fillestare të zhvillimit, për një periudhë të caktuar kohore. Ka shumë përkufizime për inkubatorët e biznesit, megjithatë, shumica janë dakord se një program i inkubacionit të biznesit është një program ekonomik dhe social i cili ofron mbështetje intensive për start-up kompanitë, për të filluar dhe për të përshpejtuar zhvillimin dhe suksesin e tyre përmes programeve në asistencë për bizneset (Al-Mubarak, Busler, 2013). Komponenti i rëndësishëm i suksesit të inkubatorit të biznesit është ai i shërbimeve mbështetëse të biznesit që lidhen me shërbime të tilla si zhvillimin e planeve të biznesit dhe marketingut, ndërtimin

e ekipeve të menaxhimit dhe shërbime të tjera më të specializuara profesionale dhe administrative (Phan, Lamine, 2016).

Në Kosovë implementimi i projektit për ndërtimin apo themelimin e inkubatorëve të biznesit ka filluar në vitin 2004. Janë themeluar katër inkubatorë biznesi në vende të ndryshme si: Deçan, Gjilan, Shtime dhe Drenas. Inkubatori i Biznesit (IB) është një objekt i cili ofron hapësirë me çmim të ulët në drejtim të mbështetjes së bizneseve dhe zhvillimit të shërbimeve për bizneset e reja të themeluara dhe ato në zhvillim për një periudhë dy vjeçare. Bizneseve të cilat gjenden brenda inkubatorëve iu ofrohet ndihma në asistencë administrative, shërbime përkrahëse teknike dhe konsulencë profesionale.

Inkubatori i biznesit në Gjilan gjendet në aksin rrugor Prishtinë-Gjilan. Inkubatori ka një infrastrukturë të kompletuar, lokacion të përshtatshëm, qasje të lehtë në rrugë etj. Hapësira e ndarë për këtë inkubator mbulon një sipërfaqe prej 1000 m², ku përfshihen 16 hapësira punuese. Brenda këtij objekti në hapësirën e paraparë për inkubator gjendet zyra e menaxherit, salla e trajnimeve dhe hapësira për vendosjen e 12 bizneseve.

Inkubatori i Biznesit në Deçan gjendet në qendër të qytetit dhe mbulon një sipërfaqe prej 830 m². Kjo sipërfaqe është e ndarë në 17 hapësira punuese. Edhe ky inkubator ka hapësirën për menaxherin, hapësirën për sallën e trajnimeve dhe 15 hapësira të dedikuara për biznese që vendosen në këtë inkubator. Inkubatori i biznesit në Shtime, shtrihet në pjesën lindore të qytetit të Shtimes dhe ka një sipërfaqe prej 529 m². Objekti i Inkubatorit në Shtime, përbehet prej 15 ndarjeve, të cilat janë të shpërndara brenda hapësirës së objektit. Si inkubatorët e tjerë edhe ky inkubator ka hapësirat e nevojshme për një funksionim normal të bizneseve, në kuadër të të cilit është zyra e menaxherit, salla e trajnimeve dhe hapësirat për zhvillimin e aktiviteteve të tjera.

Inkubatori i biznesit në Drenas, gjendet brenda hapësirës së Parkut dhe ka një sipërfaqe prej 1450 m². Objekti Inkubatorit të Biznesit në Drenas ka një sipërfaqe më të madhe se inkubatorët në qytete tjera të Kosovës dhe ka një ambient më të përshtatshëm për pjesën e administratës dhe hapësirat e bizneseve. Brenda hapësirës prej 1500 m² gjenden: zyra e menaxherit, salla e trajnimeve, amfiteatri me 200 vende, restoranti me sipërfaqe 233 m² dhe hapësira e dedikuar për biznese.

3.10 Zonat ekonomike në Kosovë mundësi për investime nga diaspora

Investimet nga diaspora në ZLE paraqesin mënyrën më efektive për të krijuar vende të reja pune dhe për të krijuar parakushtet për një rritje të qëndrueshme ekonomike në të ardhmen. Sipërmarrësit e diasporës janë të pozicionuar në mënyrë unike për të njohur mundësitë në vendet e tyre të origjinës dhe për të kontribuar në krijimin e vendeve të punës dhe në rritjen ekonomike. Duke u bazuar në hulumtimet e fundit, sipërmarrësit nga diaspora mund të kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve duke krijuar vende pune, duke stimuluar risi, krijimin e kapitalit shoqëror përtej kufijve, si dhe duke kanalizuar kapitalin financiar drejt vendeve të tyre të origjinës. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vendet e BE-së konsiderohen gjeneruesit kryesor të vendeve të reja të punës, dhe në këtë frymë zonat e lira ekonomike do të ishin vendi ideal për investimet e sipërmarrësve nga diaspora. Reagimet e politikëbërësve ndaj sfidave me të cilat përballen sipërmarrësit nga diaspora do të duhej të reflektonin: inkurajimin në qasje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëpërmjet kredive, ose ulja e tarifave për materialet e importuara dhe të pajisjeve në vendin e origjinës) për të ndihmuar sipërmarrësit e diasporës që të fillojnë bizneset transnacionale dhe krijimin e

mekanizmave që nxisin konsultime të rregullta me profesionistë etj. ZLE mund të përkufizohen si qendra të punës prodhuese intensive që përfshijnë importin e lëndëve të para ose komponentëve dhe eksportin e produkteve dhe shihen si instrumente për të rritur pranueshmërinë dhe kredibilitetin e politikave të transformimit dhe për të tërhequr investimet e brendshme dhe të huaja. Zonat e lira ekonomike i referohen zonave të caktuara në të cilat kompanitë janë tatuar shumë pak ose aspak në mënyrë që të inkurajojnë aktivitetin ekonomik.

Diaspora e sotme nëpër botë paraqet një tërësi që përfshinë në vetvete të gjitha shtresat sociale, përfshirë edhe ato me potencial të madh ekonomik dhe arsimor. Këta faktor duhet të jenë sinjal i cili obligon shoqërinë kosovare të përpiloj programe konkrete, si: zona ekonomike, parqe, inkubator të biznesit etj. për atë se si duhet shfrytëzuar ky potencial dhe si duhet bashkëvepruar. Kosova ka një numër të madh të qytetarëve të saj që me dekada jetojnë në vendet tjera kryesisht në Evropë, Amerikë por edhe më gjerë. Me Ligjin për Diasporën dhe Mërgatën 04/L 095, Qeveria e Kosovës ka krijuar një bazë ligjore që hapë rrugën për të stimuluar dhe mobilizuar diasporën e Kosovës. Ky ligj përcakton qartësisht se çdo person që ka vendbanim apo vendqëndrim jashtë Republikës së Kosovës dhe që ka lindur apo ka prejardhje familjare nga Kosova është pjesë e diasporës dhe pjesë përbërëse e Kosovës andaj atyre edhe duhet tu ofrohen kushte për të qenë të përfaqësuar në Kosovë, të ruajnë lidhjet dhe identitetin si dhe të përfshihen në politika të zhvillimit të vendit. Diaspora ka kontribuar në faza të ndryshme të historisë së Kosovës dhe ka merita të mëdha për mirëqenien e shoqërisë kosovare si dhe ndërtimin e zhvillimin e Kosovës.

Qeveria e Kosovës në vitin 2011 ka themeluar Ministrinë e Diasporës në nivelin më të lartë politik për të përfshirë nevojat dhe pritjet e diasporës në politikat e veta. Gjithashtu është

hartuar strategjia për diasporën në mënyrë që ta fuqizojë atë në angazhimin dhe pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë kosovare dhe për të lehtësuar koordinimin e politikave të diasporës. Kjo strategji për diasporën synon të jetë: gjithëpërfshirëse, përfaqësuese, dhe konsultative. Pikërisht zonat dhe parqet ekonomike mund të jenë mundësi investimi për kapitalin e diasporës Kosovare.

Biznesmenët në diasporë janë të pozicionuar në mënyrë unike për të njohur mundësitë e investimeve në vendet e tyre të origjinës dhe për të shfrytëzuar mundësitë e tilla duke përfituar nga resurset e tyre. Komuniteti i diasporës në vazhdimësi ka shprehur gatishmërinë të investoj në hapsirat brenda zonave. Njohja e tyre me mjedisin lokal politik, ekonomik dhe kulturor, është një avantazh për fillimin e bizneseve në vendet e tyre të origjinës. Nëse analizojmë numrin e aplikimeve për përfitime nga zonat, parqet apo inkubatorët e biznesit, lehtë vërehet se numri i tyre është fare i vogël. Hulumtimet e fundit tregojnë se ndërmarrësia në mesin e emigrantëve që jetojnë në ekonomitë e përparuara të botës është në rritje të gjitha llojet e bizneseve. Hulumtimi është bërë se si sipërmarrësit e diasporës kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në vendet e tyre të origjinës. Ka arsye të besojmë se nëpërmjet investimeve direkte të diasporës në vendet e tyre, mund të luajnë një rol të rëndësishëm të zhvillimit. Investimet nga diaspora nxisin zhvillimin e biznesit, krijimin e vendeve të punës, rrisht, dhe krijimin e rrjeteve të bizneseve transnacionale. Në studimet për ndërmarrësinë të realizuara në më shumë se 40 vende, nivelet e larta të sipërmarrjes pozitivisht lidhen me nivelet e larta të zhvillimit ekonomik. Edhe pse kjo marrëdhënie midis dy variablave është e vështirë për t'u zgjidhur - nëse nivelet e larta të sipërmarrjes nxitin rritjen ekonomike ose nëse nivele të larta të rritjes ekonomike inkurajojnë sipërmarrjen. Gjatë dekadës së kaluar, një numër i qeverive dhe organizatave të ndryshme kanë krijuar

programe për të nxitur emigrantët dhe pasardhësit e tyre për të investuar në vendet e tyre të origjinës. Iniciativat janë të drejuara privatisht dhe financuar nga qeveria për të udhëhequr, por shumica përfshijnë një lloj partneriteti publiko-privat. Organizatat të ndryshme promovojnë ndërmarrësinë e diasporës duke ofruar mundësi për diasporën dhe udhëheqësit lokal të bizneseve dhe profesionistë për të plotësuar njëri-tjetrin (personalisht ose nëpërmjet internetit), dhe për të diskutuar mundësitë për investime. Disa organizata të rrjeteve janë të përfshira në partneritetet publiko-private për të lehtësuar takime midis vendasve dhe pjesëtarëve të tjerë të diasporës, ndërsa të tjerët promovojnë rrjetëzimin në mesin e udhëheqësve të biznesit në diasporë për të nxitur partneritete. Dërgesat e emigrantëve kosovarë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, duke ndikuar në rritje ekonomike dhe duke siguruar të ardhura shtesë. Për shkak të gjendjes së rëndë sociale, shumica e remitancave shfrytëzohen për konsum dhe ato nuk po ndikojnë në hapjen e vendeve të reja të punës.




Figura 19. Remitancat sipas viteve në Kosovë (në milion €)

Në Kosovë, remitancat janë burimi i dytë më i madh i të ardhurave për familjet, duke përbërë rreth 14% të të ardhurave totale në vitin 2006 (Shaorshadze & Miyata, 2010).

Transfertat private, sidomos dërgesat nga jashtë, janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet (Kolberg, Pani, Bejakovic, Ymeraj, Kasimati, 2003). Mbi 25% e të gjitha bizneseve në Kosovë janë ngritur me fondet e pjesshme ose të plotë të gjeneruara nga puna jashtë (nga puna e vetë pronarit të biznesit, punën e anëtarëve të familjes së tyre ose të dyja).

Sipas disa hulumtimeve të organizatave ndërkombëtare, thuhet se Kosova është ndër vendet me më se shumti dërgesa të pranuar. Remitancat, sipas këtyre organizatave, llogariten se përbëjnë 18% të GDP-së. Në fakt, remitancat në Kosovë⁴² llogariten edhe si neto eksport për arsye se ne, pavarësisht që Kosova nuk dërgon mallra jashtë vendit, ato janë të hyra shtesë për shtetin dhe ekonominë e Kosovës.

Mërgimtarët dhe Diaspora mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik në vendet e origjinës. Ata do të mund të kontribuonin në zhvillimin ekonomik duke themeluar vetë ndërmarrje ose duke iu ndihmuar familjeve dhe të afërmeve për të vepruar nëpërmjet bartjes së njohurive dhe zotësive të përfituara— i ashtuquajturit “fitim i trurit”.

Shoqëria kosovare deri më tani nuk është angazhuar mjaftueshëm lidhur me zhvillimin e politikave përkatëse që do të mund të ndihmonin organizimin e Diasporës, por që gjithashtu do të lehtësonin ngritjen e potencialit të Diasporës për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Institucionet përkatëse të Qeverisë së Kosovës duhet të udhëheqin politikat të cilat krijojnë parakushtet për të tërhequr investimet e diasporës.

⁴²Banka Qendrore e Kosovës, Prishtinë, (2014)

3.10.1 Parakushtet për ngritjen e investimeve të diasporës në zona ekonomike

Për të tërhequr dhe për të lehtësuar ngritjen e investimeve të diasporës, duhet të miratohet një numër i reformave institucionale. Shumica e vendeve në zhvillim janë të bazuar në inkurajimin e investimeve nga korporatat shumëkombëshe. Së pari duhet të ketë trajtim të barabartë për investimet e diasporës dhe investimet e huaja direkte. Në realitet, investimet e diasporës kanë më shumë potencial për rritjen ekonomike dhe zhvillimin kombëtar, por që fatkeqësisht diskriminohen në favor të investimeve të huaja direkte. Pasi shteti ka krijuar një ambient të përshtatshëm ekonomik për investimet e diasporës, politikëbërësit janë të detyruar të nxisin në formën e stimuljeve financiare shtesë, të miratojnë reformat ekonomike më të favorshme për investime dhe sigurinë nga ndryshimet politike. Edhe pse investimet e diasporës mund të jenë një forcë e fuqishme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike, faktor vendimtar i investimeve do të jetë kthimi që ato mund të sjellin. Kosova ka kaluar periudhën e rindërtimit dhe duhet të orientojë veten drejtë zhvillimit ekonomik. Niveli i ulët i investimeve në Kosovë është mbi të gjitha pasojë e dëmtimit serioz të klimës së biznesit, për shkak të pengesave të konsiderueshme burokratike, veçanërisht korrupsionit në institucione, mungesa e stabilitetit energjetik dhe infrastruktura joadekuate rrugore. Edhe pse institucionet e Kosovës kanë bërë investime në fusha të tilla si: energjia, furnizimin me ujë, hekurudha, rrugë, telekomunikacion, etj, ka ende nevojë për investime të mëtejshme në këto zona që duhet të jenë në krye të agjendës zhvillimore të qeverisë së Kosovës.

Kosova tani ka nevojë për të krijuar një ambient të shëndosh të biznesit për investime nga diaspora.

Indikatorët kryesor të cilët dekurajojnë investimet nga diaspora janë:

- 1) Vështirësitë në fillimin e biznesit;
- 2) Marrja e lejeve dhe licencave në nivel qendror dhe komunal;
- 3) Mbrojtja e pamjaftueshme e investitorëve;
- 4) Vështirësitë në tregtinë përtej kufijve; dhe
- 5) Zbatimi i kontratave.

Përmirësimi i këtyre indikatorëve do të jetë sfidë për institucionet dhe bizneset. Qeveria e Kosovës duhet të përmirësojë rrethinën biznesore, në mënyrë që zonat ekonomike të bëhen më tërheqëse (atraktive) për investitorët nga diaspora. Aktivitetet kryesore duhet të orientohen në reduktimin e kohës, kostove dhe procedurave administrative.

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA

4.1 Hyrje

Metodologjia është analiza sistematike, teorike e metodave të aplikuara në një fushë të studimit. Metodologjitë e hulumtimit mund të jenë sasiore ose cilësore. Në mënyrë ideale, hulumtimi gjithëpërfshirës duhet të përpiqet të inkorporojë metodologjitë cilësore dhe sasiore, por kjo nuk është gjithmonë e mundur, zakonisht për shkak të kufizimeve kohore dhe financiare. Termi metodologji kërkimore, i quajtur edhe si metoda kërkimore, zakonisht përfshinë procedurat e ndjekura për të analizuar dhe interpretuar të dhënat e mbledhura. Këto shpesh përdorin një sërë analizash statistikore të sofistikuara të të dhënave për të identifikuar lidhjet ose rëndësinë statistikore në rezultate. Ekzistojnë dy lloje kryesore të metodologjisë kërkimore:

1. Metodologjia sasiore dhe
2. Metodologjia cilësore.

Metoda e sasiore e hulumtimit është metodë e hulumtimit që ka të bëjë me numrat dhe çdo gjë që është e matshme në një mënyrë sistematike të hetimit të fenomeneve dhe marrëdhënieve të tyre. Përdoret për t'iu përgjigjur pyetjeve mbi marrëdhëniet brenda variablave të matshëm me një qëllim për të shpjeguar, parashikuar dhe kontrolluar një fenomen (Leedy, 1993). Metoda sasiore zakonisht fillon me mbledhjen e të dhënave bazuar në një hipotezë ose teori dhe pasohet me aplikimin e statistikave deskriptive ose inferenciale. Hulumtimi sasior përdor të dhëna të matshme për të formuluar faktet dhe për të

zbuluar modelet në kërkime. Metodatat sasiore të grumbullimit të të dhënave përfshijnë forma të ndryshme të anketimeve: anketime online, anketime mobile, intervista ballë për ballë, intervista telefonike, studime gjatësore, interceptues në internet, sondazhe online dhe vëzhgime sistematike. Të dhënat sasiore shpesh ofrojnë një pamje "makro", meqë ato përfshijnë mostra të mëdha.

Metoda cilësore e hulumtimit është lloji më i cilin jemi në varësi të vrojtimeve dhe përshkrimeve. Është subjektive dhe përshkruuese, dhe përdoret për të vlerësuar njohuritë, qëndrimet, sjelljet dhe opinionet e njerëzve në varësi të temës së hulumtimit. Hulumtuesit, në këtë lloj metode përdor mendimin dhe përvojën e tij të cilat nuk lejohen të përdoren fare në metodën sasiore. Disa faktorë të rëndësishëm në metodologjinë e hulumtimit përfshijnë vlefshmërinë e të dhënave të hulumtimit, etikën dhe besueshmërinë e masave që shumica e punës përfundon kur përfundojmë analizën e të dhënave. Metodatat e mbledhjes së të dhënave cilësore variojnë duke përdorur teknika të strukturuar ose gjysmë të strukturuar. Disa metoda të zakonshme përfshijnë grupet e fokusit (diskutimet në grupe), intervistat individuale dhe pjesëmarrjen / vëzhgimet. Madhësia e mostrës është zakonisht e vogël dhe të anketuarit janë zgjedhur për të përmbushur një kuotë të dhënë. Hulumtimi cilësor shpesh grumbullon të dhëna nga mostra relativisht të vogla të njerëzve dhe mund të ofrojë një pamje "mikro" për çdo çështje që ne shqyrtojmë. Megjithatë, sasia relativisht e vogël e të dhënave nuk e bën punën më të lehtë të hulumtuesit.

Metoda që duhet përdorur varet se çfarë lloj përfundimesh dëshirojmë të nxjerrim nga eksperimenti do të na ndihmojë të përcaktojmë se cila metodë është më e favorshme. Nëse nuk jemi të sigurt se çfarë të presim në një eksperiment, një qasje cilësore mund të jetë vendimi më i mirë për të filluar. Njohja se çfarë të presim nga eksperimenti mund të na

ndihmojë të zhvillojmë një hipotezë që mund të testohet. Për të vërtetuar hipotezën na nevojiten të dhëna sasiore. Kjo metodë është gjithashtu e dobishme për krijimin e një marrëdhënie shkak-pasojë. Sapo kemi provuar diçka që mund të matet, qasja cilësore është e dobishme për të shpjeguar arsyetimet që mbarojnë përfundimin.

Kombinimi i metodave është i nevojshëm dhe i dobishëm në shumicën e hulumtimeve. Hulumtuesit duhet të përqafojnë të dyja metodat e hulumtimit në vend që të debatojnë rreth asaj se cila është më e mirë. Për shembull, kur masim diçka që mund të duket subjektive, si mendime, krijojmë një masë që standardizon përgjigjet e mundshme në pyetjet tona. Shkallët e Likertit matin se si ndihet dikush duke përdorur një numër shkalle nga një deri në pesë. Përveç kësaj mase sasiore, ofron një hapësirë për komente.

4.2 Përshkrimi i fazave të kërimit

Kërkimi filloi me përzgjedhjen e fushës së studimit në fund të vitit 2011 dhe përfundoi me paraqitjen shkrimore të tij në fund të vitit 2015. Eksperienca e mëparshme si dhe menaxhimi i shumë projekteve më ka ndihmuar që të hulumtojë në thellësi eksperiencat dhe të eksplorojë rëndësinë e zonave ekonomike në Kosovë si projekte të rëndësishme të programeve dhe strategjive të ndryshme zhvillimore.

Faza e parë e kërimit është fokusuar në rishikimin e literaturës dhe jam përqendruar në gjetjen e kërkimeve të ngjashme, për të shmangur përsëritjen dhe për t'u njohur me gjetjet dhe kornizat teorike të studimeve ekzistuese. Rishikimi i literaturës më ka shërbyer edhe si një kornizë për të krahasuar rezultatet e kërimit me ato të kërkimeve të tjera.

Në fazën e dytë, kam diskutuar me profesionistë të fushës për të riorientuar qëllimin dhe objektivat e studimit, si dhe për të specifikuar pyetjet kërkimore.

Në fazën e tretë të kërkimit jam ndalur në përcaktimin e metodave të kërkimit, instrumentave të kërkimit dhe popullatës që do të përfshihet në kërkim. Kam analizuar me kujdes informacionin e mbledhur në fazën e parë dhe të dytë duke u bazuar në qëllimin e kërkimit dhe nga pyetjet kërkimore të ngritura në fillim të studimit.

Duke u bazuar në pyetjet kërkimore kam përzgjedhur metodën e rishikimit të literaturës përmes analizës së të dhënave dytësore, si dhe metodën cilësore përmes pyetësorëve dhe intervistave gjysmë të strukturuar. Pas përzgjedhjes së metodës, instrumentat e kërkimit u konsultuan me specialistë të fushës së kërkimit, kam realizuar pilot testimin, janë bërë të gjitha modifikimeve të nevojshme dhe pyetësorët u administruan direkt në mostrën e zgjedhur për studim.

Në fazën e katërt është realizuar mbledhja e të dhënave nga pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturuar, dhe më pas është bërë transkriptimi i të dhënave të mbledhura, kodimi dhe analizimin e tyre.

Faza e fundit e studimit është faza e nxjerrjes së përfundimeve dhe përgatitjen e rekomandimeve të përgjithshme për institucionet përkatëse dhe për kërkime të mëtejshme.

4.3 Metodologjia e përdorur dhe analiza e të dhënave

Studimet e dukurive ekonomike mund të realizohen në këndvështrime të ndryshme për të krijuar një pasqyrë të qartë gjithëpërfshirëse të asaj dukurie ekonomike që po ndodhë.

Studimet duhet të përmbledhin lloje apo baza të ndryshme të të dhënave duke përdorur

metoda të ndryshme, të veçanta apo të kombinuara. Studimi im, për shkak të specifikave të tij, është zhvilluar në formën e një kërkimi metodash të kombinuara.

Mjet kryesor për vërtetimin e hipotezave, por jo vetëm, kam përzgjedhur pyetësorët të cilët janë përdorur për varietete të ndryshme profesionesh, moshash, vendbanimesh etj. Pyetësorët me një kujdes të madh janë përpiluar për kategori të rëndësishme shoqërore siç janë studentet, menaxheret, zyrtarët apo edhe për profesione të tjera. Kategoria më e rëndësishme e të anketuarve ishin menaxherët – pronar të bizneseve në zona por edhe zyrtarët e punësuar në nivele qendrore apo lokale, në drejtori përkatësisht divizione të zhvillimit ekonomik (në komuna në Drejtori të Zhvillimit Ekonomik, ndërsa në nivel qendror në Ministrinë për Zhvillim Ekonomik).

Qëllimi i metodologjisë është për të ndihmuar studiuesit të "shohin" apo të komunikojnë me njëri-tjetrin ose ndajnë një përvojë të përbashkët. Metodologjia e përdorur për të vërtetuar dy hipotezat do të shtjellohet në vazhdim të punimit. Për dy hipotezat është bërë një analizë përshkruese për të siguruar një validitet mbi çështjet e hulumtimit.

Duke pasur parasysh njohuritë e pakta në lidhje me zonat e lira në Kosovë dhe ekzistimi i disa paragjykimëve për rolin dhe suksesin e tyre, është ndier e nevojshme që me anë të një hulumtimi, të shpërfaqen mundësitë e pashfrytëzuara të zonave të lira si një instrument efikas i zhvillimit ekonomik në vend. Duke u nisur nga ky definim shkencor i problemit, qëllimi i disertacionit ishte që të paraqes cilësitë e zonave të lira ekonomike në Kosovë dhe të dëshmoj se, koncepti i zonave të lira ekonomike është një mënyrë e pranueshme e zhvillimit të regjioneve të caktuara, në rastin më të mirë të regjioneve të cilat konsiderohen si më pak të zhvilluara. Praktikrat në botë kanë treguar se përparësitë ekonomike të cilat

zonat e lira ju ofrojnë shtetit dhe shfrytëzuesve, janë shumë më të mëdha se dobësitë që ato kanë në funksionimin e tyre.

Studimi im ka synuar të sigurojë evidenca empirike në lidhje me performancën e ZE në Kosovë. Pyetësi i strukturuar, i përbërë prej 24 pyetjesh ka qenë instrumenti i përdorur për të mbledhur të gjitha të dhënat për këtë studim dhe i sinkronizuar përballë pyetjeve kërkimore dhe hipotezave. Pyetësi i është dërguar personave të cilët kuptojnë natyrën e çështjeve të trajtuara nga kjo anketë. Të anketuarit ishin menaxherë të kompanive, përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale dhe persona zyrtar të kyçur në mënyrë indirekte në çështjen e ZE. Janë anketuar 56 persona në regjione të ndryshme të Kosovës për të përfaqësuar një shtrirje më të madhe gjeografike.

Gjatë punimit kam përdorur metodën sasiore për mbledhjen e të dhënave. Përgjigjet e mbledhura nga pyetësit më ka ndihmuar që të bëjë më lehtë krahasimin e të dhënave të për të testuar hipotezat e parashtruara.

4.4 Përzgjedhja e kampionit

Polit dhe Hungler (1999) i referohen popullsisë si një tërësi ose tërësi të të gjitha objekteve, subjekteve ose anëtarëve që përputhen me një grup specifikash. Studimi është kryer mbi procesin e analizës së dy zonave ekonomike të cilat konsiderohen si më të mëdha për nga numri i bizneseve të vendosura në ndonjë zonë ekonomike. Gjeografikisht, zgjodhëm që t'i përqendrojmë hulumtimet tona në parkun e Drenasit me 41 biznese dhe në zonën ekonomike në Ferizaj me 14 biznese prodhuese.

Të anketuarit e përfshirë në hulumtim kanë pasur role të ndryshme që nga studentë (kryesisht të ekonomisë), zyrtarë të punësuar në institucione qendrore dhe lokale (në sektorë dhe divizione të ekonomisë) e deri te niveli i menaxherëve të bizneseve në zona ekonomike. Shumica e të anketuarve, sa i përket nivelit arsimor, kanë deklaruar se kanë diplomë universitare (74.2%). Gjithashtu, shumica e të anketuarve ishin të punësuar (79.8%) që përbënte kategorinë e dytë të të anketuarve, dhe një numër i caktuar i tyre ishin studentë. Me shume se 68% prej tyre (menaxherë në zona, punëtorë në bizneset brenda zonave, shërbyes qeveritarë dhe shërbyes lokal) ishin të përfshirë në mënyrë direkte ose indirekte në të gjitha sfidat me të cilat janë përballur zonat ekonomike, që nga ideja për themelimin e tyre, deri te fillimi i aktiviteteve të bizneseve në zonë. Në figurën 20 janë paraqitur profesionet apo kategoritë e respondentëve të anketuar në këtë studim. Vlenë të theksohet se në grupin e të tjerëve të paraqitur në grafik, kanë dominuar banorët të cilët jetojnë në vendbanimet ku ndodhen zonat ekonomike, e që në rastin tonë ishin nga regjioni i Ferizajt dhe Drenasit.




Figura 20. Profesionet (kategoria) e të anketuarve

Kampioni ishte përfaqësues edhe në këndvështrimin e pozicioneve që kishin të anketuarit brenda institucioneve (shefa të sektorëve, drejtorë, zyrtarë të lartë etj.). Në përzgjedhje jam përpjekur të bëjë një ndarje paraprake në pesë kategori: zonë ekonomike, park industrial, institucion qendror, institucion lokal dhe aleancë e bizneseve me qëllim që përfshirja të jetë sa më reprezentative.

4.5 Zgjedhja e mostrës

Gjate hulumtimit tim në caktimin e mostrës kam përdorur disa kritere: kriteri i gjinisë, vendbanimit dhe profesionit, ndërsa grupmoshat ishin të ndara në pesë nëngrupe duke filluar nga mosha “më e vogël se 20” e deri te ajo “më e madhe se 50 vjet”.

Tabela 9. Grupmosha e të anketuarve

Grupmosha	Pjesëmarrja	Përqindja
< 20	2	3.57
21-30	6	10.71
31-40	19	33.93
41-50	22	39.29
> 50	7	12.50
Totali:	56	100.00
Pa përgjigje:	0	

Metoda sasiore e mbledhjes së të dhënave përmban në vetvete analizën e të dhënave primare të mbledhura përmes pyetësorëve. “Madhësia e mostrës prej së paku 30 e më së shumti 500 është e përshtatshme për të kryer shumicën e hulumtimeve” (Sekaran, 2003). Madhësia e mostrës së përdorur prej 56 respondentëve në punimin tim, mbase është e vogël,

mirëpo ajo mund të konsiderohet përfaqësuese shumë e mirë nëse marrim parasysh raportin në numër të përgjigjeve për pyetjet\përgjigjet të cilat janë konsideruar kyçe.

Respondentëve u janë parashtruar 24 pyetje, dhe nga përgjigjet janë nxjerrë grafik të ndryshëm krahasimi në mes të variablave, për të vërtetuar hipotezat e parashtruara. Sipas Field (2005) ekzistojnë shumë rregulla sa i përket vëllimit të zgjedhjes, por si rregull i përgjithshëm duhen 10-15 përgjigje për treguesin më të rëndësishëm.

Për mbledhjen e të dhënave, janë shpërndarë pyetësorët të cilët ishin të ndara në dy grupe kryesore:

- Grupi i parë që përfshinte pyetjet për zonat ekonomike dhe
- Grupi i dytë që përfshinte pyetjet lidhur me aplikacionin për integrimin e shpenzimeve.

Pyetësorët ishin të dizajnuar në atë mënyrë që së pari të anketuarit janë informuar mbi qëllimin dhe objektivat e këtij studimi. Të anketuarve u është thënë qartësisht se pjesëmarrja në këtë hulumtim është vullnetare dhe anonime. Nga të anketuarit është kërkuar që pyetjeve t'iu përgjigjen realisht, siç ata vërtetë e gjykojnë. Shumica e pyetjeve kanë kërkuar përgjigje alternative, ndërsa vetëm në një të një prej tyre kërkohej përgjigje e hapur. Një grup i pyetjeve janë ndërtuar mbi bazën e vlerësimit popullor, ku nga të anketuarit është kërkuar të përgjigjen me numra rendor nga 1 deri në 5, që në studimin tim është analog me vlerësimin e përshkallëzuar kualitativ, nga dobët (1) deri në shkëlqyeshëm (5). Nga 56 pyetësorët e shpërndarë u plotësuan që të gjithë dhe rezultuan si të vlefshëm.

4.6 Mënyra e përpunimit dhe prezantimit të të dhënave

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar përmes paketës llogaritëse Excel. Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë prezantuar dhe analizuar në tri mënyra:

Mënyra e parë - përgjigjet e pranuar janë prezantuar në tabela si përgjigje të përgjithësuara për të gjithë të anketuarit.

Mënyra e dytë - janë prezantuar përgjigjet sipas dy nënndarjeve kryesore: për zonat ekonomike dhe për aplikacionin dhe

Mënyra e tretë - janë përdorur tabelat e kryqëzuara ku janë vënë përballë njëra tjetrës, në një tabelë.

Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një kombinim i teknikave të formatit elektronik dhe të printuar. Të gjitha të dhënat e mbledhura janë vendosur në një databazë, të cilat më pas janë përpunuar dhe analizuar për të paraqitur të gjeturat dhe për të siguruar tendencën e përgjithshme të detajuar, lidhur me ndikimin e zonave ekonomike në zhvillimin ekonomik së pari, dhe së dyti uljen e shpenzimeve përmes aplikacionit për integrimin e shpenzimeve të përbashkëta të bizneseve në zonat ekonomike.

Shumica e përgjigjeve nga 24 pyetjet e parashtruara, janë prezantuar në brendësi të punimit.

Pjesa e përgjigjeve që kishin të bëjnë me aplikacionin për integrimin e shpenzimeve në zona ekonomike është prezantuar në kapitullin e pestë.

4.7 Kufizimet

Ky studim është i përqendruar në evidentimin e ndikimit të zonave ekonomike në zhvillimin e ekonomisë kosovare. Në aspektin kohor punimi i referohet kryesisht dekadës së fundit dhe përpqet të hulumtoj ndikimin e zonave ekonomike në zhvillimin ekonomik, në punësim dhe në instalimin e teknologjive të reja në periudhën pas vitit 2000. Studimi tenton të projektoj edhe raportin e zonave ekonomike në Kosovë me ato të rajonit.

Sa i përket kampionit, i është kushtuar kujdes që ai të jetë sa më gjithpërfshirës. Disa të anketuar janë pyetur virtualisht dhe nuk ka pasur kufizim të vendndodhjes. Shumica e të anketuarve ishin nga qytetet që kanë të zhvilluara zonat ekonomike dhe parqet industriale.

Në një aktivitet të tillë studimi, është e natyrshme të paraqiten edhe kufizime të cilat në rastin tim kryesisht janë lidhur me disponueshmërinë e të dhënave. Është e vështirë të sigurohen të dhëna të cilat ndihmojnë në ndërtimin e modeleve të besueshme. Edhe atëherë kur besohet se janë gjetur të dhëna të mjaftueshme, mungojnë për shembull të dhënat krahasuese të viteve apo periudhave të fundit prandaj, në disa raste janë përdorur edhe të dhënat e marra nga burime të ndryshme, si: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Aleanca Kosovare e Bizneseve etj.

Si kufizim tjetër, konsideroj edhe pamundësinë për të vizituar nga afër më shume zona apo parqe ekonomike jashtë Kosovës, të cilat do të më shërbenin si modele krahasimi dhe referimi me zonat dhe parqet në Kosovë në disa faktorë të rëndësishëm, siç janë lokacioni, veprimtaria, lloji i bizneseve, politikat fiskale etj.

Gjithashtu si kufizim mund të konsideroj edhe:

- Mungesën e studimeve për zona dhe parqe në Kosovë;

- Fokusimi i studimit;
- Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe;
- Në raste të rralla, mungesa e disponueshmërisë ose hezitimi për plotësimin e pyetësorit; dhe
- Vështirësitë formale në realizimin e intervistave të strukturuar, të cilat mund të jenë edhe si rezultat i një kulture të munguar hulumtimi dhe kërkimi në regjionet ku është realizuar hulumtimi.

4.8 Analiza e të dhënave dhe interpretimi i tyre

Në Kosovë mungojnë studime për zonat ekonomike dhe ende nuk ka analiza të mjaftueshme mbi përparësitë e shfrytëzimit të tyre. Gjithashtu mungojnë studime dhe analiza për të përcaktuar se cili model i zonave apo parqeve duhet përzgjedhur në momentin e tanishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Edhe debati se si modeli i zgjedhur duhet të ndikoj në faktorët e zhvillimit ekonomik sikurse janë investimet, teknologjia e re, fuqia punëtore profesionale, rritja e eksportit etj., vazhdon të jetë aktual. Qëllimi kryesor i hulumtimit tim është të tregojë se zbatimi i konceptit të zonave të lira është i mundur dhe i dëshirueshëm në Kosovë, dhe se ky instrument i politikës ekonomike, në qoftë se është i projektuar dhe i menaxhuar siç duhet, është i suksesshëm në arritjen e objektivave të zhvillimit ekonomik. Zonat ekonomike mund të përdoren si mjet për rritjen e efikasitetit të aktiviteteve biznesore, për tërheqjen e investimeve dhe për rritjen e punësimit. Në këtë kohë, për arsye të zhvillimit ekonomik sa më të shpejtë të Kosovës, nevojitet një strategji efikase e dizajnuar për

zhvillim ekonomik nacional, e cila do të krijoj një sistem të instrumenteve ekonomike për tërheqjen e investimeve të huaja direkte, për përfitime dhe masa nxitëse, një nga të cilat, por jo edhe e vetme, janë edhe zonat e lira ekonomike.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë përparësitë dhe të metat e aplikimit të konceptit të zonave të lira dhe propozojnë modelin më të mirë të mundshëm për formimin dhe funksionimin e zonave të lira në Kosovë, garanton efektin maksimal dhe ndikimin në zhvillimin e ekonomisë, përmes tërheqjes së investimeve të huaja direkte, teknologjive të reja dhe rritjen e punësimit. Me qëllim të vërtetimit (verifikimit) apo kontestimit të hipotezave janë përdorur teori shkencore të analizës teorike, konkludim deduktiv indirekt dhe hulumtim interaktiv elektronik.

Hipotezat janë testuar përmes analizës së përgjithshme të koncepteve teorike të institutit të zonave të lira dhe ndarjen e tërësisë komplekse në faktorë të veçantë që mundësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e tyre. Metoda e analizës teorike ka bërë të mundur që punimi të ofroj vlerësimin e ndikimit të zonave të lira në ekonominë kosovare.

Arsyetimi shkencor i këtij hulumtimi në të ardhmen do të reflektoj në zhvillimin e konceptit të zonave të lira në Kosovë, veçanërisht institucionet që do të jenë përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e tyre. Të dhënat nga punimi mund të jenë një burim i rëndësishëm për të marrë vendime të drejta në rishikimin e ligjeve dhe dokumenteve të tjera që trajtojnë zonat ekonomike dhe parqet industriale.

Në shumë vende në zhvillim, zonat e lira kanë kontribuar në një rritje të konsiderueshme të punësimit, sidomos popullsisë me arsimim të ulët, duke zgjidhur në këtë mënyrë problemet e mëdha të papunësisë. Me krijimin e vendeve të reja të punës, shtetet rrisin shkëmbimin në

tregtinë e jashtme në formën e të ardhurave nga jashtë në zonat e lira. Shkalla e papunësisë në Kosovë vlerësohet të jetë 32.9%, ndërsa shkalla e punësimit 25.2%.




Figura 21. Ndikueshmëria e zonave ekonomike në punësim

Papunësia, më e theksuar është tek femrat me 36.6 %, krahasuar me meshkujt 31.8 %, shifra këto të prezantuara nga ASK-ja (Agjencia e Statistikave të Kosovës). Po ashtu, sipas ASK-së del se 2/3 e popullsisë në Kosovë janë popullsi në moshë pune, që përfshinë moshat nga 15-64 vjeçare. Në këtë frymë, ndër arsyt kryesore për themelimin e zonave ekonomike është edhe ulja e shkallës së papunësisë në Kosovë. Qeveria qendrore por edhe qeveritë lokale (komunat) përmes këtyre programeve për më shumë se një dekadë vazhdojnë përpjekjet për krijimin e kushteve dhe ofrimin e lehtësirave për ndërmarrjet që veprojnë brenda zonave, me qëllim rritjen e numrit të punëtorëve. Nga hulumtimi i realizuar ka rezultuar se, bizneset në të shumtën e rasteve nuk kanë përmbushur pritshmëritë lidhur me numrin e të punësuarve. Kjo është vërtetuar nga rishikimi i planeve të biznesit të prezantuara në momentin e aplikimit për ndarje të parcelës në zonë ekonomike. Më shumë se gjysma apo 57 % e të anketuarve, kanë vlerësuar me notën 3 ndikimin e zonave

ekonomike në punësim, ndërsa 31% me notën dy dhe katër. Jo me pak se 5% e të anketuarve janë krejtësisht të pakënaqur me nivelin e punësimit në kompanitë që veprojnë brenda zonave. Kosova i ka hapur rrugën zhvillimit të zonave ekonomike me miratimin e ligjit nr. 04/l-159 dhe të dokumenteve të tjera plotësuese për zonat ekonomike të cilat, vlerësohen si instrumente të zhvillimit ekonomik lokal dhe rajonal.




Figura 22. Ndikueshmëria e ZE në zhvillimin ekonomik lokal

Sipas rezultateve të hulumtimit 50% e të anketuarve pohojnë se ZE kanë pasur ndikim në zhvillimin lokal, 21% e të anketuarve pohojnë se ZE nuk kanë pasur ndikim në zhvillimin lokal, dhe 29 % e të anketuarve pohojnë se ZE kanë pasur pak ndikim në zhvillimin ekonomik ekonomik lokal. Nga grafiku i paraqitur në figurën 22 mund të konstatohet se, shumica e të anketuarve vlerësojnë ndikimin pozitiv të ZE në zhvillimin lokal. Një ndër problemet e shumta më të cilat janë sfiduar institucionet por edhe vet bizneset në zona, kanë qenë mungesa e kriterëve të qarta të përzgjedhjes për zhvilluesit e zonave ekonomike dhe mungesa e kriterëve që kanë të bëjnë me performancën e shfrytëzuesve të ardhshëm potencial, si rezultat i të cilave janë minimizuar ndikimet pozitive të pritshme nga komuniteti dhe institucionet. Që nga ideja për zhvillimin e zonave ekonomike, e deri te fillimi i aktiviteteve prodhuese në zona, themeluesit kanë qenë të përkushtuar që bizneset në

zona të kenë disa benifite të cilat do të ndikonin që performanca e tyre të jetë më e lartë. Shumica e të anketuarve, ose më saktë 31 nga 56 prej tyre, kanë dhënë vlerësimin mesatar lidhur me performancën e bizneseve në zona, ndërsa fare pak ose vetëm 3 prej tyre e vlerësojnë të shkëlqyeshme këtë performancë.




Figura 23. Performanca e zonave ekonomike

Në pyetjen se a ka nevojë Kosova për më shumë ZE, vetëm tetë prej të anketuarëve apo 14% nuk kanë dhënë përgjigje. Te anketuarit, 45 prej tyre ose 81% kanë deklaruar se Kosova ka nevojë për më shumë ZE, ndërsa 3 apo 5% kanë deklaruar se nuk ka nevojë. Nga kjo shihet se shumica e përfaqësuesve të bizneseve si dhe përfaqësuesve të institucioneve janë për rritjen e numrit të zonave ekonomike.




Figura 24. Përgjigjet e të anketuarve për rritjen e numrit të ZE

Një pyetje tjetër e cila gjithashtu kërkon analizë dhe studim më të thellë ishte se: Cilat janë vështirësitë me të cilat përballen ZE në Kosovë?. Nga të anketuarit, 25 apo 45% kanë dhënë përgjigje se korniza ligjore është e përshtatshme për ZE. Gjithashtu është vërejtur se komponentët si: politikat fiskale, përkrahja institucionale dhe infrastruktura teknike kanë ndikueshmëri afërsisht të njëjtë në morinë e vështirësive me të cilat përballen bizneset në zona.




Figura 25. Disa komponente të rëndësishme për ZE në Kosovë

Diversiteti i organizimeve të tilla në Kosove lë shumë për të dëshiruar. Pastaj edhe vet konfuzioni në emërtimin e tyre, në përparësitë, mundësitë, kërcënimet që ofrojnë këto programe zhvillimi janë një sfidë, e cila në të ardhmen duhet të qartësohet më shumë për komunitetin e biznesit. Nga të anketuarit, në pyetjen se për çfarë lloje të ZE ka nevojë Kosova, 11 apo 20% kanë deklaruar për parqe të biznesit, 10 apo 18% kanë deklaruar për parqe industriale, 3 apo 5% kanë deklaruar për eko-parqe, 12 apo 21% kanë deklaruar për parqe teknologjike dhe 20 apo 36% e të anketuarëve janë deklaruar për zona të lira ekonomike.




Figura 26. Llojet e ZE për të cilat ka nevojë Kosova

Pa dyshim se për një efikasitet gjatë gjithë zhvillimit të parqeve dhe zonave duhet një mbështetje institucionale e cila nëse mund të thuhet se nuk ka munguar, atëherë patjetër vlenë të cilësohet se nuk ka qenë mjaftueshëm kreative. Me vlerësimin nga nota 1 deri në 5 lidhur me përkrahjen institucionale kemi këto rezultate: 37 apo 66% kanë dhënë vlerësimin me 3, 12 apo 22% kanë dhënë vlerësimin me 4, ndërsa 4 apo 7% kanë dhënë vlerësimin me 2. Vetëm tre prej tyre apo 5% nga të anketuarit kanë vlerësuar përkrahjen me 5, që dëshmon se zonat ekonomike nuk kanë vëmendjen e duhur nga institucionet qendrore dhe lokale. Nga të anketuarit nuk kishte asnjë vlerësim negativ.




Figura 27. Angazhimi i institucioneve përkatëse në mbështetjen e ZE

Efikasiteti i një sistemi fiskal është i lidhur veçanërisht me karakteristikën e një takse, si një instrument për zbatimin e politikave të ndryshme ekonomike, nxitjen e zhvillimit ekonomik, arritjen e ndryshimeve të veçanta strukturore, etj.⁴³. Për të pasur një pasqyrë më të qartë mbi sfidat e parqeve industriale, është zhvilluar një anketë-intervistë me një mostër të rastit prej 35 personave të punësuar në bizneset brenda parqeve. Qëllimi i studimit ishte të merrnim opinionet e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit në lidhje me sfidat e tyre në parqet industriale në Kosovë. Përgjigjet në pyetjet e parashtruara që kishin të bëjnë me politikat fiskale, pasqyrohen në grafikun e paraqitur në figurën 28, në të cilin dominon përgjigja se, këto politika nuk janë mjaftueshëm të favorshme, ndërsa 11 prej tyre vlerësojnë se këto politika duhet ndryshuar.




Figura 28. Opinionet në lidhje me politikat fiskale për zonat ekonomike

Kuadri ligjor ekzistues që trajton aktivitetin e bizneseve në zona rezulton me cilësi jo të kënaqshme, dhe kjo ndikon negativisht në tërheqjen e investimeve të huaja dhe dekurajon investimet vendase. Kuadri rregullator jo cilësor ka nxitur një shkallë të lartë informaliteti.

⁴³E.Pere; A.Hashorva; "Tax Systems in West Balkans Countries – between simplicity and efficiency"; "Romanian Economic and Business Review". 6(2) - June 2011; Published by the Scientific Research Department of the Romanian - American University; ISSN 1842-2497. Board Editorial. Impact Factor. Classified CNCSIS B+ and indexed in EconLit, IDEAS/RePEc database, EconPapers and Index Copernicus (IC Value – Current 3.42 -2010); fq. 5 – 21.

Termi "Ekonomia joformale" i referohet të gjitha aktiviteteve "i pa vënë re" ekonomike, të kryera nga punonjësit dhe subjektet ekonomike, që synojnë shmangien e tatimit ose operimit në kundërshtim me ligjet, rregullat dhe procedurat administrative të aplikuara (Muceku, 2014). Sipas (Targosz, 2016), duke aplikuar qasje të ndryshimeve institucionale dhe europianizimin e politikave publike, më së miri shpjegohet lidhja midis akterëve të ndryshimeve institucionale në Kosovë dhe ambientit ekonomik në vend. Lidhur me këtë iniciativat e ndërmarra kanë qenë të fragmentuara, me mungesë koordinimi ndër-ministor si dhe me mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme për zbatimin dhe monitorimin e tyre. Qeveria e Kosovës në dokumentet e saja të para strategjike, në periudhën e pasluftës kishte për mision përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Në këtë frymë, në vitin 2009 ka miratuar ligjin për zonat ekonomike ndërsa më vonë edhe një sërë udhëzimesh administrative që mbështesin këto lloje biznesesh. Në përpjekjet e saja për afrimin me standardet e ekonomisë së tregut, institucionet e Kosovës në vizionin e tyre duhet të kenë krijimin e një sistemi funksional dhe të qëndrueshëm për zhvillimin dhe menaxhimin e vazhdueshëm të reformës ekonomike, monitorimit sistematik të të gjitha komponentëve të saj dhe përcaktimin e masave të reja të nevojshme në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit. Krijimi i institucioneve profesionale të qëndrueshme dhe lehtësimi i procedurave, do të garantonin një ambient miqësor, transparent dhe eficient për biznesin. Rrethina e re biznesore do të hapte rrugë krijimit, funksionimit dhe financimit të parqeve industriale pasi që nga shumë studiues konsiderohen si faktorë i rëndësishëm në ekonominë moderne. Në Bashkimin Evropian rreth 90% e të gjitha ndërmarrjeve janë NVM, në të cilat janë të punësuar rreth 65 milionë njerëz. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme konsiderohen bërthama e inovacionit dhe baza e zhvillimit të ekonomisë së një vendi.

Përveç politikave fiskale, pjesë e analizës së hulumtimit ka qenë edhe kuadri ligjor, si faktor ndikues në zhvillimin e parqeve industriale. Përgjigjet në pyetjet e parashtruara që kishin të bëjnë me kuadrin ligjor pasqyrohen në diagramin e paraqitur në figurën 29.




Figura 29. Kuadri ligjor lidhur me zonat ekonomike

Ndonëse ka parakushte për zhvillimin ekonomik, Kosova deri para disa viteve konsiderohej si një vend jo i favorshëm për biznes për shkak të politikave të pafavorshme kreditore, ngarkesave me taksa, etj. Studiuesit vlerësojnë se krijimi i një klime të favorshme për zhvillimin e bizneseve në zona - parqe do të mund të realizohej vetëm nëse krijohen parakushte për një gjë të tillë, sikurse janë ulja e taksave dhe normave të kredive bankare, të cilat për momentin nuk janë të favorshme. Përkundër nevojave për kredi që kanë bizneset për investime kapitale, kreditë që ofrojnë bankat komerciale në Kosovë, kanë norma të larta të interesit, të cilat pak vite më parë ishin nga 12 deri në 15 %, ndërsa tani janë nga 9-12 % e që janë më të lartat në rajon. Politikat kreditore në Kosovë nuk kanë krijuar situatë të favorshme për zhvillimin e bizneseve dhe rrjedhimisht edhe të ekonomisë, thonë të anketuarit dhe përfaqësuesit e bizneseve në zona të Kosovës. Përgjigjet që kishin të bëjnë me politikat kreditore pasqyrohen në diagramin e paraqitur në figurën 30.




Figura 30. Opinionet në lidhje me politikat kreditore

Modernizimi i infrastrukturës teknike në përgjithësi dhe të asaj rrugore në veçanti, sidomos në vitet e fundit, pastaj plotësimi i kornizës ligjore për zonat ekonomike, i ka bërë zonat ekonomike më atraktive për ndërmarrësit.

Shumica e të anketuarve në parkun industrial në Ferizaj janë të kënaqur me pozitën e lokacionit të zgjedhur nga institucionet.




Figura 31. Kënaqshmëria me lokacionin e zgjedhur

Ndër shumë faktorë të cituar nga të anketuarit për kënaqshmërinë në lidhje me lokacionin, menaxherët e ndërmarrjeve përfituese kanë vlerësuar në radhë të parë infrastrukturën fizike brenda zonës, qasja në rrugën nacionale Prishtinë-Shkup dhe afërsinë me autostradën. Ata

kanë marginalizuar afërsinë me vijën hekurudhore për faktin se infrastruktura hekurudhore në Kosovë, ende nuk është në funksion të zhvillimit ekonomik.

Parku industrial në Drenas si një investim i madh i qeverisë është e vështirë të thuhet nëse ka përmbushur pritshmëritë e qytetarëve. Që në fillimet e themelimit të tij ka pasur shumë variacione në informata për numrin potencial të të punësuarve. I projektuar që të ndërtohet në një zonë e cila tradicionalisht është konsideruar si më e varfër, mbase ka pasur edhe më shumë kureshtje, sidomos nga rajonet rreth zonës. Nëse infrastruktura fizike në këtë park mund të thuhet se përmbush standardet rajonale e ndoshta edhe ato evropiane, atëherë pse edhe numri i të punësuarve të mos jetë i përafërt krahasuar me zonat ekonomike në rajon. Përgjigjet për objektivat e (pa) përmbushura në këtë park janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.




Figura 32. Përmbushja e objektivave në parkun e Drenasit

Diaspora me të drejtë vazhdon të konsiderohet si një resurs i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, por edhe për investime në parqe. Në pyetjen se a konsiderohen zonat-parqet hapësira ku diaspora mund të investoj dhe nëse po, përse, ka dominuar përgjigja se Kosovës i duhet pikërisht një mentalitet dhe kulturë pune me standarde evropiane, të fituar nga

bashkatdhetarët gjatë qëndrimit në vendet e BE-së. Disa nga përgjigjet që kanë të bëjnë me rregullat dhe standardet e punës në Kosovë, duke përfshirë këtu klientelizmin, nepotizmin, korrupsionin, procedurat e tejzgjatura administrative etj., janë konsideruar dekurajuese për investitorët nga diaspora.

Vlerësoj se rezultatet e hulumtimit tim mund të paraqesin një pikë krahasimi dhe referimi për hulumtimet e ardhshme, për të identifikuar më lehtë faktorë të tjerë të rëndësishëm për zhvillimin e parqeve dhe zonave.

Nga rezultatet e hulumtimit mund të nxjerrim disa konkluzione dhe rekomandime:

- Përzgjedhja e lokacionit të zonave ekonomike duhet bërë në bazë të kritereve dhe standardeve më profesionale;
- Vështirësitë buxhetore kanë shkaktuar vonesa në ndërtimin e infrastrukturës mbrenda zonave ekonomike;
- Një zgjidhje e shpejtë dhe e qëlluar për investitorët të cilët janë duke kërkuar një vend pa vonesa administrative, do të krijoj më shumë mundësi për të gjetur investitorët e duhur;
- Moszbatimi i kritereve të përzgjedhjes dhe vlerësimit të performancës nga zhvilluesit e zonave, kanë rritur numrin e përdoruesve pasiv brenda zonave, duke minimizuar ndikimet pozitive të pritshme;
- Mungesa e koordinimit ndërinstitutional, sidomos që kanë të bëjnë me kompetencat;
- Nuk kanë ekzistuar politika të qarta në lidhje me përzgjedhjen e projekteve;
- Marketingu i dobët;
- Mungesa e mbështetjes së qëndrueshme nga institucionet.

KAPITULLI V: INTEGRIMI I SHPENZIMEVE NË PARKUN INDUSTRIAL TË DRENASIT - MODEL PËR ZONAT DHE PARQET TJERA

5.1 Menaxhimi i shpenzimeve

Menaxhimi i shpenzimeve në kuptimin më të gjerë të fjalës nënkupton përpjekjet që në kushte të caktuara të afarizmit, me zvogëlimin e shpenzimeve, të realizohen rezultate më të mira afariste. Pra, qëllimi i menaxhimit të shpenzimeve është që me shpenzime sa më të vogla, të realizohen sa më shumë efekte dhe fitim sa më i madh, pa pasoja negative afatgjate për afarizmin dhe pozitën në treg. Ekzistojnë modele të ndryshme të menaxhimit të shpenzimeve:

- Modeli procesual i menaxhimit të shpenzimeve presupozon se është e nevojshme që shpenzimet e prodhimit të përcillen dhe vlerësohen duke ndjekur rrjedhën e prodhimit në faza, me thjeshtësimin dhe shkurtimin e proceseve të caktuara të prodhimit.
- Modeli ABC i menaxhimit të shpenzimeve bazohet në përcjelljen dhe përzgjedhjen e aktiviteteve afariste që krijojnë të ardhura dhe harxhojnë resurse prodhuese. Kjo nënkupton angazhimin e menaxhmentit për ti dalluar ato aktivitete që kanë ndikim më të madh në krijimin e fitimit dhe angazhimet e tyre ti orientojnë në zvogëlimin e shpenzimeve.

- Modeli tradicional i menaxhimit siç kuptohet edhe nga vetë emri i tij, është modeli më i vjetër i menaxhimit të shpenzimeve. Bazohet në ndarjen tradicionale të shpenzimeve në shpenzimet direkte, që përfshijnë vetëm shpenzimet direkte të lëndëve të para, shpenzimet e punës së drejtpërdrejtë dhe shpenzimet direkte të pasurisë afatgjatë (amortizimi) që është përdorur në procesin e punës.

Shpenzimet janë një faktor mjaft i rëndësishëm në aktivitetin biznesor. Të gjitha shpenzimet krijohen gjatë një aktiviteti afarist, pa marrë parasysh se për cilin aktivitet është fjala (prodhim, qarkullim etj.). Ato duhet të mbulohen nga të ardhurat e tërësishme.

Shpenzimet mund t'i konsiderojmë si shprehje monetare e faktorëve material dhe të fuqisë punëtore, të cilat e përcaktojnë rezultatin financiar në një ndërmarrje. Secili drejtues i biznesit shpenzon shuma të mëdha parash për tre faktorët kryesorë të aktivitetit afarist:

- a) Në mjete të punës (ndërtesat, makineritë, veglat etj.);
- b) Në objekte të punës (lënda e parë, materiali primar, materiali ndihmës etj.); dhe
- c) Në fuqi punëtore.

Ekziston një lidhje e ngushtë ndërmjet shpenzimeve dhe rezultateve, apo të tregut dhe pronarëve të ndërmarrjes. Në teorinë dhe praktikën e përlllogaritjes së shpenzimeve ekzistojnë shumë ndarje të shpenzimeve në lloje. Ndarja e shpenzimeve bëhet nga fakti se çfarë merret si kriter bazë për klasifikimin e tyre. Por, klasifikimi i shpenzimeve në lloje më shumë i shërben drejtuesit të ndërmarrjes për ta konstatuar saktësisht çmimin kushtues.

Ndarja e shpenzimeve në lloje është rezultat i teorisë dhe i analizës së shpenzimeve, e cila organizohet në kuadër të teorisë së kontabilitetit të shpenzimeve. Më saktë, kategoria e shpenzimeve studiohet në kontabilitetin e drejtuesit, i cili ndryshe quhet edhe kontabilitet menaxherial. Të gjitha klasifikimet e shpenzimeve shërbejnë si bazë për marrjen e

vendimeve afariste. Po ashtu, rëndësia e tyre vjen në shprehje më tepër në momentin e planifikimit të prodhimit – aktivitetit, prandaj ne do t'i përmendim disa ndarje - klasifikime të shpenzimeve.

Shpenzimet janë faktorë kryesor nga të cilat varet aktiviteti afarist. Ato janë madhësi relative dhe ndryshojnë vazhdimisht. Në teorinë dhe praktikën e shpenzimeve studiohen karakteristikat e ecurisë së shpenzimeve dhe ndikimi i tyre në suksesin afarist. Mirëpo, një faktor tjetër i cili ndikon, po ashtu në aktivitetin afarist janë shërbimet e natyrave të tjera si, objektive dhe subjektive. Por, në përgjithësi, faktorët që ndikojnë në aktivitetin afarist i ndajmë në dy grupe kryesore: të brendshëm dhe të jashtëm. Në kuadër të faktorëve të brendshëm bëjnë pjesë: faktori teknik (objektiv) dhe faktori organizativ (subjektiv).

Në kategorinë e shpenzimeve indirekte bëjnë pjesë: shpenzimet e tokës, rentës (qerasë), të makinerive, administratës, tatimeve dhe kontributeve, mirëmbajtjes kolektive të repartit e të tjera.

Në grupin e shpenzimeve variabile bëjnë pjesë: shpenzimet direkte të materialit primar dhe shpenzimet e materialit ndihmës (të cilat na paraqesin shpenzimet e substancës) për produktin e prodhuar. Në këtë grup të shpenzimeve bëjnë pjesë edhe shpenzimet e përgjithshme për zhvillimin normal të aktivitetit prodhues ku hyjnë: shpenzimet e administratës së përgjithshme, të mirëmbajtjes kolektive, të higjienës, të shitjes etj.

Shpenzimet standarde i japin kuptim (domethënie) shpenzimeve, sepse shmangiet nuk janë asgjë tjetër veçse tregues i humbjeve apo i kursimeve potenciale. “ Shpenzimet nuk duhen vështruar se çfarë janë, por çfarë dhe si duhet të jenë”⁴⁴. Shpenzimet standarde vijuese janë

⁴⁴ N.Wright: “Direct Standard Cost” fq.3

të përcaktuara për një periudhë të caktuar kohore afariste. Të gjithë teoricienët e shpenzimeve i ndajnë ato në: shpenzime standarde, shpenzime ideale, reale dhe normale.

5.2 Arsyet e dixhitalizimit të shpenzimeve në parkun industrial në Drenas

Në ditët e sotme integrimi dhe dixhitalizimi i shërbimeve në përgjithësi është bërë tendencë, sidomos në vendet me ekonomi të zhvilluar. Zhvillimi i këtyre standardeve është me rëndësi kyçe për përmirësimin e efikasitetit të bizneseve, sidomos për zona dhe parqe të cilat janë objekt i studimit tonë.

Për shkak të një mjedisi të pafavorshëm për zhvillim të biznesit dhe mungesës së një kulture kreative sipërmarrëse, menaxherëve në Kosovë përgjithësisht, por edhe atyre në parqe industriale ju mungon aftësia për krijimin e shërbimeve inovative, të cilat janë tregues të rëndësishëm në suksesin e biznesit por edhe në krijimin e vendeve të reja të punës në ekonominë e zhvilluara perëndimore. Kreativiteti dhe inovacioni janë gjithnjë e më të nevojshme për bizneset për të fituar, ruajtur, krijuar dhe kultivuar avantazhe konkurruese. Përgjithësisht, ka mungesë të ideve për të vendosur se çfarë biznesesh duhen nisur, si duhen përshtatur me tendencat aktuale në biznesin rajonal apo edhe atë global.

Një faktor kyç për një fillim të mbarë lidhur me zbatimin e suksesshëm të sistemit të planifikimit të integruar të shpenzimeve në parkun industrial të Drenasit ishte themelimi i një ekipi të përbashkët menaxhimi i cili do të merrej me proceset e planifikimit. Për ta drejtuar këtë proces, u krijua Grupi për Menaxhim Strategjik, nga përfaqësues të zgjedhur nga vet bizneset i cili ishte përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të aplikacionit për shpenzime të integruara në parkun industrial.

Aktualisht, bizneset në parkun industrial në Drenas i paguajnë shpenzimet veç e veç ose të fragmentuara. Të gjitha bizneset në park, ose më saktë 41 prej tyre, shumë lloje të shpenzimeve të cilat mund të integrohen lehtë i paguajnë të ndara ose individualisht. Që nga ideja për zhvillimin e aplikacionit dhe intervistat e para të strukturuar, ka dominuar dëshira dhe përkushtimi që disa nga shpenzimet indirekte të integrohen për të përmirësuar performancën e bizneseve në zonë. Mënyra e pagesës së shpenzimeve kishte disa arsye shtesë për dixhitalizimin e tyre, gjithnjë duke pasur parasysh avantazhet e teknologjisë së informacionit. Kjo besueshmëri është parë edhe në përgjigjet e përpunuara nga hulumtimi me përfaqësuesit e bizneseve në zonë me koeficient prej 4.2, nga besueshmëria minimale 1 deri te besueshmëria maksimale 5.




Figura 33. Pranueshmëria për integrimin e shpenzimeve

Baza e të dhënave e ndërtuar dhe e zhvilluar do të shërbejë për të ndihmuar në administrimin sa më të efektshëm të informacionit për këto shpenzime. Ky aplikacion i zhvilluar për bizneset në zonën industriale në Drenas kryen shumë funksione, ndër të cilat mund t'i veçojmë:

- a. Përqendrimin e të gjitha të dhënave kryesore dhe operationale në një bazë qendrore të dhënash;

- b. Lehtësimin e decentralizimit të disa (jo të gjitha) shpenzimeve të bizneseve;
- c. Automatizimin e të dhënave dhe të shpenzimeve, duke reduktuar ndjeshëm shpenzimet por edhe kohën e kryerjes së operacioneve; dhe
- d. Zbatimin e procedurave lehtësuese, për monitorimin e këtyre shpenzimeve.

Në qendër të këtij sistemi janë:

- Biznesi;
- Ulja e shpenzimeve përmes integritit të shpenzimeve;
- Administrata/Sekretaria; dhe
- Financa.

Qëllimet kryesore mbi të cilat është zhvilluar aplikacioni për integrimin e shpenzimeve janë:

1. Ulja e shpenzimeve; dhe
2. Profesionalizimi i shërbimeve.

Zhvillimi i aplikacionit është bazuar në katër karakteristika kryesore:

- Karakteristika e parë është procesimi i informacioneve themelore të bizneseve;
- Karakteristika e dytë përbën specifikat e informacioneve themelore për pesë llojet e shpenzimeve të cilat do të integrohen;
- Karakteristika e tretë është transferimi i informacioneve tek kodi i secilit biznes sipas kërkesës së tyre; transferimi i informacionit tek menaxheret përkatës për çdo të dhënë që kërkojnë lidhur me shpenzimet dhe pagesat;

- Karakteristika e katërt është pasqyrimi i statistikave të ndryshme sipas kërkesës së bizneseve. Administratorët mund të shtojnë dhe të modifikojnë të dhënat ose informacionet lidhur me bizneset, shpenzimet, financat, sekretarinë si dhe specifikat e tyre.

Në fillim është arritur pajtueshmëria për integrimin e tri llojeve të shpenzimeve:

1. Shpenzimet e kontabilitetit;
2. Shpenzimet e IT-së; dhe
3. Shpenzimet e marketingut.

Duhet pranuar se vendet në tranzicion dhe me ekonomi jo të zhvilluar kanë mungesë përvoja por edhe hezitime në aplikimet e punës ekipore, prandaj gjatë hulumtimit nuk ishte e lehtë që të unifikoreshin mendimet dhe vlerësimet për ndikueshmërinë e aplikacionit. Gjatë zhvillimit të aplikacionit kishte diversitete në qëndrime, për faktin se bizneset në parkun industrial nuk kishin veprimtaritë e njëjta. Gjithashtu kishte objekte me madhësi të njëjtë që vështirësonin vendimmarrjen e menaxherëve për identifikimin e llojeve të shpenzimeve, të cilat mund të integrohen por edhe në mënyrën e caktimit të çmimit eventual në të ardhmen gjatë zhvillimit të aplikacionit. Që në fillim ka dominuar mendimi se më lehtë integrohen shpenzimet e marketingut, sepse tek shumica prej tyre mbizotëronte vullneti dhe dëshira se ky park, më i madhi në Kosovë, ka nevojë për më shumë marketing dhe për një qasje më profesionale. Ndërsa më vështirë të integruara, sipas të anketuarve ishin shpenzimet e sigurimit për shkak të kompleksitetit që kanë dhe shpenzimet e kontabilitetit. Në figurën 34 janë prezantuar opinionet e të anketuarve lidhur me hierarkinë e integritit të shpenzimeve.




Figura 34. Shpenzimet të cilat më së lehti do të integroheshin

Pas testimit të aplikacionit i cili që në demonstrimin e tij të parë dëshmoi një kualitet të ri të shërbimeve, menaxherët e ndërmarrjeve parashtruan kërkesën për të zgjeruar listën e shpenzimeve të integruara me:

1. Shpenzimet e mirëmbajtjes; dhe
2. Shpenzimet e sigurimit.

5.3 Përshkrimi i përgjithshëm i aplikacionit

Softueri për menaxhimin e integruar të shpenzimeve do të përfshijë informacione bazë për të gjitha bizneset në parkun industrial të Drenasit. Ky aplikacion do të jetë një lloj baze, mbështetur në modulet e tjera të programit, të cilat do të përcaktojnë operimin e drejtpërdrejtë nga modulet e tjera.

Struktura e aplikacionit përbëhet nga dy nën-komponente:

- Informacione të përgjithshme rreth bizneseve; dhe

- E-dosjet e bizneseve.

Çdo nën-komponent, do të paraqitet në formën e disa faqeve (fushave tematike të integruara). Më poshtë janë dhënë përshkrimet, funksionet dhe funksionalitetet e çdo moduli.

Aplikacioni është ndërtuar me qëllim të krijimit të një sistemi bashkëkohor në parkun industrial në Drenas për të realizuar një administrim të informacionit në mënyrë moderne, duke zvogëluar shpenzimet për biznese dhe njëkohësisht duke ngritur profesionalizmin e shërbimeve. Në këtë aplikacion përfshihen të gjitha të dhënat e bizneseve.

Ky sistem paraqet një strukturë virtuale të një parku apo zone. Këtu hidhen të gjitha të dhënat e bizneseve bashkë me të dhënat për shpenzimet e integruara për të cilat paraprakisht janë dakorduar menaxherët e bizneseve. Aplikacioni është i shpejtë dhe efikas. Po ashtu fleksibiliteti është një komponent shumë i rëndësishëm i tij.

Figura 35. Çasja në aplikacionin për integrimin e shpenzimeve

Aplikacioni për integrimin e shpenzimeve në parkun industrial është punuar në mënyrë ekipore. Për finalizimin e tij që nga dizajnimi e deri në testimin e tij, kanë dhënë kontributin e tyre ekspert të disa profileve, e cila është praktikë e punës në sisteme të tilla. Kontributi im

është dhënë që nga ideja, pastaj faza e analizës, kontrollit të vazhdueshëm, e deri te faza e testimit. I gjithë fokusi im në këtë punë ekipore ka qenë në menaxhimin e shpenzimeve.

5.4. Modulet e aplikacionit

Ky aplikacion përfshinë në vete disa module - ndërlidhje si: bizneset, shpenzimet, administrimi, llojet e shpenzimeve me nënndarjet e tyre etj. Siç vërehet nga pamja e figurës 36 por edhe nga qëllimi i zhvillimit të aplikacionit, moduli kryesor është moduli i shpenzimeve.




Figura 36. Modulet e aplikacionit

Vlerësimi i drejtë i uljes së shpenzimeve përmes integritit të tyre dhe avancimi në të ardhmen me shpenzime të tjera të përbashkëta të integruara, do të jetë një proces i cili do të zgjasë me vite. Sistemi elektronik i instaluar nëpërmjet moduleve u mundëson bizneseve gjenerim të shpejtë të të dhënave dhe informacioneve të cilat u lehtësojnë ndjeshëm vendimmarrësve dhe komunitetit të biznesit në zonë matjen e progresit, në raport me vizionin dhe objektivat e tyre në përllogaritjen e shpenzimeve.

Gjithsesi bizneset duhet të zhvillojnë një seri treguesish, nëpërmjet të cilëve do të mund të masin ecurinë e integritit të shpenzimeve të tjera në vitet vijuese. Këta tregues duhet të jenë sasiorë dhe cilësorë.

Nëpërmjet këtyre treguesve sasiorë, bizneset do të mund të masin kryesisht kursimin e mjeteve financiare dhe standardet e shërbimeve. Kjo matje softuerike e shpenzimeve do t'i shërbejë bizneseve të vlerësojnë efikasitetin dhe eficiencën e përdorimit të aplikacionit.

Sistemi i planifikimit të integruar të shpenzimeve identifikon të gjitha aktivitetet e ciklit të menaxhimit të shpenzimeve të përbashkëta në parkun industrial dhe i përmbledh këto në një kalendar vjetor, i cili specifikon datat e fillimit dhe përfundimit për secilin lloj të shpenzimeve.

5.5 Procesi i regjistrimit të bizneseve në aplikacionin për uljen e shpenzimeve

Baza e të dhënave e testuar në zonën ekonomike në Drenas ndihmon në automatizimin e disa proceseve, duke rritur efektivitetin e bizneseve por gjithmonë duke pasur parasysh edhe sigurinë si komponent shumë e rëndësishme. Procesi i regjistrimit të bizneseve të reja në zonë, përfshihet në aplikacion dhe kryhet nga sekretaria e zonës - zyrë e specializuar.

Aplikacioni siguron lidhjen logjike mes dy moduleve të tij: sekretarisë dhe zyrës së financave.

Figura 37. Regjistrimi i bizneseve

Lidhja mes dy moduleve kryhet online në kohë reale, duke ulur ndjeshëm kohën dhe duke rritur performancën e shërbimeve. Çdo pronar biznesi duhet të dëshmojë përmes certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga institucioni përkatës se është i regjistruar dhe është përfitues i parcelës në zonë për të zhvilluar aktivitetin biznesor. Me prezantimin e tij në zyrë të sekretarisë dhe financave, ai nënshkruan kontratën për mënyrën e pagesës së shërbimeve të

integruara. Pas përfundimit të procedurave paraprake, zyra kryen regjistrimin e biznesit me gjeneralitete në modulën e saj. Aplikacioni në mënyrë automatike bën lidhjen e moduleve dhe kështu biznesi shfaqet në modulën e sekretarisë për të realizuar veprimet e mëtejshme. Të gjitha këto procese kryen në kohë reale nëpërmjet sistemit, si dhe ruhen të dhënat mbi veprimet në log-et e sistemit për të evituar gabimet e mundshme.

Aplikacioni ruan të gjitha të dhënat për çdo biznes të ri të regjistruar apo për bizneset që më parë janë regjistruar në bazën e të dhënave. Regjistrimi i çdo biznesi bëhet sipas gjeneraliteteve të tij dhe certifikatës mbi regjistrim. Të dhënat për çdo biznes ruhen në bazën e të dhënave e cila përditësohet dhe mirëmbahet nga administratori i sistemit.

Aplikacioni trajton biznesin në dy aspekte, si:

- Përdorues i aplikacionit; dhe
- Si klient i tij.

Në fazën e regjistrimit në aplikacion biznesi është i detyruar të kryejë të gjitha procedurat përkatëse sa i përket tarifave të pagesave për të gjitha shpenzimet e integruara. Sistemi në këtë rast e trajton biznesin si klient duke ruajtur në bazën e tij të të dhënave të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me financat e biznesit, për shpenzimet e integruara (jo edhe për shpenzimet e tjera), tarifën, afatet kohore të pagesës, etj. Mosplotësimi i kushteve dhe i pagesave nga ana e biznesit, bën që sistemi automatikisht ta bllokojë atë, duke ia ndaluar të drejtat e përdoruesit. Shtresa bazë e sistemit ose shtresa e bazës së të dhënave ku ruhen informacionet financiare, komunikon me shtresat logjike më të larta të sistemit duke mundësuar pozita të ndryshme në lidhje me biznesin:

- Si klient me detyrime për të shlyer pagesat për shërbime të integruara; dhe

- Si përdorues i sistemit me të drejta të plota të mirëpërcaktuara për të shfrytëzuar burimet e sistemit.

MSHPPI Menaxhimi i Shpenzimeve Të Përbashkëta Në Parkun Industrial - NSHPPI		Lista e bizneseve																																																																																																													
 agim.derguti Administratori		Lloji i biznesit Kërko Të gjitha																																																																																																													
Profili largohu		Kërko Regjistro Printo																																																																																																													
Bizneset - Regjistro - Lista - Llojet e bizneseve		<table> <tr> <th>Edito</th><th>Nr.</th><th>Lloji i biznesit</th><th>Biznesi</th><th>NrFiskal</th><th>Adresa</th><th>Telefoni</th><th>Personi kontaktues</th></tr> <tr> <td>Edito</td><td>1</td><td>Prodhim dhe montim të ashensorëve</td><td>"Liftkos" sh.p.k</td><td>600085444</td><td>Parku i Biznesit</td><td>+377 44 115 870</td><td>Idriz Hysenaj</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>2</td><td>Prodhim, shërbim, shitje me pakicë dhe shumicë dhe eksport</td><td>N.T.P. " GP Metal " Sh.p.k.</td><td>600010566</td><td>Zona Industriale Perendimore</td><td>+377 44 147 257</td><td>Remzi Podvorica</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>3</td><td>Prodhim dhe distribuim i produkteve nga mielli</td><td>" MP AZZURRO " SH.P.K.</td><td>600130489</td><td>Parku Industrial</td><td>+386 49 788 733</td><td>Fadil Ukiqi</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>4</td><td>Prodhim ekskluziv i xhamit antiplumb dhe antivandal</td><td>N.P.M. " Metaj "</td><td>600391403</td><td>Prishtinë , M.Teutë</td><td>+377 44 500 774</td><td>Sylejman Meta</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>5</td><td>Shitje të pajisjeve për bebe dhe kozmetikë për të rritur</td><td>" EXIN " Sh.p.k.</td><td>600356530</td><td>Prishtinë , Arbëria Nr.139</td><td>+377 44 138 595</td><td>Arben Ibrahimaj</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>6</td><td>Mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, tregëtim të mjeteve dhe shitje të makinave</td><td>N.P.SH."ALLMAKES GLOBAL SERVICES"</td><td>600045563</td><td>Dardania</td><td>+377 44 126 028</td><td>Ideal Shala</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>7</td><td>Prodhim i uniformave dhe rrobave të punës</td><td>" Unikat " Sh.p.k.</td><td>600150495</td><td>Pejë 99, Meto Bajraktari</td><td>+377 44 125 378</td><td>Xhavit Qollaku</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>8</td><td>Prodhim letre piloteri, letër për kasa fiskale, letër krep-silotej</td><td>N.T.P. " Aero Com "</td><td>600051396</td><td>Prishtinë Rexhep Mala ,2</td><td>+386 49 500 047</td><td>Xhelal Neziri</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>9</td><td>Prodhim i kubëzave dhe anësorëve - ndërtim të lartë dhe të ulët</td><td>" Wiena " SH.P.K.</td><td>600073853</td><td>Obiliq Obiliq Shkabaj</td><td>+377 44 110 905</td><td>Isni Rukiqi</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>10</td><td>Prodhim i konstruksioneve metalike dhe përpunimi metalik. Prodhimi i objekteve industriale, shkallëv</td><td>NTP "Abi Metal"</td><td></td><td></td><td>+377 44 465 670</td><td>Arbër Beqiri</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>11</td><td>Prodhim i shkallëve dhe detyrës të hyrjes, montimi i prodhimeve. Repromaterial për prodhimin e detyrës</td><td>N.T.P.,,Shehu"</td><td>600131916</td><td></td><td>+377 44 180 601</td><td>Kreshnik Shehu</td></tr> <tr> <td>Edito</td><td>12</td><td>Prodhimin, përpunimin dhe shërbime që kanë të bëjnë me mjetet e punës për zdrukthtar. Prodhimin e bri</td><td>DPZ "Argent"</td><td>600301395</td><td>Prishtinë Nr.25, Aktash II</td><td>+377 44 214 213</td><td>Nazmi Hasolli</td></tr> </table>						Edito	Nr.	Lloji i biznesit	Biznesi	NrFiskal	Adresa	Telefoni	Personi kontaktues	Edito	1	Prodhim dhe montim të ashensorëve	"Liftkos" sh.p.k	600085444	Parku i Biznesit	+377 44 115 870	Idriz Hysenaj	Edito	2	Prodhim, shërbim, shitje me pakicë dhe shumicë dhe eksport	N.T.P. " GP Metal " Sh.p.k.	600010566	Zona Industriale Perendimore	+377 44 147 257	Remzi Podvorica	Edito	3	Prodhim dhe distribuim i produkteve nga mielli	" MP AZZURRO " SH.P.K.	600130489	Parku Industrial	+386 49 788 733	Fadil Ukiqi	Edito	4	Prodhim ekskluziv i xhamit antiplumb dhe antivandal	N.P.M. " Metaj "	600391403	Prishtinë , M.Teutë	+377 44 500 774	Sylejman Meta	Edito	5	Shitje të pajisjeve për bebe dhe kozmetikë për të rritur	" EXIN " Sh.p.k.	600356530	Prishtinë , Arbëria Nr.139	+377 44 138 595	Arben Ibrahimaj	Edito	6	Mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, tregëtim të mjeteve dhe shitje të makinave	N.P.SH."ALLMAKES GLOBAL SERVICES"	600045563	Dardania	+377 44 126 028	Ideal Shala	Edito	7	Prodhim i uniformave dhe rrobave të punës	" Unikat " Sh.p.k.	600150495	Pejë 99, Meto Bajraktari	+377 44 125 378	Xhavit Qollaku	Edito	8	Prodhim letre piloteri, letër për kasa fiskale, letër krep-silotej	N.T.P. " Aero Com "	600051396	Prishtinë Rexhep Mala ,2	+386 49 500 047	Xhelal Neziri	Edito	9	Prodhim i kubëzave dhe anësorëve - ndërtim të lartë dhe të ulët	" Wiena " SH.P.K.	600073853	Obiliq Obiliq Shkabaj	+377 44 110 905	Isni Rukiqi	Edito	10	Prodhim i konstruksioneve metalike dhe përpunimi metalik. Prodhimi i objekteve industriale, shkallëv	NTP "Abi Metal"			+377 44 465 670	Arbër Beqiri	Edito	11	Prodhim i shkallëve dhe detyrës të hyrjes, montimi i prodhimeve. Repromaterial për prodhimin e detyrës	N.T.P.,,Shehu"	600131916		+377 44 180 601	Kreshnik Shehu	Edito	12	Prodhimin, përpunimin dhe shërbime që kanë të bëjnë me mjetet e punës për zdrukthtar. Prodhimin e bri	DPZ "Argent"	600301395	Prishtinë Nr.25, Aktash II	+377 44 214 213	Nazmi Hasolli
Edito	Nr.	Lloji i biznesit	Biznesi	NrFiskal	Adresa	Telefoni	Personi kontaktues																																																																																																								
Edito	1	Prodhim dhe montim të ashensorëve	"Liftkos" sh.p.k	600085444	Parku i Biznesit	+377 44 115 870	Idriz Hysenaj																																																																																																								
Edito	2	Prodhim, shërbim, shitje me pakicë dhe shumicë dhe eksport	N.T.P. " GP Metal " Sh.p.k.	600010566	Zona Industriale Perendimore	+377 44 147 257	Remzi Podvorica																																																																																																								
Edito	3	Prodhim dhe distribuim i produkteve nga mielli	" MP AZZURRO " SH.P.K.	600130489	Parku Industrial	+386 49 788 733	Fadil Ukiqi																																																																																																								
Edito	4	Prodhim ekskluziv i xhamit antiplumb dhe antivandal	N.P.M. " Metaj "	600391403	Prishtinë , M.Teutë	+377 44 500 774	Sylejman Meta																																																																																																								
Edito	5	Shitje të pajisjeve për bebe dhe kozmetikë për të rritur	" EXIN " Sh.p.k.	600356530	Prishtinë , Arbëria Nr.139	+377 44 138 595	Arben Ibrahimaj																																																																																																								
Edito	6	Mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, tregëtim të mjeteve dhe shitje të makinave	N.P.SH."ALLMAKES GLOBAL SERVICES"	600045563	Dardania	+377 44 126 028	Ideal Shala																																																																																																								
Edito	7	Prodhim i uniformave dhe rrobave të punës	" Unikat " Sh.p.k.	600150495	Pejë 99, Meto Bajraktari	+377 44 125 378	Xhavit Qollaku																																																																																																								
Edito	8	Prodhim letre piloteri, letër për kasa fiskale, letër krep-silotej	N.T.P. " Aero Com "	600051396	Prishtinë Rexhep Mala ,2	+386 49 500 047	Xhelal Neziri																																																																																																								
Edito	9	Prodhim i kubëzave dhe anësorëve - ndërtim të lartë dhe të ulët	" Wiena " SH.P.K.	600073853	Obiliq Obiliq Shkabaj	+377 44 110 905	Isni Rukiqi																																																																																																								
Edito	10	Prodhim i konstruksioneve metalike dhe përpunimi metalik. Prodhimi i objekteve industriale, shkallëv	NTP "Abi Metal"			+377 44 465 670	Arbër Beqiri																																																																																																								
Edito	11	Prodhim i shkallëve dhe detyrës të hyrjes, montimi i prodhimeve. Repromaterial për prodhimin e detyrës	N.T.P.,,Shehu"	600131916		+377 44 180 601	Kreshnik Shehu																																																																																																								
Edito	12	Prodhimin, përpunimin dhe shërbime që kanë të bëjnë me mjetet e punës për zdrukthtar. Prodhimin e bri	DPZ "Argent"	600301395	Prishtinë Nr.25, Aktash II	+377 44 214 213	Nazmi Hasolli																																																																																																								
Shpenzimet - Regjistro - Lista - Llojet e shpenzimeve - Llojet e shpenzimeve / ndarjet për biznese																																																																																																															
Administrimi - Përdoruesi - Personeli - Pozitat e punës - Grupet - Format - Autorizimet - Komunat																																																																																																															
Lidhjet tjera																																																																																																															

Figura 38. Lista e bizneseve të regjistruara

Pas regjistrimit në aplikacion – sistem, bizneset mund të kryejnë disa veprime, si:

- Ndryshimi i fjalëkalimit;
- Monitorimi në çdo kohë i obligimeve dhe pagesave;
- Leximi i të gjitha informacioneve të dërguara në adresë të tyre nga sekretaria – zyra e financave;
- Konsultimi lidhur me afatet e pagesës;
- Konsultimi i datave të pagesave të realizuara;
- Konsultimi i listave të pagesave për të gjitha shërbimet e integruara veç e veç; dhe
- Konsultimi i planit për realizimin e pagesave.

5.6 Përdoruesit e Aplikacionit

Sikurse në të gjitha aplikacionet e tjera edhe në këtë aplikacion ka një hierarki për përdoruesit e tij, por që ajo ndryshohet lehtësisht. Me një marrëveshje të detajuar do të qartësoheshin saktësisht obligimet dhe përdoruesit e aplikacionit. Mënyra e pagesës së shpenzimeve të integruara është specifike por edhe periodike që e bën më komplekse gjithë këtë strukturë. Raporteve për të gjitha pagesat mund t'i qaset sekretaria, financat por edhe menaxherët e të gjitha ndërmarrjeve ose të autorizuarit e menaxherëve. Menaxherët e ndërmarrjeve kanë qasje vetëm në bizneset e tyre, të cilët në raste të caktuara mund të autorizojnë një zyrtar tjetër e kështu me radhë. Përdoruesit kryesor të aplikacionit janë menaxherët e lartë, drejtorët, shefat e sektorëve, etj. për ndërmarrjet e tyre, ndërsa për gjithë zonën përdorues kryesor është sekretaria bashkë me financat për të cilët rritet niveli i shërbimit, llogaridhënies dhe i transparencës. Menaxherët mund të qasen në llogarinë e tyre për të parë përmbushjen e obligimeve për të gjitha shpenzimet e integruara që nënkupton ato të llogaritura, të përmbushura, të papërmbushura etj.

Në momentin që një zyrtar autorizohet nga menaxheri për qasje në aplikacion, administratori i aplikacionit krijon ID-në dhe fjalëkalimin. Nga ky moment ata bëhen përdorues të aplikacionit nga kompjuterët e tyre që në shumicën e rasteve janë në ambientet e bizneseve. Pas identifikimit ata kanë qasje të plotë dhe mund t'i realizojnë disa veprime:

- Ndryshimi i fjalëkalimit;
- Shikimin e planeve dhe obligimeve të tyre të përmbushura dhe të papërmbushura ;
- Raportet e pagesave (muajore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore etj.);

- Leximi i të gjithë informacioneve të dërguara në adresë të tyre nga sekretaria dhe zyra e financave;
- Orarin – kohën e pagesave; dhe
- Informacione të tjera të rëndësishme.

Menaxheret ose të autorizuarit e tyre kanë gjithashtu mundësi që të parashtrojnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime lidhur me obligimet, ndryshimet, përditësimet etj.

5.7 Funksionet e sekretarisë dhe financave

Përdorues kryesor i aplikacionit do të jetë kjo zyrë. Gjatë aktiviteteve në sistem të gjitha veprimet kontrollohen në mënyrë automatike. Ndryshimet apo përditësimet e bëra ruhen automatikisht dhe në këtë mënyrë mundësohet në çdo moment nxjerrja e statistikave. Në këtë zyrë, veç të tjerëve do të funksionoj edhe administratori i IT-së, i cili do të jetë edhe administratori kryesor. Administratori financiar dhe sekretaria kanë të drejtë hyrjeje në aplikacion me të drejta të specifikuara dhe të detajuara.

Obligimet e tyre janë që të monitorojnë mbarëvajtjen e të gjitha proceseve – aktiviteteve që kanë të bëjnë me shpenzimet e integruara. Përveç të drejtave të limituara, këta kanë kufizime edhe në biznese apo sektorë të ndryshëm të bizneseve.

Aktivitetet kryesore të tyre janë:

- Regjistrimi i të dhënave gjenerale për të gjitha bizneset;
- Dhënien e fjalëkalimit për çdo drejtor dhe të autorizuar të drejtorëve - menaxherëve;
- Ndarjen e shumave të pagesës për të gjitha bizneset;

- Monitorimin e të gjitha fazave të pagesave;
- Gjenerimin e regjistrave elektronik;
- Rishikimin dhe printimin e raporteve të pagesave;
- Printimin e të gjitha vlerësimeve të protokolluara në mënyrën elektronike;
- Në rast të mosnjohjes së mirë të funksionimit të aplikacionit nga menaxherët apo të autorizuarve të tyre, ata janë të detyruar t'i ndihmojnë në të gjitha rastet kur ata kërkojnë;
- Përgatitjen e moduleve për pagesa (i cili mund të ndryshojë krahasuar me atë të fundit);
- Monitorimin e ndryshimeve eventuale të pagesave, qofshin ato ngritje apo zbritje;
- Kontaktet e vazhdueshme me të gjitha bizneset;
- Hapjen dhe mbylljen në periudha të caktuara të aplikacionit;
- Përmirësimin e gabimeve eventuale që mund të ndodhin nga të gjithë akterët në lidhje me sistemin;
- Fshirjen, kufizimin, zhbllokimin e përdoruesëve të aplikacionit për arsye të ndryshme;
- Dukshmërinë e informacioneve, sidomos atyre me rëndësi të veçantë etj.

Aplikacioni, përveç se në zyrën e sekretarisë dhe financave duhet të jetë në shërbim edhe në zyret e bizneseve i cili do të shërbej për:

- Informimin e secilit biznes në kohë reale për pagesat e realizuara dhe të parealizuara;
- Regjistrimin e bizneseve të reja;
- Regjistrimin e shërbimeve të shtuara;

- Oraret e pagesave; dhe
- Preferenca të ndryshme.



MSHPPI
Menaxhimi i Shpenzimeve Të Përbashkëta
Në Parkun Industrial - NSHPPI



agim.derguti
Administrator
[Profili](#) [largohu](#)

Bizneset

- Regjistro
- Lista
- Llojet e bizneseve

Shpenzimet

- Regjistro
- Lista
- Llojet e shpenzimeve
- Llojet e shpenzimeve / ndarjet për biznese

Administrimi

- Perdoruesi
- Personeli
- Pozitat e punës
- Grupet
- Format
- Autorizimet
- Komunat

Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve

Edito	Nr.	Lloji i shpenzimit	Ndarje e barabartë	Me marrëveshje	Shuma (€)	Aktiv
Edito	1	Shpenzimet e kontabilitetit	JO	PO	220.00	PO
Edito	2	Shpenzimet e ujit	JO	JO	50.00	PO
Edito	3	Shpenzimet e mbeturinave	PO	JO	30.00	PO
Edito	4	Shpenzimet e mirembajtjes	PO	JO	360.00	PO
Edito	5	Shpenzimet e IT-së	JO	JO	420.00	PO
Edito	6	Shpenzimet e sigurimit	JO	JO	150.00	PO

1

Figura 39. Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve

Numri i të autorizuarëve për qasje nga menaxherët për biznese nuk mund të jenë më shumë se dy. Kjo varet nga madhësia e biznesit, përkatësisht numri i punëtorëve dhe vëllimi i qarkullimit. Ata hyjnë në sistem me një emër identifikues dhe me një fjalëkalim personal. Të gjitha të dhënat që ata hedhin në sistem me automatizëm pasqyrohen te administratori. Aplikacioni për ta është i hapur 24 në 24 orë. Pas hedhjes së të dhënave nga zyrtarët e autorizuar, arkivimi i tyre bëhet në mënyrë automatike. Pra, siç vërehet nga hierarkia e

proceseve, zyrtarët e caktuar nuk mund të bëjnë ndryshime nga marrëveshja në kushtet dhe shumën e pagesës për një shërbim të caktuar.

5.8 Përfitimet nga aplikacioni për integrimin e shpenzimeve të përbashkëta

Në këtë studim janë analizuar përfitimet dhe efikasiteti që sjell menaxhimi i integruar i shpenzimeve në parkun industrial në Drenas.

Përfitimet janë të shumta si:

1. Shërbime më të profesionalizuara në të gjitha llojet e shpenzimeve të integruara;
2. Alokim i përmirësuar i shpenzimeve;
3. Ngritja e besimit të partnerët, sidomos ata të jashtëm;
4. Mundësia që ofron aplikacioni për integrimin në të ardhmen edhe të shpenzimeve të tjera të përbashkëta.

Përfitimet nga aplikacioni në mënyrë më të detajuara janë prezantuar më sipër por si më kryesoret janë identifikuar dy:

- ulja e shpenzimeve dhe
- ofrimi i shërbimeve më profesionale nga kompanitë e specializuara për shërbime të tilla, të cilat janë deficitare në tregun kosovar.

Më shumë se gjysma e të anketuarve (52 % e tyre) në hulumtimin tonë kanë deklaruar se përfitimet do të jenë në të dyja komponentët. Nga grafiku i paraqitur më poshtë rezultatet tregojnë se ulja e shpenzimeve dhe shërbimet më profesionale janë të rëndësishme së njëjtë (25%, përkatësisht 23%).




Figura 40. Përfitimet kryesore nga aplikacioni për integrimin e shpenzimeve.

Të gjitha tiparet dhe funksionet në të gjitha modulet e programit janë të mirëadministruara:

- Modulet në program janë të ndërlidhura duke siguruar shkëmbimin e lirë të informacionit për të gjithë përdoruesit;
- Aplikacioni është në përputhje me legjislacionin;
- Modulet ndryshohen lehtë teknikisht – është mundësuar modifikimi i moduleve ekzistuese dhe shtimi i moduleve të reja. Në të njëjtën kohë, ndryshimet mund të bëhen me pëlqimin e menaxherëve ose të autorizuarve të tyre;
- Programi mbrohet nga akseset e paautorizuara. Informacioni do të jetë në dispozicion të personave të autorizuar. Përveç kësaj, është siguruar vendosja e kufizimeve specifike për secilin prej tyre;
- Për qëllime të sigurisë, çdo informacion i përditësuar do të kontrollohet para regjistrimit përfundimtar;

- Programi automatikisht do të përgjigjet për mospërputhjet e identifikuara, kohën, të dhënat e IP-së dhe autori i ndryshimeve do të regjistrohet automatikisht;
- Modulet dhe tërë programi do të sigurojnë qasje në të dhënat fillestare të bizneseve me autorizimin përkatës;
- Sistemi do të sigurojë përdorim të të dhënave nëpërmjet TIK-ut;
- Të gjitha modulet janë të strukturuar në mënyrë që të dhënat e hyrjes manuale të minimizohen. Kjo është arritur përmes prezantimit të një forme të filtrimit të unifikuar me të gjitha fushat dhe lidhjen e programit me bazat e të dhënave ekzistuese. Aplikacioni nuk lejon ndryshime ose shtesa në modulet e programit pa pëlqimin\miratimin nga administratori;
- Secili modul përfshinë funksione të gjenerimit të raporteve standarde analitike në lidhje me informacionin e ruajtur;
- Secili modul do të sigurojë tiparet e ngarkimit dhe trajtimin e dosjeve të ndryshme;
- Softueri gjithashtu do të ofrojë shtypjen e dokumenteve të përgatitura në kuadër të programit;
- Dokumentet e shtypura do të kenë fuqinë ligjore;
- Të gjitha modulet do të strukturohen automatikisht për të siguruar funksionimin e lehtë për përdoruesit e papërvojë ose pa njohuri bazike në TI;
- Sistemi do të siguroj arkivim të informacionit, do të mundësoj shikimin dhe shtypjen e informacionit të arkivuar dhe në të njëjtën kohë, të gjitha dosjet do të gjenerohen në formatin PDF.

Aplikacioni për integrimin e shpenzimeve do të shërbej edhe për:

- Informimin e përdoruesve (nëpunësve, shefave të sektorëve, drejtorëve etj.) në kohë reale;
- Regjistrimin e bizneseve të reja (përfitues të parcelave në të ardhmen);
- Obligimet e (pa) përmbushura;
- Oraret dhe shumat për pagesë etj.

Gjithashtu ky aplikacion mundëson gjenerimin e statistikave, duke ruajtur të dhëna mbi pagesat e realizuara në vitet (periudhat) e kaluara. Disa nga analizat e gjeneruara janë:

- Analiza statistikore;
- Analiza cilësore;
- Analiza krahasuese për të dhëna të ndryshme.

Ky aplikacion gjithashtu mundëson edhe:

- Ndryshimin e lehtë dhe të shpejtë të llojeve të shpenzimeve të integruara dhe shtimin e tyre;
- Përshkrimin, ndryshimin – evoluimin e tyre;
- Ngarkimin, monitorimin dhe raportimin e përmbushjes së obligimeve financiare;
- Parapagimin e obligimeve të kontraktuara;
- Shfaqjen e statistikave - raporteve përmbledhëse;
- Përpunimin e raporteve dhe verifikimin e regjistrimeve të reja në punë provuese;
- Krahasimin e raporteve për vlerësim në nivele;
- Ruajtjen e të gjithë treguesve të rëndësishëm;
- Gjenerimin e listave për shpenzime me nënndarje - degëzime sipas llojeve, shumave etj;

- Menaxhimin e ndërrimeve nga drejtoria e biznesit dhe ruajtjen e dosjeve të zyrtarëve të pranuar, larguar apo transferuar me të drejta në përdorim;
- Ndërfaqen për t'u integruar në sistem dhe për të përdorur sa më me efikasitet zgjidhjet e shumta opcionale që i ofron aplikacioni etj.

5.9 Administrimi i aplikacionit për integrimin e shpenzimeve

Aplikacioni i realizuar për përdorim në parkun industrial në Drenas, përmban edhe këtë modul, i cili aksesohet nga përdoruesit me të drejta të mirëpërcaktuara. Personi i cili është përgjegjës për ngritjen dhe mirëmbajtjen e sistemit quhet administratori i sistemit. Detyrat e një administratori të sistemit janë të gjëra dhe ndryshojnë shumë nga një organizatë në tjetrën. Roli i administratorit është të monitoroj dhe analizoj rrjetin, akordimin e performancës, eliminimin e problemeve dhe shkallëzimin e nevojave për të ruajtur performancën e rrjetit për të përmbushur kërkesat e përdoruesëve. Administratori i sistemit u jep të drejta përdoruesve të financës në biznese për të aksesuar të dhënat dhe për të kryer veprimet në sistem. Sikurse përdoruesit e tjerë, çdo veprimtari e përdoruesve të financës monitorohet dhe ruhet automatikisht në log-et e sistemit, duke evituar probleme dhe gabime të mundshme. Ky modul përmban vetëm pagesat për shpenzimet e integruara duke iu mundësuar bizneseve një informacion online mbi pagesën që u takon dhe të cilën duhet ta realizojnë konform marrëveshjes dhe obligimeve kontraktuale. Ky modul gjithashtu bën transparente pagesën që ka kryer secili biznes për tarifën e paracaktuar për periudhën e caktuar kohore, që në të shumtën e rasteve është një muaj si dhe afatin kohor në të cilën duhet bërë pagesa.

MSHPPI
Menaxhimi i Shpenzimeve Të Përbashkëta
Në Parkun Industrial - NSHPPI

agim.derguti
Administrator
Profil | largohu

Bizneset

- Regjistro
- Lista
- Llojet e bizneseve

Shpenzimet

- Regjistro
- Lista
- Llojet e shpenzimeve
- Llojet e shpenzimeve / ndarjet për biznese

Administrimi

- Perdoruesi
- Personeli
- Pozitat e punës
- Grupet
- Format
- Autorizimet
- Komunat

Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve për biznese

Lloji i shpenzimit: Shpenzimet e kontabilitetit

Biznesi:

Kerko | Regjistro

Edito	Nr.	Lloji i shpenzimit	Shuma (€)
Edito	1	Shpenzimet e kontabilitetit	60.00
Edito	2	Shpenzimet e kontabilitetit	40.00
Edito	3	Shpenzimet e kontabilitetit	30.00
			1

Biznesi

Të gjitha

- N.P.M. " Metaj "
- N.P.SH. " Elting - electronics "
- N.P.SH."ALLMAKES GLOBAL SERVICES"
- N.P.T. " Emaliku "
- N.P.T. " GENTIPHARM "
- N.P.T. " SCAMPA "
- N.P.T. " Tonitex "
- N.T.P. " Aero Com "
- N.T.P. " Dijamant "
- N.T.P. " GP Metal " Sh.p.k.
- N.T.P. " Sigma "
- N.T.P. " TERMO "
- N.T.P.,,Helvetica Profarm"
- N.T.P.,,Shehu"
- NT "Besimi"
- NTP "Abi Metal"
- NTP,,Medruplast "
- R.I SPA-ARKOS
- Star sh.p.k

Të gjitha

Figura 41. Regjistrimi i llojeve të shpenzimeve për biznese

Nëse është realizuar pagesa nga cilido biznes për një shërbim të caktuar, atij i lejohe të hyjë në sistem për shikimin e të gjitha shpenzimeve të tjera. Moduli është i lidhur në mënyrë automatike me sistemin e menaxhimit të bizneseve në dy pika. Në momentin që kyçet një biznes në sistemin e menaxhimit të shpenzimeve, krijohet automatikisht një klient në sistemin financiar. Në momentin që hapet një detyrim për biznesin në sistem, krijohet automatikisht një faturë klienti në sistemin financiar. Pra, në këtë mënyrë sistemet krijojnë lidhjen logjike:

- Biznes në Sistemin e Menaxhimit të Integruar të Shpenzimeve - Klient në Sistemin Financiar; dhe
- Detyrim biznesi në sistemin e menaxhimit të integruar të shpenzimeve - Faturë Financiare për detyrimet e biznesit.

5.10 Siguria dhe arkivimi i të dhënave – komponente të rëndësishme të aplikacionit

Aplikacioni për Integrimin e Shpenzimeve në zonë me mundësi implementimi nga fillimi i vitit 2016 ka një sistem sigurie të hapur me dy nivele sigurie të aplikimit:

- Siguria e bazuar në role që paraqet nivelin e parë të sigurisë, në të cilën roli determinon funksionin e vendosur në dispozicion të mbajtësit të rolit. Përdoruesve të sistemit i caktohen një ose disa role në varësi të punës së tyre me sistemin apo administrimin e roleve që kanë dhe
- Kufizimi në qasjen e të dhënave paraqet nivelin e dytë të sigurisë. Sistemi mundëson administrimin e qasjes në të dhëna për përdorues të veçantë.

Lidhur me arkivimin e të dhënave hap pas hapi përshkruhet ecuria e të gjitha proceseve që finalizohen në dokumentacione me të dhëna përfundimtare, të cilat nëpërmjet sistemit arkivohen, duke krijuar kështu fondin e dokumentacioneve përfundimtare për çdo biznes dhe për çdo vit kalendarik.

5.11 Krahhasimet në shpenzimet jo të integruara dhe të integruara

Të gjitha bizneset e sistemuara në parkun industrial të Drenasit kanë analizuar dhe paraqitur shpenzimet e tyre para fillimit të zhvillimit të aplikacionit. Shumica prej tyre kanë reflektuar pakënaqësi në disa nga shërbimet e ofruara dhe kanë qenë në kërkim të ndërmarrjeve të specializuara për ofrimin e shërbimeve të marketingut, kontabilitetit, mirëmbajtjes etj. Përzgjedhja e ndërmarrjeve të tilla do të bëhej me një proces garues transparent dhe me të drejtë monitorimi nga të gjitha bizneset.

Tabela 10. Shpenzimet jo të integruara për të gjitha bizneset në zonë

Nr.	Emri biznesit	Llojet e shpenzimeve jo të integruara				
		Kontabili teti	IT	Marketi ngu	Mirëmbajtja	Sigurimi
1	“Liftkos” sh.p.k.	180	105	75	60	35
2	N.T.P. “ GP Metal “ sh.p.k.	100	95	85	65	30
3	“ MP Azzurro” sh.p.k.	95	110	125	70	25
4	N.P.M. “ Metaj “	135	120	95	75	30
5	“ EXIN “ sh.p.k.	110	115	90	85	35
6	N.P.SH.”Allmakes global services”	180	125	70	85	55
7	“ Unikat “ sh.p.k.	240	115	90	90	35
8	N.T.P. “ Aero Com “	270	190	130	85	45
9	“ Wiena “ sh.p.k.	320	140	120	80	50
10	NTP “Abi Metal”	380	165	120	85	25
11	N.T.P.,,Shehu”	360	180	90	100	30
12	DPZ “Argent”	350	175	125	60	25
13	“Plastika” sh.p.k	320	170	85	80	30
14	N.P.T. “ Tonitex “	340	160	100	85	40
15	N.N.T.,,Mirusha Transport”	100	110	115	65	30
16	NT “Besimi”	170	125	115	70	30
17	N.P.T. “ Gentipharm”	540	180	90	90	45
18	NTP,,Medruplast “	350	150	85	90	40
19	N.P.T. “ SCAMPA “	260	125	85	95	30
20	Dpz “Dani Plast”	400	110	90	75	40
21	“ Enggroup “ sh.p.k.	300	115	110	95	50
22	N.T.P. “ Termo “	320	125	90	85	50
23	R.I SPA-Arkos	360	120	125	95	50
24	“Antika Technologies” sh.p.k.	390	125	100	10	55
25	N.P.T. “ Emaliku “	400	120	110	110	45
26	“ MAXI 69 “ sh.p.k..	350	120	95	110	55
27	“Brymaco” Sh.p.k.	170	160	80	100	35
28	N.P.SH. “ Elting – electronics “	260	160	85	90	40
29	“ M Sora Prishtina” sh.p.k.	220	160	130	90	40
30	“ Semenarna “ sh.p.k.	330	195	140	80	35
31	“ Metropol Group “ Sh.p.k.	140	180	120	115	40
32	Hajdari WDVS – Trockenbau	200	180	65	115	45
33	“ Konica “ sh.p.k.	400	150	80	105	40

34	“Star” sh.p.k	210	155	115	130	65
35	“Behari” sh.p.k	220	110	110	80	40
36	N.T.P. “ Dijamant “	170	125	70	70	40
37	“ Adi Group “ L.L.C.	100	150	90	65	45
38	“ Kras Group “ sh.p.k.	100	110	125	70	40
39	N.T.P. “ Sigma “	270	120	115	80	35
40	N.T.P.,„Helvetica Profarm”	320	120	100	65	45
41	Europe Systems LLC	350	160	70	70	45
	Totali:	10,780.00	5,725.00	4,105.00	3,420.00	1640

Siç e kemi thënë edhe me lartë për të administruar këtë proces, është krijuar Grupi për Menaxhim Strategjik, nga përfaqësues të zgjedhur nga vet bizneset i cili ishte përgjegjës për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të aplikacionit për shpenzime të integruara në parkun industrial. Tarifat e shpenzimeve të caktuara me të cilat janë pajtuar bizneset në zonë janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Tabela 11. Shpenzimet e integruara për të gjitha bizneset në zonë

Nr.	Emri biznesit	Llojet e shpenzimeve të integruara				
		Kontabiliteti	IT	Marketingu	Mirëmbajtja	Sigurimi
1	“Liftkos” sh.p.k.	120	80	50	50	25
2	N.T.P. “ GP Metal “ sh.p.k.	65	75	60	52	20
3	“ MP Azzurro “ sh.p.k.	60	85	90	60	18
4	N.P.M. “ Metaj “	84	90	70	62	20
5	“ EXIN “ sh.p.k..	75	87	65	75	28
6	N.P.SH.”Allmakes global services”	120	95	50	75	45
7	“ Unikat “ sh.p.k.	160	87	65	80	27
8	N.T.P. “ Aero Com “	180	145	95	74	35
9	“ Wiena “ sh.p.k.	210	110	90	68	37
10	NTP “Abi Metal”	250	125	90	72	16
11	N.T.P.,„Shehu”	240	140	65	85	23
12	DPZ “Argent”	235	135	90	50	16
13	“Plastika” sh.p.k	210	130	60	68	21
14	N.P.T. “ Tonitex “	220	124	70	75	29

15	N.N.T.,Mirusha Transport”	60	85	85	55	24
16	NT “Besimi”	110	95	80	58	21
17	N.P.T. “ Gentipharm “	340	145	65	78	35
18	NTP,,Medruplast “	220	115	60	75	30
19	N.P.T. “ Scampa “	165	95	60	85	22
20	Dpz “Dani Plast”	260	85	65	65	30
21	“ Enggroup “ sh.p.k.	190	90	80	80	40
22	N.T.P. “ Termo “	210	95	65	75	38
23	R.I SPA-Arkos	240	93	90	84	40
24	“ Antika Technologies “ Sh.p.k.	250	90	75	85	46
25	N.P.T. “ Emaliku “	260	90	80	90	35
26	“ Maxi 69 “ sh.p.k.	225	92	70	90	45
27	“Brymaco” sh.p.k.	110	123	55	85	24
28	N.P.SH. “ Elting – electronics “	165	125	60	70	31
29	“ M Sora Prishtina “ sh.p.k.	145	125	95	75	32
30	“ Semenarna “ sh.p.k.	210	150	105	65	25
31	“ Metropol Group “ sh.p.k.	85	140	85	95	30
32	Hajdari WDVS – Trockenbau	125	142	45	95	35
33	“ Konica “ sh.p.k.	250	115	55	85	32
34	“Star “ sh.p.k	140	120	85	108	50
35	“Behari” sh.p.k	145	84	80	64	31
36	N.T.P. “ Dijamant “	110	95	50	60	32
37	“ Adi Ggroup “ L.L.C.	60	115	65	55	35
38	“ Kras Group “ sh.p.k.	65	85	90	60	28
39	N.T.P. “ Sigma “	185	90	85	62	24
40	N.T.P.,,Helvetica Profarm”	210	95	75	55	35
41	Europe Systems LLC	240	125	50	60	35
Totali:		7,004.00	4,407.00	2,967.00	2,960.00	1,245.00

Në tabelën 11 janë parqitur shpenzimet e integruara mujore për të gjitha bizneset. Vlerat e shpenzimeve ndryshojnë varësisht nga lloji i biznesit (qarkullimi vjetor, numri i punëtorëve etj.) dhe sipërfaqes së parcelës që disponon biznesi në zonë. Shpenzimet e kontabilitetit, për shembull, janë nga 60 € në muaj më të ulëtat e deri në 340 € më të lartat.

Tabela 12. Totali i shpenzimeve mujore të integruara dhe jo të integruara

Nr	Llojet e shpenzimeve	Shpenzimet e Integruara në €	Shpenzimet jo të integruara në €	Ndryshimi në përqindje	Ndryshimi në vlerë për një muaj
1.	Shpenzimet e Kontabilitetit	7,004.00	10,780.00	35.03	3,776.00
2.	Shpenzimet e IT-së	4,407.00	5,725.00	23.02	1,318.00
3.	Shpenzimet e marketingut	2,967.00	4,105.00	27.72	1,138.00
4.	Shpenzimet e mirëmbajtjes	2,960.00	3,420.00	15.43	460.00
5.	Shpenzimet e sigurimit	1,245.00	1,640.00	24.09	395.00
	Totali:	18,583.00	25,670.00	25.06	7,087.00




Figura 42. Grafiku i ndryshimit në mes të shpenzimeve të paintegruara dhe të integruara

Që në fillimet e dizajnit të aplikacionit ka pasur besueshmëri se shpenzimet për bizneset do të ulen, por gjithashtu ka pasur diversitet të mendimeve për nivelin e përqindjes së uljes së shpenzimeve. Shumica e të anketuarve, apo 24 prej tyre kanë besuar se ulja e shpenzimeve të integruara do të jetë nga 30-40 %, ndërsa 19 prej tyre kanë besuar se ulja e shpenzimeve të integruara do të jetë nga 10-30 %. Vetëm katër prej tyre kanë vlerësuar se kostoja e shpenzimeve të integruara do të ulet më pak se 10%. Siç vërehet nga tabela 12 ulje më të mëdha të shpenzimeve janë shënuar në shpenzimet e kontabilitetit dhe të marketingut, ndërsa më së paku në shpenzimet e mirëmbajtjes, me vetëm 15.43%.

Nga totali i shpenzimeve për këto pesë shërbime vërehet se ato për një muaj ulen në vlerë prej 7,087.00 €, ndërsa për një vit kalendarik ulen për 85,044.00 €.

Pas finalizimit dhe testimit të aplikacionit është vërtetuar se rezultatet kanë përputhshmëri edhe me hulumtimin e zhvilluar, pasi që 43 prej të anketuarve kanë pasur pritshmëri se shpenzimet do të ulen nga 10-40 %.




Figura 43. Përqindja e uljes së shpenzimeve

Aplikacioni për integrimin e shpenzimeve, implementon filtra të cilët në mënyrë automatike kryejnë veprime të ndryshme statistikore. Sistemi i statistikave dhe analizave përdoret me

gjithë funksionalitetet e tij për të nxjerrë në mënyrë automatike nga baza e të dhënave, statistika nga më të ndryshmet, si përshembull: totali i bizneseve në parkun industrial, numri i bizneseve të cilat i kanë përmbushur obligimet e tyre mujore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore, totalin e pagesave të realizuara apo pagesave të vonuara, etj. Gjithashtu, aplikacioni ka filtra me anë të të cilëve mund të nxirren statistika më të detajuara, si psh: përqindja e realizimit të pagesave për periudha të caktuara kohore, të bëjë prerjen e tyre në çdo kohë, mesatarja e pagesave të realizuara për çdo shërbim të integruar etj.

Qëllimi kryesor për ngritjen e aplikacionit ka qenë ulja e shpenzimeve për biznese në parkun industrial. Në mungesë përvoja dhe tradite, në fillimet e intervistave të strukturuar me përfaqësuesit e bizneseve (drejtor, menaxher, kontabilist, ekspert të IT-së etj.) disa prej tyre ishin mjaft të rezervuar në përgjigje.




Figura 44. Ndikimi i aplikacionit në uljen e shpenzimeve

Me zhvillimin e aplikacionit dhe me kalimin e kohës, duke i parë përfitimet, menaxherët kanë vlerësuar se teknologjia e informacionit dhe komunikimit në përgjithësi por dhe

aplikacioni në veçanti, janë faktor i rëndësishëm në rritjen e efijencës së bizneseve dhe uljen e shpenzimeve. Duke parë tendencën e zhvillimeve dhe ndikimin që gjithnjë e më shumë po fiton TIK te bizneset, në të ardhmen pasurimi i aplikacionit me module të tjera do të rris edhe më shumë përfitimet për bizneset në zonë.




Figura 45 . Shpenzime te integruara dhe jo te integruara për pesë biznese

Integrimi në të ardhmen edhe i shpenzimeve të tjera në këtë aplikacion, do të ishte një vlerë e shtuar për bizneset në parkun industrial në Drenas. Janë shumë shpenzime të tjera të cilat në të ardhmen janë projektuar që të integrohen si:

- Shpenzimet e transportit të punëtorëve (sepse në këtë park ka të punësuar jo vetëm nga ai region, por edhe nga vendbanime më të largëta);
- Shpenzimet për trajnime të punëtorëve;
- Shpenzimet për konsulencë etj.

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Përfundimet

Në epokën e ndryshimeve të mëdha siç është kjo e ditëve tona, dinamika e ndryshimeve në menaxhimin e programeve është shumë e shpejtë. Në këtë kontest mund të themi se edhe zonat ekonomike janë bërë pjesë e rëndësishme e programeve zhvillimore shtetërore, rajonale dhe ndërkombëtare. Në tregtinë ndërkombëtare ende nuk është kristalizuar një prototip model i zonës së lirë të cilin do të duhej t'a aplikojnë të gjitha vendet. Gjatë ndërtimit të modelit të zonës së lirë të një vendi, duhet analizuar shumë faktorë rrethanorë, por mbi të gjitha zona duhet tu përshtatet kërkesave të tregut vendor por edhe atij regjional e ndërkombëtarë. Në këto kushte, disa prej vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë prezantuar zonat e lira ekonomike me qëllim tërheqjen e investitorëve dhe promovimin e ekonomisë së tyre. Në këtë vazhdimësi të arsyeshmërisë, qeveritë e vendeve të BE, por edhe ato të rajonit po hartojnë politikat e tyre ekonomike në funksion të tërheqjes së IHD-ve. E sigurisht që në këtë kuadër, zonat e lira ekonomike paraqesin një mjet efikas në axhendën e politikave të një qeverie për nxitjen e zhvillimit ekonomik vendas dhe tërheqjen e investitorëve në kërkim të një mjedisi të favorshëm për të zhvilluar biznes. Zonat ekonomike dhe parqet industriale zhvillojnë dhe promovojnë bashkëpunimin ndërmjet investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm, institucioneve arsimore, shkencore etj., si dhe kontribuojnë në bashkëpunimin në mes të investitorëve dhe mjedisit në tërësi.

Përkundër angazhimeve të deritanishme, Kosova ka ende rrugë për të bërë në plotësimin e kushteve për krijimin, funksionimin dhe financimin e zonave ekonomike, si instrument i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik. Rezultatet indikative të fituara nga hulumtimi im, tregojnë se zonat ekonomike në Kosovë janë ende në stadin e kompletimit të infrastrukturës së nevojshme, qoftë ajo teknike apo ligjore. Në zonat ekonomike në Kosovë më së shumti ka biznese të cilat hyjnë në kategorinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ku investimet, por edhe numri i të punësuarve është i ulët. Vlerësoj se rezultatet e këtij studimi do të jenë të dobishme jo vetëm për menaxherët e NVM-ve, por edhe për organet vendimmarrëse përgjegjëse të zonave ekonomike, që kanë arsye për të qenë të shqetësuar për gjendjen e NVM-ve.

Investimet e huaja direkte jo vetëm që janë prioritet strategjik për vet themelimin e zonave, por ato vijnë të mbeten një prioritet parësor në strategjinë e zhvillimit afatgjatë të Kosovës. Argumentet e ofruara në konkluzionet e shumë studimeve akademike me fokus ndikimin e politikave në tërheqjen e investimeve të huaja, vënë në pah nivelin e ulët të taksave dhe ndikimin pozitiv relativ në këtë aspekt, si dhe uljen e shpenzimeve gjatë aktiviteteve të bizneseve në zona dhe parqe ekonomike. Përmes aplikacionit që kam zhvilluar për integrimin e shpenzimeve në zona ekonomike, kam synuar që të ulët kostoja e shpenzimeve dhe njëkohësisht të profesionalizohen shërbimet. Ky aplikacion i testuar në parkun industrial të Drenasit do të përmirësonte efikasitetin dhe do të gjeneronte kursime duke ulur kostot e shpenzimeve. Kjo diferencë në mes të shpenzimeve të paintegruara dhe shpenzimeve të integruara mund të përdoret për investime në sektorë të ndryshëm ose aty ku menaxherët në planifikimet e tyre strategjike mendojnë se kanë më së shumti nevojë. Ky aplikacion nuk duhet parë vetëm si një sistem për ulje të shpenzimeve, por në të njëjtën

kohë edhe si mekanizëm për profesionalizim e shërbimeve dhe si tendencë kah standardet bashkëkohore të menaxhimit.

Ky punim, veç të tjerash kishte për qëllim analizimin e mjedisit kosovar dhe sfidat me të cilat po përballen ZE, si dhe uljen e shpenzimeve në këto zona përmes ngritjes dhe zhvillimit të një aplikacioni për integrimin e disa shpenzimeve. Për të realizuar qëllimin mbi këtë punim u ngritën pyetjet kërkimore: Cili është efektiviteti i zonave ekonomike në Kosovë dhe a mund të përdoret teknologjia e informacionit në rritjen e efikasitetit dhe uljen e shpenzimeve të përbashkëta të bizneseve në zonat ekonomike (shpenzimet e kontabilitetit, IT-së, mirëmbajtjes, sigurimit, marketingut etj.)?

Rezultatet e hulumtimit tim vërtetuan hipotezën e dytë dhe pjesërisht hipotezën e parë se: Zonat ekonomike në Kosovë kanë krijuar mundësinë për të rritur investimet e huaja direkte, futjen e teknologjive të reja dhe hapjen e vendeve të reja të punës, por që kjo mundësi nuk është shfrytëzuar mjaftueshëm. Po ashtu rezultatet e hulumtimit vërtetuan plotësisht hipotezën se aplikacioni i zhvilluar për integrimin e shpenzimeve do të ndikoj në uljen e kostos së shpenzimeve të bizneseve në zona ekonomike.

6.2 Konkluzionet

Kosova, përkundër shumë sfidave ka hedhur disa hapa të rëndësishëm për të hyrë në një epokë të re të zhvillimit ekonomik. Në këtë drejtim është në kërkim të identifikimit të modeleve më të sukseshme të zonave ekonomike nga vendet e ndryshme dhe faktorët që kanë kontribuar në suksesin e tyre.

Nga studimi i realizuar mund të nxjerrim këto konkluzione:

- Për suksesin afatgjatë të konceptit zonë ekonomike apo park industrial në Kosovë, është e nevojshme për të përcaktuar saktësisht llojin, objektivat dhe kahet e zhvillimit të zonave të lira. Krijimi i një mjedisi të efektshëm apo përmirësimi i rrethit biznesor përmes stimulave të ndryshëm, rrit aftësinë për të tërhequr investime.
- Karakteristikat socio-ekonomike të Republikës së Kosovës i referohen dy tendencave kontraktore. Nga njëra anë, ka rajone dhe zona me infrastrukturë të zhvilluar, nga ana tjetër ka rajone të pazhvilluara, pa nivelin e kënaqshëm të infrastrukturës për themelimin apo zhvillimin e një zone. Vendndodhja e zonave ekonomike të jetë në përputhje me strukturën ekonomike të rajonit dhe mundësitë e zhvillimit. Disponueshmëria e hapësirës brenda zonës të jetë e mjaftueshme pasi është një parakusht në përpjekje për të tërhequr dhe të zgjeruar investimet. Nga intervistat e zhvilluara me menaxherët e zonës ekonomike në Ferizaj, për shembull, disa prej tyre janë të pakënaqur me sipërfaqen që ju është ndarë, të cilën e konsiderojnë të pamjaftueshme për zhvillimin e bizneseve të tyre.
- Mbështetja për konceptin e zonave të lira po rritet në mbarë botën. Një numër i madh i vendeve dhe kompanive multinationale njohin interesat e tyre në themelimin dhe funksionimin e formave të ndryshme të zonave të lira me profile të larmishme. Numri i zonave të lira ka pësuar rritje të shpejtë sidomos në njëzet vitet e fundit. Kur investimet e huaja direkte në botë regjistruan një rënie (2003/2004) në vendet me një rrjet të zhvilluar të zonave të lira, këto investime shënuan rritje si në Hungari, Poloni, Turqi, etj.).

- Raporti i zonave të lira të cilat aktualisht funksionojnë, tregon se ende nevojiten shumë punë për përmbushjen e kërkesave dhe standardeve të vendeve anëtare të OBT-së. Kjo organizatë nuk parandalon stimulime rajonale, dhe në këtë drejtim, Kosova mund të shfrytëzoj disa përparësi duke bërë kombinimin e përfitimeve të zonave konvencionale, komerciale të lira, të tilla si: shkallë zero për detyrime të importit, ndërtimi i objekteve në parqe, ndërtimi i objekteve për inkubatorë dhe përdorimi i tokës të përjashtohen nga të gjitha taksat e autoriteteve qendrore dhe lokale.
- Zonat e lira, si institut ekonomik legal janë të rëndësishme për vendin pritës, përveç arsyeve të mësipërme edhe për shkak se ato kontribuojnë jo vetëm në zonat ekonomike të lokalitetit, por ndikimi i tyre pasqyrohet edhe në ngritjen e të ardhurave në rritje valutore nga eksporti i produkteve të ndërmarrjeve që veprojnë në zonën e lirë dhe punësimin e fuqisë punëtore lokale. Po ashtu ato kontribuojnë edhe në zhvillimin e infrastrukturës, ndërtimin e rrugëve dhe lidhjeve me rrethina të zonës së lirë.
- Investimet e diasporës mund të jenë një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe zhvillimin ekonomik si dhe për investime në zona. Shembujt e suksesshëm të kthimit të diasporës në disa shtete pasqyrojnë ndikimin real dhe potencial të këtyre investimeve. Ekonomitë e reja të migracionit kanë ndryshuar praktikat tradicionale të investimeve të huaja, sepse shumë prej investitorëve të sotëm kanë jo vetëm stimuj ekonomik për investime kapitale, por kanë edhe një ndjenjë të caktuar qoftë

personale apo nostalgjike, kulturore apo kombëtare për investime në vendin e origjinës.

- Zonat e lira nuk janë vetëm një instrument për përdorimin e përfitimeve tatimore dhe koncesioneve tarifore, por ato gjithashtu përfshijnë mekanizmin e zhvillimit të politikave dhe procedurave ekonomike. Si institucion, zona e lirë përfshinë proceset që tërheqin dhe mbajnë investitorët nën kushtet e favorshme për zhvillimin e tyre, instalimin e programeve industriale, futjen e teknologjive të reja dhe për të arritur fitime më të larta.
- Matja apo vlerësimi i efikasitetit të zonave gjithashtu është një segment i rëndësishëm. Në këtë drejtim Kosova duhet të themelojë një agjension i cili do të monitoronte zhvillimin e zonave ekonomike dhe do të identifikonte sfidat në rrugëtimin e tyre.
- Zonat e lira të cilat veprojnë në territorin ekonomik të një vendi, duhet të jenë pjesë integrale e një strategjie të përgjithshme e cila çon në reforma të mëtijshme ekonomike. Kjo qasje parasheh që zona ekonomike duhet të ketë një hapësirë të kufizuar, duke humbur rëndësinë e saj kur vendet të orientohen në tregun global për të arritur parametrat e projektuar makroekonomike.

6.3 Rekomandimet

Bazuar në gjendjen në të cilën ndodhen zonat ekonomike në Kosovë, kërkohet përkushtim më i madh i qeverisë, i këshillit kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike, i agjensionit

për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe i të gjithë akterëve për krijimin e kushteve më të favorshme për formimin e zonave ekonomike, zhvillimin, promovimin e tyre dhe orientimin e të gjitha kapaciteteve në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit. Programi i zonave ekonomike në Kosovë duhet të fokusohet në nxitjen e sektorëve me rëndësi për zhvillimin e integruar ekonomik, ku faktori i produktivitetit njerëzor është më i lartë, me qëllim që të maksimizojë impaktin pozitiv ekonomik në një periudhë më afatgjate. Kosova ka mundësi të marrë mësim nga evoluimi i zonave ekonomike dhe nga historitë e sukseseve në zonat ekonomike të vendeve të rajonit apo të vendeve të BE.

Nga rezultatet e fituara mund të thuhet se Kosova ka siguruar një bazë ligjore për themelimin e zonave ekonomike, ka identifikuar ndikimin e ZE në zhvillimin ekonomik lokal, mirëpo duhet ende të punohet në reformimin e politikave fiskale për bizneset të cilat operojnë brenda zonave ekonomike. Gjithësesi rezultatet do të jenë më të kënaqshme nëse edhe kompanitë ndryshojnë qasjen e tyre. Ndërmarrjet kosovare duhet të bëhen pjesë e komunitetit të gjerë, të përfshihen në erën e re të virtualizimit të ekonomisë dhe teknologjisë bashkëkohore duke u bërë konkurruese, së pari në tregun rajonal, e pastaj edhe në tregun global.

Në kuadër të gjetjeve dhe hulumtimit të kryer mund të rekomandojmë:

- Përmirësimin e klimës së përgjithshme të investimeve dhe promovimi i Kosovës si vend i sigurt për investime në zona ekonomike,
- Zonat e lira ekonomike në Kosovë duhet konsideruar si një instrument i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke siguruar fluksin e investimeve të huaja direkte, futjen e teknologjive të reja dhe krijimin e vendeve të reja të punës si faktor

shumë i rëndësishëm për vendet me nivel të lartë të papunësisë siç është Kosova. Nga rezultatet e hulumtimit u vërtetua se nuk janë përmbushur pritshmëritë lidhur me punësimin në zonat ekonomike në Kosovë,

- Të ndërtohen kritere gjithëpërfshirëse dhe parime të qëndrueshme mbi të cilat do të bazohet politika e re fiskale për ZE në Kosovë. Të bëhet ulja e barrës fiskale dhe të rriten stimulimet për bizneset në zona-parqe; lirimi nga tatimi në pronë për një vit apo më shumë për bizneset fillestare në zona; lirimi nga qeraja e investitorëve të huaj apo vendas deri në fillim të aktivitetit biznesor; përjashtim ose shtyrje e pagesës së TVSH-së ose rimbursim i shpejtë i TVSH-së etj. Politikat fiskale, siç u vërtetua edhe në hulumtim nuk janë mjaftueshëm të favorshme, prandaj ato duhet ndryshuar, apo rishikuar,
- Integrimi dhe dixhitalizimi i shpenzimeve por edhe i shërbimeve, në dekadën e fundit është një tendencë në vendet e zhvilluara. Këtë tendencë duhet ta ndjek edhe Kosova në rrugëtimin e saj drejtë zhvillimit të zonave ekonomike,
- Të filloj sa më shpejtë aplikimi i programit të zhvilluar për integrimin e shpenzimeve në zona dhe në të ardhmen të shqyrtohen mundësitë për pasurimin e tij duke integruar edhe shpenzimet e tjera,
- Ti jepet rëndësi më e madhe marketingut dhe promovimit të zonave ekonomike. Bizneset në ZE nuk janë mjaftueshëm të virtualizuara. Transformimi nga marketingu tradicional në marketingun virtual do të jetë njëra ndër sfidat e radhës për këto biznese,

- Të themelohet një agjension i cili në mënyrë periodike do të monitoronte zhvillimin e zonave ekonomike, do të identifikonte sfidat me të cilat do të përballen këto zona në Kosovë dhe do të rekomandonte standarde të cilat janë të krahasueshme me zonat ekonomike në regjion, e në perspektivë edhe me zonat në vendet e BE-së.

Hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse për zhvillimin e zonave dhe parqeve ekonomike duhet të jetë një nga objektivat kyçe të programeve zhvillimore qeveritare në të ardhmen. Mbetet për tu parë në vitet në vijim nëse zonat ekonomike janë një mjedis i favorshëm i mundësive për të bërë biznes të suksesshëm dhe a do të rrisin këto zona ekonomike konkurrueshmërin e ekonomisë kosovare në kontekst rajonal apo dhe më gjerë.

LITERATURA:

1. Aggarwal, A. (2005). Performance of export processing zones: a comparative analysis of India, Sri Lanka and Bangladesh. *Indian Council for Research on International Economic Relations*, 155, 10-13.
2. Al-Mubarak, H. M., & Busler, M. (2013). The effect of business incubation in developing countries. *European Journal of Business and Innovation Research*, 1(1), 19-25.
3. Akinci, G., & Crittle, J. (2008). *Special economic zone : Performance, lessons learned, and implication for zone development*. Foreign Investment Advisory Service (FIAS) occasional paper. Washington, DC: World Bank.
4. Asakura, H. (2003). *World history of the customs and tariffs*. World Customs Organization.
5. Barry, F. (2002). Foreign direct investment, infrastructure and the welfare effects of labour migration. *The Manchester School*, 70(3), 364-379.
6. Burani, M. (2016). The Role of Economic Zones and their Potential to Attract Diaspora Investment in Kosovo.
7. Cheesman, A. (2012). *Special Economic Zones & Development: Geography and Linkages in the Indian EOU Scheme*. Development Planning Unit, University College London.
8. David I. Cleland, *Project Management: Strategic Design and Implementation* 2nd ed (Singapore: McGraw-Hill, Inc, 1994), 4.

9. Dodescu, A., & Chirila, L. (2012). Industrial Parks in Romania: From Success Stories to Emerging Challenges. *International Journal of e-Education, e-Business, e-Management and e-Learning*, 2(4), 331.
10. Engman, M., Onodera, O., & Pinali, E. (2007). *Export processing zones: Past and future role in trade and development* (No. 53). OECD Publishing.
11. Falcke, C. O. (1999). Industrial Parks Principles and Practice. *Journal of economic cooperation among Islamic countries*, 20 (1), 1-19.
12. Farole, T. (2011). *Special economic zones in Africa: comparing performance and learning from global experiences*. World Bank Publications.
13. Farole, T., & Akinci, G. (Eds.). (2011). *Special economic zones: progress, emerging challenges, and future directions*. World Bank Publications.
14. Farole, T., & Kweka, J. (2011). Institutional best practices for special economic zones: An application to Tanzania. *Washington: The World Bank*.
15. FIAS, 2008. "Special Economic Zones: Performance, Lessons Learned, and Implications for Zone development". The Multi-Donor Investment Climate Advisory Service of the World Bank Group. Washington, DC.
16. Goldstein, H. (2009). "Theory and practice of technology-based economic development." *Theories of Local Economic Development: Linking Theory to Practice* (2009): 237-264.
17. Gordon, I. R., & McCann, P. (2000). Industrial clusters: complexes, agglomeration and/or social networks?. *Urban studies*, 37(3), 513-532.
18. Grubel, H. G. (1982). Towards a theory of free economic zones. *Weltwirtschaftliches Archiv*, 118(1), 39-61.

19. Johansson, H., & Nilsson, L. (1997). Export processing zones as catalysts. *World Development*, 25(12), 2115-2128.
20. Ketels, C. H., & Memedovic, O. (2008). From clusters to cluster-based economic development. *International journal of technological learning, innovation and development*, 1(3), 375-392.
21. Kerzner, H. R. (2013). *Project management: a systems approach to planning, scheduling, and controlling*. John Wiley & Sons.
22. Kuznetsov, A. (1993). Promotion of foreign investment in Russia: An evaluation of free economic zones as a policy instrument. *Russian & East European Finance and Trade*, 29(4), 43-65.
23. Kolberg, J., Pani, S., Bejakovic, P., Ymeraj, A., & Kasimati, M. (2003). Reducing Social Exclusion Through the Mechanism of Social Assistance Albania. *Center for Economic Research and Graduate Education and the Economics Institute (CERGEI), Prague, [on line], available at < <http://www.gdnet.org/middle.php>*.
24. Krasniqi, A. (2016). Legal or business personality of the commercial companies according to business law in Kosovo.
25. Litwack, J. M., & Qian, Y. (1998). Balanced or unbalanced development: special economic zones as catalysts for transition. *Journal of Comparative Economics*, 26(1), 117-141.
26. Marshall, A. (1920). *Principles of economics: an introductory volume*.
27. Meng, G. (2003). *The theory and practice of free economic zones: A case study of Tianjin, People's Republic of China* (Doctoral dissertation).

28. McCalla, R. J. (1990). The geographical spread of free zones associated with ports. *Geoforum*, 21(1), 121-134.
29. Muceku, H., & Muça, A. (2014). Informal Economy In Albania—Its Costs in the Country Development. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 5(9), 642.
30. Mustafa, M., & Gashi, P. (2006). Biznesi i vogël dhe i mesëm. *Prishtinë, Kosovë*.
31. O'Flaherty, D. D. (2008). *Understanding dynamic linkages and technology spillover from Korea's Masan Free Export Zone* (Doctoral dissertation, University of Ottawa (Canada)).
32. O'Sullivan, E., Andreoni, A., López-Gómez, C., & Gregory, M. (2013). What is new in the new industrial policy? A manufacturing systems perspective. *Oxford Review of Economic Policy*, 29(2), 432-462.
33. Peddle, M. T. (1993). Planned industrial and commercial developments in the United States: a review of the history, literature, and empirical evidence regarding industrial parks and research parks. *Economic Development Quarterly*, 7(1), 107-124.
34. Pere, E. (2013, June). Economic trade relation in focus of regional integration of West Balkans Countries. International Conference on Balkan Studies.
35. Pere, E., & Hashorva, A. (2011). Tax systems in west balkans countries¹-between simplicity and efficiency. *Romanian Economic and Business Review*, 6(2), 80.
36. Phan, P. H., & Lamine, S. A. M. (Eds.). (2016). *Technology entrepreneurship and business incubation: Theory, practice, lessons learned*. World Scientific.
37. Porter, M. E. (1998). Clusters and Competition. New Agenda for Companies. In *Governments and Institutions*, in: *Ibid.*, *On Competition*.

38. Porter, M. E. (1990). The competitive advantage of nations.
39. Porter, M. (2003). The economic performance of regions. *Regional studies*, 37(6-7), 549-578.
40. Razaq, A. (2014). Chinese investors to establish power plant, four additional factories in Ogun-Guangdong FTZ. *Businessday*, February, 19.
41. Rolfe, R. J. (1991). The Challenge of Free Economic Zones in Central and Eastern Europe International Perspectives. *Journal of International Business Studies*, 22(3), 531-532.
42. Saleman, Y., & Jordan, L. (2015). The implementation of industrial parks: some lessons learned in India. *Journal of International Commerce, Economics and Policy*, 6(01), 1550005.
43. Saydikaharov, O. (2012). *Location Determinants of Foreign Firms in Poland: The Role of Special Economic Zones* (Doctoral dissertation, Central European University).
44. Schmitz, H., & Musyck, B. (1994). Industrial districts in Europe: policy lessons for developing countries?. *World development*, 22(6), 889-910.
45. Sekaran, U., & Bougie, R. (2011). Research method for business: A skill building approach.
46. Sujie, F., & Guangzhong, W. (1993). "World Free Economic Zone". *Shijie Ziyu Jingjiqiu*, People's Publishing House, Beijing.
47. Sunkara, R. (2016). The study of free trade zone policy in India: A make in India initiative. *EXCEL International Journal of Multidisciplinary Management Studies*, 6(2), 10-18.

48. Shao, L., Zilibotti, F., & Alder, S. (2013). The Effect of Economic Reform and Industrial Policy in a Panel of Chinese Cities. In *2013 Meeting Papers* (No. 1309). Society for Economic Dynamics.
49. Shaorshadze, I., & Miyata, S. (2010, December). Foreign remittances and poverty reduction in Kosovo. In *Conference Western Balkans-Poverty and Inclusion*.
50. Targosz, E. (2016). Informality and the Institutional Change in Kosovo. *OnEuropean Integration 2016*, 1005.
51. Torres, R. A. (2007). Free Zones and the WTO agreement on subsidies and countervailing measures. *Global Trade and Customs Journal*, 2(5).
52. Totoni, A., & Qefalia, A. (2013, July). Industrial parks in the balkans and their performance in competitiveness growth and FDI's attraction. International Balkan Annual Conference.
53. Thomas, F. & Gokhan, A. (2011). *Special economic zones : progress, emerging challenges, and future directions*. Directions in development ; trade. Washington, DC: World Bank.
54. Thoman, R. S. (1956). *Free ports and foreign-trade zones*. Cornell Maritime Pr/Tidewater Pub.
55. UNIDO. (1997). *Industrial Estates: Principles and Practices*. Vienna: UNIDO
56. UNIDO. (2002). *Industrial Development Report 2002-2003*. Vienna: UNIDO
57. UNIDO. (2013), *The Industrial Competitiveness of Nations*, Industrial Competitiveness Report. Vienna:UNIDO
58. Wang, J. (2013). The economic impact of special economic zones: Evidence from Chinese municipalities. *Journal of development economics*, 101, 133-147.

59. Xiangming Chen (1995), "The Evolution of the Free Economic Zones and the Recent Development of Cross-National Growth Zones", In: "International Journal of Urban and Regional Research", Vol. 19, p. 593, explanation
60. Zeng, D. Z. Special Economic Zones: Lessons from the Global Experience.
61. Zeng, D. Z. (2011). Building Engines for Growth and Competitiveness in China: Experience with Special Economic Zones and Industrial Clusters. Washington, DC, World Bank
62. Zhiping, Z., & Jizi, L. (2012). Research on the Combination Mechanism of Cluster Supply Chain and Eco-industrial Park [J]. In Forum on Science and Technology in China (Vol. 5, p. 026).

Burime të tjera

1. Askarov, Z., & Doucouliagos, H. (2015). Aid and Institutions in Transition Economies. *European Journal of Political Economy* , 38, 55-70.
2. Banka Qendrore e Kosovës, (2014)
3. Castells, M. (2014). Technopoles e botës: Bërja e komplekseve industriale të shekullit të 21. Routledge.
4. Civici, A., Ibrahim, F., & Manxhari, M. (2010). Modeli ekonomik " post-tranzicion" dhe lloji i kapitalizmit që duam të ndërtojmë. *Albanian Journal of Natural & Technical Sciences*, 29(3).
5. Europen Commision, TAXTION AND CUSTOMS UNION, List of free zones.
6. Field A., (2005), Discovering Statistics using SPSS, SAGE publications.
7. GAP, Analize politikash, 2012 , Prishtine faqe 13
8. Industrial Destinations Hungary 2014, f.18
9. Ligji Nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike
10. Ligji Nr. 03/L-129 për Zonat Ekonomike
11. Ligji Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike
12. Ligji për mbështetje ndërmarrjeve të vogla e të mesme Nr.02/L-5
13. Ligji Nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 02/l-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme
14. Ligji për mbështetje ndërmarrjeve të vogla e të mesme Nr.02/L-5
15. Ligji Nr. 03/L-031 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 02/l-5 për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

16. Ministry of Economy and Transport, 2003
17. Pakdeenurit, P., Suthikarnnarunai, N., & Rattanawong, W. (2014). Special Economic Zone: Facts, roles, and opportunities of investment. *Lecture Notes in Engineering and Computer Science*, 2210.
18. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis, 2008.
19. Prikhodko, S., Volovik, N., Hecht, A., Sharpe, B., & Mandres, M. (2007). Special economic zones. *Consortium for Economic Policy Research and Advice. Moscow, IET.*
20. Plani Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2013-2030, Bashkia Lezhë
21. Polish Information and Foreign Investment Agency (PAIiIZ), Why Poland?, Edition 2011.
22. Politika Qendrore Evropiane Rajonale dhe Gjeografia Njerëzore, Viti III, nr.2, 2013, f.19.
23. Programi për menaxhimin e zonave ekonomike, Prishtinë 2011
24. Ymeraj, A. (1999). The role of Social Protection to social exclusion and social capital. *Robert MacNamara Fellowship Program.*
25. Vajjhala, N. R., & Vucetic, J. (2013). Key Barriers to Knowledge Sharing in Medium-Sized Enterprises in Transition Economies . *International Journal of Business and Science* , 90-98.

Konferenca shkencore, revista dhe publikime

1. MsC Agim DERGUTI, PhD candidate: *Management of the Industrial Park in Kosovo*, European Academic Research, Rumani, April 2014 Vol. II , Issue 1, **Impact Factor: 0.485** (GIF); **3.1** (UIF). **ISSN 2286-4822**, (Print); electronic 1361-1370.

<http://euacademic.org/UploadArticle/457.pdf>

2. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Zonat e lira ekonomike - mundësi investimi për diasporën*, Instituti i Financave i Kosovës – IFK, Konferenca e dymbëdhjetë Ndërkombëtare, Kontributi i diasporës dhe i investimeve të jashtme në zhvillimin e ekonomisë, biznesit dhe rritjes së punësimit në Kosovë dhe vende tjera botërore, Prishtinë, Kosovë, 2013. **ISBN 978-9954-567-04-6**.

3. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The impact of free economic zones in the economic development of the country*, 2nd International Conference, Regional Challenges for the Sustainable Development, Elbasan, Shqipëri, 2013. **ISBN 976-9926-115-30-0**.

<http://uniel.edu.al/materiale/CP.pdf>

4. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): - *Management of Investment Projects in Kosovo - Differences with European Standards*, Menaxhimi i resurseve ekonomike në funksion të zhvillimit të vendeve në tranzicion, Prishtinë, Kosovë, 2013. **ISBN 978-9951-492-07-2**

<http://www.pjeterbudi.com/docs/Abstraktet.pdf>

5. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Infrastruktura turistike në Kosovë*, Konferenca e Parë Shkencore Ndërkombëtare, Trendet në zhvillimin e turizmit dhe hotelërisë, Revista shkencore Vol.5/2012 “**Logos**” Prishtinë, Kosovë, 2012.

6. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *“Përmirësimi i rrethinës biznesore, sfidë për tërheqjen e investime të huaja dhe për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik”*, Qendra për hulumtime ekonomike, Konferencën e pestë shkencore ndërkombëtare, Investimet në funksion të zhvillimit ekonomik dhe proceset integruese, Ulqin, Mali i Zi, 2013. **ISSN 1800-9794.**
http://www.ekonomskiinstitut.com/publikime/agjenda_konferenca_pestë_v.pdf

7. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Funksioni shumëdimensional i ndërtimit të autostradës Durrës-Morinë-Prishtinë-Merdare*, Konferencë Shkencore Ndërkombëtare Ndërdisciplinore, Identiteti, imazhi dhe kohezioni social në epokën e integritimeve dhe globalizimit, Vlorë, Shqipëri, 2012. **ISBN 978-9925-4000-2-4**

8. MsC Lulzim SHABANI, PhD (c) Agim DERGUTI, PhD (c): *Analysis of strategy for E-Government 2009 - 2015, dynamics of development, comparisons with other regional strategies, conclusions and recommendations*, ICCSIS Emerging Information Technology and Telecommunication Solutions, Prishtinë, Kosovë, 2012. **ISSN 66488** , Bashkëautor.
<http://eitts.ubt-uni.net/Conference-Agenda.pdf>

9. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Roli i parqeve industriale në mobilizimin e investimeve vendore*, DSSH/ASD Ditët e Studimeve Shqiptare, International Scientific Conference, Tiranë, Shqipëri, 2014.

10. Agim Derguti, PhD (c), MSc Lulzim Shabani, PHD (c): *The impact of electronic business on the development of small and medium enterprises in the Republic of Kosovo*, Progressive Academic Publishing, Britani e Madhe, Volume 3 Nr. 4, 2015, (Print); elektronik 1-13. **ISSN 2056-6018.**

<http://www.idpublications.org/wp-content/uploads/2015/05/the-impact-of-electronic-business-on-the-development-of-small-and-medium-enterprises-in-the-republic-of-kosovo.pdf>

11. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Parqet industriale - evoluimi dhe ndikimi i tyre në punësim*, Konferenca e IV shkencore ndërkombëtare, “Economic Development as a basis to generate new jobs”, Prishtinë , maj 2015. **ISBN 978-9951-492-10-2.**

12. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Economic zones in Kosovo - performance and its role in the promotion of investment*, Fifth international scientific and applicative conference, Knowledge – who and what, Bansko, Bullgari, 2015. **ISSN 1857-92.**

13. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Small and medium enterprises incentive of industrial clusters in Kosovo*, International Conference on Sustainable Development, 3rd ICSD 2015, 6 June 2015 Rome, Italy, **ISSN 2239-5938.**

<http://www.ecsdev.org/images/conference/ICSD2015/3ICSD%206%20June%20Program.pdf>

14. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The impact of industrial parks in local economic development*, International 4th International Multidisciplinary Conference “Integrating Science In New Global Challenges”, ICTEA 2015 University of Dubrovnik, Croatia 27-29 March 2015

ISBN 978-99288-4221-5-6.

15. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The management of the projects with MS Project*, European International Virtual Congress of Researchers (EIVCR) 2015, EIVCR 2015 is a multidisciplinary conference organized by Progressive Academic Publishing, UK and IGoAR, in Birmingham, England, UK, EU. **ISSN 2059-2752.**

<http://www.idpublications.org/wp-content/uploads/2015/05/THE-MANAGEMENT-OF-THE-PROJECTS-WITH-MS-PROJECT.pdf>

16. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The Importance of locations in the industrial parks - Ferizaj case study*, International Conference Economy and Business, 1-5 September 2014 in Elenite, Bulgaria. Volume 8, 2014. **ISSN 1314-7242**

<http://www.scientific-publications.net/get/1000007/1409340809559721.pdf>

17. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The process of investment project management – comparisons between Kosovo and Albania*, 1st International Scientific Conference, “CORPORATE ALBANIA – The Past, the Present and the Future”, Tiranë, Shqipëri, 2012.

18. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Types of economic zones and their impact on the economic development of Kosovo*, Proceedings QUAESTI (QUAESTI - Virtual Multidisciplinary Conference), DOI: 10.18638/quaesti.2015.3.1.253.

ISBN:978-80-554-1170-5, ISSN: 2453-7144, vol. 3,issue 1,pp. 37 - 41, 2015.

<http://www.quaesti.com/archive/?vid=1&aid=2&kid=160301-253>

19. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Economic zones in the western Balkans and their challenges*, International Masaryk Conference for P.h.D. Students and Young Researchers 2015, Proceedings MMK 2015, Volume VI.December 14 - 18, 2015, Hradec Králové, The Czech Republic. **ISBN 978-80-87952-12-2**

www.vedeckekonference.cz/library/proceedings/mmk_2015.pdf

20. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *Management practices in public institutions of the republic of Kosovo and the challenges of the project manager*, 5th International Scientific

Conference for PhD students of EU countries, CER Comparative European Research 2016, March 28-31, 2016, London. Vol. 3, Issue 1. **ISBN 978-0-9928772-9-3**

http://www.sciemcee.org/library/proceedings/cer/cer2016_proceedings01.pdf

21. MsC Agim DERGUTI, PhD (c): *The art of planning and its impact on project management*, Journal of European Academic Research, March 20, 2017, Czech Republic. Vol. 3. (**Impact factor: 2.415 / ISSN: 1387-3821**)

http://www.jear-eu.com/Articles/4/Images/24-03-2017/555697_JEAR_3rd_EDITION.pdf

The world's first multidisciplinary Open Access Journal and Conference, March 20, 2017, Czech Republic. (**Impact Factor: 2.415 / ISBN 1387-3812**)

http://www.jear-eu.com/Articles/3/Images/08-01-2017/847205_1_Agim_Derguti.pdf

SHTOJCA

Pyetësi

Të nderuar!

Përpara jush keni një pyetësor me disa pyetje. Përgjigjet tuaja do të jenë kontribut i rëndësishëm për mua në këtë hulumtim shkencor.

1. Gjinia ?

a) M ☐

b) F ☐

2. Mosha juaj ?

a) < 20 ☐

b) 21 – 30 ☐

c) 31 – 40 ☐

d) 41 – 50 ☐

f) > 50 ☐

3. Vendbanimi juaj ?

a) Qytet _____ ☐

b) Fshat _____ ☐

4. Si do ta përshkruani profesionin tuaj?

a) Punëtor i (pa) kualifikuar ☐

b) Zyrtar ☐

- c) Menaxher ☐
- d) Student ☐
- e) Profesion i lirë (avokat, mjek etj.) ☐
- f) Shërbyes qeveritar ☐
- g) Të tjerë ☐

5. Vlerësoni angazhimin e institucioneve përkatëse në mbështetjen e ZE ?

- a) Dobët ☐
- b) Mjaftueshëm ☐
- c) Mirë ☐
- d) Shumë mirë ☐
- e) Shkëlqyeshëm ☐

6. Opinioni i juaj lidhur me politikat fiskale për zonat ekonomike?

- a) Të pafavorshme ☐
- b) Të favorshme ☐
- c) Duhet ndryshuar ☐

7. Opinioni i juaj lidhur me kuadrin ligjor për zonat ekonomike?

- a) I pafavorshëm ☐
- b) I favorshëm ☐
- c) Duhet ndryshuar ☐

8. Mendimi i juaj për lokacionet e zgjedhura për zona ekonomike?

- a) Janë zgjedhur shumë mirë ☐
- b) Nuk janë zgjedhur mirë ☐
- c) Nuk janë të qëlluara ☐

9. Si e vlerësoni infrastrukturën fizike në zonat ekonomike në Kosovë?

- a) Lë shumë për të dëshiruar ☐
- b) E mirë ☐
- c) Shumë e mirë ☐

10. Cilët sipas jush cilët janë faktorët më të rëndësishëm në zgjedhjen e lokacionit për ZE?

- a) Afërsia me autostradën ☐
- b) Afërsia me shtetin fqinj ☐
- c) Afërsia me hekurudhën ☐
- d) Afërsia me kryeqytetin ☐
- e) Të tjera ☐

11. A kanë ndikuar ZE në zhvillimin ekonomik ?

- a) Po ☐
- b) Jo ☐
- c) Kanë pasur ndikim më pak se sa pritshmëritë ☐

12. A ka nevojë Kosova për më shumë zona ekonomike ?

- a) Po ☐
- b) Jo ☐
- c) Pa përgjigje ☐

13. Për çfarë lloje të ZE ka nevojë Kosova?

- a) Parqe të biznesit ☐
- b) Eko-Parqe ☐
- c) Parqe teknologjike ☐

d) Parqe industriale ☐

e) Zona të lira ekonomike ☐

14. Si e vlerësoni në përgjithësi performancën e zonave ekonomike deri më tani?

a) 1 ☐

b) 2 ☐

c) 3 ☐

d) 4 ☐

e) 5 ☐

15. Si e vlerësoni ndikimin e tyre në punësim?

a) 1 ☐

b) 2 ☐

c) 3 ☐

d) 4 ☐

e) 5 ☐

16. Sa janë përmbushur objektivat e synuara për ZE në Drenas?

a) Pjesërisht ☐

b) Kënaqshëm ☐

c) Plotësisht ☐

17. A janë zonat-parqet ekonomike në Kosovë hapësira ku diaspora mund të investoj?

a) Po ☐

b) Po, sepse _____

c) Jo ☐

d) Jo sepse _____

18. Sa janë përmbushur objektivat e qeverisë për zhvillimin e zonave ekonomike?

a) Aspak ☐

b) Pjesërisht ☐

c) Kënaqshëm ☐

d) Plotësisht ☐

19. Në mes të gjendjes së tanishme kur disa nga shpenzimet (shpenzimet e kontabilitetit, IT-së, sigurimit, marketingut, mirëmbajtjes etj.) i paguani individualisht dhe integrimit të këtyre shpenzimeve, cilën do të zgjidhni ?

a) Integrimin e shpenzimeve ☐

b) Të vazhdohet në këtë mënyrë ☐

20. A do të ndikoj aplikacioni në uljen e shpenzimeve?

a) Aspak ☐

b) Fare pak ☐

c) Do të ndikoj kënaqshëm ☐

d) Do të ketë ndikim të madh ☐

21. Cili është niveli i besimit se aplikacioni do të ulë shpenzimet e bizneseve (nga 1-5)?

a) 1 ☐

b) 2 ☐

c) 3 ☐

d) 4 ☐

e) 5 ☐

22. Numëroni përfitimet kryesore nga aplikacioni për integrimin e shpenzimeve në zonë?

- a) Ulja e shpenzimeve ☐
- b) Shërbime më profesionale ☐
- c) Të dyja ☐

23 Shprehur në përqindje, sa mendoni se do të ulen shpenzimet në këto lloje shpenzimesh: të kontabilitetit, IT, mirëmbajtjes, marketingut dhe sigurimit?

- a) Më pak se 10% ☐
- b) 10-30% ☐
- c) 30-40% ☐
- d) Më shumë se 40% ☐

24. Cilat nga këto shpenzime i shihni të integruara më lehtë?

- a) Shpenzimet e kontabilitetit ☐
- b) Shpenzimet e IT ☐
- c) Shpenzimet e mirëmbajtjes ☐
- d) Shpenzimet e sigurimit ☐
- e) Shpenzimet e marketingut ☐
- f) Të gjitha ☐

Ju faleminderit për bashkëpunimin!